




LUFTA E NDIJTË NË SIRI



Tim Anderson



Tim Anderson

LUFTA E NDYTË NË SIRI

Vashingtoni, ndryshimi i dhunshëm i regjimit dhe rezistenca

Përktheu nga bosnjakishtja: Azem Bajrami

ISBN xxxxxxxx



Mbi autorin

Dr. Tim Andersoni është ligjërues i ekonomisë politike në universitetin e Sidnejit në Australi (The university of Sydney). Merret me hulumtimin e zhvillimit të të drejtave dhe vetëvendosjes në Amerikën Latine, me rajonin azio-pacifik dhe me Lindjen e Mesme. Ka botuar një numër të punimeve akademike në publikime të ndryshme dhe në revista shkencore.

Librin e tij më të ri me titull ‘Land and Livelihoods in Popua New Guinea – Toka dhe mirëmbajtja në Papui të Guinesë së RE’ e botoi shtëpia botuese Australian Scholarly Publishing, në Melburn, 2015. Copyright Prof. Tim Anderson, Global Research, 2015. Ky libër është botuar me leje të autorit.

Shënime mbi burimet

Lexuesi i kujdesshëm do të vërejë se kam përdorur një spektër të gjerë të burimeve kryesisht në gjuhën angleze. Këtë e kam bërë jo vetëm pse gjuha angleze është gjuha e ime amtare, por për atë shkak se i kam parasysh lexuesit në gjuhën angleze të cilëve para së gjithash ky libër u dedikohet. Dëshiroj që lexuesit të mund të vijnë gjer te këto burime relevante. Po ashtu jam i vetëdijshëm për paragjykimet e thella të Perëndimit ndaj burimeve ruse, iraniane, siriane dhe latino-amerikane. Nga ndonjë herë duhej shërbyer me përkthime duke ua bashkangjitur disa intervistave nga Siria.

Burimet perëndimore i kam shfrytëzuar aty ku kishte mundësi, dhe atë jo për shkak se ato ishin më të besueshme, por për t’i ikur rrezikut të mos marr kritika për shkak të mbështetjes në burimet pro-siriane. Mediat perëndimore përgjithësisht janë katasrofike kur është në pyetje informimi për luftën në Siri, marr parasysh se janë thellë të lidhur ngushtë me përcaktimin dhe politikën e qeverive të tyre që kanë qëndrime intervencioniste ndaj Sirisë. Mu për këtë argumentet e mia aspak nuk i bazoj duke u mbështetur në burimet perëndimore. Megjithatë, unë i shfrytëzoj në mënyrë që të karakterizoj pozitat dhe për të gjetur pohim dhe pranim kundër interesit të qeverive që sillen në mënyrë agresive ndaj Sirisë. Në fund kam shkruar vërejtje për burimet e posaçme dhe të pavarura.

Mirënjohje dhe falënderim

Dua t'u falënderohem miqve të mi nga Siria, mësuesve të mi që më ndihmuan të mësoj diçka për vendin e tyre dhe kulturën e atij vendi si dhe për përleshjen në vendin e tyre Siri. Këtu nuk kam mundësi t'i numëroj ata të cilët kanë shpenzuar kohë për të biseduar me mua, andaj do t'i përmendi vetëm disa miq të mi të mirë, Renin, Ilhamin, Jasminin, Ahmedin, Meramin, Hanadin, Thaniun, Favazin, Mahirin, Liadin, Samirin, Mazinin, Renain, Afrain dhe Muhamedin.

Gjithashtu duhet t'u shpreh falënderim dy shkencëtarëve të mëdhenj nga Siria për mësimet dhe lekcionet që m'i afruan. I falenderohem rahmetli shejh Muhamed Seid Ramadan el- Butij.

Shpreh respekt të madh ndaj marrëdhënies dinjitoze dhe humanitetit të shumë njerëzve konservatorë të fesë. Pas kësaj takimin me muftiun karizmatik Ahmed Bedruddin Hassunin, i cili më ndihmoi të përtërij besimin në përshtatshmërinë e sinqertë që buron nga religjioziteti i vërtetë. Ky gjithsesi është një melhem i mirëpritur në plagë pas pseudomuslimanëve të cilët realisht e mundësuan këtë konflikt. Gjithnjë do t'i kujtoj shpjegimet e mufti Hassunit që më ka treguar për Islamin cili e karakterizon Sirinë 'Shamin Islam'. Edhe një herë u falënderohem të gjithë mësuesve të mi sirianë, por, natyrisht të gjithë përgjegjësinë për fjalët e mia e mbaj vet.

Përmbajtja

1. Hyrje: Lufta e ndytë në Siri.....	10
2. Siria dhe ‘Lindja e afërme e re’ e Vashingtonit	23
3. Fuçi-bombat, burimet e anësishme dhe propaganda luftarake	35
4. Daraa 2011. Edhe një kryngritje islamike.....	53
5. Bashar el Asadi dhe reformat politike.....	71
6. Xhihadistët e perandorisë	105
7. Mediat e kooptuara dhe ‘rojtaret’ e të drejtave njerëzore	137
8. Edhe një rishikim i masakrës Houli	173
9. Shpifjet kimike: Rasti i Goutës lindore	197
10. Përgjegjësia për të mbrojtur dhe Loja e dyfishtë	217
11. Shëndetësia dhe sanksionet.....	229
12. Vashingtoni, Terorizmi dhe ISIL-i: Provat-dëshmitë	239
13. Intervenimi perëndimor dhe ndërgjyrgjia koloniale	261
14. Kah Lindje e afërme e pavarur.....	271
15. Të mbetemi të informuar.....	283

1. Hyrje: Lufta e ndytë në Siri



Pika e qëndrimit të armatës siriane, Damask

Tekstin që e kemi përpara është hyrje e kreut të librit Lufta e ndytë në Siri e profesorit Tim Anderson

Edhe pse çdo luftë përmban shumë të pavërteta dhe mashtrime, lufta në Siri është e bazuar në dezinformata masive që kurrë gjer më sot nuk i kemi hasur në këtë masë. Gazetari britaniko-australian Philip Knightley tregon faktin se propaganda e luftës tipikisht përfshinë formën depresive të paraparë të demonizimit të udhëheqësit armiqësor, më pastaj demonizon popullin armiqësor duke i rrëfyer mbi masakrat, qofshin ato të vërteta apo të imagjinuara (Knightly 2001).

Në këtë mënyrë specialisti i padjallëzuar i oftalmologjisë Bashar al Asad u bë ‘burim i ri i krimi’ në botë, dhe në atë mënyrë sipas paraqitjeve konsistence të mediave, ushtria siriane nuk ka bërë asgjë tjetër pos që ka vrarë civilë plot katër vite. Deri më sot e kësaj dite shumë njerëz konfliktin e Sirisë e vështrojnë si një luftë qytetare, kryengritje popullore, ose si një lloj konflikti i brendshëm sektar. Këto mite janë të arritura të shumëfishta dhe sukses i fuqive të mëdha të cilat gjatë këtyre 15 viteve që kaluan zbatuan një sërë operacionesh me qëllim të përmbysjes dhe ndryshimit të dhunshëm të regjimit në rajonin e Lindjes së Afërme, secili prej tyre në bazë të një preteksti të gabuar.

Ky libër është një punë akademike precize por edhe një mbrojtje e fuqishme e të drejtave të popullit sirian që ai vet të përcaktojë formën e shoqërisë dhe të sistemit politik të udhëheqjes me shtetin. Ky pozicion është konzistent me parimet e të drejtës ndërkombëtare dhe të drejtave të njeriut, edhe pse ajo mund të jetë irituese kur është në pyetje senzibiliteti i Perëndimit, siç jemi edhe ne vet, në të drejtën e intervenimeve që ia kemi kundërvënë vetes. Kohë pas kohe detyrohem të jem përafërsisht i vendosur në mënyrë që t’i shmangem bisedës së dyfishtë.

Fuqitë e mëdha janë munduar në Siri t’i fshehin gishtat e vet, duke shfrytëzuar këtë herë armatën, me ç’rast duke demonizuar qeverinë siriane dhe armatën, vazhdimisht duke i akuzuar për krime ndërkaf pastaj duke u shtirë gjoja se populli sirian dëshiron të shpëtojë nga pushteti i vet. Një numër shumë më i vogël i njerëzve në Perëndim i është kundërvënë luftës në Siri se sa që

ishte rasti i invadimit në Irak ngase u mashtruan në pikëpamje të natyrës së atij konflikti. Në fillim të viti 2011 kam pasur një kuptim bazik për Sirinë dhe historinë e saj. Mirëpo, u bëra gjer diku i dyshimtë kur fillova të lexoj raportet e gazetave për dhunën që kishte shpërthyer në kufirin jugor të Sirisë në qytezën Daraa. E dija se një dhunë e tillë, të gjuajturit me snajper e policisë dhe civilëve, përdorimi i armës gjysmë automatike nuk mund të ndodh spontanisht nga protestat e thjeshta të rrugëve. Isha shumë i dyshimtë kur ishin në pyetje fuqitë e mëdha.

Tërë jetën jam duke dëgjuar rrena me të cilat mundohen të arsyetohen luftërat. Andaj vendosa vet të hulumtojë prapavijën të konfliktit në Siri, duke lexuar me qindra libra e artikuj, duke analizuar një numër të madh të video-incizimeve dhe duke biseduar, me sa kam pasur mundësi, me një numër të madh të sirianëve. Kam shkruar me dhjetëra tekste dhe dy herë e kam vizituar Sirinë gjatë luftës. Ky libër është rezultat i atij hulumtimit tim. Luftërat e ndyta nuk janë kurrgjë e re. Heroi kombëtar kuban Jose Marti, duke i treguar shokut të vet, parashikon që Vashingtoni do të provojë të intervenojë në Kubë në mënyrë që të pengojë luftën e saj për pavarësi kundër spanjollëve. Ata dëshirojnë të nxitin luftë, shkroi më 1889, për të pasur pretekst për intervenim, ndërkaq kur të intervenojnë shfrytëzojnë të drejtën e ndërmjetësuesit dhe garantuesit të paqes në mënyrë që të marrin kontrollin mbi shtetin. Nuk ka akt më të poshtër në analet e popujve të lirë, madje as krim më gjakftohtë. (Marti 1975: 53). Nëntë vjet më vonë, gjatë luftës së tretë për pavarësi, në shpërthimin që ndodhi në portin e Havanës u shkatërrua anija luftarake amerikane USS Maine, ku humbën jetën 258 marinarë amerikanë e që shërbeu si pretekst për invadimin amerikan në Kubë. Me këtë lufta ameriko-spanjolle ua kidnapoi kubanëve fitoren, pas së cilës SHBA - të marrin kontrollin mbi kolonitë të tjera spanjolle. Një pjesë e territorit kuban u aneksua, ndërsa iu imponua edhe një kushtetutë komprometuese. Asnjëherë s'është vërtetuar se spanjollët kanë qenë përgjegjës për sulmin me bomba ndaj anijes amerikane Maine. Aq më tepër shumë kubanë besojnë se amerikanët vetë e kanë bombarduar anijen e vet. Përmendorja në Havanë, në shenjë

përkujtimi të marinarëve të rënë, edhe më tej mban këtë mbishkrim: “Për sakrificat e Mainës, që u sakrifikuan për ambicie imperialiste, dëshira për marrjen e kontrollit mbi Kubën” (Irichter 1998). Administrata amerikane bën dhjeta intervenime në Amerikën Latine gjatë shekullit vijues. Lufta e rëndësishme e fëlliqur udhëhiqet nën mbrojtjen e CIA -s dhe të ashtuquajturit “luftëtarët për liri, mercenarë nga Hondurasi që sulmuan Qeverinë e Sandinit dhe popullin i Nikaraguas gjatë vitit 1980. Modeli që është përdorur në atë konflikt nuk dallon shumë nga metoda e luftës në Siri. Në Nikaragua janë vrarë më se 30.000 njerëz. Gjyqi ndërkombëtar qeverinë e SHBA -s e shpall përgjegjëse për një sërë sulmesh terroriste në këtë shtet të vogël të Amerikës së Mesme. I njëjti gjyq i caktoi Nikaraguas kompensim të dëmit (ICJ 1896). Vashingtoni nuk i pranoi këto vendime të gjyqit. Me paraqitjen e “Pranverës arabe” më 2011 fuqitë e mëdha shfrytëzuan rastin të një situatë të nxehtë politike për të marrë një iniciativë ta imponojnë “dimrin islamik” duke sulmuar disa shtete të pavarura që kishin mbetur në rajon. Shumë shpejt e pamë zhdukjen e Libisë, vendit të vogël me standard më të lartë jete në Afrikë. Bombardimet e NATO dhe fushatat e forcave speciale u ndihmuan grupeve të Al Kaidës në teren. Këto bishtnime në mënyrë rapide e ngacmuan rezolutën e Këshillit të sigurimi të KB që u soll nën pretekstin të sigurojë mbrojtjen e banorëve civilë duke shpallur zonën e ndalimit të fluturimeve - no fly zone. Tani më e kemi të njohur se ky besim është bishtnuar dhe vendet e paktit të NATO - s e keqpërdorën lejen e kufizuar të KB -së për ta përmbysur qeverinë e Libisë (McKinney 2012).]

Më në fund, dëshmitë që Gaddafi ka patur për qëllim, ka kryer apo është kërcënuar se do të bëj krime me përmasa të mëdha, siç iu vesh atij (Forte 2012), Genevieve Garrigos nga Amnesty international (Francia) pranoi që “nuk ka dëshmi” që mund t’i arsyetojnë pohimet e mëparshme të organizatës së vet për atë se Gaddafi ka shfrytëzuar ‘mercenarë zezakë’ për kryerjen e masakrave (Forte 2012; Edvards 2013). Alan Kupermani, duke u thirrë kryesisht në burimet e Amerikës Veriore ilustron me sa vijon. Së pari akcioni i Gaddafit për të shuar kryengritjen,

kryesisht të kryengritësve muslimanë në veri të Libisë ishte me një intensitet të dobët në aspekt të përdorimit të forcës, por kjo që më herët ishte sugjeruar. Ekzistojnë dëshmi për atë se qeveria e tij ndërmori të gjitha masat e të përmbajturit për përdorim të tepruar të forcës. Islamikët ishin të armatosur që nga fillimi. Sipas vlerësimeve të më vonshme amerikane, në mes të një mijë sakrificave që ranë shtatë javët e para, afër tre për qind prej tyre ishin gra dhe fëmijë (Kuperman 2015).

E dyta, kur forcat qeveritare u përgatitën ta marrin anën veriore të Libisë, atëherë NATO intervenoi duke pohuar se me atë dëshiron të pengojë masakrat që padyshim do të ndodhnin po të mos vinte gjer te intervenimi. Dhjetëmijë njerëz humben jetën pas intervenimit të NATO-s në krahasim me njëmijë veta para intervenimit të forcave të NATO-s.

Gaddafi premtoi se nuk do të bëjë reprezalje në Bengazi dhe nuk është gjetur asnjë dëshmi apo arsye me të cilën do të mund të vërtetohet pohimi se Qeveria e tij ka planifikuar të kryej vrasje masive (Kuperman 2015). Megjithatë dëmi u bë. NATO e dorëzoi vendin në duart e grupeve të ngatërruara islamike dhe të ‘liberalëve’ properëndimorë. Deri atëherë relativisht shteti i pavarur u shkatërrua, ndërkaq Libia në atë proces u rrënuar krejtësisht. As katër vjet pas kësaj, Libia nuk ka qeveri funksionale, dhuna vazhdon ende, ndërkaq agresioni ndaj Libisë kaloi pa u ndëshkuar.

Dy ditë para bombardimit të NATO- s Libinë, ndodhi edhe një kryengritje islamike në Duraa, qytet në fund të jugut të Sirisë. Megjithatë marrë parasysh se kjo kryengritje u fut në lidhje me protestat e lëvizjes për reforma politike, me këtë karakteri i saj ishte i maskuar. Shumëkush nuk e vërejti që vendet të cilat i furnizuan kryengritësit me armë, e ato para së gjithash ishin Katari dhe Arabia saudite, njëherit mbi karakterin e kryengritje përhapën lajme të rrejshme dhe raporte gazetash përmes makinerisë së mediave të veta, Al- Xhezire dhe Al- Arabijje. Ka arsye të tjera për këta imagjinata mitologjike afatgjata mbi luftën në Siri. Shumë vëzhguesve perëndimorë, liberalëve dhe majtistëve si dhe shtresave konzervative të popullatës u pëlqeu ideja për rolin e tyre

të shpëtimtarit për një popull të huaj, duke folur fortë dhe me emocione për një vend që absolutisht asgjë nuk kishin ditur dhe që nuk e kishin kuptuar. Megjithatë ata iu bashkëngjitën asaj propaganda e cila për ta donte të thotë luftë ‘e drejtë’ kundër regjimit të një ‘diktatori të ri’ duke krijuar një imagjinatë të veten. Këta gjoja se kishin harruar rrenat propagandistike që i karakterizonin disa luftëra të mëparshme si dhe trashëgiminë e vet koloniale. Do të merrja guxim të shkoj aq larg që të them se në luftën e fëlliqur kundër Sirisë, kultura perëndimore krejtësisht e kishte harruar pjesën më të mirë të traditës së vet, të kuptuarit, ngulmimin në parimet etike dhe gjurmimin për arsye të pavarura gjatë kohës së konfliktit, në dobi të traditës së tij më të keqe, prerogativave imperialiste për nevojën e intervenimit që e përcjellin paragjykimet e thella raciste dhe reflektimi i keq mbi historinë e kulturës së vet. Kjo dobësi edhe më tepër është një mbështetje e ashpër e fushatës të propagandës së luftës. Pasi që filloi fushata e demonizimit të udhëheqësit sirian Bashar el Asad u vendua një bllokadë e plotë informative e cila ishte e orientuar kundër çdo variant tjetër të komentimit të ndodhive që do të mund ta vinte në dyshim versionin zyrtar të luftës të përhapur nga ana e Perëndimit. Pas 2011 krejtësisht një numër i vogël i interpretimeve objektive mbi luftën në Siri vinin nga Perëndimi, marrë parasysh se të gjithë qëndrimet kritike ishin bllokuar si të pa dëshirueshme. Pikërisht në këtë kontekst vendosa ta shkruaj këtë libër. Ky është kontributi im kushtuar mbrojtjes së Sirisë, pikësëpari nuk u dedikohet atyre që janë të zhytur në mitet perëndimore, por atyre që dëshirojnë t’u kundërvihen atyre me argumente. Andaj ky libër është një resurs dhe kontribut i historisë së konfliktit sirian. Versionet perëndimore lidhur me këtë janë thellë të preokupuara me botëkuptimet e tyre, për çka mendoj se është humbje e kohës që t’ua lajmë gjynahet së tepërmi atyre. Mendoj se më e mira është për ndodhitë aktuale të flasim për atë që ata në të vërtetë janë, ndërsa perden e tymosur për ata t’ua adresojmë më vonë. Unë nuk i injoroj mitet perëndimore në atë luftë, aq më tepër, ky libër shumë prej tyre i argumenton. Por shkruaj për realitetin e asaj lufte.

Mitologjia perëndimore mbështetet në idenë e prerogativave imperialiste, duke pyetur se çka duhet ndërmarrë ‘ne’ në lidhje me problemet e popujve tjerë, çka në të vërtetë paraqet afrimi që nuk ka bazë në të drejtën ndërkombëtare ose të drejtat njerëzore në përgjithësi. Hapat në vijim shqyrtojnë serinë e dëshmime të fabrikuara për shkakun, karakterin dhe rrjedhën e luftës që vendet e paktit të NATO-s dhe monarkive të Gjirit i kanë inicuar në shenjë përkrahje të ‘revolucionit shekullarist demokratik’. Kur u bë e qartë se kjo nuk është e pëlqyeshme, u shfaq një gjë tjetër, ajo se si ata në realitet duan ta shpëtojnë pjesën më të madhe të shtypur të popullatës siriane që janë ‘muslimanët sunitë’ nga ‘regjimi sektar alevit’. Pas kësaj, kur u pa haptas se pjesëtarët e forcave antiqeveritare kanë kryer krime të mëdha, dhe kur ajo tërhoqi vëmendjen e botës, shkaku për luftë u shndërrua në arsyetim se në skenë, në realitet, është një luftë nën hijen e një konflikti të gjerë në kuadër të të cilit pohohet se ‘kryengritësit e matur’ luftojnë kundër grupeve ekstremiste. Andaj intervenimi i Perëndimit është i patjetërsueshëm në mënyrë që t’i forcojnë ‘kryengritësit e matur’ kundër grupeve ekstremiste të cilat përnjëherë u paraqitën në mënyrë misterioze e të cilat paraqesin kanosje për mbarë botën. Ky është rrëfimi ‘B’. Nuk ka asnjë fije dyshimi se Holivudi në vitet e ardhshme në bazë të këtij skenari do të prodhojë shumë filma. Megjithatë ky libër mbështetet në rrëfimin ‘A’.

Përfaqësuesit e armatës islamike të cilët i armatosën aleatët rajonalë të Shteteve të bashkuara të Amerikës (kryesisht Arabia Saudite, Katari dhe Turqia) u infiltruan në radhët e lëvizjes për reforma duke hapur zjarr ndaj forcave siriane të rendit dhe në popullatën civile. Pastaj për sulm e akuzojnë Regjimin dhe nxitën kryengritje të armatosur me qëllim të përmbysjes së Regjimit sirian dhe të shtetit shekullar dhe plural. Kjo ngjau menjëherë pas ambicieve të shprehura haptas të SHBA-s që kërkojnë të hapin ‘Lindje të afërme të re’, duke i nënshtruar të gjitha vendet e rajonit, qoftë me anë të reformave, çarmatimit unilateral ose përmbysjes së drejtpërdrejt të qeverisë legjitime. Siria ishte e radhës pas Afganistanit, Irakut dhe Libisë. Në rastin e Sirisë, përfaqësuesit e armatës u formuan prej kombinimit të Vëllezërve

muslimanë dhe vehabistëve fanatikë nga Arabia Saudite. Krahës luftës të kohëpaskohshme për pushtet midis këtyre grupeve dhe sponsorëve të tyre, si këta edhe ata kanë një ideologji të përbashkët selefiste e drejtuar kundër regjimeve shekullare ose nacionale, ndërsa qëllimi final është krijimi i një shteti fetar sipas kallëpit ideologjik të tyre.

Mirëpo, islamikëve të Vashingtonit në Siri iu kundërvu ushtria nacionale e disiplinuar e cila nuk u shkatërrua sipas kallëpit fetar edhe përkundër provokimeve të shumta. Shteti sirian gjithashtu kishte aleatë në Rusi dhe Iran. Siria nuk donte të bëhet Libia e dytë. Në këtë konflikt shumëvjeçar, sipas versionit perëndimor, dhunë ka ushtruar ushtria siriane e cila ‘qëllimisht’ i sulmon civilët. Sipas Sirisë njerëzit ballafaqoheshin me sulme të përditshme të terroristëve ndaj qyteteve e banorëve të tyre, shkollave, spitaleve dhe me masakrimin e qytetarëve të thjeshtë nga ana e ‘luftëtarëve për liri’ të NATO-s. pas së cilës pasuan kundërsulmet e Armatës. Terroristët e huaj rekrutoheshin nëpër dhjetra shtete dhe atë sipas udisjes së Arabisë Saudite dhe Katarit me anë të së cilëve ndihmoheshin mercenarët vendorë.

Edhe pse grupet terroriste, jashtë Sirisë, shpeshherë quhen si opozitarë, militantë; ose grupe sunite, brenda Sirisë, sërish opozita politike i braktisi islamikët që nga fillimi i vitit 2012. Protestat u larguan nga rruga me dhunë, ndërsa shumica e opozitës, përveç (Vëllezërve muslimanë dhe disave në egzil), iu bashkëngjiten shtetit dhe armatës, edhe pse jo partisë Ba’th në pushtet. Armata siriane u soll brutalisht ndaj terroristëve, por për dallim nga cytjet e propagandës perëndimore, u ofroi ndihmë popullatës civile. Ndërkaq islamikët u sollën brutalisht ndaj të gjithëve dhe atë në mënyrë të hapët. Miliona njerëz të shpërngulur internisht kërkonin mbrojtje nga armata dhe qeveria, ndërsa disa prej tyre u larguan nga vendi. Në kërkim të aktit përfundimtar të mbarimit të luftës, fuqitë e mëdha provuan ta përmbysin qeverinë siriane, ose në pamundësi të arritjes të kësaj, shqyrtojnë vendosjen e një shteti jo funksional po bile edhe copëzimin e tij në shtete të vogla sektare, ashtu që me këtë të shkatërronin boshtin e shteteve të pavarura të rajonit. Këtë bosht e përbën Hizbullahu në jug të Libanit dhe

Lëvizja palestineze e rezistencës, krahas Sirisë dhe Iranit, dy shtete të vetme të rajonit ku nuk ka baza ushtarake amerikane. Në kohën e fundit, edhe më tej Iraku i traumatizuar me invazionin perëndimor, me maskara dhe okupim, ka filluar gradualisht t'i bashkëngjitet këtij boshti. Rusia gjithashtu fillon të luajë rol të rëndësishëm. Historia e re dhe veprimi tregojnë se as Rusia as Irani nuk kanë kurrfarë ambicie imperialiste për të cilat do të mund të thuhej se u rrinë ballë ambicieve të Vashingtonit dhe aleatëve të tij, në mes të cilëve janë disa prej tyre (Britanija, Franca dhe Turqia), ish udhëheqësit kolonialistë në atë rajon. Sipas këndvështrimit të shteteve të boshtit të rezistencës, humbja e luftës së ndytë kundër Sirisë do të thoshte fillimi i ngjeshjes së radhëve të përbashkëta kundër politikës së fuqive të mëdha. Mbrojtja e suksesshme e Sirisë don të thoshte fillimi i fundit të 'Lindjes së afërme të re' të Vashingtonit.

Kjo është një paraqitje e situatës në makro plan. Ky libër do ta dokumentojë rrëfimin 'A', ndërkaq rrëfimin 'B' do të insistoje ta zbulojë. Këtë do ta bëjë në atë mënyrë që t'i shpëtojë disa zakone më të mira të traditës perëndimore si shfrytëzimi i të kuptuarit, të hulumtuarit në parime morale dhe etike dhe të gjurmuarit e dëshmimeve të pavarura sa i përket këtij konflikti. Shpresoj se kjo në këtë kuptim do të shërbejë si një resurs i dobishëm. Pason shfaqje e shkurtë e përmbajtjes së librit sipas kapitujve.

Kapitulli i dytë, Siria dhe 'Lindja e afërme e re' e Vashingtonit, Sirinë e pozicionon në kontekst të planeve amerikane për 'Lindje të afërme të re', më e reja në historinë e gjatë të orvatjeve amerikane për të dominuar në rajon.

Kapitulli i tretë, 'Fuçi- bombat, burimet e anësishme dhe propaganda e luftës, adreson problemin e raportimit dhe të kuptuarit e krizës siriane. Shtëpitë e mediave treguan mbështetje shumë të madhe në burimet e anësishme informative, të cilat mbajnë anën e agresorit kundër Sirisë dhe të cilat nënçmojnë rolin e armatës siriane. Kjo paraqet një pengesë kryesore në rrugën e të kuptuarit të paqartësive në lidhje me gjoja përdorimin e armëve kimike, krimin ndaj civilëve, dhe shkallës së përkrahjes ose opozitës ndaj Asadit.

Kapitulli i katërt Daraa 2011, edhe një kryengritje islamike' në bazë të shumë burimeve rekonstruon kryengritjen e armatosur të mbështetur nga ana e Arabisë Saudite në qytezën Daraa, në mars të vitit 2012. Këto sulme të armatosura përafërsisht janë ndryshe nga protestat e qytetarëve që kanë kërkuar reforma, që islamikët, jo shumë vonë nga kjo, i larguan nga rugët e këtij qyteti.

Kapitulli i pestë, 'Bashar al Asadi dhe reformat politike' flet për reforma politike që nga koha kur Asadi është zgjedhur për kryetar të Sirisë gjatë vitit 2000 dhe gjer në fillimin e krizës siriane më 201. Nga kjo mund të shohim se grupet opozitare të cilat u ishin kushtuar reformave në kontekstin e brendshëm të Sirisë, praktikisht të gjitha u kundërvunë sulmeve ndaj shtetit të Sirisë. Ky kapitull shqyrton rolin e Basharit si reformator si dhe dëshmitë për popullaritetin e tij.

Kapitulli i gjashtë, 'Xhihadistët e perandorisë', ka të bëjë me çështjen e bashkëpunimit të Islamit selefisto-politik me forcat imperialiste në Lindjen e afërme. Ndryshe nga rrjedhat imperialiste islame në Iran dhe në Libanin jugor, Islami selefisto-politik u bë një forcë sektare në marrëdhëniet konkurruese ndaj nacionalizmit arab në Egjipt, Palestinë, dhe Siri, i cili gjatë kohës është mbështetur në bashkëpunim me fuqitë e mëdha. Historian e ofron një rrëfim të rëndësishëm me prapavijë mbi karakterin e 'revolucionit' sirian islamik dhe parullave të tij të ndryshme.

Kapitulli i shtatë, 'Mediat e kooptuara dhe mbrojtësit e të drejtave njerëzore', identifikon teknikat propaganduese të kanaleve mediatike dhe rrjetin e organizatave për të drejta njerëzore (Human Rights Watch, Avaaz e tj.) të cilët funksionojnë si megafonë dhe moderatorë në shërbim të agjendës së Vashingtonit. Shumë prej tyre u bënë mbrojtës të zjarrtë të 'luftës humanitare'. Një numër i ri i organizatave joqeveritare perëndimore, (për shembull The Syria Campaign - Fushata siriane, The Whaite helmets - Helmetat e bardha), themeluan agjenci në Wall Street dhe atë me një qëllim të veçantë të udhëheqjes së luftës së ndytë kundër Sirisë. Ky kapitull dokumenton një sërë të fabrikime të tyre.

Kapitulli i tetë, 'Edhe një vështrim i masakrës në Houli', detajisht shqyrton dëshmitë nga krimi i parë më i madh që u orkestrua (falë

aplikimit të suksesshëm të kësaj teknike në rastin e Libisë) e i cili është paramenduar me qëllim që të nxit Këshillin e sigurimit të KB -së të japë leje për intervenim. Gjersa grupi i parë i Kombeve të bashkuara. ai në Siri, erdhi në përfundim se dëshmitë- provat për këtë çështje janë kontradiktore, ekipi tjetër i KB-së, ai jashtë Sirisë, që e udhëhoqi një diplomat amerikan, u mundua që përgjegjësinë për dy masakrat t'ia hedh Qeverisë siriane. Përsëri, dhjeta dëshmitarë për këtë krim akuzonin grupin islamik Faruk, që vepron në kuadër të Ushtrisë të lirë siriane (FSA), për vrasjen e disa fshatarëve proqeveritarë, pas së cilës morën kontrollin mbi atë territor të cilin disa muaj me radhë e mbajtën nën kontroll. Ky kapitull gjithashtu elaboron një numër të krimeve të ngjashme me flamur të rrejshëm 'false flag'.

Kapitulli i nëntë, 'Fabrikimi i dëshmimeve - provave për armë kimike : Incident në Gautën Perëndimore' 'false flag' i dytë detajizon incidentin me rëndësi ndërkombëtare. Ky rast që ndodhi në gusht të vitit 2013 i cili për pak do të nxiste eskalim të gjerë të luftës, duke i bashkangjitur edhe mundësinë e lëvizjes së sulmit raketor amerikan kundër Sirisë, është shfrytëzuar për ta akuzuar qeverinë siriane për vrasjen e disa qindra civilëve, madje gra dhe fëmijë, me armë kimike. Për një kohë relativisht të shkurtër një numër i madh i burimeve të pavarura duke u bashkangjitur edhe ato të Amerikës veriore, i hodhi poshtë këto akuza. Mirëpo edhe përkundër kësaj kundërshtarët e Sirisë vazhduan me akuza të rrejshme deri më sot, mu sikur të ishin ato të vërteta.

Kapitulli i dhjetë, 'përgjegjësia për mbrojtje dhe loja e dyfishtë', ka të bëjë me doktrinat më të reja politike që paraqesin një sërë masash të intervenimit humanitar i njohur si alet (mjet) i materialit doracak imperialist. Zbatimi i kësaj doktrine në Libi u tregua katastrofale për këtë vend të vogël. Fatmirësisht, përpjekjet që ajo të implementohet në Siri dështuan.

Kapitulli i njëmbëdhjetë, 'Sankcionet dhe sistemi shëndetësor publik', dokumenton sulmet islamike të ndihmuara nga NATO ndaj sistemit shëndetësor të Sirisë i cili është i lidhur me influencën e sanksioneve ekonomike perëndimore kundër këtij vendi. Kjo rrjedhë dy kahesh i shkaktoi dëme jashtëzakonisht të

mëdha sistemit shëndetësor publik në Siri. Sulmet e tilla nuk janë bazuar në asnjë motiv të arsyeshëm me të cilin do të siguroj përkrahja e popullatës vendore, ashtu që patjetër t’i interpretojmë si një pjesë e strategjisë së gjerë qëllimi i të cilit është shkatërrimi i sistemit të shtetit të Sirisë në mënyrë që ajo të bëhet më e lënduar dhe më e nënshtuar për intervenim të jashtëm.

Kapitulli i dymbëdhjetë, ‘terrorizmi dhe ISIL-i’: Dëshmitë, vërtetojnë lidhjen në mes të fuqive të mëdha dhe grupeve më të reja terroriste, kundër të cilëve amerikanët pohojnë se janë duke luftuar. Mendim më i drejtë informativ për këtë çështje kontradiktore mund të formohet vetëm në bazë të dëshmive të sakta, ndërsa këto dëshmi janë me bollëk. Pak është dallimi ideologjik ndërmjet grupeve të ndryshme selefiste islamike, ndërsa Vashingtoni dhe aleatët e tij e kanë financuar dhe armatosur çdo njëren prej tyre. Kapitulli i trembëdhjetë, ‘Intervenimi perëndimor dhe vetëdija koloniale, shpjegon ndërthurjen kulturore mentale të Perëndimit, që është i qëndisur me shkelje të pandërprerë të të drejtave të popujve tjerë.

Kapitulli i katërbëdhjetë, ‘Kah Lindja e afërme e pavarur’, shqyrton përfundimin e krizës siriane dhe implikimin e saj të mundshëm në rajonin e Lindjes së afërme. Duke paguar tatim të rëndë, Republika Arabe e Sirisë, armata dhe populli i saj me vite i bënë, me sukses, rezistencë heroike agresionit të armiqve të shumtë dhe të fuqishëm. Siria arrin të mbijetojë falë rezistencës së fortë dhe unitetit të brendshëm, i forcuar me mbështetjen e disa aleatëve të fuqishëm. Fillimi i sulmeve ajrore ruse, kah fundi i vitit 2015 ka një rëndësi të veçantë. E rëndësishme është edhe mbështetja e forcave tokësore të Iranit, Irakut dhe Libanit, që i erdhën në ndihmë Sirisë së pavarur.

Kur do të ndalen sulmet ndaj Sirisë, Lindja e afërme do të jetë e gatshme të transformohet, me një vullnet më të madh politik dhe përgatitje të fuqive të zgjeruara të boshtit rezistues. Kjo do të thotë fillimi i mbarimit të dasmës së përgjakur të Vashingtonit, të gjakderdhjes dhe ndërrimit të regjimit me dhunë, që shkatërrojnë nëpër rajonin e Lindjes së afërme qe pesëmbëdhjetë vjet.

Shënime :

Edwards, Dave (2013) 'Limited But Persuasive' Evidence - Syria, Sarin, Libya, Lies', Media, Lens, 13June, online:

<http://www.medialens.org/index.php/alerts/alert-archive/alerts-1013/735-limited-but-persuasive-evidence-syria-sarin-libya-lies.html>

Forte, Maxmilian (2012) Slouching Towards Sirte: NATO's War on Libya and Africa, Baraka Books, Quebec

ICJ (1986) Case concerning the military and paramilitary activities in and against Nicaragua (Nicaragua v. United States of America) Merits', International Court of Justice, Judgement of 17 June 1986, online: <http://www.icj.org/docket/?sum=367&p1=3&p2=3&case=70&p3=5>

Knightley, Philip (2015) 'The disinformation campaign', The Guardia, 4 Octomber,online: <http://www.theguardian.com/education/2015oct/04/socialsciences,highereducation>

KUPERMAN, Alan J. (2015) Obama's Libya Debacle', Foreign Affairs, 16 April, online: <http://www.foreignaffairs.com/articles/libya/2015-02-16/obamas-libya-debacle>

Marti, Jose (1975) Obras Completas, Vol. 6, Editorial de Ciencias Sociales, La Habana

McKinney, Cymthia (Ed) (2012) The Illegal War on Libya, Clarity Press, Atlanta

Putin, Vladimir (2015) 'Violence instead of democracy: Putin slam 'policies of exceptionalism and impunity' in UK speech', RT, 28 September, online: <http://www.rt.com/news/316804-putin-russia-unga-speech/>

Richter, Larry (1998) 'Havana Journal; Remember the Maine? Cubans See an American Plot Continuing to This Day', New York Times, 14 February, online:

<http://www.nytimes.com/1998/02/14/world/havana-journal-remember-maine-cubans-see-ameriacn-plot-continuing-this-day.html>

2. Siria dhe 'Lindja e afërme e re' e Vashingtonit



Pas invazionit në Afganistan dhe Irak dhe shkatërrimit të Libisë, Siria ishte shteti i radhës që duheshite shkatërruar. Vashingtoni dhe aleatët e tij të rajonit që më herët kishin planifikuar një skenar për Sirinë. Pas ndërrimit të regjimit në Damask, Hizballahu, aleati sirian dhe lideri libanez i lëvizjes së rezistencës ndaj Israelit, do të ishte krejtësisht i izoluar. Në atë rast, Republika islamike e Iranit, do të ishte i vetmi shtet që kishte mbetur ku nuk do të ishin të pranishme bazat ushtarake amerikane. Po ta nënshtroj Iranin

atëherë Vashingtoni do të ishte në grindje ta kontrollojë krejt Lindjen e afërme, duke eliminuar në këtë mënyrë konkurrentët e vet potencialë, Rusinë dhe Kinën. Palestina do të ishte e humbur. Ishte pjesë e planit të Vashingtonit krijimi i 'Lindjes së afërme të re'. Por, kjo ende nuk është realizuar. Rezistencën e fortë dhe të koordinuar mirë kurrë nuk duhet nënçmuar. Armata nacionale siriane arriti t'i zmbraps shumë grupe fanatike islamike, të ndihmuara nga anëtarët e paktit të NATO -s dhe monarkive të Gjirit. Me atë rast, përkrahja e Iranit dhe Rusisë ndaj Sirisë, gjatë tërë kohës ka qenë solide. Gjithashtu është fakt i rëndësishëm që Siria arriti të ndërtojë forma të reja të bashkëpunimit me Irakun e dobët e të lodhur, ashtu që forcimi i marrëdhënieve ndërmjet Iranit, Irakut, Sirisë, Libanit dhe Palestinës paraqet një provokim të 'Lojës së re' të kohës tonë.

Lindja e afërme nuk ishte më teatër i garimit vetëm i fuqive të mëdha. SHBA dhe kolaboracionistët e vet rajonal (Arabia Saudite, Izraeli, Turqia. Katari dhe Jordania), tanimë e kemi të qartë, gjithë kohën në mënyrë aktive janë kyçur në luftën kundër Sirisë, që nga fillimi i saj më 2012. Shtetet e lartpërmendura kanë shfrytëzuar formacionet më reaksionare ekstremiste sektare për t'i arritur qëllimet e veta. Boshti i rezistencës, nga ana tjetër, nuk është dashur të kuptohet si fenomen sektar. Ky grup aktorësh - Republika Islame e Iranit, Siria shekullare, Lëvizja libaneze e rezistencës e udhëhequr nga Hizballahu dhe palestinezët - është shumë atimperialiste. Siria, si vend i vetëm shekullar që ka mbetur në Lindjen e afërme vite me radhë vlen si aleat i afërm i Iranit, madje edhe gjatë kohës së Irakut shekullar, kur nël krye të tij ishte Sadam Husejni.

Vashhingtani atëherë e shfrytëzoi Sadamin për ta dobësuar Iranin, pas revolucionit islamik në atë vend që u realizua në vitin 1979. Nga ana tjetër, Irani asnjëherë nuk i ka mbështetur Vëllezërit muslimanë në orvatjet e tyre që ta rrëzojnë me dhunë Qeverinë shekullare të Sirisë. Irani, natyrisht, o ofron ndihmë muslimanëve shiitë të Hizbullahut, por është interesante që Irani më së shumti demonizohet për shkak të armatimit që ua bën palestinezëve, në mesin e të cilëve gati edhe nuk ka shiitë. Ky veprim i Iranit hedh

poshtë akuzat se Boshti i rezistencës me orientim sektar. Nxitja për sektarizëm në Lindjen e mesme kryesisht vjen nga ana e aleatëve të ngushtë të Vashingtonit, Arabisë Saudite, monarkive të tjera të Gjirit dhe Izraelit, i cili shihet nga pastrimi etnik i palestinezëve. Këto vende janë në pajtueshmëri me Amerikën, e cila rajonin e Lindjes së mesme e mban të dobët dhe të përçarë. Si ndodhi që Siria të jetë shënjestër e agresionit? Armiqësinë kundër Sirisë mund të kërkojmë më herët që nga roli mesor i Sirisë në luftërat arabe-izraelite 1967 dhe luftës 1973, të cilat në atë paraqitnin luftën e përbashkët rajonale kundër ekspansionizmit të shtetit sionist. Pas kësaj, mbështetja e Sirisë që i dha Revolucionit islamik më 1979, shkaktoi keqësimin e marrëdhënieve në mes Sirisë dhe SHBA-ve. Që nga 1980, gjatë administratës së Karterit, Vashingtoni hulumtonte modele që sa më lehtë ta përmbyste regjimin në Damask. Telegrami diplomatik të cilin Këshilli nacional i sigurimit ia dërgoi sekretarit shtetëror të Amerikës Zbigniew Brzezinski, propozoi të bëjë një studim detal dhe të koordinuar, ku duhej të inkorporoheshin partnerët evropianë si dhe partnerët e Vashingtonit nga monarkitë e Gjirit, në mënyrë që të identifikoheshin regjimi alternativ i cili do të mund dhe do të duhej ta ndërrojë pushtetin të Hafez el Asadit. Mirëpo, ata atëherë u frikësoheshin pakënaqësive dhe reagimeve të aleatit të Sirisë, Bashkimit sovjetik -BRSS në rast të tentimit për përmbysje të regjimit sirian. Ky dokument, gjithashtu, kishte parasysh, në rast të tërheqjes së trupave siriane nga Libani - (Siria i kishte dërguar trupat e veta në Liban me qëllim të ndalimit të luftës qytetare në atë vend në vitin 1975, të cilat qëndruan aty gjer në vitin 2005) - kjo paraqiste rrezik të madh që do t'i kanosej përsëritjes së luftës qytetare në Liban dhe me këtë do t'i jepej shkas Izraelit që edhe ai të ngjitet në luftë në anën jugore të Libanit. (NSC 1980).

Prandaj aspak nuk habit fakti që Vëllezërit muslimanë - që gjithnjë kanë pasur vlerë si grupi më i organizuar sirian, historia kolaboracionit e të cilit, me fuqitë e jashtme, shtrihet që nga viti 1940, e filloi fushatën e sulmeve të përgjakshme sektare kundër forcave qeveritare në Siri ashtu që kryengritja e tyre e armatosur u thye në qytetin Hama në vitin 1982. Kryengritjen e tyre e

mbështetën aleatët e Amerikës në Lindjen e afërme, Arabia Saudite, Iraku dhe Jordania gjatë kohës së Sadam Huseinit. (Seale 1988: 336 - 337)

Të dhënat të inteligjencës amerikane të asaj kohe, vlerësuan se Qeveria siriane është treguar pragmatike dhe se thjeshtë nuk u ka lejuar Vëllezërve muslimanë që ta rrëzojnë me dhunë Asadin dhe të formojnë qeverinë e Vëllezërve muslimanë. (Dia 1982). Mirëpo, jo shumë kohë pas kësaj, analistët e shërbimit inteligjencë amerikan i shfrytëzuan masat represive që qeveria siriane i kishte aplikuar kundër Vëllezërve muslimanë në Hama, për ta paraqitur Sirinë si një shtet totalitar (Wikas 2007). Ky qe një trillim i dobishëm. Ndryshimi strategjik i radhës të marrëdhënieve ndaj Sirisë ndodhi pas sulmit në Qendrën tregtare botërore në New York më 9 shtator të vitit 2001 dhe vendimit të administratës së atëhershme Xhorxh W. Bushit me anë të së cilës ‘i shpalli luftë terrorit’ Edhe pse për invazionet që pasuan më pastaj janë shfrytëzuar lloj-lloj pretekste, mu atëherë filluan përgatitjet e shpejta për planin kryesor mbi Lindjen e afërme. Ish gjenerali i lartë amerikan Wesley Clark, në memoaret e veta u shpreh se dy javë para se të ndodh sulmi i 11 shtatorit, kolegu i tij nga Pentagoni i kishte thënë se qe atëherë është sjell vendimi për sulmin në Irak, i cili u realizua 18 muaj më vonë. Gjashtë muaj pas kësaj, i njëjti gjeneral, thekson Clark-u, i ka thënë diç shumë më keq se ajo, dhe ajo është, siç përmendet ne referendumin e Pentagonit: ‘Kemi ndërmend në një interval kohorë prej pesë vjetësh të sulmojmë shtatë shtete’. I pari në listën e shteteve të parapara për invazion ka qenë Iraku, pastaj Siria, e më në fund Irani. (Clark 2007). Lideri i Irakut, Sadam Huseini gjatë kohë është vlerësuar si armik i Sirisë për shkak të mbështetjes oportuniste të Vëllezërve muslimanë të Sirisë, si dhe për shkak të kolaboracionit të tij me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në luftën e përgjakshme shumë-vjeçare kundër Iranit. Por qeveria e Sirisë që udhëhoqi Hafeze el Asadi e mbështeti aksionin ushtarak me të cilin u dëbuan forcat irakiane nga Kuvajti gjatë kohës së luftës së parë të Gjirit (1990 - 1991). Ajo luftë, pa marrë parasysh atë se si e shikon monarkinë e Kuvajtit, është nisur në mënyrë jo ligjore, dhe në të kundërtën mer

doktrinën mbi sigurimin kolektiv, ashtu si u definua nga ana e Kombeve të Bashkuara, në bazë të së cilës SHBA siguroi mandatin e Këshillit të sigurimit të KB që lejuan këtë intervenim ushtarak.

Megjithatë, edhe Siria edhe Irani më vonë e kundërshtuan invazionin në Irak që ndodhi më 2003, edhe pse nga ky invazion u rrëzua nga pushteti armiku i tyre i përbashkët, Saddam Huseini. Invazioni në Irak ishte jo legjitim dhe paraqiste akt agresioni. Pasojat e padëshirueshme të invazionit dhe okupimi i Irakut, sollën deri te ndryshimi në politikën amerikane, deri te tundja nga vendi i quajtur ‘riorientim’ (Hersh 2007). Pasi u përmbys nga pushteti qeveri ba’thiste e Saddam Huseinit, qeveria e posaçëformuar në Bagdad e ndryshoi kursin dhe vuri marrëdhënie të mira me Iranin. Jo vetëm që shumica e banorëve irakianë janë muslimanë shiit, edhe pse jo aq në numër sa në Iran, irakianët zhvilluan një formë të kulturës pluraliste, madje ata për këtë shkak nuk dëshironin të formojnë shtet fetar. Por, marrë parasysh se armiku i Iranit, Saddam Huseini ishte larguar, u krijua një atmosferë ku për çështje të interesit të përbashkët mund të bisedohej për një atmosferë normale të marrëdhënieve të mira fqinjësore të dy shteteve. Aq më tepër, vënia e marrëdhënieve të mira midis dy shteteve filloi, në realitet, gjithnjë e më tepër ta bëjë merak Vashingtonin. Qëllimi i amerikanëve, gjatë kohës kur e ndezën luftën irake-iraniane, dhe kur më vonë e okupuan këtë vend, nuk ishte i motivuar për afrimin e Irakut dhe Iranit.

Që nga viti 2005 sekretari shtetëror i SHBA, Condoleezza Rice, filloi të përmend përhapjen të një ‘kaosi kreativ’ në Lindjen e afërme, për të plotësuar dëshirën e planit të Bushit për një Lindje të afërme të re. (Karon 2006). Duke marrë mësim nga trashëgimia e fuqive të mëdha koloniale, Vashingtoni solli një strategji të re ‘përçaj e sundo’. Indsajderët e Shtëpisë së bardhë strategjinë e Bushit e quajtën ‘riorientim’ dhe kjo nënkuptonte konfrontim të hapët me Iranin dhe vënie të një hendeku sektar në mes sunitëve dhe shiitëve... (përkundër kësaj), Irani, për dëshpërim të Shtëpisë së bardhë, arriti të vë një lidhje të afërt me qeverinë dominante shiite irakiane të kryeministrit Nuri el Meleki (Hersh 2007). Rice

deklaroi para komisionit për punë të jashtme të Senatit amerikan se ajo vëren një ‘riorientim të ri strategjik’ në rajonin e Lindjes së afërme, sipas të cilit ‘shtetet sunite’ (monarkitë e Gjirit) paraqesin ‘qendrat e maturisë’ gjersa Irani, Siria dhe Hizbullahu gjenden ‘në anën tjetër të këtij copëzimi’ (Herch 2007).

Ideja ishte të luhet në kartën e ndarjeve komunitare në mënyrë që të arrihet deri te konflikti, veçanërisht në Irak. Stërviija e ‘Ekipit të kuq’ të komandës qendrore amerikane filluan në 2006. Me ç’rast planifikimi ushtarak ishte i fokusuar në krijimin e ndasive të mëdha sipas kallëpit arabe-persian, në mënyrë që më vonë vëmendja të drejtohet ka boshti (për çdo rast) i pranueshëm ‘sunito-shiit’. Mendimi i planifikuesve amerikanë ishte i bazuar në supozimin se është i mundshëm ‘skenari sipas të cilit arabët dhe persianët mund të bashkohen ushtarakisht kundër SHBA/Perëndimit’ (Narwani 2011). Pjesa më efektive e atij operacioni ishte formimi i AL- Kaidës në Irak (IQI) të cilën do ta furnizonte Arabia saudite. IQI sipas atij skenari kishte për detyrë të realizojë sulme sektare në xhamia dhe në qendra të tjera të bashkësisë irakiane me qëllim të keqësimit të tensioneve komunitare.

Funksionarë të lartë të Perëndimit, gjatë bisedave private, pranuan se një numër i madh i miliardërëve sauditë si dhe të tjerë nga monarkitë e Gjirit kanë siguruar ‘pjesën më të madhe të mjeteve financiare për financimin e grupeve terroriste sunite në mbarë botën’ (Jones 2014).

Edhe pse Al- Kaida në Irak, e njohur si Shteti islam i Irakut (ISI), në fillim pohoi se kryesisht është e përbërë prej irakianëve (Felter dhe Fishman 2008: 3), atë e internacionalizuan në masë të madhe financat dhe rekrutimet e Saudisë. Këtë e vërtetojnë të dhënat deri te të cilat arritën forcat amerikane në Sinxhar, në kufirin irake-sirian në tetor të vitit 2007. Ato të dhëna flasin për një grup prej afro 500 luftëtarësh, mes të cilëve ishin shtetasë të Arabisë saudite si edhe të tjerë nga Afrika Veriore (libianë, algjerianë, tunizianë dhe marokenë) dhe të tjerë. Vlerësimet të tjera datojnë nga 2005 dhe 2007. Gjithashtu pohojnë, me më shumë ose më me pak siguri, madje edhe numri më i madh i pjesëtarëve të nacionaliteteve të

ndyshme, në mes të cilëve më së shumti kishte (40-50 përqindje) saudianë (Felter dhe Fishman 2008 : 8, 30-31).

Shembulli më tragjik i shfrytëzimit të strategjisë për nxitje të konflikteve sektare padyshim se është sulmi me bomba ndaj xhamisë Askeri në Samarra, në jug të Irakut që u realizua më 2006 dhe ku humbën jetën përmbi 1000 civilë të pafajshëm. Përkundër vërejtjes së liderëve fetarë shiit të Irakut, Iranit dhe Libanit që thërrisnin në përmbajtje nga hakmarrja, sërish erdhi gjer te sulmet revanshiste në shenjë hakmarrjeje për krimin në Samarra.

Kur erdhi deri te burgimi i përgjegjësve për këtë krim, u shpall se e kanë bërë pjesëtarët e një celule të Al- Kaidës që i priu një irakian, gjersa pjesëtarët të tjerë të grupit terrorist kanë qenë një tunizian, katër saudianë dhe dy irakianë (Ridolfo 2007). Edhe pse Al- Kaida që nga vet fillimi ka qenë e përfshirë, fokusimi i mediave dhe analistëve me qëllim është i drejtuar kah ndarjet sektare të Irakut’ (Worth 2016). Edhe pse Saddam Husejni, në kohën e vet, i përkrahte Vëllezërit muslimanë në Siri, ai kurrë nuk lejoi në Irak të veprojnë grupet e Al-Kaidës. Fenomeni i Al-Kaidës është një paraqirtje e re dhe e njëjta nuk është themeluar vetëm si reaksion ‘organik’ ndaj okupimit amerikan. Burimet perëndimore ndonjëherë pranojnë që shumica e financave dhe luftëtarëve vijnë nga Arabia saudite (Bruno 2007). Megjithatë ato burime e mjugullojnë situatën duke pohuar se Irani dhe Hizballahu, koh pas kohe, e përkrahin Al-Kaidën (Kapllan 2006). Sërish këto pretkste janë të pasakta.

Izraeli, tërë kohën është i përfshirë në Planin për ‘Lindje të afërme të re’, veçanërisht është aktivizua gjatë muajve korrik - gusht të vitit 2006. Pasi mori ‘dritë jeshile’ nga Washingtoni (Herth2006), Izraeli e shfrytëzoi rastin që sipas atij preteksti të bëjë invazion ndaj Libanit jugor. Plani i gjerë i Izraelit kishte për qëllim të dobësojë dhe çarmatos Hizbullahun. Por, pasi që në atë luftë humbën jetën 1200 libanezë dhe 165 izraelitë, KB-ja arriti të bëjë ndërprerjen e luftës. Izraeli nuk arriti të realizojë asnjë qëllim të invazionit. Sekretari shtetëror amerikan Condoleezza Rice këtë tragjedi që shkaktoi vdekjen e 400 vetave dhe gjysmë milioni të shpërngulsve, në mënyrë të lehtë e quajti ‘Mundimet e lindjes të

Lindjes së afërme të re’ (Karon 2006). Kjo deklaratë e provokoi Rami Huri-n nga Dayli Star i Bejrutit, të shkruajë me sa vijon: ‘ Vashingtoni gati në një bazë ekskluzive bashkëpunon me qeveritë arabe (monarkitë e Gjirit) të cilat në Siri nuk kanë thuar se kurrfarë ndikimi, kredibiliteti i të cilit në sy të publikut arab është i parëndësishëm, legjitimiteti i të cilit në shtëpi gjithnjë e më shumë është në pikëpyetje dhe politika amerikane e të cilit ka tendenca të promovojë luftë të lëvizjeve islamike (ekstremiste)’ (Huri 2006). Gjatë kohës së destabilizimit në Irakun e pas-Sadamt, Siria, për sa i përket Vashingtonit, ishte në listën e pritjes, por jo edhe e haruar. Prej telegrameve të Wikilksit kuptojmë se ambasada e Amerikës në Siri ishte e brengosur nga fakti që, edhe përkundër sanksioneve që më 2005 u aplikuan në Siri për shkak të refuzimit të saj të bashkëpunojë me Irakun, Siria më 2006 ishte ‘bile në pozitë më të fortë në planin e brendshëm dhe ndërkombëtar se sa në vitin 2005’. Vashingtoni u mundua ta akuzojë Damaskun që u dha strehim luftëtarëve irakian të rezistencës kundër agresionit amerikan (Siria pranoi më se një milion të refugjatëve irakian, pas invazionit amerikan në Irak në vitin 2003), por ambasada amerikane privatisht pranoi se ‘elementet ekstremiste gjithnjë e më tepër shfrytëzojnë si bazë por SARG (Qeveria e republikës arabe të Sirisë) merr masa kundër grupeve që pohojnë se janë zë lidhura me Al-Kaidën. Pa marrë parasysh këtë fakt, Ambasada e Stejt Departmentit propozoi të marrë masa me qëllim të ‘sabotimit (të kryetarit të Sirisë Bashar al Asadit) për sjelljen e vendimit, në mënyrë që ta destabilizojë dhe ta detyrojë të paguajë çmim të lartë për gabimet e veta’ (Ambasada amerikane, Damsk 2006).

Në ndërkohë, në rrugë e sipër ishte përgatitja e terrenit për intervenim kundër Sirisë. Stejt departamenti amerikan, kah fillimi i vitit 2006, ndau shumë prej 5 milion dollarësh për ‘Programin e reformave siriane të udhëheqjes’ (Wikas 2007; viii). Administrata e Bushit i financonte kanalet e mediave dhe organizatat jo qeveritare në Siri. Telegramet diplomatike amerikane pohojnë se Stejt departamenti ka financuar Kanalin televiziv të bashkësisë

siriane në egzil, TV Barada, me seli në Londër si dhe ‘Lëvizjen e të drejtës dhe zhvillimit’ (Whitlock 2011).

Ky ishte një program special i vënë paralelisht me projektet e ngjashme, të cilat amerikanët i kanë aplikuar gjerë e gjerë përmes Fondacionit Nacional për përhapjen e demokracisë NED që financohej nga buxheti i Ministrisë së punëve të jashtme të Amerikës. Financat për këto aktivitete sigurohen përmes organizatave ndërmjetësuese në Amerikë, veçanërisht përmes Këshillit për demokraci (Democracy Council), i cili, përsëri, fondet i siguron përmes kanaleve e Iniciativës të partnerëve për Lindjen e afërme - MEPI. Telegramet e ambasadës amerikane në Damask prej 2009 e më vonë flasin qw Këshilli për demokraci - DC ka pranuar 6.3 milion dollarë për udhëheqjen e programit të Sirisë me titull: ‘Iniciativa për forcimin e shoqërisë civile të Sirisë - CSSI, e cila përmbante ‘koncepte të ndryshme të imitimit’ duke përfshirë edhe TV Baradën. Shuma më e madhe, afro 12 milion dollarësh, është ndarë më vonë në periudhën ndërmjet viteve 2005 dhe 2010, me një vërejtje nga ambasada amerikane në Damask ndaj Stejt departamentit që qeveria siriane çfarëdo financimi të SHBA që jepet nga grupet politike jo legjitime {patjetër duhet ta konsiderojë si një fakt që ka për qëllim ndryshimin e regjimit’. Ambasada ishte e brengosur që bashkësia e inteligjencës së Sirisë (famëkeqi Muhaberat) mos t’u bjerë në gjurmë këtyre programeve. (Whitlock 2011). Edhe pse administrata e Bushit vuri një sërë sanksionesh kundër Sirisë në periudhën në mes vitit 2003 dhe 2008, gjoja për shkak të rolit të Sirisë në Liban dhe Irak, në të njëjtë kohë, amerikanët edhe më tej i mbajtën marrëdhëniet diplomatike me Sirinë në shkallë të lartë. Politika amerikane shpeshherë dukej inkohërente, ndërsa armiqësia ndaj Sirisë vepronte nën sipërfaqen e atyre marrëdhënieve. Administrata amerikane kërkoi aplikimin e liberalizimit të politikës ekonomike të Sirisë, por me këtë rast bllokoi orvatjet të Sirisë që të bëhej anëtare e Organizatës ndërkombëtare tregtare WTO. (Sadat and Jones 2009. William Rugh, ish ambasadori amerikan në Emiratet e bashkuara arabe, politikën amerikane ndaj Sirisë e karakterizoi si një politikë ‘izolimi dhe monologu’, ndërsa ish analisti i CIA-s

Martha Kessler deklaroi se e gjithë politika patjetër të vihet në premisën 'e kontekstit ku dominonte pohimi te shumica e anëtarëve të administratës amerikane që regjimi (qeveria siriane) duhet rrëzuar' (Sadat and Jones 2009).

Ambiciet e tilla përfshijnë edhe përgatitjet ushtarake dhe atë jo vetëm ato të natyrës konvencionale. Dy vjet para se të plasë dhuna në Siri, ish ministri i punëve të jashtme të Francës, Rolan Dumas, deklaroi: 'U takova me njerëzit më të lartë britanikë të cilët pranuan se përgatitin diç shumë të madhe lidhur me Sirinë... Britania kishte përgatitur invazionin e kryengritësve në Siri. Bile më pyetën, edhe pse unë atëherë nuk isha ministër i punëve të jashtme, nëse kam dëshirë të marr pjesë në këtë'. Dumasi shprehet se e ka refuzuar një gjë të tillë. (Lehman 2013). Cilët kanë qenë në të vërtetën detajet e atij plani të 2009, është e paqartë. Pa marrë parasysh atë, SHBA kanë përvojë shumëvjeçare në luftërat e ndyta dhe të fshehta, të cilat i ka udhëhequr përmes përfaqësuesve të vet në Amerikën Latine (El Salvador dhe Nikaragua), në Afrikë (Yair dhe Angolë) dhe në Lindjen e afërme (Afganistan). Pasiqë presidenti Bush e shpalli 'Luftën e tij kundër terrorizmit në vitin 2001 doracaku i ushtrisë amerikane mbi zhvillimin 'e luftës jokonvencionale' (UW), disa herë është ndryshuar, në mënyrë që t'i jepen një sërë aktiviteteve të cilat SHBA t'i marrin parasysh për t'i arritur qëllimet dhe ambiciet e veta. Versioni i këtij doracaku nga viti 2008 citon historianin e vjetër kinez Sun Tsu: 'ta mundësh armikun pa luftë është shkathtësia më e lartë (US Army 2008: 1.1). Kjo do të thotë që në mënyrë efikase t'i zhvillosh ato mjete që nuk nënkuptojnë konfrontim të drejtpërdrejt ushtarak. Ky doracak parasheh 'Luftë jokonvencionale' që duhet zhvilluar qoftë përmes surrogatit qoftë pa të', duke cituar shembuj të më hershëm nga Nikaragua dhe Afganistani. Doracaku në fjalë thekson 'qëllimin e definuar qartë të luftës jokonvencionale - UW (që nënkupton) dhënien e përkrahjes grupeve rebele, lëvizjeve të resitencës dhe operacioneve konvencionale ushtarake' (US Army 2008: 1.1 - 1.2). Një luftë e tillë jokonvencionale është ajo që është përgatitur për Sirinë, para ngjarjeve që ndodhën në gjysmën e dytë të vitit 2010 dhe 2011 në Egjipt dhe Tunis e që u

bënë të njohur si Pranvera arabe. Ai model, në të vërtetë, është vazhdim i strategjisë së Al-Kaidës (apo të Shtetit islam) në Irak që është i mbështetur në rrjetin e degës së Sirisë të Vëllezërve muslimanë, dhe gjithnjë të gatshëm për bashkëpunim me sauditët e disponuar, me orientim sektar dhe të nënshtruar.

Po të ishte Siria e izoluar si Iraku dhe Libia, do të ndodhte që ky plan të ishte zbatuar thjeshtë. Por, ushtria e NATO-s dhe përfaqësuesit e monarkive arabe të Gjirit u ballafaquan me boshtin e rezistencës (Axis of Resistance), së bashku me disa aleatë të fuqishëm që kanë përvojë të madhe në luftë me provokuesit sektar.

Shënime:

Brouno, Greg (2007) 'Profile: Al Qaeda in Iraq', Council on Foreign Relations report, Washington Post, 19 November, online:

<http://www.washingtonpost.com/wpdyn/content/article/2007/11/19/AR2007111900721.html>

Clark, Wesley (2007) A Time to Lead: for duty, honor and country, St. Martin's Press, London

DIA (1982) 'Syria: Muslim Brotherhood Pressure Intensifies', Defence Intelligence Agency (USA), May,

<http://syria360.files.wordpress.com/2013/11/dia-syria-muslimbrotherhoodpressureintensifies-2.pdf>

Felter, Josep and Brain Fishman (2008) 'Al- Qa'ida's Foreign Fighters in Iraq: a first look at the Sinjar records', Combating Terrorism Center at West Point, New York, online:

<https://www.ctc.usma.edu/posts/al-qaidas-foreign-fighters-in-iraq-a-first-look-at-the-sinjar-records>

Hersh, Seymour (2006) 'Watching Lebanon', The New Yorker, 21 August, <http://www.newyorker.com/magazine/2006/08/21/watching-lebanon>

Hersh, Seymour (2007) 'The Redirection', New Yorker, 5 March, online:<http://www.newyorker.com/magazine/2007/03/05/the-redirection>

Jones, Owen (2014) 'To really combat terror, end support for Saudi Arabia', The Guardian, 1 September,

<http://www.theguardian.com/commentisfree/2014/aug/31/combat-terror-end-support-saudi-arabia-dictatorship-fundamentalism>

Kaplan, Eben (2006) 'The Al-Qaeda-Hezbollah Relationship', Council on Foreign Relations, 14 August, online:

<http://www.cfr.org/terrorist-organizations-and-networks/al-qaeda-hezbollah-relationship/p11275>

Karon, Tony (2006) 'Condi in Diplomatic Disneyland', Time, 26 July, <http://content.time.com/time/world/article/0,8599,1219325,00.html>

Khoury, Rami (2006) 'Birth pangs of a New Middle East', Daily Star, July, <http://www.dailystar.com.lb/GetArticleBody.aspx?id=113043>

Lehmann, Christof (2013) 'Dumas, 'Top British officials confessed to Syria war plans two years before Arab Spring', NSNBC, 1 June, online: <http://nsnbc.me/2013/06/16/dumas-top-british-officials-confessed-to-syria-war-plans-two-years-before-arab-spring/>

Narwani, Sharmin (2011) 'Pentagon game to divide Iranians and Arabs', Salon, 26 October: http://www.salon.com/2011/10/26/pentagon_game_to_divide_iranians_and_arabs/

NSC (1980) 'Syria July 16, 1980', National Security Council, 4203XX, Memorandum for Zbigniew Brzezinski, declassified document

Ridolfo, Kathleen (2007) 'Iraq: Samarra Bombing Set Off Year Of Violence', Radio Free Europe, Radio Liberty, 12 February, online: <http://www.rferl.org/content/article/1074662.html>

Sadat, Mi H and Daniel B Jones (2009) 'U.S. Foreign Policy Towards Syria: balancing ideology and national interests', Middle East Policy Council, Summer, Volume XVI, Number 2, online:

<http://www.mepc.org/journal/middle-east-policy-toward-syria-balancing-ideology-and-national-interests?print>

Seale, Patrick (1988) *Asad: the struggle for the Middle East*, University of California Press, Berkeley CA

US Army (2008) 'Army Special Operations Forces: Unconventional Warfare', FM 3-05.130, United States Army John F. Kennedy Special Warfare Center and School, Fort Bragg NC

US Embassy Damascus (2006) 'Influencing the SARG in the end of 2006', Cable to US State Department, Wikileaks, 13 December, online: http://wikileaks.org/plusd/cables/06DAMASCUS5399_a.html

Wikas, Seth (2007) 'Battling the Lion of Damascus: Syria's domestic opposition and the Asad regime', Washington Institute for Near East Policy, Policy Focus #69, May,

<http://www.washingtoninstitute.org/policy-analysis/view/battling-the-lion-of-damascus-syrias-domestic-opposition-and-the-asad-regim>

Worth, Robert F. (2006) 'Blast Destroys Shrine in Iraq, Setting Off Sectarian Fury', New York Times, 22 February, online:

http://www.nytimes.com/2006/02/22/international/middleeast/22cnd-iraq.html?_r=0

3. Fuçi - bombat, burimet e anësishme dhe propaganda luftarake



Propaganda luftarake shpeshherë kërkon heqje të mendjes së shëndosh, ndërsa Lufta e ndytë në Siri këtë edhe e demonstroi me të madhe. Rrjedha e vazhdueshme e raporteve mbi krimet - ‘fuçi - bombat’, armët kimike, ‘vrasjes të nivelit industrial, vrasjet e foshnjave - përshkojnë të gjitha poret e raporteve të mediave perëndimorë mbi Sirinë. Pika e përbashkët e të gjitha këtyre të dhënave është se të gjithë, kryetarin e Sirisë dhe armatën, i konsiderojnë si monstrume që bëjnë masakra në popullatën civile duke përfshirë këtu edhe fëmijët. Mirëpo, po t’i analizojmë mirë të gjitha këto rrëfime, shihet se ato janë të përhapura nga burime të thjeshta. Neve për çdo ditë na shpëllajnë trurin.

Zakonisht të kuptuarit etik të principit të gazetarisë, siç është shmangia nga konflikti i interesave, të gjurmuarit e të dhënave të

pavarura dhe hetimi e diskualifikimi i të gjitha pohimeve që i përhapin palët ndërluftuese në mënyrë që të vërtetojnë versionin e vet të rrëfimit, injorohen krejtësisht në një pjesë të madhe të diskursit përëndimor të mediave.

Këtë atmosfere edhe ashtu toksike edhe më tepër e rëndon fabrikimi i dëshmimeve - provave me të cilat merret masa naïve. Edhe pse në të njëjtën mënyrë janë munduar të arsyetohen invazionet në të kaluarën (në Irak 2003) dhe lufta e fëlliqtë (në Libi 2011) të cilat ende janë të freskëta në kokat e njerëzve. Si në rastin e luftërave të më hershme, qëllimi i kësaj propaganda plotësisht është për demonizimin e armikut, duke shfrytëzuar pohime të shpeshta për kryerjen e krimeve dhe në këtë mënyrë të mobilizojë një përkrahje të gjerë të publikut për luftë (Knightley 2001). Megjithatë, bile edhe në rrethana lufte, lojaliteti ndaj parimeve të objektivitetit dhe të së vërtetës është i domosdoshëm kur shqyrtohen dëshmitë problematike: së paku atëherë kur dëshirojmë ta marrim vesh të vërtetën. Palët ndërluftuese gjithnjë kanë interes t'i diskreditojnë dhe t'i deligjitimojnë kundërshtarët e vet. Andaj dëshmitë e njëjës palë në konflikt gjithnjë duhet kundërvënë me argumente të kundërshtarit me një dozë të madhe të skepticismit.

Nuk bëhet fjalë për atë se njëra palë në konflikt është e paaftë ta kuptojë kundërshtarin e vet, por për atë se të gjitha pohimet e njëjës dhe të tjetrës palë gjithnjë janë të kushtëzuara me interesat e tyre të veçanta. Andaj gjithnjë duhet ta kemi parasysh lojalitetin. Nëse nuk ka mënyrë për t'u vërtetuar burimi dhe validiteti i dëshmisë, madje nëse ato dëshmi janë të anësishme dhe kanë për qëllim të arsyetojnë veprimin e njëjës palë ato patjetër të hudhen poshtë si të pavlefshme. Përrjashtimi i dëshmimeve të anësishme është i bazuar në parimet përgjithësisht të pranuar që aplikohen në të drejtën penale. Dëshmitë e tilla kanë vlerë vetëm në rast se janë të drejtuara kundër njëjës palë ndërluftuese, si te pranimi, ose kur ka çka të thotë mbi mentalitetin e palës që mundohet t'i shes si të vërteta.

Ky parim aplikohet pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për natyrën e dhunës së luftës, mendimin publik apo për lojalitet politik. Për shembull, kur grupet e armatosura islamike dhe ndihmësit e tyre

pohojnë se armiku i tyre për vdekje, Ushtria arabe e Sirisë bënë masakra mbi civilë (e.g. Ap 2015), pohimi i tillë është i parëndësishëm. Është krejtësisht e pritur që palët ndërluftuese të akuzojnë njëra tjetrën duk e shfrytëzuar propagandën dhe armën. Pohimet e rrejshme mbi krimet e forcave qeveritare përdoren që nga fillimi i konfliktit. Kreu i një manastiri në Hums, nëna Agnes-Mariam, i hedh si të pavërteta pohimet mbi krimet e ushtrisë siriane që i përhapën pjesëtarë të Ushtrisë së lirë të Sirisë gjatë vitit 2012, me çrast pamjet e civilëve të vrarë u recikluan në mediat që i transmetonin islamikët (SANA 2011). Në të njëjtën mënyrë, gazetari amerikan Nir Rosen luftëtarët e vrarë të opozitës së armatosur siriane i paraqet si ‘civilë të pafajshëm që i vranë forcat e sigurimit sirian’. (Rosen 2012). Çfarë mësimi mund të nxjerrim nga kjo? Bëheni të kujdesshëm ndaj rrëfimeve të anësishme mbi krimet. Këto më së miri mund të shërbejnë si shkas që duhet nxitur ndaj një procesi të pavarur të hulumtimit për dëshmi të pavarura.

Nga të njëjta arsye, kur monarkia e Katarit (e cila investoi miliarda dollarë për sulmet e armatosura ndaj Sirisë) prezanton dëshmitarë anonimë dhe të paguar nga Mbretëria me fotografi të një numri të madh të trupave të deformuar, duke fajësuar ushtrinë siriane se ka bërë ‘masakra të nivelit industrial’ (O’Toole 2014: MMM 2014).

Fakti se këto dëshmi i ofron njëra palë ndërluftuese në konfliktin pak para se të mbahej Konferenca për paqë në Gjenevë, andaj nuk ka arsye më serioze për të dyshuar në ato dëshmi.

Pa dëshmi të vërteta të pavarura që do ta vërtetonin pohimin e dëshmitarit, nuk mund të verifikohen ato incizime se në cilin vit, në çfarë rrethana madje edhe në cilin vend janë bërë. Ata që financojnë dhe armatosin grupet sektare kanë masakruar me mijëra njerëz gjatë disa viteve të kaluar në luftërat në Afganistan, Irak dhe Siri. Mungon fotografia e trupave të vdekur. Fakti se burimet e mediave perëndimore i përsëritin këto akuza, duke i shfrytëzuar avokatët e vet, (të cilët po ashtu i paguan Katari) ashtu që prej kurrigje ta shtynë argumentin e vet si të vërtetë.

(Cartalucci 2014; Murphy 2014) tregon kufizimin e të kuptuarit të nocioneve të dëshmimeve të pavarura. I njëjti princip zbatohet kur bëhet fjalë mbi dhënien e të drejtës për legjitimitet.

Pohimi i nëpunësve të qeverisë së SHBA të cilëve haptas (dhe në të kundërtën me normat e të drejtës ndërkombëtare) u kërkohet ‘ndryshim e regjimit në Siri’, madje, me që kryetari Asad ‘humbi legjitimitetin’ (e.g. Hilary Clinton në Al-Xhezire 2011) duhet trajtuar si propaganda egoiste dhe të anësishme.

Me rastin e pohimit të Vashingtonit në lidhje me sulmin e gushtit në anën veriore të Ghouta 2013 në të cilën, gjoja se, janë përdorur armë kimike, administrate amerikane dhe disa agjenci të saj provuan të shfrytëzojnë disa forma të dëshmitit indirekt në mënyrë që ta futin ushtrinë siriane në këtë krim. (Gladstone and Chiver 2013; HRW 2013). Por, pasi që pohimet u hodhën poshtë me një sërë dëshmi të pavarura (Llozd and Postol 2014; Hersh 2014; Anderson 2015), Vashingtoni dhe periferia e tij e mediave, thjeshtë, vazhduan me përsëritjen e të njëjtave akuza diskreditive. Në rrethana lufte, të rrallë janë ata që kanë guxim të mjaftueshëm për të thënë se ‘mbreti është lakuriq’.

Edhe më tepër kujdes duhet kushtuar në situatën kur dëshmitë e njëres palë ndërloftuese veprojnë kundër interesave të veta. Për shembull, gjatë vitit 2012, mediat perëndimore morën në intervistë tre komandantë të Ushtrisë së lirë siriane (FSA) në Halep (Aleppo). Që të tre pranuan se banorët lokale nuk mund t’i durojnë, ndërsa presidenti i Sirisë gëzon përkrahjen e shumicës së popullatës. Njëri deklaroi se Asadi gëzon 70 përqind të përkrahjes (Bayoumy 2013) në atë qytet që me shumicë është i banuar me muslimanë sunitë, Tjetri tha se banorët lokale, ‘të gjithë me radhë’ janë lojalë të Basharit, dhe ata neve na spiunojnë (Abouzejd 2012). I treti deklaroi se të gjithë banorët ‘spiunët që na urejnë neve... na akuzojnë për shkatërrim’ (Abdul - Ahad 2012). Edhe pse kjo është një dëshmi anekdotike sepse u kundërvihet interesave të palës në konflikt, përsëri ka vlerën e vet sepse nuk është shfrytëzua për interes personal.

Në të njëjtë mënyrë, kur shefat e qeverisë së NATO-s pohuan se kryetari Asad ‘shumë herët ka humbur të gjitha llojet e legjitimitetit’, raporti intern i NATO-s vlerësoi se 70 përqindje të sirianëve e përmbajnë Asadin, 20 përqind janë neutralë ndërsa 10 përqindje i përmbajnë ‘kryengritësit’ (World Tribune 2013; Bin 2013).

Edhe pse nuk ekzistojnë detaje që mund të gjenden në lëmin publik mbi metodat në bazë të së cilave janë sjell këto ndryshime, ato përsëri kanë një rëndësi të kufizuar me që ato ndryshime nuk janë të motivuara interesave personale por në dëm të tyre. Më pastaj, ato vlerësime përafërsisht janë të njëjta me rezultatin të zgjedhje presidenciale që u mbajtën në qershor të vitit 2014, ku Bashar el Asadi fitoi 65 të përkrahjes të të gjithë votuesve që është afro 88,7 përqindje të trupit votues nga 73,4 përqindje të atyre që dolën në votime. (Idea International 2015). Gabimi më i shpeshtë dhe më i madh i mediave të perëndimit që merren me raportimin mbi krizën e Sirisë, gjithsesi se është mbështetja jo e zakonshme e burime individuale njerëzore të raportimit, në këtë rast bëhet fjalë për personin që jeton në Londër e që veten e quan observatori sirian për të drejta njerëzore (SOHR).

Shumica e raporteve mbi numrin e sakrificave qeveritare dhe mbi dëmin shumë të madh pikërisht vjen prej këtij burimi. Nga ana tjetër, është e njohur se ky person me emrin Rami Abdur-rahman gjatë kohë në veb faqen e tij ka ngritur flamurin e ‘Ushtrisë së lirë siriane’ që vepron nën udhëheqjen politike të Vëllezërve muslimanë. (SOHR 5015).

Ai pohon se informatat i mbledh nga rrjeti i bashkëpunëtorëve të vet në Siri dhe në vendet më të afërta. E logjikshme është të konkludojmë se këto informata vijnë prej burimeve antiqeveritare. Kanalet e mediave që mbështeten në këtë burim haptas të anësishëm informative ia bëjnë varrin krdeblitetit të vet. Mbase nuk e zënë për të madhe nëse janë apo jo të sakta informacionet. Fakti që shumica e qeverive perëndimore përkrahin linjën e Vëllezërve muslimanë kur është fjala për konfliktin sirian, (rrëfim sektar kundër shtetit shekullar) më pak i brengos objektiviteti i informimit. Ato kanale rregullisht prezantojnë versionin e rrëfimit që e përhapën

SOHR, shpeshherë madje edhe me një numër të madh sakrificash, sikur të ishin ato të vërteta (e.g. AP 2015; Pollard 2015).

Injorimi i atyre pohimeve nga ana e ‘regjimit’ nganjëherë i shtohet paragrafit 7 dhe 8, për të lënë përshtypje për gazetari objektive. Kritikata e kohëpaskohshme të Abdur-rahmanit grupeve rivale selefiste (sikur DAESH -ISIL) me siguri raporteve të tij u jep një kredibilitet iluzor. Sidoqoftë të pranuarit kuturu të këtyre raporteve të anësishme është një mbështetje e rëndësishme në jetën e miteve të Perëndimit mbi atë se armata siriane nuk bënë thuajse asgjë tjetër pos vrasjes së popullatës civile.

Një problem gati identik mund të shihet edhe në fushatën gjatë viteve 2014-2015, kundër përdorimit të ‘fuçi- bombave’, ku përmendet se është një lloj bombe specifike që e ka përdorur aviacioni luftarak i Sirisë (e cila përbëhet prej karburantit motorik dhe lëndës shpërthyes) e përshtatshme për viktima civile masive. Robert Parry (2015) thekson një moment të rëndësishëm kur thotë se cilado lloj bombe e improvizuar që gjuhet me helikopter ka shumë më pak efekt gërryes dhe diskriminator prej shumë sulmeve raketore, mos të flasim për municionin që përmban uranium të varfëruar, napalm, fosfor të bardhë dhe municion klaster që e shfrytëzon Washingtoni.

Megjithatë, këtu s’është fjala vetëm për problemin e teknologjisë perse, por fjala është për një metodë të re të përhapjes së frikës që ka për qëllim sigurimin e përkrahjes së luftës kundër Sirisë, duke pohuar se armata siriane, në realitet, nuk bënë asgjë tjetër përpos vrasjes së civilëve.

Pa marrë parasysh atë, pjesa më e madhe e lokacioneve për të cilat thuhet se kundër tyre janë përdorur ‘fuçi - bomba’, në periudhën prej 2014-2015, në realitet janë që vite me radhë janë të banuara nga bandat islamike sektare; pjesa verilindore e Halepit, pjesa periferike e Domës në anën verilindore të Damaskut dhe Rakkasë në lindje të shkretëtirës të Sirisë.

Human Rights Watch selia e së cilës është në Washington (e lidhur ngushtë me Këshillin për politikë të jashtme, organ joformal i

politikë së jashtme amerikane - Council on Foreign Relations) publikoi mapën që tregon vendet se ku janë hudhur me qindra nga fuçi - bombat në pjesën verilindore të Halepit që është nën kontrollin e forcave opozitare (HRW 2014). ‘Opozita’ në këto vise është degë zyrtare e Al-Kaidës në Siri (Xhebhatu-nusra) që është në aleancë me Frontin islam pas të cilit qëndron Arabia saudite (ndërsa grup konglomerat i Ushtrisë së lirë siriane që përbëhet prej Hareket el ahrar es-Sham, Sukursh --Sham, Livaut-Tawhid, Xhejshul-Islam, Xhebbhetul kurdiije, Livaul-hak dhe Ahrarush-Sham) kurse më vonë edhe ‘shtetet islame në Irak dhe Levant’ (ISIL), Partisë turkeстане islame dhe Ushtrisë së fitores, thuajse të gjitha formacionet e përmendura në planin ndërkombëtar zyrtarisht janë shpallur si organizata terroriste që janë përgjegjëse për krime të shumëfishta në Siri. Aspak nuk habit fakti që ushtria siriane rregullisht i bombardon grupet e armatosura të cilat gjenden në këtë territor.

Përkundër mitit mbi ‘kryengritësit e përmbajtur, grupet terroriste shumë shpesh bashkëpunojnë ndërmjet. Për shembull, Udhëheqësi i lartë i Ushtrisë së lirë siriane të cilën e përmban qeveria e SHBA-së, Abdul-Xhabir el -Ukaidi, për afërsisht është i hapur në lidhje me faktin se bashkëpunojnë ndërmjet me formacionet ISIL të Daesh-it (shih Eretz Zen 2014). FSA gjithashtu, që nga fillimi, është e lidhur ngushtë në bashkëpunim me grupin tjetër udhëheqës të Al-Kaidës, Xhebbhetun-Nusra

Pohimet e burimit të informacioneve mbi viktimat ‘civile’ ekskluzivisht vijnë nga grupet islamike, ose nga aktivistët që veprojnë në bashkëpunim me ata. Madje pohimet e tyre më vonë magnifikojnë mediat perëndimore edhe disa organizata jo qeveritare për të drejta njerëzore, të cilat gjithashtu, në aspekt praktik, janë të pandashme nga politika e jashtme e vendeve perëndimore.

Numri i viktimave tipikisht shpallet nga ana e observatorit sirian për të drejta njerëzore i stacionuar në Britaninë e Madhe, (SOHR 2015) nga rrjetet siriane për të drejta njerëzore, po ashtu në Britani, (SN4HR 2015) ose nga Qendra e Stambollit për dokumentacionin e lëndimit në Siri (VDC 2015; Masi 2015). Të gjitha këto qendra janë të afërta me grupet islamike, por zakonisht haptas janë të

distancuara prej ISIL. VDC i ka dokumentuar disa viktime në Siri si ‘shehidë’ të revolucionit, por poenta kryesore qëndron në atë se të gjitha këto qendra në realitet janë përfaqësuese lojale të forcave opozitare të islamikëve sektarë që i janë përkushtuar idesë të përmbysjes me dhunë të shtetit sirian dhe për këtë janë shumë të motivuar për të nxjerrë të pavërteta për ushtrinë siriane.

Komandanti suprem në luftën propaganduese, presidenti amerikan Obama, është prijësi i tyre, duke pohuar se ushtria siriane ‘përdor fuçi - bomba për t’i masakruar fëmijët e pafajshëm’ (Obama in Mosendz 2015). Meqë kurrë nuk janë gjetur argumente se kryetari Asad ka pasur për qëllim të vras fëmijë’ Parry (2015) ka plotësisht të drejtë kur një pohim të tillë e quan ‘propagandë të pafytyrë dhe mashtruese’. Shtëpinë e bardhë për këtë e përkrahin ‘vëzhguesi i instaluar’ Human Rights Watch, shefi Kenneth Roth i të cilit në mënyrë të tërbuar përsërit fjalët ‘fuçi - bomba’, ndërkaq është zbuluar se si bën fotografi të Gazës Kobanës së rrënuar, duke pohuar rrejshëm se këto janë fotografite të Halepit pas bombardimit nga ana trupave të Asadit. (MOA 2015; Interventions Watch 2015). Në të vërtetë ato fotografi tregojnë pasojat e bombardimit të Izraelit, Amerikës dhe ISIL. Riciklimi i fotografive të viktimave të rëna nga lufta u bë një dukuri rutinore e zakonshme. Por themelet mbi të cilat qëndron propaganda luftarake e Perëndimit mbështetet në burime të anësishme dhe lojale.

Fushata në lidhje me ‘fuçi - bombat’ haptas shihet së është e trilluar për të legjitimuar ushtrinë siriane dhe ushtrinë e vet, por edhe për të penguar ose ngadalësuar sulmet ndaj grupeve islamike, Pa marrë parasysh këtë, qeveria siriane askujt nuk i kërkon falje për bombardimin e pjesëve të vendit që i mbajnë terroristët.

Shumica e civilëve në viset që janë bombarduar me ‘barel bomba’ kohë më parë i ka braktisur ato vendbanime. Në janar të viti 2015 Reuters (2015a) publikoi një video incizim të disave nga evakuimet të Doum-s që e kreu ushtria siriane. Disa muaj më vonë e njëjta agjenci ndihmoi për masakrën e civilëve në Doum, me ndërmjetësimin e ‘aktivistëve’ të SOHR-it që e përmend si burim. (Reuters 2015b), Përsëritja e këtyre pohimeve të rrejshme nga ana e

islamikëve dhe aktivistëve të lidhur me ta si dhe nga mbështetësit e tyre perëndimorë, nxori tituj si ‘burel bombat e regjimit sirian që ka vrarë më shumë civilë se sa ISIL-i së bashku me Al-Kaidën’ (Masi 2015). Titujt e këtillë kanë nxitur sulme edhe më të ashpra kundër Sirisë. Fotografitë e grave dhe të fëmijëve të vrarë apo të lënduar në qytetet e braktisura të banuara me grupe të armatosura thjesht janë huazuar nga situatat e tjera kontekstuale. Amnesty International (SHBA) kryesisht e përvetësoi rrëfimin mbi barel bombat së bashku me numrin e trilluar të civilëve të vrarë. Por, Amnesty-a dobësinë metodologjike të veçantë e mbështeti në burime të anësishme si dhe VDC, SN4HR dhe SOHR. Animi properëndimor i Amnesty-së e solli këtë organizatë deri aty të përsërit budallallëqet të cilat NATO i kishte konstruktuar më në situata tjera, si ato në Kuvajt dhe Libi (Sterling 2015b).

Krejt atë që e thamë më lartë nuk do të thotë se ushtria siriane nuk ka vrarë civilë, veçanërisht ata që kanë jetuar së bashku me grupet terroriste. Mirëpo, shumë sirianë familjet e të cilëve janë goditur nga sulmet terroriste, parashtrojnë pyetje se pse trupat qeveritare nuk e kanë bombarduar gjithashtu zonën siç është Doum-ën në anën verilindore të Halepit Rakka-së. Ata qytetarë vërtetojnë se të vetmit civilë që kanë mbetur atje, realisht, janë ata që i përkrahin bandat tjera të njohura me therjen në fyt.

Amerika gjithsesi nuk ka ngurruar t’i bombardojë pjesëtarët e rezistencës kundër okupimit të Irakut në Falluxhë (Irak) gjatë vitit 2014. (Democracy Now (2015). Megjithatë, në Siri situata ka qenë krejt ndryshe, si deklaroi një ish pjesëtar i milicisë ruse-siriane shtetërore: ‘Islamikët me qëllim fshihen pas civilëve. Por sikur t’i kishim vrarë me të vërtetë të gjithë ata që i japin ndihmë armikut, distriki i DOUM-ës do të ishte zhdukur shumë kohë më parë - ai thjesht do të ishte rrafshuar me tanke për një ditë të vetme, siç e kërkojnë gjatë kohë disa sirianë kokëfortë. Por Asadi nuk e dëshiron këtë...detyrë e jona është të mundohemi ta bashkojmë vendin. Prandaj, para çdo aksioni, neve na është dhënë urdhër i rreptë që në asnjë mënyrë nuk kemi të drejtë të gjuajmë në civilë. Nëse ndodh që të vdes ndonjë civil, gjithnjë bëhen

hetim e nëse konstatohet fajtori, pason gjyqi ushtarak. (Mizah 2015). Ky rezon thjesht injorohet në bisedimet e paarsyeshme perëndimore mbi luftën e Sirisë.

Ata që marrin mendimin publik jashtë Sirisë patjetër e kanë të mbajnë llogari të veçantë dhe të jenë të kujdesshëm kur lehtë sjellin përfundime mbi situatën e luftës të Sirisë së shkatërruar. Për shembull edhe pse ORB International e Britanisë nuk është agjenci shtetërore, ajo sërish vepron brenda dhe është e financuar nga një vend me orientim armiqësor ndaj Sirisë dhe është e angazhuar në mënyrë aktive në diskutimet që janë me interes për palët ndërluftuese. Rasti që vërteton këtë është me sa vijon: Të kërkuarit e mendimit publik është zbatuar kah mesi i vitit 2014 sugjeroi që ‘tre prej pesë sirianëve mbështetin intervenimin ushtarak ndërkombëtar’ (ORB 2014: Table 1). Një përfundim i këtillë tërheq vëmendjen e qeverive perëndimore dhe ky numër thjesht është joreal. Para së gjithash, ata qytetarë sirian që mbështetin qeverinë (e që sipas numrit më të madh të hulumtimeve përbëjnë shumicën e popullatës) gjithnjë kanë qenë kundër intervenimit ushtarak. Tjetra, shumica e opozitës siriane po ashtu e kundërshton intervenimin e jashtëm. Dokumenti më voluminoz i opozitës siriane, Deklarata e Damaskut (2005) njësoj u kundërvihet sulmeve të armatosura ndaj forcave qeveritare si dhe intervenimit të jashtëm. Vetëm Vëllezërit muslimanë. disa personalitete në egzil, dhe disa grupe kurde janë ndarë nga opozita. Pohimi se 60 përqindje e qytetarëve sirianë, pas tre viteve luftë, dhe vuajtja e madhe e popullit sirian, të cilëve iu bashkëngjitën në masë të madhe intervenimet e forcave të vendeve të paktit të NATO-s dhe monarkive të Gjirit, dëshiron një lloj intervenimi të atillë të huaj thjesht nuk i përgjigjet gjendjes faktike. Kjo është një arsye që i përgjigjet shkaktuar joreprezentativ që u jep përparësi atyre që e mbështetin opozitë e armatosur. Andaj është e domosdoshme të analizohet mënyra në të cilën ORB i mbledh të dhënat. Metodot e tyre janë jo transparente. Kjo organizatë me seli në Britani bën hulumtimin e mendimit (opinionit) publik në mënyrë që të inkluadrojë në punë një numër të vogël sirianësh me të cilët komunikojnë përmes telefonit dhe

interesit. Këto aktorë lokalë stërviten si të bëjnë selektimin dhe si t'u bëjnë intervista grupeve të vogla njerëzish në mbarë Sirinë. ORB ofron informacione të vogla për mënyrën e zgjedhjes së bashkëpunëtorit në Siri, dhe në bazë të të cilëve kritere si revanshim bëjnë seleksionimin e informuesve. Ata thjesht pohojnë se hulumtimet e tyre pasqyrojnë gjendjen e përgjithshme dhe se janë reprezentative.

Sipas një analize të bërë kah mesi i vitit 2014 thuhet se 4 përqind e sirianëve pohojnë se grupi islamik që e përmban Arabia saudite, ISIS/Daesh 'më së miri i përfaqëson interesat dhe dëshirat e popullit sirian' (ORB 2014). ISIL- i deri në atë moment ishte bë grupi më i dalluar i armatosur antiqeveritar në Siri. Ky rezultat (i përkrahjes prej 4 përqindje) vërtetë dukej i pranueshëm dhe ishte konzistent me informacionet tjera në dispozicion. Por lojaliteti i saj u rrënuar në mënyrë joreale me nivelin e lartë të përkrahjes së intervenimit ushtarak të jashtëm.

Anomali shtesë është ajo që anketimi i ORB që është realizuar në korrik të vitit 2015 tregon se 21 përqindje e të anketuarve në Siri përmkrahin ISIL-in (ORB 2015: Table 3). Edhe pse parashtrimi i pyetjes nuk ka qenë identik, dallimi në mes dy rezultateve (4% dhe 21%) është i madh dhe është rëndë për ta shpjeguar me çfarëdo qoftë që ka ndodhur në ndërkohë në mes vitit 2014 dhe 2015. Askush tjetër nuk e ka dëshmuar që fanatikët e ISIL-Daesh-it për aq kohë të shkurtër kanë mbetur të përkëdhelur për aq një grup njerëzish. Përkrahja prej 35% e grupit terrorist Xhebhethun-Nusra (ORB) që i ka dalë nami për sulme vetëvrasëse, kamina bombë dhe prerje të kokave gjithashtu objektivisht është e papranuar. Thjeshtë thënë, si mundet që një e treta e popullit 'me dashamirësi' të shikojë në këtë organizatë terroriste e cila ka marrë namin për krimet e bëra? Haptas duket se këtu diçka nuk është në rregull. I vetmi shpjegim i pranueshëm është që shkalla e lartë e lojalitetit ka ndikuar në pohimin mbi përfaqësimin e gjerë të anketimit që e realizoi ORB. Kjo organizatë edhe më herët ka qenë goditje të kritikave akademike për mos transparencën e vet dhe nxjerrjen në sipërfaqe të metodave dhe 'parregullsive të

rëndësishme' në vlerësimet e tyre për viktimat e rëna në luftën e Irakut. (Spagat and Dougherty 2010).

Ky lojalitet është prezent edhe në të dhënat që kanë të bëjnë me Sirinë. Efhe përkundër numërit të fryrë të mbështetjes së madhe të Al= Kaidës, anketimi i vitit 2015 tregon se kryetari Asad është forca më pozitive në vend edhe pse përkrahja e tij ishte vetëm 47% (ORB 2015: Table 3), numëri më i vogël prej cilitdo anketim tjetër (sirian apo josirian) gjatë kohës së krizës. Interesant është që anketimi ORB nga viti 2015 pohon që 82% e sirianëve besojnë se SHBA e ka prodhuar ISIL-in (ORB 2015: Table 20). Por, sipas anomalive tjera që e karakterizojnë punën e ORB- së nuk mund vërtetohet se sa është ky numër i besueshëm. Thjesht duket se anketimi ORB-së për shkak të procesit të tyre selektiv jo transparent, tepër rëndësi u ka dhënë anketuesve antiqeveritarë. Kjo mbase nuk habit marrë parasysh se bëhet fjalë për organizatë britanike dhe mund të provokojë mendimin e gjerë publik në vendet perëndimore, por kjo nuk ndihmon te popujt perëndimorë për ta kuptuar më mirë Sirinë.

Edhe pse është me rëndësi të kuptohen burimet e lojalitetit, të përsëriturit e rrëfimit në bazë të burime lojale nuk mund të jetë vetëm çështje lojaliteti **për se**. E kemi të njohur në bazë të dëshmive të pavarura që mohimet e mëparshme mbi masakrat janë fabrikuar nga ana e grupeve sektare, të cilat atëherë gëzonin përkrahjen e Vashingtonit. Kjo është e dokumentuar në lidhje me vrasjet masive në qytetet Houla, Akrah, Daraza dhe në Ghoutën Veriore (shih Anderson 2015a dhe 2015b). Pasi që u zbulua kjo, nuk u kërkuar asnjë falje as u dha ndonjë mirënjohje si nga ana e Shtëpisë së Bardhë ashtu edhe nga mediat perëndimore që të parët e publikuan këtë. Ky shembull tregon se ka pasur edhe trillime tjera. Pra, gjersa vëzhguesit autentik të krizës patjetër t'i kushtojnë vëmendje kërkimit principiell të pohimit dhe kundër pohimit, po ashtu duhet kushtuar kujdes makinerisë që prodhon propagandë të gjerë, e cila me siguri me një ritëm të njëjtë do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Shēnime :

Al Jazeera (2011) 'Clinton says Asad has 'lost legitimacy'', 12 July, <http://www.aljazeera.com/news/middleeast/2011/07/201171204030379613.html>

Anderson, Tim (2015) 'The Houla Massacre Revisited: 'Official Truth' in the Dirty War on Syria', Global Research, 24 March, online: <http://www.globalresearch.ca/houla-revisited-official-truth-in-the-dirty-war-on-syria/5438441>

Anderson, Tim (2015b) 'Chemical Fabrications: East Ghouta and Syria's Missing Children', Global Research, 12 april, online: <http://www.globalresearch.ca/chemical-fabrication-east-ghouta-and-syria-missing-children/5442334>

AP (2015) 'Syrian army barrel-bomb attacks kill at least 70 in Alpepo, activists say', The Guardian, Associated Press, 31 May, online:

<http://www.theguardian.com/world/2015/may/30/syrian-army-air-strikes-alpepo-islamic-state>

Cartalucci, Tony (2014) 'US Foreigns 'Horror' Over Cooked- Up Report on Syrian War They Engineered', Land Destroyer Report, January, online:

<http://www.landdestroyer.blogspot.com.uk/2014/01/us-feing-horror-over-cooked-up-report.html>

Damascus Declaration (2005) 'The Damascus Declaration for Democratic National Change', English version in Joshua Landis blog 'Syria Comment', 1 November, online:

<http://faculty-staff.ou.edu/L/Joshua.M.Landis-1/syriablog/2015/11/damascus-declaration-in-english.htm>

Democracy Now (2005) 'Pentagon Reverses Position and Admits U.S. Troops Used White Phosphorus Against Iraqis in Fallujah', 17 November, online:

http://www.democracynow.org/2005/11/17/pentagon_reverses_position_and_admits_u

Eretz Zen (2014) 'US Key Man in Syria Worked Closely with ISIL and Jabhat al-Nusra', Youtube, 17 August, online:

http://www.youtube.com/watch?v=piN_MNSis1E

Gladstone, Rick and C.J Chivers (2013) 'Forensic Details in U.N. Report Point to Assad's Use of Gas', New York Times, 16 September, online:

http://www.nytimes.com/2013/09/17/world/europe/syria-initiated-nations.html?_r=0&adxnnl=1&adxnnlx=1387381766-55AjTxhuELAeFSCuukA70g

Hersh, Seymour (2014) 'The Red Line and the Rat Line', London Review of Books, 17 April, online:

<http://www.lrb.co.uk/v36/n08/seymour-m-hersh/the-red-line-and-the-rat-line>

HRW (2013) 'Attacks on Ghouta: Analysis of Alleged Use of Chemical Weapons in Syria', Human Rights Watch, Washington, 10 September, online:

<http://www.hrw.org/reports/2013/09/10/attacks-ghouta>

HRW (2014) 'Syrian Government Bombardment of Opposition-held Districts in Aleppo', Human Rights Watch, 30 July, online:

<http://www.hrw.org/video-photos/image/2014/07/30/syrian-government-bombardment-opposition-held-districts-aleppo>

Idea International (2015) 'Voter turnout data for Syrian Arab Republic', online:

<http://www.idea.int/vt/countryview.cfm?id=210#pres>

Interventions Watch (2015) 'CEO of Human Rights Watch misattributes video of Gaza destruction', 9 May, online:

<http://interventionswatch.wordpress.com/2015/05/09/ceo-of-human-rights-watch-misattributes-video-of-gaza-destruction/>

Jalabi, Raya (2015) 'Images of Syrian torture on display at UN: 'It is imperative we do not look away'', The Guardian, 12 March, online:

<http://www.theguardian.com/world/2015/march/11/images-syrian-torture-shock-new-yorkers-united-nations>

Knightley, Philip (2001) 'The disinformation campaign', The Guardian, 4 October, online:

<http://www.theguardian.com/education/2001/oct/04/socialsciences.highereducation>

Lloyd, Richard and Theodore A. Postol (2014) 'Possible Implications of Faulty US Technical Intelligence in the Damascus Nerve Agent Attack of August 21, 2013'. MIT, January 14, Washington DC, online:

<http://www.documentcloud.org/documents/1006045-possible-implications-of-bad-intelligence.html#storylink=relat>

Masi, Alessandria (2015) 'The Syrian Regime's Barrel Bombs Kill More Civilians Than ISIL and Al Qaeda Combined', IBTimes, 18 August, online:

<http://www.ibtimes.com/syrian-regimes-barrel-bombs-kill-more-civilians-isil-al-qaeda-combined-2057392>

- Mint Press (2015) 'US Propaganda War in Syria: Report Ties White Helmets to Foreign Intervention', 11 September, online:
<http://www.mintpressnews.com/us-propaganda-war-in-syria-report-ties-white-helmets-to-foreign-intervention/209435/>
- Mizah, Michel (2015) 'A Russian- Syrian volunteer talks about his experience in the "Shabiha" pro-Asad paramilitary', interviewed by Arthur Avakov, Live Leak, 15 September, online:
http://www.liveleak.com/view/?i=992_1442362752
- MOA (2015) 'Human Rights Watch Again Accuses Syria Of 'Barrel Bomb' Damage Done By Others ', Moon of Alahama, 9 May online:
<http://www.moonofalahama.org/2015/05/human-rights-watch-again-accuses-syria-of-barrel-bomb-damage-done-by-others.html>
- Mosendz, Poll (2015) 'The Full Transcript of President Obama's Speech at the United Nations General Assembly', Newsweek, 28 September, online:
<http://www.newsweek.com/read-full-transcript-president-obamas-speech-united-nations-general-assembly=377504>
- MMM (2014) 'Fail Caesar: Exposing the Anti- Syria Photo Propaganda' Monitor on massacre marketing', 8 November, online:
<http://www.libyancivilwar.blogspot.com.au/2014/11/fail-caesar-exposing-anti-syria-photo.html>
- Murphy, Dan (2014) 'Syria 'smoking gun' report warrants a careful read', Christian Science Monitor, 21 January, online:
<http://www.csmonitor.com/World/Security-Watch/Backchannels/2014/0121/Syria-smoking-gun-report-warrants-a-careful-read>
- ORB (2014) 'Three in Five Syrians Support International Military Involvement', ORB International, July, online:
<http://www.opinion.co.uk/article.php?s=three-in-five-syrians-support-international-,military-invlvement>
- ORB (2015) 'ORB/IIACSS poll in Syria and Iraq gives rare insight into publik opinion', ORB International, July, online:
<http://www.opinion.co.uk/article.php?s=orbiiacss-poll-in-iraq-and-syria-gives-rare-insight-into-publik-opinion>
- O'Toole, Gavin (2014) 'Syria regime's 'industrial scale killing', Al Jazeera, 22 January, online:
<http://www.aljazeera.com/indepth/features/2014/01/syria-regime-industrial-scale-killing-2014122102439158738.html>

Parry, Robert (2015) 'Obama's ludicrous 'barel bomb' theme', Consortium News, 30 September, online:

<http://www.consortiumnews.com/2015/09/30/obamas-ludicrous-barrel-bomb-theme/>

Pollard, Ruth (2015) 'Asad regime's barrel bomb attacks caused many civilian deaths in Syria: UN Envoy', Sydney Morning Herald, 23 July, [the headline suggests the UN envoy is the source of the 'barrel bomb' kills civilians story, in fact the SOHR is the source] online:

<http://www.smh.com.au/world/assad-regimes-barrel-bomb-attacks-caused-many-civilian-death-in-syria-un-envoy-20150722-giibvw.html>

Reuters (2015) 'Over 1,000 Syrian civilians evacuated from near Damascus', Youtube, 17 January, online:

<http://www.Youtube.com/watch?v=H-DstETWITY>

Reuters (2015b) 'Air strikes near Damascus kill at least 80 people: activists', 16 August, online:

<http://www.reuters.com/article/2015/08/16/us-mideast-crISISIL-syria-idUSKCNOQLOE320150816>

Rosen, Nir (2012) 'Q&A: Nir Rosen on Syria's armed opposition', Al Jazeera, 13 Feb, online:

<http://www.aljazeera.com/indepth/feauters/2012/02/201221315020166516.html>

SANA (2011) 'Mother Agnes Merriam al-Saeed: Nameless Gunmen Possessing Advanced Firearms Terrorize Citizens and Security in Syria', Syrian Free <http://www.moonofalabama.org/2015/05/human-rights-what-again-accuses-syria-of-barrel-bomb-damage-done-by-others.html>

Mosendz, Poll (2015) 'The Full Transcript of President Obama's Speech at the United Nations General Assembly', Newsweek, 28 September, online:

<http://www.newsweek.com/read-full-transcript-president-obamas-speech-united-nations-general-assembly-377504>

MMM (2014) 'Fail Caesar: Exposing the Anti-Syria Photo Propaganda', Monitor on massacre marketing', 8 November, online:

<http://libyancivilwar.blogspot.com.au/2014/11/fail-caesar-exposing-anti-syria-photo.html>

Murphy, Dan (2014) 'Syria 'smoking gun' report warrants a careful read', Christian Science Monitor, 21 January, online:

<http://www.csmonitor.com/world/Security-Watch/Backchannels/2014/0121/Syria-smoking-gun-report-warrants-a-careful-read>

ORB (2014) 'Three in Five Syrians Support International Military Involvement', ORB International, July, online:

<http://www.opinion.co.uk/article.php?s=three-in-five-syrians-support-international-military-involvement>

ORB (2015) 'ORB/IIACSS poll in Syria and Iraq gives rare insight into public opinion', ORB International, July, online:

<http://www.opinion.co.uk/article.php?s=orbiiacss-poll-in-iraq-and-syria-gives-rare-insight-into-public-opinion>

O'Toole, Gavin (2014) 'Syria regime's 'industrial scale killing', Al Jazeera, 22 January, online:

<http://www.aljazeera.com/indepth/features/2014/01/syria-regime-industrial-scale-killing-2014122102439158738.html>

Parry, Robert (2015) 'Obama's ludicrous 'barrel bomb' theme', Consortium News, 30 September, online:

<http://www.consortiumnews.com/2015/09/30/obamas-ludicrous-barrel-bomb-theme/>

Pollard, Ruth (2015) 'Assad regime's barrel bomb attacks caused many civilian deaths in Syria: UN Envoy', Sydney Morning Herald, 23 July, [the headline suggests the UN envoy is the source of the 'barrel bomb' kills civilians story, in fact the SOHR is the source] online:

<http://www.smh.com.au/world/assad-regimes-barrel-bomb-attacks-caused-many-civilian-death-in-syria-un-envoy-20150722-giibvw.html>

Reuters (2015) 'Over 1,000 Syrian civilians evacuated from near Damascus', Youtube, 17 January, online:

<http://www.Youtube.com/watch?v=H-DstETWITY>

Reuters (2015b) 'Air strikes near Damascus kill at least 80 people: activists', 16 August, online:

<http://www.reuters.com/article/2015/08/16/us-mideast-crISIL-syria-dUSKCNOQLOE320150816>

Rosen, Nir (2012) 'Q&A: Nir Rosen on Syria's armed opposition', Al Jazeera, 13 Feb, online:

<http://www.aljazeera.com/indepth/feauters/2012/02/201221315020166516.html>

SANA (2011) 'Mother Agnes Merriam al-Saeed: Nameless Gunmen Possessing Advanced Firearms Terrorize Citizens and Security in Syria', Syrian Free Press Network, 19 November, online:

<http://syrianfreepress.wordpress.com/2011/11/19/mother-agnes-merriam-al-saleeb-nameless-gunmen-possessing-advanced-firearms-terrorize-citizens-and-security-in-syria/>

Smith- Spark, Laura (2014) 'Syria: Photo charging mass torture by regime 'fake'', CNN, 23 January, online:

<http://edition.cnn.com/2014/01/22/world/meast/syria-torture-photos/>

SN4HR (2015) Syrian Network for Human Rights, online:

<http://sn4hr.org/>

Sterling, Rick (2015a) 'Humanitarians for war on Syria', Counter Punch, 31 March, online:

<http://www.counterpunch.org/2015/03/31/humanitarians-for-war-in-syria/>

Sterling, Rick (2015b) 'Eight Problems with Amnesty's Report on Aleppo syria', Dissident Voice, 14 May, online:

<http://dissidentvoice.org/2015/05/eight-problems-with-amnestys-report-on-aleppo-syria/>

SOHR (2015) 'Syrian Observatory for Human Rights', online:

<http://www.syriahr.com/en/>

Spagat, Michael and Josh Dougherty (2010) 'Conflict Deaths in Iraq: A Methodological Critique of the ORB Survey Estimate', Survey Research Methods, Vol 4 No 1, 3-15

VDC (2015) 'Violation Documentation Center in Syria', online:

<http://www.vdc-sy.info/index.php/en/>

4. Daraa 2011. Edhe një kryngritje islamike



“Protestat kundër qeverisë në Siri gjer në shtator të vitit 2011, kryesisht kanë qenë të një karakteri të qetë” - Human Rights Watch, mars 2012, Vashington.

Që nga fillim kam parë protestues të armatosur në demonstratë... ata janë të parët që kanë filluar të gjuajnë ndaj policisë. Shumë shpesh, dhuna e forcave të sigurimit paraqitet si përgjigje kundër dhunës brutale të kryengritësve të armatosur” - i ndjeri Fra. Frans Van der Lugt, janar 2012, Hums, Siri.

“Pohimi se kryengritja e armatosur kundër qeverisë siriane ka filluar pak kohë më parë është plotësisht gënjeshtër. Vrasja e

ushtarëve, policisë dhe civilëve, shpeshherë në mënyrë shumë brutale, ndodh thajse që nga fillimi” - Profesor Jeremy Salt, tetor, 2011, Ankara, Turqi.

.....

Rrëfimi i dyfishtë mbi konfliktin e Sirisë ka filluar në fillim të kryengritjes së dhunshme të armatosur që filloi në vitin 2012 në qytezën Daraa më jugore kufitare. Prova e parë na vjen nga dëshmitarët e pavarur në Siri. siç është i ndjeri ati Frans Van der Lugt nga Humsi. Ata pohojnë se disa persona të armatosur u infiltruan në radhët e protestuesve të reformuar politikë që kërkonin reforma politike, ashtu që të gjuajnë ndaj policisë dhe popullatës civile. Kjo dhunë erdhi nga radhët e sektarëve islamistë. Valën e dytë të dhunës e filluan grupet islamike (‘kryengritësit’) dhe ndihmësit e tyre perëndimorë. Ata pohojnë se nuk ka pasur dhunë ‘të paarsyeshme’ nga radhët e forcave të sigurimit me qëllim të veprimit represiv kundër protestave politike që i filloi lëvizja me orientim shekullar për reforma politike.

Studimi me kujdes i dëshmimeve të pavarura, tregon se rrëfimi mbi ‘kryengritësit’ që nxit Vashingtoni, edhe pse është shumë i përhapur ai, në të vërtetë është pjesë e strategjisë për t’u deligjitimuar qeveria siriane, me qëllim nxitjeje të ‘ndërrimit të regjimit’. Ta kishim kuptuar këtë domosdo do ta vërenim që para se të fillojë kryengritja e armatosur në mars të vitit 2011, erdhi gjer te lëshimi i dërgesave me armë për islamikët në xhaminë el Omer nga Arabia saudite. Gjithashtu është me interes të përmendet kryengritja e armatosur e më hershme që e bënë Vëllezërit muslimanë në qytetin Hama në vitin 1982, marrë parasysh mitin paralel që është ngritur mbi themelet e këtyre kryengritjeve.

Të dhënat inteligjencës amerikane (DIA 1982) dhe autori britanik i ndjeri Patrick Seale (1998) ofrojnë dëshmi të pavarura për atë që ndodhi në qytetin Hama. Pas sulmeve të armatosura shumëvjeçare të dhunshme të natyrës sektare që i realizuan organet siriane të Vëllezërve muslimanë, gjer kah mesi i vitit 1980, kryetari Hafez

el Asad arriti 't'ia thyejë kurrizin' kryengritjes sektare e cila kishte për qëllim të vendojë model selefist të shtetit islam në Siri. Orvatja e fundit e grushtit shtetëror u zbuluar, gjë që 'i detyroi Vëllezërit muslimanë' të bëjnë kryengritje në pikëmbështetjen e vet Hama. Seale përshkruan fillimin e asaj dhune në këtë mënyrë:

Në ora dy të mëngjesit, me 3 shkurt të vitit 1982, një aradhe e ushtrisë siriane që kontrollonte lagjen e vjetër të qytetit u futën në pusi. Snajperët që ishin vendosur nëpër çatitë e ndërtesave që ishin afër lëshuan një rrebesh plumbash ku i vranë disa ushtarë... Udhëheqësi i vëllezërve muslimanë Ebu Bekr (omer Xhevvad) urdhëroi për kryengritje të përgjithshme... u çuan me qindra luftëtarë muslimanë... deri në orët e mëngjesit u masakruan afër shtatëdhjetë ba'thistë kryesorë ndërsa gerila e kryengritësve triumfalisht e shpalli qytetin 'të çliruar' (Seale 1988:332)

Armata ua ktheu me një forcë të madhe duke angazhuar 12.000 ushtarë, ndërsa luftimet zgjatën tre javë. Kjo ishte një luftë qytetare e mbështetur nga jashtë krahas disa dezertorëve nga ushtria siriane. Seale vazhdon:

'Me që filloi lufta të shndërrohet ngadalë në dobi të qeverisë, guerilët u tërhoqën bërthamën e vjetër të qytetit... pas një granatimit të fuqishëm, komandosët dhe vullnetarët partiakë të përkrahur nga tanket hyrën në qytet... në operacionet e vazhdueshme të pastrimit humbën jetën një numër i madh civilësh, ndërsa krejt lagjja u rrafshua me tokën' (Seale 1988:333).

Dy muaj më vonë raporti i shërbimit të inteligjencës amerikan thotë: 'Numri i përgjithshëm i viktimave të incidentit në Hama me siguri ka arritur afro 2000. Ai përfshinë 200 deri më 400 pjesëtarë të aparatit të fshehtë të elitës së Vëllezërve muslimanë (DIA 1982: 7). Seale bën të ditur se edhe ushtria siriane ka pasur humbje të mëdha. Në të njëjtën kohë 'një numër i madh ka humbur jetën duke i ndjekur sulmuesit e armatosur... simpatizuesit e Vlae vlerësojnë se kanë qenë 3.000 të vrarë, ndërsa kritikët pohojnë se numri i të vrarëve është bile 20.000... megjithatë numri prej 5.000 deri më 10.000 mund të jetë më afër

numrit të vërtetë të të vrarëve’. Ky autor shton: ‘Guerilët kanë qenë armiq seriozë që kanë pasur në dispozicion shuma të mëdha monedha devizash... dhe jo më pak se 15.000 tyta të armëve automatike’ Seale 1988: 335). Vlerësimet e më vonshme që i bënë pjesëtarët e Vëllezërve muslimanë e rritën me qëllim, ashtu që ai numër arrinte deri në ‘40.000 civilë, me këtë u munduan të fshehin se kishte të bëjë me një kryengritje të armatosur dhe masakër sektare, duke pohuar se Hafez el Asadi ka bërë masakra mbi civilët e pafajshëm (p.sh. Nassar 2014. Kryetari i atëhershëm i Sirisë për masakrën në Hama i akuzoi fuqitë e huaja. Seale beson se Hafez el Asadi ‘nuk ka qenë paranoik’ në ato vlerësimet e tij me që konfiskimi i një sasive të madhe të armatimit ka qenë e prodhuar në SHBA, ndërsa disa prej kolaboracionistëve akuzojnë: Huseinin, mbretin e Jordanisë, milicinë krishtere të Libanit si dhe Sadam Huseinin kryetarin e Irakut (Seale 1988 : 336-337).

Kryengritja e armatosur në Hama na ndihmon ta kuptojmë dhunën që ndodhi në Hama, sepse gjatë vitit 2011 i kemi parë islamikët e armatosur që gjuanin me snajperë prej çative të afërta kundër policisë dhe zyrtarëve shtetërorë, të cilët me këtë i nxitën forcat e armatosura, që më pastaj të pohojnë se kishte të bëjë me ‘masakrën e civilëve të thjeshtë’ ku kryengritësit dhe kolaboracionistët u gjendën përballë sulmit të ushtrisë siriane. Edhe pse SHBA-të, përmes aleatëve të vet, luajtën një rol të rëndësishëm në kryengritjen e armatosur të pa suksesshme në Hama, kur ajo u shua, makineria e inteligjencës amerikane solli përfundim se si ‘sirianët janë popull pragmatik që nuk dëshiron pushtet të Vëllezërve muslimanë’ DIA 1982: vii).

Me rastin e kryengritjes në qytezën Daraa dhe sulmeve që më vonë, në prill 2011, u përhapën edhe në vendet përreth, përsëri qëllimi i asaj kryengritje haptas duket se ishte rrëzimi i regjimit shekullar ose atij alevit. Pjesëmarrësit amerikanë në këtë kryengritje të cilët u paraqitën si lojtarë në front janë Arabia saudite dhe Katari, si dhe Turqia. Lideri sirian i Vëllezërve muslimanë, Muhamed Rijad esh-Shekfa, në deklaratën që e bëri publike më 20 mars, nuk la aspak dyshim se qëllimi i kësaj

organizate ishte ‘regjimi shekullar’, ndërsa anëtarët e Vëllezërve muslimanë ‘patjetër e kanë të kujdesen që revolucioni të cilin kanë vendosur ta bëjnë patjetër të jetë islam, ndërsa kjo nënkupton se asnjë sekte as grupacioni tjetër nuk mund t’i takojë një pjesë e meritës pasi të korr sukses revolucioni. (Esh-Shakfa 2011). Sheikho edhe pse mundohet ta zvogëlojë rolin fillestar të Vëllezërve muslimanë pohon se Vëllezërit musلمانë ‘kanë kafshuar një kafshatë aq të madhe sa që nuk mund ta përpijnë, kur është në pyetje lidhja e forcës në teren... (për shkak) të përkrahjes Katare-Turke’, por edhe marrë parasysh edhe kapacitetet e tyre organizative në përgjithësi (Sheikho 2013). Deri në momentin e formimit të ‘Këshillit të lartë të Sirisë së lirë’, 2012 i cili, në të vërtetë, më shumë ishte kanal për depërtimin e armëve se sa komandë e vërtetë ushtarake, është thënë se Këshilli do të konstituohet në atë mënyrë që dy të tretat e anëtarëve të tij t’i përbëjnë Vëllezërit muslimanë. Raporti inteligjencës amerikane i publikuar në gusht të vitit 2012, përkundër deklaratave për opinion që i lëshoi Vashingtoni zyrtar në lidhje me ‘kryengritësit e matur’, përmban me sa vijon: “Selefistët, Vëllezërit muslimanë dhe AKI (Al-Kaida në Irak, më pas ISIL) janë fuqitë kryesore që udhëheqin me kryengritjen e armatosur në Siri... AKI që nga fillimi i kryengritjes e ka përmbajtur opozitën siriane, si në aspekt ideologjik ashtu edhe përmes mediave” (DIA 2012)

.....

Në shkurt të vitit 2012 erdhi në Siri deri te një kryengritje e pasuksesshme, e cila në një masë të caktuar ishte e nxitur nga ngjarjet që ndodhën në Egjipt dhe Tunis.

Në Siri erdhën paralel demonstratat qeveritare dhe antiqeveritare dhe deri te paraqitja e lëvizjes së vërtetë për reforma politike e cila disa vite ka luftuar për eliminimin e korrupsionit dhe monopolit të qeverisë së partisë Ba’th. Një raport nga viti 2005 përmend ‘tërë allatken e lëvizjeve reformiste e cilët pa zë dhe gradualisht u organizuan nën sipërfaqe (Ghadry 2005), ndërsa me të vërtetë punohet për ‘shumë fytyrat’ e opozitës siriane, shumica e së cilës ishin joislamike dhe që ishin orvatur për ndryshime që

nga viti 2005. (Sayyid Rasas). Këto grupe politike opozitare kërkojnë shumë vëmendje për të thënë diçka për to, e për të cilin do të flasim në diskutimin tonë, (shih kapitullin e pestë).

Megjithatë, vetëm një pjesë e asaj opozite, Vëllezërit muslimanë dhe selefistë tjerë, lidhen me dhunën e armatosur që plasi në qytezën Daraa. Shumica e demonstratave antiqeveritare janë pritur gjithashtu me demonstrata të mëdha antiqeveritare. Kah fillimi i muajit mars u burgosën një grup tinejxherësh në Daraa për shkak të grafitit që këta djem i imituan ata nga Afrika Veriore e të cilët shpreheshin ‘populli kërkon ndërrimin e regjimit’. Mediat thanë se policia lokale ka përdorur forcën kundër këtyre djemve. Bashar el Asadi ka qenë i përzier personalisht, dhe guvernatori lokal menjëherë u ndërrua ndërsa tinejxherët u liruan (Abouzeid 2011).

Krahas kësaj, kryengritja islamike e armatosur u përgatitë, duke u fshehur prej grupeve protestuese publike. Më 11 mars, para se të vinte deri te shpërthimi i dhunës në Daraa, mediat lajmëruan se forcat siriane kanë konfiskuar ‘dërgesa të mëdha armësh, të mjeteve shpërthyes dhe të instrumenteve optike për vëzhgim gjatë natës që ishin sjell me një kamion të ardhur nga Iraku’. Ky kamion ishte ndaluar në pikën kufitare jugore Tanaf, afër Jordanisë. Agjencia shtetërore siriane e gazetarisë SANA lajmëroi se armatimi i konfiskuar ka qenë i dedikuar ‘për shfrytëzim në aksionet kundër forcave shtetërore për të provokuar parregullsi dhe kaos’. Në fotografitë e armatimit të konfiskuar shihen ‘më se 20 granata dhe pistoleta si dhe një sasi pushkësh me fishekore’. Shoferi i kamionit deklaroi se armët janë ngarkuar në Bagdad ndërsa për t’i futur në Siri është paguar 5.000 dollarë. (Reuters 2011. Pa marrë parasysh hasjen e këtyre dërgesave, armët arritën deri te qyteti kufitar Daraa ku jetojnë afër 150.000 banorë. Pikërisht këtu shpërndahen versionet e rrëfimit të ‘kryengritësve perëndimorë’ dhe i të pavarurve dhe atë në mënyrë shumë dramatike. Mediat e perëndimit pajtohen me atë se protestuesit kanë djegur dhe thyer zyrat e qeverisë, kundër të cilave, më vonë, forcat lokale të sigurimit hapën zjarr kundër protestuesve duke

vrarë disa prej tyre' (Abouzejd 2011). Pas kësaj 'protestuesit' filluan të demonstrojnë përpara xhamisë el Omer, por atëherë u sulmuan. Nga ana tjetër, qeveria siriane deklaroi se kanë ndodhur sulme provokuese ndaj forcave të sigurimit, ku humbën jetën pjesëtarë të policisë dhe civilë, krahas djegies së lokaleve të institucioneve shtetërore. Burimet e huaja vërtetojnë këtë version të ngjarjes.

Edhe pse titulli i Dayli Mail-t (2012) britanik, për vdekjen e 'protestuesve', i akuzoi forcat shtetërore të sigurimit, kjo listë i publikoi edhe fotografitë e pushkëve AK47 dhe të granatave të dorës të cilat forcat e sigurimit të Sirisë i kishin konfiskuar pas sulmit ndaj xhamisë el-Omer. Kjo listë ka përmendur edhe informatat mbi atë se 'grupet e armatosura' kanë gjuajtur me zjarr ndaj veturës së spitalit, me ç'rast u vra një mjek, anëtarë i personelit të mjekëve dhe një polic. Rrjeti televiziv i vendeve fqinje publikuan lajmin për vrasjen e policit sirian në mes 17-18 marsit. Një lajm i mediave libaneze prej 21 mars thekson që 'gjatë protestave janë vrarë shtatë policë' (Ja Libnan) 2010), gjersa lajmi i gazetës izraelit pohon se në protesta kanë humbur jetën 'shtatë policë dhe së paku katër protestues... dhe se janë djegur selia e partisë Ba'th në pushtet dhe gjykata' (Queenan 2010). Policët në fjalë i kanë qëlluar snajperët që gjendeshin nëpër çatitë e ndërtesave të afërta.

Madje edhe në këto rrethana qeveria thërriste në përmbajtje nga përdorimi i forcës. duke u munduar t'u përgjigjet kërkesave të lëvizjes për reforma. Këshilltari i kryetarit Asad, Dr. Bothain Sha'ban, deklaroi në një konferencë për shtyp se kryetari dha urdhrë 'të mos përdoret municion luftarak, bile edhe në rast se vriten pjesëtarët e policisë ose nëpunësit shtetëror' Asadi premtoi se do t'ua plotësojë kërkesat politike të protestuesve, siç ishte e drejta për themelimin dhe regjistrimin e partive politike, heqja e masës për gjendje të jashtëzakonshme dhe liri më të madhe mediave. (al- Khalidi 2011). U pa se islamikëve asgjë prej kësaj nuk u interesoi po as që i pengoi nga kërcënimet e tyre.

Disa raporte, duke përfshirë këtu edhe video raportin, theksuan se gjuajtja me armë zjarri ndaj protestuesve dhe policisë erdhi nga snajperët e çatave të ndërtesave, gjatë varrimit të personave që humbën jetën më parë. Nëpër raporte është thënë se ‘e paqartë është se kush kundër kujt ka gjuajtur’(el -Xhezira 2011a), si një ‘grup i armatosur i panjohur nëpër çatitë e shtëpive gjuanin kundër protestuesve dhe forcave të sigurimit,’ (Mektebi 2010). Edhe përkaj kësaj, El-Xhezira (2011b), pronar i së cilës [është monarkia e Katarit, jo shumë vonë pas kësaj publikoi se snajperët kanë qenë prej forcave qeveritare.

‘Kryetari Bashar el Asad dërgoi në Derra me mijëra ushtarë sirian me armatim të rëndë për kryerjen e një operacioni të cilin u mundua regjimi ta fsheh nga sytë e botës, lajmëroi ky rrjet televiziv i Katarit. Megjithatë, raporti i el- Xhezirës se snajperët e fshehtë të qeverisë i kanë vrarë ‘edhe ushtarë edhe protestues, është i palogjikshëm dhe shkon ndesh me rrjedhën e ngjarjeve. Pjesëtarët e forcave të armatosura janë dërguar në Daraa mu pse atje janë vrarë pjesëtarët e policisë. Arabia saudite, aleati kryesor i SHBA- ve, e ka armatosur dhe e ka financuar sekten sunitë selefiste për kryengritje të armatosur kundër shtetit shekullar. Zyrtari saudit Enver el Eshki më vonë u shpreh për televizionin e BBS që vendi i tij ka dërguar armë në Daraa si dhe në xhaminë el-Omer (Truth Szria 2012). Shejhu selefist Adnan Arur, nga Arabia saudite ku gjendet në egzil, thirri në luftë të shenjt kundër muslimanëve liberal alevit, për të cilët thuhet se dominojnë në qeverinë siriane. ‘Pasha All-llahun do t’i bluajmë alevitet në makinat për bluarjen e mishit, ndërsa me atë mish do t’i ushqejmë qentë’ (MEMRITV 2011). Qëllimi i selefistëve është të formojnë shtet teokrat ose halifat. Parulla gjenocide, ‘Krishterët në Bejrut, alevitet në varr’ është shumë e përhapur, fakti që mediat të Amerikës veriore e kanë publikuar që në maj të vitit 2011. (p.sh. Blanford 2011). Këtyre thirrjeve kërcënuese së shpejti do t’u përgjigjet islamikët nga brigada El-Faruk që kanë vepruar në kuadër të Ushtrisë së lirë siriane FSA. (Crimi 2012). Analisti kanadez Michel Chossudovsky (2011) e vërejtë se: ‘Përdorimi i

forcave të armatosura duke ua bashkangjitur edhe tanket në Duraa kanë qenë të drejtuara kundër kryengritjes së armatosur të organizuar, që ka vepruar në këtë qytezë kufitare që nga 17-18 i muajit mars’.

Pas atyre pak ditëve të para në Duraa, vazhdoi vrasja e pjesëtarëve të forcave të sigurimit sirian, po për këtë nuk u gjet as nam as nishan në informacionet e mediave jashtë Sirisë. Pa marrë parasysh këtë, analistja e pavarur Sharmine Narwani në shtyllën e vrasjeve për herë të parë shkroi në 2012, dhe përsëri kah mesi i 2014. Prita dhe masakra e ushtarëve në afërsi të Daraa kanë ndodhur kah fundi i marsit ose kah fillimi i prillit. Një kamion ushtarak është ndaluar për derdhjen e naftës në rrugë në luginën ndërmjet Daraa el- Mehata dhe Daraa el- Beled, pastaj drejt kamionit u hap zjarr nga armët automatike. Sipas burimeve të qeverisë dhe sulmuesve, numri i ushtarëve të vrarë në këtë masakër vlerësohet të jetë prej 18 - 60. Një banor i Daraa-së deklaroi se në këtë incident nuk ka patur asnjë lajm sepse ‘Në atë kohë, qeveria nuk dëshoi të tregojë se është e lënduar dhe e dobët, ndërsa opozita e armatosur dëshoi ta fsheh faktin se është e armatosur mirë’. Sipas blogerit opozitar Nizar Nayoufit kja masakër ka ndodhur javën e fundit të muajit mars. Edhe një gazetar opozitar antiqeveritar, Rami Abdur-rahman (që jeton në Angli dhe i cili quhet ‘Observatori sirian për të drejta njerëzore SOHR) pohon: ‘Sulmi ka ndodhur në 1 prill, ndërsa janë vrarë 18 ose 19 pjesëtarë të forcave të sigurimit’... (Narwani 2014). Zëvendësministri i punëve të jashtme të Sirisë, Fejsal Mikdad, që vet është i lindur në Daraa, vërteton se: ‘Këtë incident qeveria e ka fshehur me qëllim... që mos ta antagonizojë situatën, mos të shpërthejë emocione, por që t’i qetësojë gjërat - në mënyrë që mos të vijë ngritja e emocioneve që ka mund të shpiej gjer te një eskalim i pakontrolluar i dhunës’ (Narwani 2014)

Por, efekti që u arritë me këtë injorim që erdhi gjer te vdekja e ushtarëve, te mediat e perëndimit prodhoi bindje se të vrarët në të vërtetë kanë qenë ata që janë prezantuar si (a) viktimat të ushtrisë siriane dhe (b) si civilë. Më se gjashtë muaj, sa herë të përmendej

në mediat perëndimore numri i të vrarëve, zakonisht konsiderohej e pranueshme të flasësh se si të gjithë të vrarët kanë qenë ‘protestues’ që i ka vrarë ushtria siriane. P.sh., një raport i Rojterit i publikuar me 24 mars tregon se në spitalin qendror në Daraa janë sjellë ‘më së paku 37 trupa të protestuesve të vrarë ditën e martë’ (Halid 2011). Do ta shihni se të gjithë të vrarët paraqiten si ‘protestues’ pa marrë parasysh raportet e më hershme mbi vrasjet e policëve dhe punëtorëve të shëndetësisë. Edhe 19 ushtarë janë vrarë më 25 prill, gjithashtu në afërsi të Daraa. Narwani arriti të vijë gjer te emrat e tyre si dhe te të dhënat që i mori nga Ministria e mbrojtjes të Sirisë, ndërsa këto informata i vërteton edhe dokumenti tjetër nga burimet joqeveritare. Ajo ka llogarit se gjatë prillit të vitit 2011 janë vrarë 88 ushtarë sirianë ‘që kanë humbur jetën nga plumbi i sulmuesve të panjohur të viseve të ndryshme të Sirisë’ (Narwani 2014). Ajo hedh poshtë pohimet se ushtarët e vrarë, në të vërtetë, janë ‘dezertorë’ të cilët i vrau ushtria siriane se nuk pranuan të gjuajnë në civilë. Human Rights Watch duke u referuar në intervistat e bëra me afër 50 ‘aktivistë’ të paemëruar. pohon se luftëtarët që janë vrarë në këtë rast të gjithë kanë qenë ‘dezertorë’ që i ka vrarë ushtria siriane (HRW 2011b). Megjithatë, varrimi i oficerëve lojalë të armatës i cil, në atë kohë, u publikua në internet, ishte krejtësisht i dukshëm. Madje edhe Rami Abdurrahmani (SOHR), i cili, përndryshe, është i gatshëm t’ia hedh fajin armatës siriane për vrasjen e civilëve, deklaroi ‘se armata vret dezertorët pse kalojnë në anën e opozitës së armatosur - unë këtë kurrë nuk mund ta pranoj’ (Narwani 2014). Pa marrë parasysh këtë, kundërshtarët dhe informimi emocional janë bë shumë të çuditshëm.

Dhuna u përhap kah veriu, falë ndihmës së luftëtarëve islamikë nga Libani që arritën gjer te vendet Banijas dhe paralagjja e Humsit. Më 10 prill u vranë nëntë luftëtarë në sulmin ndaj autobusit në Banijas. Më 17 prill në Hums u vra gjenerali Abdul-Hudr et-Tallawi me dy djem e tij dhe nipin, ndërsa komandanti sirian Ijad Kamil Harfushi u vra jo larg shtëpisë së vet. Dy ditë më vonë, koloneli Muhammed Abdul-Kadër, që nuk ishte në

detyrë, u vra duke drejtuar automjetin e vet (Narwani 2014). Një komentuesi nga Amerika Veriore Joshua Landis (2011a) lajmëroi se është vrarë i afërmi i bashkëshortes së vet që ishte njëri nga ushtarët në Baniyas. Nuk kanë qenë vetëm këta të vrarë, por këtu i përmendi për shkak se të gjitha kanalet e mediave perëndimore deri më sot e kësaj dite mundohen të mbajnë fiksimin në atë se pse nuk është punuar me kryengritjen e armatosur islamike, ashtu që ‘protestuesit e qetë’ nuk kanë i kap armët gjer në shtator të vitit 2011.

Al-Xhezira, kanali më i fort televiziv i Lindjes së afërme që i përmban Vëllezërit muslimaë, këto sulme me qëllim nuk i ka publikuar, as përforcimin që erdhi nga jashtë nga grupacionet e armatosura. Ish gazetari i Al-Xhezira, Ali Hashim është njëri ndër shumë gazetarët që ka dhënë dorëheqje nga rrjeti TV i Katarit (RT 2012) në shenjë proteste për shkak të animitet të këtij rrjeti kur është fjala për informim mbi dhunën e armatosur në Siri. Hashimi kishte një incizim të pjesëtarëve të armatosur që kishin ardhur nga Libani, por këta i fshehën redaktorët e tyre të Katarit. ‘Në letrën e dorëheqjes i shkrova shefit tim... sikur në Siri nuk ka ngjarë asgjë.’ Ai mendon se ‘Revolucioni i Libisë’ për Al-Xhezirën, donte të thotë fillimi i autoritetit të këtij rrjeti mediatik si grup kredibil mediatik. (Hashim 20120.

Provokuesit luajtën një rol të rëndësishëm. Xhihadisti tunizian Ebu Kusaj më vonë pranoi se ka qenë ‘kryengritës i dalluar sirian’ i cili kishte për detyrë të kryej ‘minimin e xhamive sunitë’, duke shkruar disa fjalë ofenduese si ‘s’ka Zot pos Basharit’ që paraqiste një ofendim të madh për muslimanët. Më vonë porositë si këto, natyrisht, i janë përshkruar ushtrisë siriane, me qëllim që të provokojnë dezertimin e oficerëve sunitë në anën e opozitës. Ebu Kajsit i kanë bërë intervistë gazetarët e huaj të cilin nuk e njohën se nuk është shtetas i Sirisë as në bazë të akcentit të tij. (Eretz Zen 2014).

Gazetari amerikan Nir Rosen, raportet e të cilit kryesisht ishin kritikë ndaj qeverisë siriane, gjithashtu sulmoi konsensusin perëndimor kur ishte në pyetje fillimi i dhunës në Siri. Çështja e

dezertorëve ishte një orvatje për të tërhequr vëmendjen. Kryengritja e armatosur filloi shumë më herët por erdhi gjer te dezertimi nga radhët e ushtrisë siriane... Opozita për çdo ditë publikon listën e të vrarëve, zakonisht pa ndonjë sqarim. Një numër i madh i të vrarëve ishin luftëtar opozitarë të përshkruar ci civilë të pafajshëm që i kanë vrarë pjesëtarët e ushtrisë siriane, të agjencive të sigurimit... që i vranë luftëtarët antiqeveritarë,’ (Rosen 2012).

Loja me fjalë e numra është përdorur me qëllim të delegjitimizimit të qeverisë siriane, regjimit dhe armatës siriane, me të cilën sugjerohej përgjegjësia e tyre për krejt dhunën. Pikërisht ashtu si bombarduan Libinë forcat e NATO-s për ta rrëzuar qeverinë e Libisë. Zyrtarët e Qeverisë Amerikan filluan të kërkojnë që kryetari Asad patjetër të largohet nga pushteti. Brooking Institution (Shaik 2011) pohoi se kryetari Asad ‘e ka humbur legjitimitetin për të mbetur në pushtet’. Senatorët amerikanë John McCain, Lindsay Graham dhe Joe Lieberman kanë thënë se ka ardhur koha ‘të kalojmë në anën e popullit sirian, në kërkesat e tyre të qeta për pushtet demokrat’ (Fox News 2011). Ky ishte fillimi i shpalljes edhe të një fushate për ‘ndërrimin e regjimit’.

Sekretari shtetëror amerikan Hilary Clinton e hudhi si të pavërtetë mendimin se ‘provokuesit e huaj’ janë të kyqur në nxitjen e kryengritjes së armatosur duke pohuar se ‘shumica e viktimave janë civilë të paarmatosur’ (Clinton 2011). Në realitet, Hilary Clinton shumë mirë e ka ditur se aleatët e saj sauditë që nga fillimi i kanë armatosur ekdtremistët. Pohimi i saj për viktimat gjithashtu është jo i vërtetë. Kombet e bashkuar (që më vonë nuk do t’i numërojnë më viktimat) sipas disa burimeve kanë vlerësuar se deri kah fillimi i vitit 2012 ka pasur më se 5.000 viktima, përfshirë këtu 478 policë dhe 2091 pjesëtarë të forcave ushtarake dhe të sigurimit (OHCHR 2012:2; Narwani 2014). Kjo don të thotë se më shumë se gjysma e viktimave që ranë në vitin e parë ishin pjesëtarë të forcave të sigurimit sirian. Ky vlerësim i pavarur mungon në raportet perëndimore mbi luftën në Siri. Organizatat

perëndimore siç është Human Rights Watch së bashku me kolumnistët amerikanë, (e.g. Allaf 2012) edhe më tej vazhdojnë me pohimet, bile edhe pas humbjes së formacioneve sektare el - Faruk (FSA) në Hums kah viti 2012, se forcat siriane të sigurimit i kanë masakruar ‘protestuesit të paarmatosur’, se populli sirian ‘nuk ka pasur zgjidhje tjetër’ pos të kap armët, dhe se ‘lëvizja e protestuesve’ që nga fillimi ka qenë e qetë gjer në dhjetor të vitit 2011.’ (HRW 2011a, HRW 2012). Argumentet që i prezantuar më lartë vërtetojnë se nuk ka ndodhur një gjë e tillë dhe se ai rrëfimi nuk është aspak i saktë.

Në realitet, lëvizjen për reforma politike selefistët e armatosur e kanë larguar nga rruga gjatë muajit mars dhe prill. Grupet opozitare siriane me vite janë munduar dhe kanë agjituat haptas kundër koopcionit dhe monopolit të qeverisë së partisë Ba’th. Por, shumica prej tyre nuk dëshironin destruktimin e një shteti inkluziv shoqëror po edhe sikur të jetë autoritar. Shumica prej tyre e kundërshton si dhunën sektare ashtu dhe ndërhyrjen e fuqive të huaja. Përkrahën mbrojtjen që Siria ua ofron pakicave fetare dhe etnike. i ofron gruas pozitive relativisht të mirë, garanton shkollim dhe shërbim falas, me çrast u kundërvihet rrjeteve kooptive dhe policisë politike që fut frikë. (Wikstrom 2011; Otrakji 2012).

Reporterja Hala Xhabir (2012) vërejti në qershor se afër 5.000 veta në demonstrata në qytezën Ma’arat en- Nu’man, në anën veriperëndimore të Sirisë, ndërmjet Halepit dhe Hama. Ai thekson se para shtatë ditëve janë vrarë disa ‘protestues’ deri sa ishin duke vendur disa barrikada në rrugë ndërmjet Damaskut dhe Halepit. Pas negociatave me qeverinë e cila e reduktoi prezencën e forcave të sigurimit në qytet, ‘disa meshkuj me mjekra nëpër automjete dhe pikap-kamionetave pa targa, të armatosur me pushka automatike dhe me minahedhëse’ filluan të gjuajnë me armë kundër një numrit të vogël të pjesëtarëve të forcave të sigurimit që kishin mbetur në qytet. Si ndihmë ushtarëve sirianë u është dërguar një helikopter. Si rezultat i kësaj përleshjeje humbën jetën ‘katër policë, njëzetë sulmues dhe njëzetë policë u plagosën’. Oficerët që arritën t’i shmangen përleshjes i fshehën

pjesëtarët e bashkësive fisnore që vet kishin marrë pjesë grupet protestuese që nga fillimi. Kur u mbajtën demonstratat e ardhshme, të premten, për futjen e demokracisë, në to u paraqitën vetëm 350 persona, kryesisht njerëz të rinj dhe një numër i mjekroshave militantë (Xhabir 2012). Pas sulmit të hapët selefist pesë mijë protestues ua vërën zjarrin vetëm 350 vetave.

Pas manipulimeve shumë muajshe mediatike që u munduan ta fshehin kryengritjen islamike të armatosur. Sirianët sikur që ishte Samir el - Ahras, një i ri nga një familje sunitë i cili më parë e shikonte Al-Xheziren sepse e preferonte më shumë se televizionin shtetëror, tanimë nuk e shikon atë. Ai vet u bind në manipulimin mediatik të informacionit që i transmetonte Al-Xhezira, kah fundi i muajit qershor të vitit 2010, shkroi me sa vijon: Unë jam qytetar i Sirisë dhe humanist. Pas katër muaj liri të rrejshme..... Ju flisni për demonstrata të qeta ndërsa i vritni qytetarët tanë. Prej sot... unë jam kapter në forcat rezerviste të armatosura të armatës siriane. Nëse arrij ta kapi cilin do qoftë... në cilën organizatë terroriste qoftë që vepron në tokën siriane, do ta gjuaj me armë ashtu si gjuan edhe ai në mua. Kjo është toka e jonë e jo e juaja, ju o robër të lirisë së rrejshme amerikane.’ (el-Ahras 2011).

Shënime

Abouzeid, Rania (2011) ‘Syria’s Revolt, how graffiti stirred an uprising’, Time, 22 March

Al Akhras, Samer (2011) ‘Syrian Citizen’, Facebook, 25 June, online: <http://www.facebook.com/notes/sam-al-akhras/syrian-citizen/241770845834062?pnref=story>

Al Jazeera (2011a) ‘Nine killed at Syria funeral processions’, 23 April, online:

<http://www.aljazeera.com/news/middleeast/2011/04/20114231169587270.html>

Al Jazeera (2011b) ‘Deraa: A city under a dark siege’, 28 April, online: <http://www.aljazeera.com/indepth/features/2011/04/2011427215943692865.html>

Al- Shaqfa, Muhammad Riyad (2011) ‘Muslim Brotherhood Statement about the so-called ‘Syrian Revolution’, General supervisor for the Syrian Muslim Brotherhood, statement of 28 March, online at:

<http://truthsyria.wordpress.com/2012/02/12/muslim-brotherhood-statement-about-the-so-called-syrian-revolution/>

Allaf, Rime (2012) 'This Time, Assad Has Overreached', NYT, 5 Dec, online:

<http://www.nytimes.com/roomfordebate/2012/02/06/is-assads-time-running-out/this-time-assad-has-overreached>

Blanford, Nicholas (2012) 'Assad regime may be gaining upper hand in Syria', Christian Science Monitor, 13 May, online:

<http://www.csmonitor.com/World/Middle-East/2011/0513/Assad-regime-may-be-gaining-upper-hand-in-Syria>

Chossudovsky, Michael (2011) 'Syria: who is behind the protest movement? Fabricating a pretext for US NATO 'Humanitarian Intervention'', Global Research, 3 May, online:

<http://www.globalresearch.ca/syria-who-is-behind-the-protest-movement-fabricating-a-pretext-for-a-us-nato-humanitarian-intervention/24591>

Clinton, Hilary (2011) 'There is No Going Back in Syria', US Department of State, 17 June, online:

<http://www.state.gov/secretary/20092013clinton/rm/2011/06/166495.htm>

Maktabi, Rima (2011) 'Reports of funeral, police shootings raise tensions in Syria', CNN, 5 April, online:

<http://edition.cc.com/2011/WORLD/meast/04/05/syria.unrest/>

Crimi, Frank (2012) 'Ethnic Cleansing of Syrian Christians', Frontpagemag, 29 March, online:

<http://www.frontpagemag.com/2012/frank-crimi/ethnic-cleansing-of-syrian-christians/>

Daily Mail (2011) 'Nine protesters killed after security forces open fire by Syrian mosque', 24 March

DIA (2012) 'Department of Defence Information Report, Not Finally Evaluated Intelligence, Country: Iraq', Defence Intelligence Agency, August, 14-L-0552/DIA/297-293, Levant report, online at:

<http://levantreport.com/2015/05/19/2012-defence-intelligence-agency-document-west-will-facilitate-rise-of-islamic-state-in-order-to-isolate-the-syrian-regime/>

Draitser, Eric (2012) 'Unmasking the Muslim Brotherhood: Syria, Egypt and beyond', Global Research, 12 December, online:

<http://www.globalresearch.ca/unmasking-the-muslim-brotherhood-syria-egypt-and-beyond/5315406>

Eretz Zen (2014) 'Tunisian Jihadist Admits: We Destroyed & Desecrated Mosques in Syria to Cause Defections in Army', Youtube Interview, 16 March, online:

<https://www.youtube.com/watch?v=fQ8awN8GLAk>

FOX News (2011) 'Obama Under Pressure to Call for Syrian Leader's Ouster', 29 April, online:

<http://www.foxnews.com/politics/2011/04/29/obama-pressure-syrian-leaders-ouster/>

Ghadry, Farid N. (2005) 'Syrian Reform: What Lies Beneath', Middle East Quarterly, Vol 12 No 1, Winter, online:

<http://www.meforum.org/683/syrian-reform-what-lies-beneath>

Haidar, Ali (2013) interview with this writer, Damascus 28 December.

[Ali Haidar was President of the Syrian Social National Party (SSNP), a shekullar rival to the Ba'ath Party. In 2012 President Bashar al Assad incorporated him into the Syrian government as Minister for Reconciliation.]

Hashem, Ali (2012) 'Al Jazeera Journalist Explains Resignation over Syria and Bahrain Coverage', The Real News, 20 March, online:

http://therealnews.com/t2/index.php?option=com_content&task=view&id=31&Itemid=74&jumival=8106

HRW (2011a) 'We've never seen such horror: crimes against humanity by Syrian Security Forces', Human Rights Watch, June, online:

<http://www.hrw.org/news/2011/06/01/we-have-never-seen-such-horror-0>

HRW (2012) 'Open Letter to the Leaders of the Syrian Opposition, Human Rights Watch, Washington, 20 March, online:

<http://www.hrw.org/news/2012/03/20/open-letter-leaders-syrian-opposition>

Jaber, Hala (2011) 'Syria caught in crossfire of extremists', Sunday Times, 26 June, online:

http://www.thesundaytimes.co.uk/sto/news/world_news/Middle_East/article657138.ece

Khalidi, Suleiman (2011) 'Thousands chant 'freedom' despite Assad reform offer', Reuters, 24 March, online:

<http://www.reuters.com/article/2011/03/24/us-syria-idUSTRE72N2MC20110324>

Landis, Joshua (2011a) 'The Revolution Strikes Home: Yasir Qash`ur, my wife's cousin, killed in Banya's, Syria Comment, 11 April, online:

<http://www.joshualandis.com/blog/the-revolution-strikes-home-yasir-qashur-my-wifes-cousin-killed-in-banyas/>

Landis, Joshua (2011b) 'Syria's Opposition Faces an Uncertain Future', Syria Comment, 26 June, online:

<http://www.joshualandis.com/blog/syrias-opposition-faces-an-uncertain-future/>

MEMRITV (2011) 'Syrian Sunni Cleric Threatens: "We Shall Mince [The Alawites] in Meat Grinders"', Youtube, 13 July, online:

<https://www.youtube.com/watch?v=Bwz8i3osHww>

Nassar, Jessy (2014) 'Hamma: A rebirth from the ashes?' Middle East Monitor, 11 July, online:

<https://www.middleeastmonitor.com/article/middle-east/12703-hama-a-rebirth-from-the-ashes>

Narwani, Sharmin (2012) 'Questioning the Syrian "Casualty List"', 28 Feb, online:

<http://english.al-akhbar.com/content/questioning-syrian-%E2%80%9Ccasualty-list%E2%80%9D>

Narwani, Sharmin (2014) Syria: The hidden massacre, RT, 7 May, online:

<http://rt.com/op-edge/157412-syria-hidden-massacre-2011/>

OHCHR (2012) 'Periodic Update', Independent International Commission of Inquiry established pursuant to resolution A/HRC/S-17/1 and extended through resolution A/HRC/Res/ 19/22, 24 May, online:

<http://www.ohchr.org/Documents/HRBodies/HRCouncil/CoISyria/PeriodicUpdate24May2012.pdf>

Otrakji, Camille (2012) 'The Real Bashar al Assad', Conflicts Forum, 2 April, online: <http://www.conflictsforum.org/2012/the-real-bashar-al-assad/>

Queenan, Gavriel (2011) 'Syria: Seven Police Killed, Buildings torched in protests', Israel National News, Arutz Sheva, March 21

Reuters (2011) 'Syria says seizes weapons smuggled from Iraq', 11 March, online:

http://www.reuters.com/article/2011/03/11/us-syria-iraq-idUSTRE72A3MI20110311?HC_location=ufi

Rosen, Nir (2012) 'Q&A: Nir Rosen on Syria's armed opposition', Al Jazeera, 13 Feb, online:

<http://www.aljazeera.com/indepth/features/2012/02/201221315020166516.html>

RT (2012) 'Al Jazeera exodus: Channel losing staff over 'bias'', 12 March, online: <http://rt.com/news/al-jazeera-loses-staff-335/>

Salt, Jeremy (2011) Truth and Falsehood in Syria, The Palestine Chronicle, 5 October, online:
http://palestinechnicle.com/view_article_details.php?id=17159

Sayyid Rasas, Mohammed (2013) 'From 2005 to 2013: The Syrian Opposition's Many Faces', Al Akhbar, 19 March, online:
<http://english.al-akhbar.com/node/15287>

Shaikh, Salman (2011) 'In Syria, Assad Must Exit the Stage', Brookings Institution, 27 April, online:
<http://www.brookings.edu/research/opinions/2011/04/27-syria-shaikh>

Sheikho, Youssef (2013) 'The Syrian Opposition's Muslim Brotherhood Problem', Al Akhbar English, April 10, online:
<http://english.al-akhbar.com/node/15492>

Truth Syria (2012) 'Syria - Daraa revolution was armed to the teeth from the very beginning', BBS interview with Anwar Al-Eshki, YouTube interview, video originally uploaded 10 April, latest version 7 November, online:
<https://www.youtube.com/watch?v=FoGmrWWJ77w>

Seale, Patrick (1988) Assad: the struggle from the Middle East, University of Clifornia Press, Berkley CA

van der Lugt, Frans (2012) 'Bij defaitisme is nieman gebaat', from Homs, 13 January, online:
<https://mediawerkgroepsyrie.wordpress.com/2012/01/13/bij-defaitisme-is-niemand-gebaat/>

Wikstrom, Cajsa (2011) Syria: 'A kingdom of silence', Al Jazeera, 9 Feb, online:
<http://www.aljazeera.com/indepth/features/2011/02/201129103121562395.html>

YaLibnan (2011) '7 Syrian policemen killed in Sunday clashes', 21 March, online:
<http://yalibnan.com/2011/03/21/7-syrian-policemen-killed-in-sunday-clashes-report/>

5. Bashar el Asadi dhe reformat politike



E natyrshme është të pritet që të vendosurit për procese politike brenda një shteti sovran i takon popullit të atij vendi dhe askush tjetër jashtë këtij shteti nuk do të duheshe të ketë guxim të përzihet në ato procese. Megjithatë, me që Vashingtoni insiston në të drejtën për vendosje se kush mundet e kush jo të drejtojë një vend, këtu do të ishte e udhës të bisedohet për prapavijën e situatës siriane, veçanërisht për Bashar el Asadin dhe për procesin e reformave politike në Siri.

Në diskursin perëndimor gati është e pamundshme të hapësh diskutim lidhur me këtë, pas kryengritjes së armatosur islamike që ndodhi më 2010. Në vend të atij diskutimi, diskursi mbi luftën në

Siri ka marrë një pamje karikature, krejtësisht e reduktuar në parulla të trishtueshme mbi luftën e përgjakshme që i janë nënshtruar politikës së ‘ndërrimit të regjimit’, si ato mbi ‘diktatorin gjakpirës brutal’ i cili keqtrajton dhe bën masakra mbi popullin e vet. Kurrë nga kjo nuk ndihmon për ta kuptuar drejt situatën reale në Siri. Për fat të mirë në Siri ekzistojnë një numër i burimeve të pavarura që na ndihmojnë për të ardhur gjer te një kuptim më objektiv dhe më real.

Sikur t’u besonim shumicës së raporteve perëndimore, do të mendonim se kryetari Asad kryen sulme të vazhdueshme indiskriminatore ndaj banorëve civilë, përfshirë edhe përdorimin e helmeve të luftës kundër fëmijëve. Gjithashtu do të mendonim se regjimi i tij kryesisht është ‘alevit’ ku pakica prej 12 përqind bën represion ndaj shumicës sunite, ngulfat ‘revolucionin’ popullor të cilin pas vitesh e kanë ‘kidnapuar’ ekstremistët.

Problemi kyç që nuk përputhet me këtë version të rrëfimit është popullariteti i Asadit në mesin e popullit. Fakti që ka pasur pakënaqësi popullore me koopcion dhe klientalizëm, se ka ekzistuar frikë nga policia e fshehtë e regjimit, madje se shteti autoritar ruan një lloj kulti të personalitetit, në asnjë mënyrë nuk do të thotë se Asadi nuk gëzon popullaritet në mesin e qytetarëve të Sirisë. Bile këtë e pranojnë edhe numri më i madh i armiqve të tij. Andaj ky detal duhet analizuar thellë.

Basha el Asadi, specialist i syve i cili një pjesë të studimeve universitare e kaloi në Britani të Madhe, praktikisht në vitin 2000 detyrohet të marrë funksionin e presidentit nga ana e partisë Ba’th pas vdekjes së babait të tij Hafez el Asadit. Prej këtij pritej ta ruajë trashëgiminë plurale por nacionaliste politike të vendit në njërën anë, por gjithashtu të sjell masa të domosdoshme të reformave politike dhe ekonomike. Hafez el Asadi i solli Sirisë tri dekada stabilitet të brendshëm politik, pas trazirave që e goditën këtë vend gjatë gjashtëdhjetë viteve. Kjo periudhë mundësoi një përparim të dukshëm shoqëror. Ndasitë shoqërore u zbutën duke përdorur presion të madh ndaj qytetarëve që të ndjehen dhe të identifikohen para së gjithash si sirianë, pa ndonjë aksent të

theksueshëm të përcaktimit ndaj ndonjë bashkësie religjioze. Në suaza të arsimit dhe shëndetësisë u bënë shumë ndryshime pozitive, përfshirë edhe programin universal të vaksinimit, madje zhvillimi dhe përparimi i shkrim-leximit të gjinia femërore. Në mes viteve 1970 dhe 2010 mortaliteti i foshnjave ra prej 132 gjer në 14 (në 1000 banorë), ndërsa mortaliteti i nënave ra prej 482 deri në 45 (në 1000 banorë). Furnizimi me rrymë elektrike në vend rurale u rit prej 2 përqind në 1963 në 95 përqindje në vitin 1992 (Hinnebusch 2012: 2). Tradita e pluralizmit shoqëror së bashku me zhvillimin në sferën arsimimit e ngritën indeksin e zhvillimit njerëzor të vendit mbi atë të disa vendeve më të pasura në rajon. Pa marrë parasysh këtë, sistemin që e ndërtoi Hafez el Asadi në aspekt shoqëror ka qenë inkluziv, ai edhe më tej mbeti sistem autoritar një partiak, i kushtëzuar me luftë me Izraelin dhe me kryengritjet e kohëpaskohshme të armatosura që i bënë Vëllezërit muslimanë. Të dhënat inteligjencës amerikane theksojnë se shumica e qytetarëve sirianë lejuan ngufatjen e orvatjes së kryengritjes së armatosur që e bënë Vëllezërit muslimanë në vitin 1980. (DIA 1982, vii). Krahas kësaj, pas kësaj ngjarje, çdo kritikë ndaj qeverisë shihej me një dozë të madhe dyshimi. Atëherë u ndaluan grupet sektare si dhe pranimi i ndihmave financiare nga jashtë për qëllime politike. Në një situatë të atillë, pohojnë disa personalitete opozitarë, qytetarët e Sirisë u ndjenë pa ndonjë ndihmë dhe ‘nuk dijtën si të ndërmarrën ndonjë iniciativë ose të prezantojnë apo t’i zhvillojnë idetë e veta’ (Wikas 2007: 2). Policia e fshehtë famëkeqe (muhaberat) në çdo moment ishte e gatshme t’i identifikojë spiunët sionistë dhe komplotet e reja të Vëllezërve muslimanë, por kjo gjithashtu nënkuptonte se në të njëjtën kohë kanë maltretuar një shtresë të gjerë të kritikëve të qeverisë (Seale 1988:335). Nga pikëpamja e opozitës shekullare, partia social-nacionaliste ishte e pakënaqur me kompromisin e dështuar që e la pas vete Hafez el Asadi, sipas të cilit me kushtetutën e vendit kryetari i republikës patjetër të jetë musliman (El-Ahbar, 22 shkurt 2012). Përveç kësaj, mbretëronte një pakënaqësi e madhe nga shkaku i përhapjes së koopcionit që u shkaktua nga klientalizmi i cili zbatohet përmes

rrjetit të Ba'th partisë. Bashari me krejt këtë u ballafaqua kur e mori detyrën e kryetarit.

Ky kapitull ka të bëjë me analizën e lëvizjes për reforma politike prej momentit të ardhjes së Bashar el Asadit për krytar të Sirisë gjer te paraqitja e kryengritjes së armatosur në vitin 2010. Madje, kapitulli analizon dëshmitë me kualitative mbi përkrahjen vendore që e gëzon kryetari Asad.

5.1 Lëvizja për reforma

Me fillimin e këtij mileniumi, Bashar el Asadi u paraqit si kandidat zyrtar për realizimin e atyre reformave, por në këtë u ndesh me opozitën serioze politike, edhe pse e fragmentuar që ishte kundër Ba'th partisë. Shumë vetë në fizionominë e re të kryetarit të ri shihnin shansa për reforma, ndërsa të tjerët, veçanërisht organizata e ndaluar e Vëllezërve muslimanë, dëshironin të demonstrojnë plotësisht sistemin e shtetit shekullar dhe të vënë një lloj teokracie. Por, me vet faktin që erdhi te ndërrimi i udhëheqësisë, dhe që kryetari i Sirisë tani u bë një lider i shkolluar në Perëndim, viti 2000 i dha shkas idesë së 'Pranverës së Damaskut' të qëndrueshme.

Bashari në kuptimin më të gjerë shihej si një njeri që do të mund t'i zbatojë reformat, por me që ngritja e tij meteorike varej shumë nga vullneti i rrjetit të shtrirë të Ba'th partisë në pushtet e cila e kandidoi për kryetar për këtë nuk ndodhën reforma politike dramatike, krahas akuzave të qytetarëve për shtrirje të gjerë të koopcionit. (Otrakji 2012).

Megjithatë, reformat e tij socio-ekonomike shiheshin në atë se ai përsëri ka nxitur arsimim të përgjithshëm dhe të drejtë shtetësie, krahas liberalizimit të kontrolluar ekonomik që ua hapi dyerët tregjeve të reja por që nuk e arriti shkallën e privatizimit që e vërshoi Evropën lindore. Asadi mundësoi të lirohen disa mijëra të burgosur politikë, kryesisht islamikë dhe simpatizuesit e tyre (Landis and Pace 2007 : 47). Ai me siguri nuk ka pasur më tepër hapësirë për reforma politike gjatë viteve të para të qeverisjes së tij marrë para sysh se nuk e ka pasur të organizuar bazë të përkrahjes jashtë partisë Ba'th. Me siguri, me dëshirë që në një farë mënyre ta

kompensojë, filloi të vë lidhje me një numër të madh biznismenësh, ndërsa edhe inicoi themelimin e disa organizatave joqeveritare për të rinj, studentë dhe për punëtorë rural. Në mesin e këtyre organizatave bën pjesë edhe Fondacioni sirian për zhvillim dhe Fondi për zhvillimin të integruar rural të Sirisë (FIRDOS). Zonja e parë, Esma el Asad ka pasur një rol të veçantë në disa prej këtyre organizatave, veçanërisht në ato aktivitete të cilat kanë pasur të bëjnë me çështjet e rinisë dhe fëmijëve. Këto organizata tërhoqën edhe disa partnerë ndërkombëtarë, përfshirë edhe UNDP dhe UNICEF (Kawakibi 2013. Një analist amerikan tregoi se gjatë Pranverës së Damaskut e vitit 2000 erdhi gjer te ‘lulëzimi i lirisë së mendimit dhe të fjalës dhe te e drejta për tubim dhe veprim politik, që nuk ka qenë më parë që nga viti 1950. (Wikas 2007: 4). Pa marrë parasysh reformat e tregut, Siria e ruajti praktikisht shërimin falas dhe të drejtën për shkollim falas. Universitetet shtetërore gjithashtu kanë qenë thuajse falas deri më sot, ku u regjistruan disa qindra mijë studentë. Ky nivel i shkollimit masiv është kritik për vënien e implikimit shoqëror.

Në atë periudhë u formua një numër i konsiderueshëm i grupeve politike dhe i klubeve debatuese, të cilat kanë patur një orientim kritik ndaj qeverisë. Përfshirë edhe forumet shoqërore: Kawakibi, Attasi dhe forumin për dialog popullor. Këto forume filluan me sjelljen e apeleve dhe kërkesave ndaj qeverisë. Një kërkesë e tillë tërhoqte 1.000 nënshkrues (Landis and Pace 2007 : 47). Për kundër kësaj, ligjet mbi ‘gjendjen e jashtëzakonshme’ ende ishin në fuqi, ashtu që shërbimet inteligjencës ushtarake në disa prej këtyre organizatave të sapoformuara i njihnin komplotistët, që solli gjer te burgosjet të cilat këtë periudhë optimiste e shndërruan në njëfarë, si e quajtnë disa, ‘Dimri i Damaskut’. Prej disa disidentëve është bërë publike se janë të torturuar, madje edhe të vrarë. (Ghadry 2005; Ultas 2011: 80-90). Pa marrë parasysh këtë, disa analistë amerikanë relativisht mirë të informuar thonë se pas ‘Pranverës së Damaskut kanë mbetur disa të arritura pozitive, edhe pse modeste’. Nuk ekzistonte bashkimi i opozitës, por për herë të parë pas shumë dekadave ‘disa individë fituan shansin që

t'i shprehin lirshëm qëndrimet e veta publikisht'. Disa prej këtyre forumeve debative mbijetuan disa vite, në mesin e të cilëve edhe Komiteti për rimëkëmbjen e shoqërisë civile si dhe forumi Attas për dialog demokratik. (Landis and Pace 2007: 48-49).

Por, me invazionin amerikan në Irak, Siria u gjet e zënë ngushtë midis dy fuqive të mëdha okupuese ushtarake, izraelite dhe amerikan, ndërkaq të dyja ishin të ndara në mënyrë antagonistë ndaj Sirisë. Më se një milion refugjatë sirianë u arratisën në Siri për t'i ikur masakrës. Zemërgjerësia e Sirisë që e tregoi me rastin e pranimit të refugjatëve nga Iraku, nga ana e amerikanëve është komentuar se si Siria, në fakt, i jep përkrahje lëvizjes irakiane të rezistencës kundër agresionit amerikan, pas së cilës iu vunë sanksione Sirisë. Por, ajo që sërish ndezi shkëndijën të aktiviteteve të opozitës në Siri, në të vërtetë ishte tërheqja e papritur e trupave siriane nga Libani në vitin 2005. pas afërsisht 10 vjet okupim të këtij vendi, që më vonë solli gjer te paraqitja e të ashtuquajturit 'Cedër revolucion' i Libanit. Edhe pse ky 'revolucion' libanez është vlerësua me një dozë të madhe të skepticizmit. (Narwani 2015), ai sërish inicoi në mënyrë të jashtëzakonshme shfaqjen e fortë të bashkimit në mes grupeve opozitare në Siri. Deklarata e dokumentit nga ajo kohë mbetet përafërsisht një tregues i mirë i parimeve ku të gjitha ato grupe të ndryshme mund të pajtohen.

Takimi që ndodhi në tetor të vitit 2005 që rezultoi me 'Deklaratën e Damaskut' e cila kërkonte reforma demokratike, konsiderohet 'takimi më i madh i opozitës politike në historinë e qeverisjes së partisë Ba'th e cila është në pushtet prej vitit 1963. Në atë takim morën pjesë islamikët, liberalët, marksistët si dhe arabët e nacionalistët kurdë. (Rasas 2013). Ky miting opozitar kontribuoi për parimet e pluralizmit, mos dhunës, bashkimit të opozitës dhe për ndryshime demokratike. (Ulutas 2011: 90). Deklarata që u soll atëherë fillon me pohimin se qeverisja Ba'thiste shpronësoi popullin, duke pohuar se pushteti vuri monopol mbi tërë shoqërinë për një periudhë të gjatë 30 vjeçare dhe se ka vënë regjim autoritar të një klike të ngushtë si pasojë e të cilës ishte se njerëzit humbën interesimin për politikë dhe për ngjarjet politike.

Thjeshtë thënë, qytetarët si rezultat i kësaj e humbën vullnetin dhe dëshirën për veprimtari publike. Deklarata bënte apel për ‘vënien e pushtetit popullor demokratik me mjete të qeta, gradualisht, me një marrëveshje popullore e bazuar në dialog dhe në respektimin dhe pranimin e tjetrit dhe të mendimit tjetër. Kategorikisht e hodhi poshtë përdorimin e dhunës dhe eliminimit dhe në mënyrë decide haptas i dha përkrahje Islamit si ‘komponenti më i rëndësishëm kulturore në jetën kombit sirian’. Deklarata gjithashtu hodhi poshtë çdo ide për një shtet një partiak. Ligji për gjendje të jashtëzakonshme, për regjim ushtarak për gjykatat me autorizime speciale patjetër duhet anuluar me theks të forcimit të armatës nacionale që do të jetë e depolitizuar dhe e cila s’mund të jetë arbitër i garave politike, i konfliktit ose edhe e cila krejtësisht do t’u nënshtrohet parimeve demokratike të pushtetit. Organizatat popullore dhe shoqërore, lëvizjet, sindikata e punëtorëve dhe shoqatat tjera duhet liruar nga ‘kontrolli shtetëror dhe hegjemonia e sigurimit që deri më atëherë mbi ta qëndronte shteti dhe partia Ba’th në pushtet. Kjo ishte një deklaratë e matur të cilën e karakterizonin shenjat e neutralitetit dhe laicizmit. Sistemi i ri do të duhej të ishte i përcaktuar për Sirinë si pjesë përbërëse e ‘rendit arab’ me një theks të veçantë për unitet arab. Deklarata kategorikisht e hudhi poshtë çfarëdo ndryshimi që do të vinte me ndikim nga ndonjë faktorë prej jashtë. Gjithashtu u është bërë apel për gjetjen e ‘zgjidhjes së drejtë demokratike’ për ‘çështjen e kurdëve në Siri’. Dokumenti në konkluzë gjithashtu bën apel në mbajtjen e ‘konferencës popullore’ e cila do të duhej të shpije deri te mbajtja e zgjedhjeve të lira për kuvendin përfaqësues, planin e kushtetutës së re në bazë shumicës politike (Deklarata e Damaskut 2015).

Kjo shkallë e bashkimit opozitar u shkatërrua shumë shpejt dhe atë sipas linjës të cilën lehtë mund të parashikohej. Siç thekson Landis dhe Pace (2007: 46) ‘Prijsit e të majtës marksiste dhe e të djathtës islamike u ndeshën atëherë kur u munduan të gjejnë pikë të përbashkët’ në bisedat në të cilat gjithashtu participonin liberalët, kurdët, opozita politike në egzil dhe asirianët (Uuta 2011: 90). Në fillim Vëllezërit muslimanë (së bashku me të ikurin nga partia

Ba'th, Abdul-halim Haddamin) formuan 'Frontin islamik' të shpëtimit gjatë vitit 2006. Pas kësaj, në mbledhjen e Këshillit Nacional të deklaratës së Damaskut në dhjetor të vitit 2007, uniteti socialist dhe Partia e aksionit komunist i hodhën poshtë kërkesat e partisë liberale kurde të cilët biseduan në interes të faktorëve të jashtëm intervenimi i të cilëve do të ndihmonte në realizimin e ndryshimeve politike. Partia socialiste dhe komuniste së bashku me partinë kurde të së majtës (ndërsa më vonë edhe me një parti tjetër kurde të cilën e themeloi Nasruddin Ibrahim) u mundësuan të gjejnë zgjidhje alternative 'herën e tretë' në mes Deklaratës së Damaskut dhe qeverisë së partisë Ba'th.

Vëllezërit muslimanë që nga viti 2009 e lëshoi aleancën opozitare, ndërsa kah fundi i vitit 2009 grupet kurde (në përjashtim të PYD-së) formuan Këshillin politik kurd (Rasas 2013). Krahas kësaj, qeveria po ashtu mori masa kundër disa nënshkruesve të Delaratës. U ndalua Atassi Forum (Ulutas 2011 : 91). Në mars të vitit 2005 qeveria ua mori lejen kanaleve mediatike (Al Hurra dhe Radio Sawa -së) të cilat i financonte SHBA. (Landis dhe Pace 2007: 57). Ky fragmentim pamundësoi çfarëdo veprimi të përbashkët të opozitës së bashkuar.

Baza për bashkëpunim të islamikëve me opozitën pluraliste shekullare-nacionaliste dhe me forcat e së majtës, gjatë gjithë kohës ka qenë afërsisht e dobët dhe kryesisht është bazuar në kritika ndaj pushtetit ba'thist për koopcion dhe për zbatimin e represionit shtetëror, Një kohë, këto forca diametralisht të kundërta kanë patur një retorikë të përbashkët. Siç thekson Kaweakini (2007: 3), pjesëtarët e Vëllazërisë muslimanë 'shpesh përmendnin se si të drejtat njerëzore janë viktima më e madhe e sistemit represiv' edhe pse kanë qenë përafërsisht selektivë kur kishte të bëjë me 'ato aspekte që e pengonin çështjen e tyre'. trajtimi i tyre ndaj të drejtave njerëzore ka qenë i trishtueshëm. Gjatë pesëdhjetë viteve të shekullit të kaluar përfaqësuesit politikë të vëllezërve muslimanë janë ulur në parlamentin sirian. Por prej atëherë e këtej, një pjesë e konsiderueshme e masave autokratë që i zbatonte shteti ishin të drejtuara kah pengimi i veprimit të kryengritjes

sektare, e cila disa herë kryente vrasje, atentate dhe masakra në qytetarët e pafajshëm.

Pas Deklaratës së Damaskut, një raport amerikan ‘opozitën laike të Sirisë’ e vlerësoi ‘plotësisht të paaftë’, ndërsa ngufatja e islamikëve me orientim sektar mundësoi formimin e taktikës dhe politikës së tanishme shtetërore ndaj islamikëve (Wikas 2007: 12,22). Megjithatë, nacionalizmi arab dhe solidariteti rajonal edhe më tej ishin të fuqishëm ndërsa kryetari i ri nuk humbi në popullaritet si në rajon ashtu edhe në vet Sirinë. Hulumtimi i opinionit publik që u shpall në 2009 dhe atë në gjashtë shtete, ku Izraeli dhe SHBA-të u përmendën si dy kanosjet më të mëdha ndaj rajonit, (88 për qind Izraeli dhe 77 përqind SHBA), gjithashtu Bashar el Asadin e përmend si liderin arab më me popullaritet në Lindjen e afërme. (Mesi 2009). Kjo pasqyrë rajonale do të ndryshojë në mënyrë dramatike me shpërthimin e dhunës në vitin 2011, pavarësisht mendimit që dominonte brenda Sirisë.

Me tubimet protestuese që filluan në shkurt e deri në mars të vitit 2011, erdhi deri te forcimi i ndikimit të aktiviteteve politike dhe atë kryesisht në qendrat rajonale dhe jo aq në Damask dhe Halep (Ulutas 2011: 99 -100). Kësaj here gjërat ishin krejtësisht ndyshe. Shumica e grupeve opozitare vendase, siç e pohuan në Deklaratë nga viti 2005, nuk i përkrahën sulmet e armatosura ndaj shtetit po as lejuan kyqjen e fuqive të jashtme. Shumica mbetën në Siri, e disa si partitë social-nacionale përkrahën qeverinë e Sirisë. Ato tjerat, edhe pse s’e përkrahën politikën e qeverisë, përkrahën shtetin dhe armatën. Siria edhe më herët ka pasur përvojë me opozitën sektare islamike të armatosur. Ajo që në qarqet perëndimore do të quhej ‘opozitë’ kryesisht ishin opozitarët në egzil dhe islamikët që e filluan përmbysjen e dhunshme. Takimet e opozitës në egzil nisën nga Parisi, Turqia dhe Briseli. Nëpër këto takime kanë marrë pjesë një numër individësh dhe grupesh, por ishin keq të koordinuar dhe menjëherë ranë nën kontrollin e jashtëm, ndërkaq Vëllazëria muslimane menjëherë e mori rolin udhëheqës (Ulutas 2011: 91 -94). Informacionet perëndimore mbi lidhshypin islamik shpeshherë janë prezantuar me zemërgjerësi, sepse Vëllazëria

muslimane ka qenë më mirë e organizuar dhe si e tillë ka paraqitur partnerin më të besueshëm në cilin do operacion 'për ndryshim të regjimit' në marrëveshje me fuqitë perëndimore.

Hasan Mneimneh u kërcënua, në deklaratën për 'Forum-in e Briselit' të stacionuar në Vashington se si rreziku i vërtetë për rajonin është 'Dimri islam', marrë parasysh që e ashtuquajtura Pranvera arabe u ka dhënë islamikëve 'fitore të papritur dhe mbase të pamerituar'. Por, ai vazhdon së tepriuari të nxjerr në pah përkrahjen të cilën gjoja se e gëzojnë Vëllezërit muslimanë si dhe grupet tjera selefiste muslimane, duke pohuar se si selefistët 'gëzojnë përkrahje të madhe të bazës zgjedhore siriane' gjersa Vëllazëria muslimane gëzon një numër të rëndësishëm të votave bile 'përkrahjen e shumicës' (Mneimneh 2012 : 1- 4). Natyrisht, pohimet e këtilla janë në përplasje me historinë e fortë pluraliste të Sirisë dhe as hulumtimet rajonale të mendimit publik nuk i mbështetin pohimet e këtilla. Për shembull hulumtimi i mendimit publik i cili u realizua më 1984 në mes palestinezëve, tregoi se edhe pse gjysma e banorëve janë shumë religjioz (falin pesë kohët e namazit), pra më religjioz në këtë aspekt se sirianët, politika shekullare-nacionaliste e Organizatës Çlirimtare Palestineze OÇP ka gëzuar 90% të përkrahjes. Kjo ka reflektua keq në strategjinë e Vëllazërisë muslimane që ishte e orientuar kundër palestinezëve me orientim shekullare-nacionalist të palestinezëve në krahasim me forcën okupuese. Nga ana tjetër, Izraeli konsideronte se të kishte 'çfarëdo suksesi të Vëllazërisë muslimane do të ishte në dëm të nacionalistëve'. Mu për këtë shkak 'Vëllezërit muslimanë kanë gëzuar një trajtim më të butë (nga ane e izraelitëve) se sa ndaj nacionalistëve palestinezë' (Shadid 1988: 663, 674 - 675, 679). Përkrahjen e Islamit nuk duhet ngatërruar me përkrahjen e islamikëve sektar. Zyrtari lartë i qeverisë në Damask kah fundi i vitit 2013 pranoi se Vëllazëria muslimane tërë kohën ka qenë grupi më i madh dhe më i organizuar në vend, por përkrahje e banorëve Vëllazërisë që nuk e përkrahin dhunën, nuk kalon më shumë se 15 %. Në momentin kur Vëllezërit muslimanë do të shfrytëzojnë metoda të dhunshme dhe dhunë sektare, ajo

përkrahje do zvogëlohet më shumë. Në rrethanat të clat e kishin kapluar më Egjiptin dhe Tunizinë, por dy muaj para se të shpërthejë dhuna në Siri, Asadi deklaroi se është i gatshëm për të bërë reforma serioze. Asadi deklaroi : Nëse nuk ndjeni nevojë për reforma para ngjarjeve në Egjipt dhe Tunizi, atëherë është shumë vonë për çfarëdo reforme'. Plani i tij për reforma kishte të bëjë me zgjedhjet komunale (lokale), dhënie liri më të madhe sektorit joqeveritar NVO, pastaj sjelljen e ligjit të ri për mediat.. Qeveria e tij i kishte rritur donacionet për ngrohje (Solomon dhe Spindle 2011), Jo shumë koh pas kësaj u soll edhe ligji i ri për zgjedhje, edhe pse e kundërshtuan grupet opozitare në egzil. (Hatem 2011). Të tjerët e vërejtën se Siria është ndryshe nga Egjipti, në kuptim që qeveria e Sirisë në mënyrë aktive ka bërë reforma pozitive sociale dhe arsimore, nuk ka akumuluar borxh të jashtëm, ka siguruar të drejta për pakicat fetare dhe etnike dhe ka mbajtur politikën e jashtme të pavarur, pavarësisht nga ndikimi i agjendës amerikane-izraelite. 'Kur Bashar el Asadi thotë se i përkrah reformat politike, shumë sirianë i besojnë... Qytetarët e Sirisë gjatë viteve të kaluara me të vërtetë kanë gëzuar më shumë liri fetare dhe qytetare, që natyrisht vë në veprim lirinë për shumicën sunite' (Hetou 2011). Siria nuk është Egjipt.

Gjatë vitit 2011 në kohën e liberalizmit të hapësirës shtetërore janë formuar një sërë shoqatash dhe këshillash qytetare, disa prej tyre ishin me veçori të ndryshueshme madje më me shumë ose më me pak përkatësi me partitë politike. Në mes tyre ka pasur këshilla lokale koordinuese (LCC), federata të këshillave koordinuese të revolucionit sirian (FCC) dhe komitet të aksionit nacional. Deri sa një numër prej tyre filluan të veprojnë si grupe lokale fqinje, shumë prej këtyre organizatave u bënë shumë më aktive në koordinimin e mediave se sa në udhëheqjen e lëvizjeve protestuese (As Ebu Naim 2011). Këshillat koordinuese lokale, edhe pse gjatë vitit 2011 kanë apeluar 'përmbysjen e regjimit', kategorikisht i kanë hedhur poshtë thirrjet për kryengritje të armatosur e intervenim ushtarak' duke pohuar se si 'militarizimi i revolucionit do ta zvogëlonte përkrahjen e gjerë popullore dhe pjesëmarrjen në revolucion'

(LCC 2011). Megjithatë vetëm nga fillimi i vitit 2013 ajo pak që kishte mbetur nga LCC-ja u bë me të madhe pjesë përbërëse e grupeve të armatosura islamike, ashtu që krejt aktiviteti i këtij trupi u reduktua në informim mbi humbjet e tyre në fushëbeteja (LCC 2013).

Me paraqitjen e kryengritjes së armatosur islame, hendeku i ndarjes midis grupeve opozitare filloi gjithnjë e më tepët të thellohet, por përkundër kësaj vazhdoi me përpjekjet për të gjetur një pikë të përbashkët. Një dokument që është prezantuar në Paris dhe Damask dhe u është paraqitur grupeve opozitare por jo edhe Vëllazërisë muslimane, gjoja se ishte në dilemë mes ‘mbrojtjes së reformave e ndryshimit të rendit politik, por përkrahu kryengritjen e armatosur dhe përmbysjen e qeverisë me mjete të dhunshme’. Ky dokument paraqiste bazë për krijimin Këshillin koordinues nacional për ndryshime demokratike në Siri. (NCC), që paraqiste trupin i cili përkrahu modelin e qëndrueshëm ‘për herën e tretë’ e që ishte formuar në muajin qershor të vitit 2011. Në këtë trup ka marrë pjesë edhe Partia socialiste e bashkimit, grupet marksiste me orientim majtist, katër parti kurde, përfshirë këtu edhe Partinë e bashkimit demokratik PYD pastaj një numër i caktuar i aktivistëve politikë të pavarur. Për këto grupe politike u pohua se përfaqësojnë të majtën arabe, kurde dhe marksiste.’ (Rasa 2013).

Muajin e ardhshëm, në korrik të vitit 2011 erdhi deri te përpjekja e formimit të Këshillit nacional të Sirisë (SNC), ashtu që përmes këtij të lidh NCC me atë që kishte mbetur nga Deklarata e Damaskut dhe me Vëllazërit muslimanë. Për fat të keq ky plan dështoi sepse Vëllazëria muslimane dhe grupi që ishin mbledhur përreth Deklaratës iu kundërvunë kërkesave të NCC që haptas ‘refuzoi të pranojë çfarëdo intervenimi të jashtëm ushtarak në Siri dhe insistoi për një zgjidhje të drejtë të çështjes kurde’. Rezultat i kësaj ishte që Vëllazëria muslimane dhe ajo që kishte mbetur nga grupacioni që u krijua me Deklaratën e Damaskut të cilën e përbënin shumica e Këshillit nacional të Sirisë që gëzonte përkrahjen nga jashtë e që ishte themeluar në Stamboll në tetor të vitit 2011. (Rasas 2013).

Por, çdo sponsorim nga jashtë ka çmimin e vet. Kah fundi i vitit 2011 SNC në egzil nga ana e qeverive perëndimore dhe monarkive të Gjirit shpallet ‘përfaqësues legjitim’ i popullit sirian, që më pas, për më pak se një vit, përsëri të mbetet pa pompën e madhe i hedhur në dobi të një organizate të re në egzil e cila u quajt Kualicioni nacional i revolucionit sirian dhe i forcave opozitare, ose, si njihet shkurtimisht si Partia social-nacionaliste e Sirisë SNC (Al Arabija 2012). Vendimi për formimin e saj është sjellë në Vashington.

Partia social-nacionaliste e Sirisë (SSNP), e dyta parti politike shekullare për nga madhësia pas ba’th partisë socialiste arabe (në Siri), me formacionin e vet ushtarak pastaj me degët në Liban, mbeti edhe më tej lojale në ‘ruajtjen e stabilitetit të shtetit’. Kjo parti përsëri hyri në parlamentin e Sirisë gjatë vitit 2005 dhe konsiderohej mbrojtëse kryesore e lëvizjes për reforma në Siri (Haidar, Ali 2013). Disa komentatorë konsiderojnë se instancat më të ulëta të degëve të kësaj partie kanë patur disa mospajtime në aspekt të mbështetjes së qeverisë, por nënkryetari i SSNP-së për Sirinë, Safwan Selmani deklaroi: ‘Përiqem paralelisht për stabilitetin e shtetit Sirian dhe për kohezionin e shoqërisë siriane, por pas reformave të vërteta dhe me ndikim më të gjerë. Besojmë se për sukses të reformave politike është e patjetërsueshme të ruhet stabiliteti i shoqërisë siriane.

Në kohën e amendamenteve të kushtetutës dhe zgjedhjeve parlamentare që u mbajtën kah fillimi i vitit 2012, SSNP -ja u bë kritik i hapët ndaj qeverisë (duke insistuar në apel se si Kuvendi popullor patjetër të sjell kushtetutë të re) duke shprehur haptas pakënaqësinë ndaj punës së kuvendit, por përsëri vendosi të mos e bojkotojë seancën e tij (al Ahbar 22 shkurt 2012; al-Abar 15 maj 2012); nuk e bojkatoi as partia komuniste që e udhëhiqte Kadir Xhemil. Pas zgjedhjeve të përmendura disa përfaqësues jashtë rrethit të ngushtë të ba’th partisë u inkorporuan në qeveri, ndërsa kryetari i SSNP-së, Ali Haidari, pranoi ftesën e kryetarit Asad i cili e emëroi ministër për pajtim, me qëllim të vazhdimit të dialogut me opozitën civile si dhe me grupet e armatosura.

5.2 Bashar, i demonizuar në botë, i popullarizuar në Siri

Popullariteti i kryetarit të Sirisë, së paku në shtëpi -Siri, seriozisht dëmton përpjekjet me të cilat tërë kohën mundohet bota ta paraqes si monstrum. Monarkia e Katarit është armike a hapët e Sirisë, me që ky vend tekstualisht ka investuar me miliarda dollarë në grupet e armatosura islamike (Halef dhe Smith 2013). Megjithatë, edhe marrja e mendimit publik të cilin e realizoi rrjeti televiziv i Katarit pranoi popullaritetin e kryetarit Bashar. Në janar të vitit 2011 rrjeti kryesor televiziv i Katarit, El-Xhezira erdhi në përfundim që mundësitë që në Siri të vijë gjer te revolucioni janë shumë të dobëta, pikërisht për shkak të popullaritetit të madh të Asadit. Edhe pse punohet për një qeveri autokrate, ‘popullariteti real që gëzon kryetari i shtetit dhe prania e pluralizmit fetarë janë faktorë që nuk i shkojnë në favor paraqitjes së kryengritjes në atë vend’ (Wikstrom 2011). Bashari ka gëzuar popullaritet veçanërisht midis të rinjëve, deklaroi analisti amerikan Joshua Landis ‘Të rinjtë mbase nuk e duan regjimin e Asadit, ata nuk e lejojnë koopcionin, por për këto dukuri negative i akuzojnë njerëzit përreth Asadit, të ashtuquajturën “gardën e vjetër”. Qytetarët kërkojnë ndryshime për shkak të varfërisë që i ka kapluar, për shkak të koopcionit dhe për shkak të aparatit represiv të policisë politike, por sirianëve u pëlqen mbështetja e Asadit ndaj pluralizmit dhe reformave të modernizimit të shoqërisë (Wikstrom 2011).

Popullariteti i fituesit u vërejt në fillim, gjatë kohës së tubimeve të mëdha proqeveritare si përgjigje e grupeve protestuese opozitare. Njëri nga gazetarët e rrallë të Perëndimit me një ndjenjë serioze ndaj historisë arabe madje ai që ka sy për detaje të imëta, Robert Fisku, por në të njëjtë kohë ai që për afërsisht është cinik ndaj regjimit sirian, regjistroi vërejtjen që vijon: ‘Fillon edhe një tubim në shenjë përkrahje Asadit... Deri në mesditë, numri i simpatizuesve të tij në tregun Emevit (në Damask) arriti numrin prej 200.000.. njerëzit këtu nuk janë vozitur me autobusë dhe kamionë ashtu siç vepronte një kohë Sadam Huseini në Irak... vetëm pjesëtarët e ushtrisë qëndronin me familjet e veta. Çka të

tregojë njeriu për demonstratat proqeveritare gjatë kohës së Zgjimit arab? Gra të mbuluara, pleq, me mijëra fëmijë... a mos i detyroi dikush këta që të shprehin mbështetjen e vet Asadit? Unë mendoj se jo' (Fisk 2011). Kritikët më të dijshtëm vërejtën se shansi për të ardhur gjer te konflikti i armatosur në Siri gjithnjë ka qenë sipas shabllonit të shtetit pluralist dhe islamikëve me orientim sektar, të cilët i përmbajnë fuqitë e mëdha. Analisti irako-britanik, Sami Ramadani, kritik i qeverisë në Damask, pohon se 'Me Sirinë udhëheq regjimi i kooptuar i paskrupull përmes aparatit represiv të policisë'. Megjithatë ai gjithashtu shton se për shkak të pranisë së forcave reaksionare që i përmban Arabia saudite dhe Katari, opozita demokratike dhe mbështetja e gjerë popullore anuan në dobi të qeverisë (Ramadani 2012). Ai thekson se pohimi për atë se Siria është regjim sektar alevit është i pabazë dhe 'shumë i tepruar'. Qeveria gëzon 'përkrahje të madhe të qytetarëve' përfshirë edhe shtresat e larta sunitë të popullatës pastaj 'milionatë të popullatës femra' që mendon se Siria mund të bjerr nën dominimin selefist. Më pastaj, 'një numër i madh i të varfërve, të papunësuarve dhe studentëve' të cilët në fillim me entuziazëm u bashkëngjiteshin protestave antiqeveritare, janë dëshpëruar dhe ndjejnë një armiqësi të madhe ndaj grupeve opozitare në egzil siç është Këshilli nacional i Sirisë dhe ushtria e lirë e Sirisë, ku plotësisht dominojnë Vëllezërit muslimanë (Ramadani 2012).

Analisti sirian Camille Otrakji konsideron se kryetari Asad: 'e ka humbur përkrahjen e shumë simpatizantëve' në vitin e parë kur erdhi deri te shpërthimi i dhunës sepse e konsideronin 'udhëheqës të dobët i cili nuk arriti që vullnetin e vet t'ia imponojë aparatit të sigurimit që ishte nën kontrollin e tij. Të tjerët mendonin se ai nuk është treguar sa duhet i rregjur kur është në pyetje shfrytëzimi i mjeteve të mas-komunikimit.. madje disa e konsideronin përgjegjës për numrin e madh të viktimave' (Otrakji 2012). Si do qoftë, shumica e sirianëve ishte ende më e pezmatuar me kryengritjen e dhunshme të armatosur. Një anketë e Turqisë e opinionit publik që u realizua gjatë vitit 2011 tregoi se qytetarët e Sirisë, në krahasim me rajonin 'më pak anonin' kah ngjarjet që i nxiti

‘Pranvera arabe’ në atë vit. Vetëm 22% e sirianëve kanë pranuar se ato ngjarje kanë efekt pozitiv në vendin e tyre ndërsa 91 % e kanë kundërshtuar dhunën (ndërkaq vetëm 5% i kanë përmbajtur protestat e dhunshme (TESEF 2012. Ramadani pajton këto dy pikëpamje dhe trendin duke konsideruar që pasi në fillim erdhi deri te rezistenca ndaj regjimit në pushtet në vitit 2011 ‘përkrahja e gjerë popullore u kthye në dobi të regjimit, atëherë kur qytetarët e Sirisë u bindën që pas kryengritjes së armatosur dhe dhunës sektare qëndron Arabia saudite dhe Katari (Ramadani 2012).

Në llogarinë provizore, Otrakji thekson se kryetari ‘meriton notë të dobët sepse nuk tregoi gatishmëri në luftën kundër koopcionit, si dhe për shkak se u dha pak prioritet reformave të sistemit autokrat të qeverisë që e trashëgoi’. Sa i përket ekonomisë këtu i dhuroi pak më shumë ‘nata të larmishme’, sepse zhvillimi ekonomik u aplikua në qytetet e mëdha, ndërkaq rajonet dhe vendet rurale ngecën prapa. Nga ana tjetër, Basharit mund t’i jepet mirënjohje për vendosmërinë që Sirinë u mundua ta ruajë si ‘ujdhesë të stabilitetit’ në krahasim me pjesën tjetër të rajonit që krejtësisht është në hallkë zjarri. Regjimi i Asadit mund të lavdërohet se niveli i participimit të gruas në shqërinë siriane është më i lartë për dallim nga shumë vende tjera në rajon, pavarësia në udhëheqjen e politikës së jashtme, si dhe ‘përvulësia dhe qasja si individ’. Edhe pse Asadi, natyrisht, nuk çon jetë modeste siç ishte rasti me babain e tij, akuzat në llogari të tij për shkallën e lartë të koopcionit që vijjnë nga jashtë, thjeshtë janë të ekzagjeruar’ (Otrakji 2012).

Anketimet që në vitin 2011 i financuan armiqtë e Basharit nga Katari tregojnë që shumica e të anketuarve jashtë Sirisë dëshirojnë që kryetari i Sirisë të largohet nga pushteti për shkak të ‘trajtimit brutal ndaj protestuesve nga ana e regjimit’. Megjithatë, ajo edhe më interesante është që, i njëjti anketim tregoi se 51% e qytetarëve të Sirisë dëshirojnë që Asadi të mbetet në pushtet (Doha Debates 2011). Kur anketimi që e realizon armiku tregon këtë rezultat atëherë patjetër duhet marrë atë seriozisht. Luftëtarët islamikë në Halep ishin më pak zemërgjerë, tre udhëheqës të Sirisë së lirë (por që të tre kanë bashkëpunuar me forcat e Al-Kaidës) deklaruan se

kryetari sirian gëzon më së paku '70 përqind' të përkrahjes në qytetet me shumicë muslimane sunitë (Bejumi 2013). Banorët lokalë 'të gjithë, pa përjashtim, janë lojalë të kriminelit Bashar, ata i japin informata dhe na spiunojnë neve' (Ebu Zejd 2012); 'të gjithë ata janë spiunë... ata na urrejnë nga loçka e zemrës. Ata na akuzojnë për shkatërrimin e tokës' (Ghaith 2012). Mungesa e popullaritetit në popull është fatale për një revolucion, ndërsa për një fanatik fetar kjo është e parëndësishme, por është vetëm një gjë e papëlqyeshme. Një studim intern që e bëri NATO gjatë vitit 2013 gjithashtu vlerësoi se afër 70 % e qytetarëve të Sirisë e përkrahin kryetarin e vet, 20% janë neutralë, ndërkaq 10% i përkrahin kryengritësit (World Tribune 2013; BIN 2013). Këto vlerësime nuk dallojnë shumë nga rezultatet e zgjedhjeve presidenciale që u mbajtën në Siri më 2014).

Megjithatë shkalla e demonizimit të Asadit jashtë Sirisë është shumë e lartë. Akuzohet kryetari i Sirisë se ka urdhëruar dhe ka udhëhequr me një numër të madh të masakrave të tmerrshme. Për shembull, masakra në të cilën janë vrarë më se njëqind dhe atë kryesisht fshatarë me orientim proqeveritar, distrikti i Houlit (në periferi të qytetit të Humsit) është shfrytëzuar si shkas për përzënien e diplomatëve sirianë dhe vënien e sanksioneve drakoniane ndaj Sirisë. Ky sulm, me siguri, ka qenë sulm 'false flang' (siulm nën flamurin e rrejshëm) (shih kapitullin e 8-të). Përkundër lojalitetit në dëm të qeverisë siriane, disa burime perëndimore po ashtu zbuluan sulme tjera të kryera nën flamurin e rrejshëm. Për shembull masakrën e 245 njerëzve që ndodhi në gusht të vitit 2012 në Daraja, për të cilën, në fillim, ishte e akuzuar 'Armata e Asadit' (Uveys 2012) më vonë këtë e argumentoi Robert Fisku që kishte të bëjë me masakrën mbi civilët dhe oficerët e kidnapuar që nuk ishin në detyrë, e kishin bërë pjesëtarët e ushtrisë së lirë të Sirisë -FSA, pas përpjekjes së pasuksesshme të ndërrimit e të zënëve rob (Fisk 2012). Në mënyrë të ngjashme, për masakrën që ndodhi më 10 dhjetor të vitit 2012 ku u vranë 100 fshatarë në Akreb, gjithashtu në fillim akuzohej qeveria siriane (Stack dhe Murteda 2012). Mirëpo, gazetari britanik Alex Thompson (2012) më vonë lajmëroi

se pjesëtarët e FSA-së i kanë mbajtur rob nëntë ditë 500 vendas alevitë, prej të cilëve shumë veta i vranë dhe kur armata siriane u afrua, pjesëtarë e këtyre bandave ua dhënë këmbëve.

Për incidentin në të cilin gjoja se është përdorur armë kimike në gusht të viti 2013 në Gautën perëndimore gjithashtu përgjegjësia iu përshkrua qeverisë së Asadit. Megjithatë të gjitha dëshmitë e pavarura gjithashtu e zbuluan këtë sulm si njërin në radhën e ‘false flag’ sulmeve. Në kapitullin 8 dhe 9 i kam dokumentuar në detaje shkrimet propaganduese që kanë të bëjnë me këtë masakër.

Një numër i konsiderueshëm i sirianëve me të cilët kam biseduar ishin kritikë ndaj kryetarit Asad, por jo në atë mënyrë si paraqitet në vendet perëndimore. Më thanë se u vjen keq pse Asadi nuk është dorë e hekurt siç ishte babai i tij. Shumë qytetarë të Sirisë, të paktën në fillim të krizës, konsideruan se Asadi përafërsisht është i butë dhe i pavendosur, kështu u bë i njohur si ‘Mr. Soft Heart’. Në vitin 2013 disa ushtarë me të cilët bisedova në Damask më thanë se është lëshuar urdhri ushtarak për burgosjen e kryengritësve të gjallë. Ky urdhër duket kontradiktor, sepse shumë veta terroristët sirianë i konsiderojnë tradhtarë të cilët aspak nuk janë më pak fajtorë nga terroristët e huaj. Ajo çka ndodhi me ata pas burgosjes, është diçka tjetër. Edhe pse nuk ekzistojnë dëshmi të pavarura kredibile mbi sulmet e qëllimshme të ushtrisë siriane ndaj civilëve, ekzistojnë disa video shkrime dhe dëshmi anekdotash mbi ekzekutimin e terroristëve të zënë rob nga ushtria siriane. Një akt i këtillë gjithsesi paraqet krim lufte, por ky krim lufte në Siri pranohet me të madhe, marrë parasysh se shumica e sirianëve kanë humbur ndonjë nga anëtarët e familjes së vet që janë vrarë nga ana e terroristëve.

Natyrisht, arsyeja kryesore, kur është fjala për demonizimin e Asadit duke ia ngjeshur atij ‘vrasjen e qëllimshme të civilëve’ për çka bëjnë zhurmë mediat perëndimore, qëndron në atë se ato akuza shkojnë në llogari të ushtrisë arabe të Sirisë, që gëzon autoritet të madh në popull, bile dhe në opozitën politike të Asadit brenda në Siri. Tradita e fortë shekullare e Sirisë më së shumti është ruajtur në institucionet e ushtrisë së saj. Ushtrinë siriane që ka afër

gjysmë milioni njerëz, si ushtarë të rregullt ashtu edhe rezervë, e përbëjnë ushtarët dhe oficerët që vijnë nga radhët e bashkësive të ndryshme fetare e etnike (sunit, alevit, shiit, të krishterë, druzë, kurdë, armenë, asirianë dhe të tjerë) dhe që të gjithë këta identifikohen si ‘sirianë’. Të përkujtojmë se Deklarata e Damaskut që është sjell në vitin 2005 si një prej themeleve të saj kryesor i dha përkrahje të fortë ‘ushtirisë së përbashkët nacionale’ duke dashur me këtë të heq qafe monopolin që e kishte deri atëherë mbi ushtrinë siriane partia Ba’th, por duke u përpjekur ta ‘ruajë shpirtin nacional (ushtarak) profesional për qëllim të mbrojtjes ‘të pavarësisë së vendit, ruajtjes së rendit kushtetues dhe mbrojtjes së atdheut popullor’. Kjo tregon faktin se komplet lëvizja antiba’thiste për reforma që ka filluar më 2005, qartë është përcaktua kundër çfarëdo sulmi ndaj armatës nacionale të Sirisë.

Grupi i parë që e theu këtë deklaratë, natyrisht, janë Vëllezërit muslimanë. Ata iu kthyen praktikës së tyre të kahershme të vjetër që kishte për qëllim përmbysjen e shtetit shekullar me mjete të dhunshme (Esh-Shakva 2011). Qëllimi i parë i kryengritjes që e inicuan Vëllezërit muslimanë ishte që të ndahet ushtria sipas parimit srktar. E logjikshme ishte që një numër i kuadrit të oficerëve, veçanërisht i atyre që kishin lidhje familjare me Vëllezërit muslimanë të heq dorë nga bashkimi dhe të largohet. Krimet që kishin bërë islamistët mbi alevitët dhe krishterët, padyshim se e ngritën tensionin në mes konfesioneve të ndryshme. Megjithatë para fundit të vitit 2011 zëdhënësi FSA- së në Angli, Rami Abdurrahman pranoi që më pak se 1.000 ushtarë sirianë kanë dezertuar (Atassi 2011). Ushtria siriane, e cila në mediat perëndimore shpeshherë quhet ‘lojaliste e Asadit’, ka mbetur përafërsisht e bashkuar si institucion nacional. Për dallim nga ajo, Vëllazëria muslimane dhe grupet tjera selefiste kryesisht janë mbështetur në parimin selefist. Këto grupe dhe aleatët e tyre të huaj të lidhur me Al-Kaidën, prej të cilëve perëndimi e pranoi idenë se qeveria e Asadit në të vërtetë është ‘regjimi alevit’, filluan t’i vrasin civilët alevitë dhe shiitë duke u përpjekur ta thellojnë konfliktin.

Armata nacionale siriane aq është e madhe sa që gati çdo njëra prej bashkësive të ndryshme konfesionale që jetojnë në Siri kanë në të nga një të vetin apo të afërm, përfshirë edhe ata që kanë humbur jetën në luftë. Gjatë kohës së konfliktit rregullisht janë organizuar grupe të përkrahjes dhe ceremoni që i ka përmbajtur qeveria në shenjë përkujtimi me familjet e të vdekurve në radhët e ushtrisë siriane. Mijëra njerëz me krenari i nxirrnin fotografitë e të vrarëve (IIT 2012; Sana 2015). Për më tepër, me miliona sirianë të cilët janë zhvendosur nga shkaku i luftës nuk e lëshuan Sirinë por vetëm se u shpërngulën në vise tjera ku gëzojnë mbrojtjen e ushtrisë siriane. Ky fenomen nuk do të ishte i mundur po të ishin në një farë mënyre të sakta akuzat në llogari të armatës që pa gajle të vrasë popullin e vet, veçanërisht civilët. Armata që vepron në mënyrë represive ndaj popullit nxitë frikë dhe urrejtje, por në Damask nuk është kështu dhe njerëzit ngatërrohen kur detyrohen të lëvizin ndërmjet shumë barrikadave, që janë vendua si mbrojtje prej ‘automobilave bombë të kryengritësve’. Trillimet mbi Basharin monstrum’ në Siri nuk pijnë ujë, përveç si parulla më të rënda të kritikëve të Asadit, për shkak se këto tregime reflektohen në autoritetin e ushtrisë, ndërkaq populli ka përvojat e tij të përditshme me armatën. Ato trillime janë të konceptuara për konsumimin e popullatës eksterne jashtë Sirisë, Qytetarët e Sirisë e dinë mirë se armata e tyre nacionale mban pluralitetin e Sirisë dhe se ajo lufton kundër sektarizmit dhe terrorizmit që i përmbajnë fuqitë e huaja. Ushtria e Sirisë nuk ka gjuajtur sipas linjës sektare siç kanë pritur bandat sektare, ndërsa dezertimi nga ajo ka qenë i rrallë, shumë më pak se dy përqind. Këshilltari i unionit evropian, Kemal Alem e ka përshkruar këtë në këtë mënyrë: ‘Mënyra se si vepron ushtria e Sirisë, detyrimisht mbështet në përkrahjen e popullit të cilën nuk mund ta zëvendësojë asnjë strategji tjetër (Alem 2015).

Atëherë çka po na tregojnë hulumtimet mbi nivelin e përkrahjes së kryetarit Asad në Siri? Natyrisht se kjo është një çështje substanciale kur flitet për cilin do lloj të legjitimitetit demokrat. Ka disa hulumtime të mendimit publik, si prej analistëve sirianë ashtu edhe prej atyre të huajve lidhur me zgjedhjet presidenciale

të vitit 2014. Kur janë në pyetje këto hulumtime atëherë duhet të mbajmë llogari, veçanërisht në kohën e luftës, ku qëndron çështja kryesore rreth së cilës thyhen shtizat, pra çështja e legjitimitetit. Siç e kam sqaruar në kapitullin e tretë, kuptimi i zakonshëm i shmangies së konfliktit të interesave, gjurmimi pas dëshmive të pavarura dhe diskualifikimi i pohimeve që kanë për qëllim të arsyetojnë veprimet e anës së vet në konflikt, rregullisht janë injoruar në pjesën më të madhe të diskutimeve ndërkombëtare mbi konfliktin e Sirisë. Mu për këtë e kemi për obligim të mbështetemi në diapazonin e gjerë të burimeve të ndryshme.

Disa hulumtime haptas duhet hedhur poshtë si të pabesueshme, siç është për shembull hulumtimi i institutit republikan ndërkombëtar që është bërë në bashkëpunim me hulumtimin e Pechte-it që e financoi kongresi amerikan (IRI 2012). Kjo pasqyrë i referohet intervenimit të jashtëm. Hulumtimi sjell përfundim se si ‘anëtarët e opozitës siriane përmbajnë intervenimin ushtarak ndërkombëtar në vendin e vet, duke përfshirë edhe vendosjen e ndalimit të zonës së fluturimeve të “no-fly” zonës, korridoret humanitare pastaj stërvitjen e luftëtarëve të ushtrisë së lirisë siriane, por jo përkrahjen e pranisë së trupave të huaj në Siri’ (Dougherty 2012). Ky hulumtim në kuptimin forenzik është i pavlerë, kur janë në pyetje qëndrimet e opozitës siriane sepse hedh poshtë metodën e shkakut të rastësishëm në dobi të së ashtuquajturës metoda e topit të borës ‘snowball’. Individë (ose kanale) të rëndësishëm janë shfrytëzuar si zinxhirë rekomandimesh të cilët në fund vijnë gjer te përfundimi se prej 1.168 të anketuarve prej të cilëve të gjithë janë anëtarë të opozitës. ndërsa 315 janë brenda Sirisë. Mundësia e gabimit nuk mund të zbatohet në këtë metodë të hulumtimit sepse të anketuarit nuk janë pyetur me metodën e shkakut të rastësishëm’ (IRI 2012).

Me fjalë tjera bashkëpunëtorët politikë të IRI-t pyetjet ua kanë parashtruar miqve të vet e që këta më pastaj t’i pyesin të vetët në të njëjtën mënyrë dhe kështu erdhi deri te rezultati ku 75% të atyre që u janë parashtruar pyetjet janë të vendosur jashtë Sirisë. Vështirë është të verifikohet sa përqindje e opozitës siriane i dalin

zot këtij modeli. Ç'është më e rëndësishme, ky hulumtim, s'tregon asgjë më me kujdes mbi mbarë mendimin publik të siarianve.

Proceset e zgjedhjeve në Siri në kohën e krizës, dhe pjesëmarrja e popullit në të, janë shumë me rëndësi. Kryetari Asad ua plotësoi disa prej kërkesave kyçe për reforma, kur me dekretin nën numrin 101 në gusht të vitit 2011 nënshkroi ndryshimin e ligjit zgjedhor. Qeveria e tij pastaj përgatiti amendamente kushtetuese të cilat ndryshuan karakterin e shtetit sipas të cilëve partia socialiste Ba'th duhej të humbë monopolin e pushtetit dhe të lejojë zgjedhje të lira presidenciale. Ky ligj u pranua me referendum që u mbajt kah fundi i shkurtit të vitit 2012. Grupet opozitare qytetare si SSNP-ja dhe komunistët e kundërshtuan këtë proces (ata kërkuan që këto procese që do të menaxhojnë me ndryshimet t'i sjell kuvendi i zgjedhur me vota të lira) ndërsa i kundërshtuan disa elemente të ligjit të paraparë por nuk e bojkotuan referendumin (el Ahbar 22 shkurt 2012; el Ahbar 15 maj 2012). Grupet islamike të organizuara e bojkotuan referendumin dhe zgjedhjet për kuvendin popullor në vitin 2012 duke u kërcënua se do t'i sulmojnë ata që do të marrin pjesë në to.

Kjo reformë zgjedhore doli si rezultat i regjistrimit të gjashtë partive politike të reja, përkrah tetë të tjerave ekzistuese, në të njëjtë kohë duke ia marrë partisë Ba'th statusin e privilegjuar dhe monopolin (As Safir 2012). Dalja e votuesve në zgjedhjet parlamentare të Sirisë në maj të vitit 2012 ka qenë e ulët 51.26 % më e vogël se 56 % sa dolën në vitin 2007. (International IDEA 2015). Ky ishte rezultat i kërcënimeve të grupeve të armatosura. Në atë kohë brigada el-Faruk që i takonte ushtrisë së lirë të Sirisë (FSA) të cilën në atë kohë armata siriane e dëboi nga Humsi, paraqiste kërcënimin më të madh ndaj referendunit. Brigada Faruk më vonë, nga një numri të dëshmitarëve, është vlerësuar si përgjegjëse për vrasjen e civilëve në fshatin Houli, që ndodhi 18 ditë pas zgjedhjeve. Disa banorë të Houlit morën pjesë në zgjedhje (shih Chapter Eight), Faktori i dytë që ndikoi në dalje të dobët të votuesve ishte dhënia pak rëndësi e zgjedhjeve parlamentare në sistemet presidenciale.

Rezultat i zgjedhjeve për kuvendin popullor në vitin 2012 ka qenë 150 deputetë të partisë ba'th dhe 90 kandidatë të pavarur që formonin parlamentin prej 250 anëtarë. Në mesin e anëtarëve të dalluar që nuk i takonin ba'th partisë ishin edhe Ahmed Kousi nga partia demokratike e Sirisë, Kadri Xhemili dhe Ali Hajdari nga Fronti për ndryshime dhe çlirime dhe Amër Eusi nga Iniciativa e kurdëve sirianë (Landis 2012). Përbërja e parlamentit po ashtu ishte e rëndësishme sepse sipas kushtetutës kushti i ri për zgjedhje presidenciale parashihte që çdo kandidat për kryetar e kishte patjetër të sigurojë mbështetjen prej 35 përfaqësuesve të parlamentit ndërkaj çdo parlamentar kishte të drejtë të mbështet vetëm një kandidat për kryetar. Kushtetuta gjithashtu parasheh që kandidatët për kryetar patjetër të kenë status rezidencial në Siri më pak gjatë 10 viteve të kaluar, gjë që i diskualifikoi kandidatët që jetojnë në egzil (As Safir 2012).

Zgjedhjet presidenciale të vitit 2014, për herë të parë, gjatë shumë dekadave, kandidatit të ba'th partisë u kundërviheshin kandidatë konkurrentë në zgjedhjet e lira. Të gjitha zgjedhjet e deriatëhershme në realitet kanë qenë plebishit me të cilët është deklaruar për mbështetjen oficiale të kandidatit. Natyrisht, më se 40 vite qeverisje të ba'th partisë si dhe kushtet e luftës nënkuptonin që Bashar el Asadi ka shumë përkrahje të madhe dhe shans për të fituar në ato zgjedhje. Ai ishte shumë i njohur, njerëzit e identifikonin me shtetin por edhe gëzonte popullaritet të vërtetë. Gjatë fushatës presidenciale analisti sirian Dr. Talib Ibrahim rastësisht u pajtua me ish konsulentët e NATO - s në vlerësimin që mbështetja e Basharit përafërsisht do të jetë afër 70 % (Ibrahim 2014).

Vet fakti që shumë vende perëndimore i kishin shpallur zgjedhjet në Siri 'të trilluara, para se të mbaheshin ato, thajse edhe nuk kanë ndonjë kredibilitet. Bëhet fjalë për ato qeveri perëndimore të cilat mundohen me këmbëngulje ta heqin nga pushteti qeverinë e Sirisë (Herrin 2014). Zëri i amerikës nga Vashingtoni deklaroi rrejtshëm se Siria 'nuk do të lejojë pjesëmarrjen e vëzhguesve të huaj' (VOA 2014). Në fakt, më se njëqind vëzhgues zgjedhor nga India, Brazili, Rusia, Kina, Afrika Jugore, Irani dhe nga vendet e

Amerikës Latine, së bashku me vëzhguesit jozyrtarë nga SHBA-të dhe Kanada, mbikëqyrën zgjedhjet (KNN 2014; Bartlett 2014).

Edhe pse për zgjedhje u paraqitën shtatë kandidatë, vetëm tre prej tyre u kualifikuan, sepse disa prej tyre nuk arritën të sigurojnë mbështetjen e 25 deputetëve parlamentarë siç ishte e paraparë me ndërrimin e ligjit zgjedhor. Biznismeni Hassan en-Nuri (ish ministri i qeverisë së Asadit) dhe deputeti i parlamentit të partisë komuniste nga Halepi, Mahir Hazher, ishin kundër-kandidatë të Asadit (al Saadi 2014; Harbi 2014). Për çështjen e bashkimit nacioanl rreth përkrahjes së ushtrisë siriane dhe luftës kundër terrorizmit, ata u pajtuan me Asadin. Praktikisht, dallimi me Asadin ka qenë vetëm në suaza të politikës ekonomike (Harbi 2014; Bakir 2014). Partia e dytë më e madhe SSNP e përkrahu Asadin.

Mediat ndërkombëtare e njohën përgjigjen masive të votuesve, si në Siri ashtu në mes refugjatëve sirianë në Liban. Disa media madje edhe mezi pranuan se ‘mobilizimi i një numëri aq të madh votuesish që dolën në votime, sidomos ata jashtë Sirisë, vetvetiu paraqet një fitore të madhe (Dark 2014). Associated Press lajmëroi se në Damask dhe Latakij kanë dalur në zgjedhje dhjetë mijë njerëz, që të përkujton një ‘atmosferë festivali’, gjersa radhët para vendvotimeve në Hums ishin shumë të gjata (FNA 2014a). Ap gjithashtu thekson se votuesit jashtë Sirisë ‘ia bllokuan hyrjet kryeqytetit Bejrut’ si dhe për ithtarët e Asadit që janë në Suedi. Raportet e përmendura vërtetuan se kryetari Asad ‘ruajti një përkrahje të rëndësishme të votuesve në mes shtresës së gjerë të popullatës’ (FNA 2014b). Sigurisht, dalja në zgjedhjet presidenciale të popullit sirian në vitin 2014 prej 73,4% votues është shumë më e madhe se cila do zgjedhje parlamentare amerikane që janë mbajtur dekadave të kaluara, ku niveli i participimit të votuesve sillej prej 52% dhe 60% (Idea International 2015a, 2015b).

Bashar el Asadi duke fituar bindshëm në këto zgjedhje parlamentare siguroi 88,7 % vota (Ap 2014). Hassan en-Nuri dhe Mahir Haxher kanë fituar 4,3% dhe 3,2 % (Aji 2014). Me daljen në votim të votuesve prej 73% (ose 11,6 milion prej gjithësejt 15,8 milion qytetarë me të drejtë vote), kjo don të thotë se për të

kanë votuar 10,3 milion votues, 64 % e tyre. Bile edhe sikur çdo qytetar i Sirisë që nuk ka mundur të votojë të ishte kundër Asadit, ai përsëri do ta fitonte bindshëm mandatin. Vashingtoni zyrtar u ankua se votimet janë mbajtur në kushte lufte, por me kënaqësi i pranoi votimet të mbajtura në Afganistan dhe Ukrainë, edhe pse të dy shtetet i ishin ekspozuar luftës dhe korrupsionit. Associated Press konkludoi shumë logjikisht se mbështetja Asadit nuk erdhi vetëm nga ana pakicave konfesionale dhe etnike por ishte rezultat i trashëgimisë së reformave siç është liberalizimi i ekonomisë, mbështetja e të drejtave të gruas, benifitet e vërteta në fushën e arsimit, shëndetësia, furnizimi me rrymë elektrike dhe mbi të gjitha, përgatitja e Asadit që me ngulmë t'u kundërvihet grupeve ekstremiste sektare të armatosura (AP 2014).

Zgjedhjet presidenciale të qershorit në Siri të mbajtura në vitin 2014 mund të konsiderohen si tregues autoritarë i përkrahjes së Bashar el Asadit. Edhe pse është një prioritet institucional i madh, më shumë do të thoshte një lloj hibridi ndërmjet plebishitit dhe zgjedhjes, përkrahja që e fitoi në zgjedhjet e para konkurruese presidenciale të mbajtura për herë të parë gjatë disa dekadave të kaluara, krejtësisht është e qartë dhe konsistente me vlerësimet e më hershme. Vlerësimet e përmendura janë të shprehura në vijim, ku i kam vënë edhe vlerësimet që vijnë prej armiqve të Asadit nga Katari e NATO-ja

Tabela 1: Anketat relevante të qeverisë siriane, 2011 - 2014

Pyetje ankete	Data	%	Anketuesi
Revolucioni në Siri 'sipas të gjitha gjasave i pabesueshëm për shkak të popullaritetit të Asadit	Shkurt 2011		Wikstrom Feb 2011 in Al Jazeera (Qatar)
91 % u kundërvihen protestave të dhunshme kundër qeverisë (5% e përkrahën)	Fundi i 2012	91%	TESEV (2012) (Turqia) sirianët
A duhet Asadi të mbetet kryetar?	Dhjetor 2011	51%	Anketa e Doha Debates (Qatar)
Anketa mbi ndryshimet kushtetutare	Shkur 2012	E kaluar	Qeveria e Sirisë

Zgjedhjet parlamentare (rezultati i partisë ba'th, dalja në zgjedhje 51%)	Maj 2012	60%	Qeveria e Sirisë
Përkrahja e Asadit në Halep	Mesi i 2012	70%	Konsulenti i NATOS-s
Përkrahja popullore Asadit	2013	70%	Siriani Dr. Talib Ibrahim
Zgjedhjet parlamentare (votat e Asadit) në dalje për votim prej 73,4 % (me të drejtë vote)	Qershor 2014	88% (64%)	Qeveria e Sirisë

Vërejmë një pajtueshmëri ndërmjet agjencive të ndryshme, burimeve lojale dhe armiqësore partiake, ato që janë në lidhje me grupet e armatosura antiqeveritare dhe me procesin e zgjedhjeve të Sirisë. Rezultatet e zgjedhjeve relativisht janë konsistente me vlerësimet mirë të informuara gjatë kohës së krizës. Kryetari i Sirisë gëzon besimin e më se dy të tretave e trupit zgjedhor në vend. Ky realitet nuk paraqet sfidë për shkak të prioritetit institucional të Asadit. Përkrahja e armatës siriane me siguri se është më e madhe se përkrahja e kryetarit, gjersa përkrahja e partisë ba'th është me e ulët. Rezultati i kombinuar vërteton bindjen se ka më shumë parti politike jo ba'thiste dhe forca shoqërore gjithashtu të bashkuara që qëndruan pas Asadit në momentin e krizës.

Nga deklaratat e më hershme që kanë të bëjnë me realizimin e reformave (veçanërisht nga Deklarata e Damaskut prej vitit 2005) vërejmë arsye për shkak të të cilave shumica e pjesëtarëve të opozitës së brendshme të Asadit nuk iu bashkëngjiten luftës së armatosur kundër shtetit. Shumica e opozitarëve qëndruan në mbrojtje të shtetit kundër terrorizmit sektar që e udhëhoqi faktori i jashtëm. Përgjashtim kryesor kanë qenë Vëllazëria muslimane dhe grupet e vogla selefiste. Këto grupe absolutisht nuk brengosen për demokraci, por insistojnë të vendosin vizionin e vet të shtetit fetar. Për ta realizuar këtë, patjetër, përsëri u mbështetën në ndihmën ushtarake të huaj.

Shënime:

Abouzeid, Rania (2012) ‘Aleppo’s Deadly Stalemate: A visit to Syria’s Divided Metropolis’, Time, 14 November, online:

<http://world.time.com/2012/11/14/aleppos-deadly-stalemate-a-visit-to-syrias-divided-metropolis/>

Aji, Albert (2014) ‘Bashar Al-Assad wins landslide victory in Syria election despite three-year fight to oust him’, National Post, 4 June, online:

<http://news.nationalpost.com/news/bashar-al-assad-wins-landslide-victory-in-syria-election-despite-three-year-fight-to-oust-him>

Alam, Kamal (2015) ‘Endless Predictions of Syrian Regime’s Collapse, but Why Hasn’t it Happened?’ Levant Report, 6 July, online:

<http://levantreport.com/2015/07/06/endless-predictions-of-the-syrian-regimes-collapse-but-why-hasnt-it-happened-an-interview-with-kamal-alam-of-the-uk-based-institute-for-statecraft>

Akhbar al (22 Feb 2012) ‘Disputes grow over new Syria constitution ahead of vote’, online:

<http://english.al-akhbar.com/node/4440>

al Akhbar (15 May 2012) ‘Opposition Disputes Syria Election results’, online: <http://english.al-akhbar.com/node/7372>

Al Akhbar (2014) ‘Four new candidates enter Syrian presidential race’, 27 April, online: <http://english.al-akhbar.com/node/19565>

Al Arabiya (2012) ‘Arab League recognizes Syria’s new opposition bloc’, 12 November, online:

<http://english.alarabiya.net/articles/2012/11/12/249215.html>

al Saadi, Yazan (2014) ‘Syrian Presidential elections: three candidates, one face’, Al Akhbar, 2 June, online: <http://english.al-akhbar.com/node/20000>

Al-Shaqfa, Muhammad Riyad (2011) ‘Muslim Brotherhood Statement about the so-called ‘Syrian Revolution’’, General supervisor for the Syrian Muslim Brotherhood, statement of 28 March, online at:

<http://truthsyria.wordpress.com/2012/02/12/muslim-brotherhood-statement-about-the-so-called-syrian-revolution/>

AP (2014) ‘Syrian election shows depth of popular support for Assad, even among Sunni majority’, Fox News, 4 June, online:

<http://www.foxnes.com/world/2014/06/04/syrian-election-shows-depth-popular-support-for-assad-even-among-sunni-majority/>

Asi Abu Najm (2011) ‘Syria’s Coordination Committees: a Brief History’, Al Akhbar, 1 October, online:

<http://english.al-akhbar.com/node/764>

As Safir (2012) 'Contents of Proposed Amendments to the Syrian Constitution Revealed', Al Monitor, 17 February, online:

<http://www.al-monitor.com/pulse/politics/2012/02washington-mocks-while-moscow-we.html>

Atassi, Basma (2011) 'Free Syrian Army grows in influence', Al Jazeera, 16 November, online:

<http://www.aljazeera.com/indepth/features/2011/11/20111116154829885782.html>

Baker, Aryn (2014) 'Meet The Two Candidates Taking on Assad For Syria's Presidency', Time, 9 May, online:

<http://time.com/93656/assads-rivals-for-the-presidency/>

Barnard, Anne (2014a) 'Syrians in Lebanon flood polling place, choosing Assad out of Fervor or Fear', New York Times, 28 May, online:

http://www.nytimes.com/2014/05/29/world/middleeast/syrian-exiles-in-lebanon-vote-in-advance-of-national-ballot.html?_r=0

Barnard, Anne (2014b) 'Assad's win is assured, but limits are exposed', New York Times, 3 June, online:

<http://www.nytimes.com/2014/06/04/world/middleeast/amid-fear-and-pressure-syrians-vote-for-president.html>

Barlett, Eva (2014) 'International Observers Endorse Syrian elections', Oriental Review, 3 June, online:

<http://orientalreview.org/2014/06/03/international-observers-endorse-syrian-elections/>

Bayoumy, Yara (2013) 'Insight: Aleppo misery eats at Syrian rebel support', Reuters, 9 January, online:

<http://www.reuters.com/article/2013/01/09/us-syria-crISISIL-rebels-idUSBRE9070VV20130109>

BIN (2013) 'Poll: 70% of Syrians Support Assad, says NATO', Before its News, 13 June, online:

<http://beforeitsnews.com/middle-east/2013/06/poll-70-of-syrians-support-assad-says-nato-2452134.html>

Damascus Declaration (2005) The Damascus Declaration for Democratic National Change, English version in Joshua Landis blog 'Syria Comment', 1 November, online:

<http://faculty-staff.ou.edu/L/Joshua.M.Landis-1/syriablog/2005/11/damascus-declaration-in-english.htm>

Dark, Edward (2014) 'Rebels shell Aleppo as Syria votes', Al Monitor, 3 June, online:

<http://www.al-monitor.com/pulse/originals/2014/06/syria-aleppo-elections-rebels-strike-shell-assad.html>

DIA (1982) 'Syria: Muslim Brotherhood Pressure Intensifies', Defence Intelligence Agency (USA), May, online:

<https://syria360.files.wordpress.com/2013/11/dia-syria-muslimbrotherhoodpressureintensifies-2.pdf>

Doha Debates (2011) 'This House believes President Assad must resign', 27 November, online:

<http://thedohadebates.com/debates/item/index46d6.html?d=112&s=8&mode=opinions>

Dougherty, Jill (2012) 'Survey: Syrian opposition want 'no-fly' zone', CNN Security Clearance, 17 August, online:

<http://security.blogs.cnn.com/2012/08/17/survey-syrian-opposition-want-no-fly-zone/>

Fisk, Robert (2011) 'Syria is slipping uncontrollably towards a bitter sectarian war', The Independence, 27 October, online:

<http://www.independent.ie/opinion/analysis/robert-fisk-syria-is-slipping-uncontrollably-towards-a-bitter-sectarian-war-26786116.html>

FNA (2014A) 'World Media acknowledge masive turout in Syria's Presidential election', Fars News Agency, 4 June, online:

<http://english.farsnews.com/newstext.aspx?nn=13930314000436>

FNA (2014b) 'World Media admits masive turnout in Syrian Pre sidential elections abroad', Fars News Agency, 29 May, online:

<http://english.farsnews.com/newstext.aspx?nn=13930308000580>

Francis, Ghadi (2011) 'The Syrian Social Nationalists: in the hurricane of the revolt', Al Akhbar, 26 August, online:

<http://english.al-akhbar.com/node/136>

Ghadry, Farid (2005) 'Syria reform: what lies beneath', The Middle East Quarterly, Winter, 61-70, online:

<http://www.meforum.org/683/syrian-reform-what-lies-beneath>

Ghaith, Abdul-Ahad (2012) 'The people of Aleppo needed someone to drag them into the revolution', The Guasrdian, 28 December, online:

http:

<http://www.theguardian.com/world/2012/dec/28/aleppo-revolution-abu-ali-sulaibi>

Haidar, Ali (2013) Interview with this writer, Damascus, 29 December

Haidar, Ziad (2012) 'Contents of Proposed Amendments to the Syrian Constitution Revealed, Al Monitor, 17 February, online: <http://www.al->

monitor.com/pulse/politics/2012/02/washington-mocks-while-moscow-we.html#

Haidar, Ziad (2014) 'The other candidates in Syria's election', Al Monitor, 14 May, online:

<http://www.al-monitor.com/pulse/politics/2014/05/syria-presidential-election-assad-candidates.html#>

Harbi, Rana (2014) 'Syrians vote in presidential election', Al Akhbar, 3 June, online: <http://english.al-akhbar.com/node/20010>

Hatem al, Fadwa (2011) 'Syrians are Tired of Assad's 'reforms'', UK Guardian, 1 June, online:

<http://www.theguardian.com/commentisfree/2011/may/31/syrians-assad-bill-fair-elections>

Herring, Jessica Michele (2014) 'Syria Holds Presidential Election, President al-Assad's Likely Election Considered Unfair by Western Nations', Latin Post, 3 June, online:

<http://www.latinpost.com/articles/14097/20140603/syria-holds-presidential-election-president-al-assads-likely-election-considered-unfair-by-western-nations.htm>

Hetou, Ghaidaa (2011) 'Syria: the art of 'branding' political reform', The New Middle East, 31 March, online:

<http://new-middle-east.blogspot.com.au/2011/03/syria-art-of-branding-political-reform.html>

Hinnebusch, Raymond (2009) 'Syria under the Ba'th: the political economy of populist authoritarianism' in Raymond Hinnebusch and Søren Schmidt (2009) *The State and the Political Economy of Reform in Syria*, University of St Andrews Centre for Syrian Studies, Fife Scotland

Hinnebusch, Raymond (2012) 'Syria: from authoritarian upgrading to revolution?' *International Affairs* 88, 95-113

Ibrahim, Taleb (2014) 'Over 70 % of Syrians support Assad ahead of elections', Live Leak, 7 May, online:

http://www.liveleak.com/view?i=a3a_1399500866

Idea International (2015a) 'Voter turnout data for Syrian Arab Republik', online:

<http://www.idea.int/vt/countryview.cfm?id=210#pres>

idea International (2015b) 'Voter turnout data for United States', online:

<http://www.idea.int/vt/countryview.cfm?id=231#pres>

IIT (2012) 'Syria's Mufti Meets Scholars... Honors Families of Syrian Army Martyrs in Lattakia' Islamic Invitation Turkey, 22 November, online:

<http://www.islamicinvitationturkey.com/2012/11/22/syrias-mufti-meets-scholars-honors-families-of-honors-families-of-syrian-army-martyrs-in-lattakia/>

IRI (2012) 'Survey of Syrian Opposition Reveals Desire for International Intervention', International Republican Institute, 17 August, online: <http://www.iri.org/resource/survey-syrian-opposition-reveals-desire-international-intervention>

Kawakibi, Salam (2007) 'Political Islam in Syria', CEPS Working Document No. 270/June, Centre for European Policy Studies, Brussels, online: <http://aei.pitt.edu/11726/>

Kawakibi, Salam (2013) 'What Might have Been: a decade of civil activism in Syria', Open Democracy, London, 11 March, online: <https://www.opendemocracy.net/salam-kawakibi/what-might-have-been-decade-of-civil-activism-in-syria>

Khalaf, Roula and Abigail Fieldfing Smith (2013) 'Qatar bankrolls Syrian revolt with cash and arms', Financial Times, 16 May, online: <http://www.ft.com/cms/s/0/86e3f28e-be3a-11e2-bb35-00144feab7de.html#axzz3oW3SeESu>

KNN (2014) 'Indian delegation to monitor Syria election on June 3', Kohram, 2 June, online: <http://www.kohraam.com/international/indian-delegation-to-monitor-syria-election-on-june-3/>

Landis, Joshua and Joe Pace (2007) 'The Syrian Opposition', The Washington Quarterly, Vol 30 No 1, Winter 2006-2007, 45-68

LCC (2011) 'Syrian Lokal Coordination Committees on Taking up Arms and Foreign Intervention', Lokal Coordination Committees of Syria in Jadaliyya reports, 29 August, online: <http://www.jadaliyya.com/pages/index/2539/syrian-lokal-coordinating-committees-on-taking-up->

LCC (2013) 'Dignity Strike ... We make our revolution by our own hands', Lokal Coordination Committees of Syria, December, online: <http://www.lccsyria.org/3528>

MESI (2009) 'Assad is most popular Arab leader, according to poll', Middle East Strategic Information [citing the University of Maryland and Al-Zughbi International Foundation for Polls], 22 May, online: <http://mesi.org.uk/ViewNews.aspx?ArticleId=2461>

Mneimneh, Hassan (2012) 'The Arab Spring: a Victory for Islamism?' Brussels Forum Paper Series, Washington, March, online:

<http://www.gmfus.org/publikations/arab-spring-victory-islamism>

Mroue, Bassem and John Heilprin (2012) 'Syria Elections: Opposition Boycotts, US Says Vote 'Borders On Ludicrous'', The Huffington Post, 8 May, online:

http://www.huffingtonpost.com/2012/05/08/syria-elections-ballots-tallied-parliament_n_1499094.html?ir=Australia

Mufti, Malik (1996) *Sovereign Creation: pan-Arabism and Political Order in Syria and Iraq*, Cornell University Press, London

Narwani, Sharmine (2015) 'Ten years on, Lebanon's Cedar Revolution', RT, 13 March, online:

<http://rt.com/op-edge/240365-lebanon-revolution-anniversary-cedar-2005/>

Otrakji, Camille (2011) 'No Revolution in Syria: an interview with Camille Otrakji by Elias Muhanna', MRZine, Monthly Review, 3 May, online:

<http://mrzine.monthlyreview.org/2011/otrakji030511.html>

Otrakji, Camille (2012) 'The real Bashar al Assad', Conflicts Forum, 2 April, online: <http://www.conflictsforum.org/2012/the-real-bashar-al-assad>

Pechter Polls (c2013) 'Survey: Syrian opposition want 'no-fly' zone', online: <http://www.pechterpolls.com/survey-syrian-opposition-want-no-fly-zone/>

Perthes, Volker (2004) *Syria Under Bashar al Assad: Modernisation and the limits of Change*, Adelphi Papers, Oxford University Press, London

Pew Research Centre (2013) 'The World's Muslims: religion, politics and society', Pew Forum on Religion and Public Life, April 30, online: <http://www.pewforum.org/Muslim/the-worlds-muslims-religion-politics-society.aspx>

Ramadani, Sami (2012) 'Between Imperialism and Repression', Information Clearing House, 13 June, online:

<http://www.informationclearinghouse.info/article31570.htm>

Rasas, Mohammed Sayyed (2013) 'From 2005 to 2013: The Syrian Opposition's Many faces', Al Akhbar, 19 March, online:

<http://english.al-akhbar.com/node/15287>

Reuters (2014) 'Islamic State appeals to only four percent of Syrians: Poll', 8 July, online: <http://www.reuters.com/article/2014/07/09/us-syria-crisis-poll-idUSKBN0FE00720140709>

Rosen, Nir (2012) 'Q&A: Nir Rosen on Syria's armed opposition', Al Jazeera, 13 Feb, online:

<http://www.aljazeera.com/indepth/features/2012/02/201221315020166516.html>

SANA (2015) '500 Families of Working Class Martyrs Honoured in Damascus', 10 July, online: <http://sana.sy/en/?p=47888>

Seale, Patrick (1988) *Assad: the struggle for the Middle East*, University of California Press, Berkeley CA

Sen, Kasturi; Waleed Al-Faisal and Yaser Al-Saleh (2012) 'Syria: effects of conflict and sanctions on public health', *Journal of Public Health*, Vol. 35, No. 2, pp. 195-199

Shahid, Mohammed K. (1988) 'The Muslim Brotherhood Movement in the West Bank and Gaza', *Third World Quarterly*, Vol 10 No 2, April pp.658-682

Solomon, Jay and Bill Spindle (2011) 'Syria Strongman: Time for Reform', *Wall Street Journal*, 31 January, online:

<http://www.wsj.com/articles/SB10001424052748704832704576114340735033236>

TESEV (2012) 'The perception of Turkey in the Middle East 2011', *Türkiye Ekonomik ve Sosyal Etüdler Vakfi*, Istanbul, February, online: <http://www.tesev.org.tr/the-perception-of-turkey -in-the-middle-east-2011/Content/236.html>

Ulutas, Ufuk (2011) 'The Syrian Opposition in the making: capabilities and limits', *Insight Turkey*, Vol 13 No 3, 87-106, online:

<http://insightturkey.com/insight-turkey-volume-13-no-3/issues/29>

Veldkamp, Joel (2014) 'Resurgence of the SSNP in Syria: an ideological opponent of the regime gets a boost from the conflict', *Syria Comment*, 19 December, online:

<http://www.joshualandis.com/blog/resurgence-of-the-ssnp-in-syria-an-ideological-opponent-of-the-regime-gets-a-a-boost-from-the-conflict/>

VOA (2014) 'Assad: No Syrian Election ewith Foreign Observers', *Voice of America*, online:

<http://www.voanews.com/content/assad-rules-out-syrian-elections-with-foreign-observers/2932940.html>

Wikas, Seth (2007) 'Battling the Lion of Damascus', *Washington Institute for Near East Policy*, Policy Focus#69, May, online:

<http://www.washingtoninstitute.org/policy-analysis/view/battling-the-lion-of-damascus-syrias-domestic-opposition-and-the-assad-regime>

Wikstrom, Cajsa (2011) 'Syria: A Kingdom of Silence', Al Jazeera, 9 February, online:

<http://www.aljazeera.com/indepth/features/2011/02/201129103121562395.html>

World Tribune (2013) 'NATO Data: Assad winning the war for Syrian's hearts and minds', 31 May, online:

<http://www.worldtribune.com/2013/05/31/nato-data-assad-winning-the-war-for-syrians-hearts-and-minds/>

6. Xhihadistët e perandorisë



Vështruesi i mençur mund të pyes se cilët janë arsyet që këta fanatikë mizorë sektar të cilët ua presin njerëzve kokat, të cilët janë orientuar në një lloj misioni të vet islamik, por në të njëjtën kohë janë në anën e fuqive të mëdha? Përgjigjja në këtë pyetje nuk gjendet në Islam si religjion por duhet kërkuar te dy fenomenet historike: Te vehabitët e Arabisë saudite dhe te fenomeni shumë i gjerë dhe shumë mirë i organizuar i Vëllazërisë muslimane. Andaj duhet kushtuar kujdes këtyre dy fenomeneve historike.

Vehabizmi është i bazuar në rrjetin feudal të monarkive të Gjirit që i udhëheq Arabia saudite, ndërkaq Vëllazëria muslimane, organizatë kjo që është formuar në Egjipt, ka trajektoren e vet historike të garës konkurrenente për nacionalizëm shekullar. Vëllazëria muslimane si e tillë zhvilloi pikëpamjet e veta selefiste sektare që janë të ngjashëm me trendët në shtetet ku dominon vehabizmi të cilin kryesisht e financojnë Vëllazëria, pikëpamjet e të cilëve kufizojnë popullaritetin e vehabizmit te shoqëritë tolerante arabe të vendeve

muslimane. Ajo që këtë trend e bën të papranueshëm është historia e gjatë e kolaboracionit të këtyre dy trendëve me fuqitë e mëdha të botës, në luftë kundër kundërshtarëve të tyre të brendshëm. Këta janë njerëzit të cilët e zhvlerësuan nocionin e ‘xhihadi’ që don të thotë koncepti i përkryer respektabil në Islam që tregon luftën e drejtë dhe shpirtërore, për dallim nga vizioni i xhihadistëve të mbrapsht që bëjnë krime monstruoze. Bëhet fjalë për njerëzit të cilët haptas bëjnë krime të rënda duke pohuar se ata i përfaqësojnë muslimanët ortodoks sunitë. Në realitet ata nuk i përfaqësojnë muslimanët as më pak e as më shumë se Klu Klux Klan-i në Amerikën Veriore që përfaqëson krishterimin. Historia fanatike dhe sektare e vehabitëve dhe Vëllezërve muslimanë zhvlerëson çfarëdo mundësie që ky lloj i Islamit politik mund t’i kontribuojë demokracisë popullore, stabilitetit rajonal, bashkëpunimit dhe zhvillimit të shoqërisë njerëzore.

Këto dy trendë bashkëpunojnë me njëri tjetrin, por njëherit ka elemente të rëndësishme në të cilat dallojnë dhe në të cilat i konkurrojnë njëri tjetrit: Për shembull në fillim të kryengritjes ushtarake në Siri, monarkia e vogël e Katarit vlente si financier kryesor i ushtrisë së lirë siriane të lidhur me Vëllazërinë musluimane. Për dallim nga Katari familja mbretërore saudite kurrë nuk i ka besuar Vëllazërisë muslimane, meqë kjo organizatë shumë e gjerë paraqet një konkurrencë potenciale njëherit edhe kanosje fuqisë së monarkisë më të madhe të Gjirit (Zambelis 2030; Yigit 20141). Prandaj saudianët preferojnë ndihmën e grupeve të pavarura të internacionalizuara selefiste (që nuk kanë pikëmbështetje në bashkësinë vendore) dhe të cilat në një farë mënyre janë në distancë nga Vëllazëria, ashtu si është Al-Kaida, Xhebbhetun-nusra, shteti islam në Irak dhe Levant (ISIL - Daech dhe Fronti Islam. Katari si partneri më i vogël në fund patjetër t’u përshtatej dëshirave të Arabisë saudite (Pandy 2014). Në vitin 2015 Qeveria e Erdoganit e Turqisë dhe qeveria e Arabisë saudite disa prej këtyre grupeve të udhëhequra nga Xhebbhetun-Nusra i riemërtuan ‘Ushtri çlirimtare’ (Jaysh el Fatih) (Mezzofiore 2015; MEC 2015). Grupet më të vogla u shpërndanë në kërkim të

pareve dhe sponsorëve të huaj. Ky kapitull paraqet historinë sektare të vehabizmit dhe të Vëllazërisë muslimane në Lindjen e afërme, duke treguar se pse dhe për çfarë arsye u afruan dhe në mënyrë të afërt kolaborojnë me fuqitë e mëdha të perëndimit, Pas kësaj trason rrugën e kryengritjes së tyre të armatosur në Siri.

6.1 Imperializmi, Vehabizmi dhe Vëllazëria muslimane

Islami është fe shumë komunikative dhe inkluzive shoqërore, e cila e merr në konsideratë pluralitetin dhe e cila nxit në tolerancë. Kur'an i veçanërisht nxit në mëshirë dhe dënon keqtrajtimin e muslimanëve (Kur'an 49: 11), njëkohësisht duke insistuar në bashkëpunim dhe bashkëjetesë me grupet e ndryshme të besimtarëve (Kur'an 5: 69; 5: 48). Në Islam nuk ekziston pushtet/autoritet i centralizuar ashtu që gjatë historisë së tij shumëshekullore janë zhvilluar ndryshime sektare të vogla por me ndikim.

Përkundrazi, në Lindjen e afërme shumë është përhapur tolerance dhe 'shekullarizmi' pa marrë parasysh udhëheqjen politike që nuk ishte e lidhur vetëm për ndonjë doktrinë fetare partikulare.

Bahtiar dhe Norton (2015) përmendin disa shkrimtarë egjiptian, sirian dhe iranian bashkëkohorë dhe shumë me influencë të cilët në forma të ndryshme promovojnë tolerancë dhe pluralizëm, duke mos hequr dorë nga identiteti i vet islamik. Për më tepër, siriani Muhamed Shahrur 'halifatin' osman e krahason me 'despotizmin', të cilin Mustafa Kemal Atatürk, në kohën e vet arriti ta heq (Bahtiar dhe Norton 2005:39). Perandori në fjalë, në të vërtetë, ka qenë fenomen politik e jo projekt fetar.

Despotizmi dhe sektarizmi më shumë janë krijim politik se sa shprehje e vlerave religjioze. Carroll-i thekson se, edhe pse Islami është 'njëri prej burimeve më të forta të identitetit arabe-politik, reflektimi i tij në formimin e bashkësive politike shumë është i varur nga 'kushtet gjeopolitike' (Carroll 1996: 186). Ngjashëm me këtë edhe nga Islami si 'ideologji politike e jo si konstruksion teologjik', shkruan Ejub-i. Natyrisht se kjo ndryshon prej rajoni në rajon varësisht nga rrethanat shoqërore dhe fuqitë ekstremiste (Ejub 1979 Ë 535).

Nëse historia dhe rrethanat shoqëror të Islamit dallojnë në një masë, në lindjen e mesme padyshim do të ndikojnë disa ‘forca të jashtme të përbashkëta’. Në mesin e të parave, natyrisht se është shërbimi hegjemonist i fuqive të jashtme, ku bëjnë pjesë edhe fuqitë e kahershme koloniale. Shekulli i kaluar dëshmon një angazhim konstant të këtyre fuqive të cilat me përpjekje të përbashkëta dominojnë mbi naftën dhe gazin në rajonin e pasur. Përkrahja e fuqive të mëdha Izrailit është një faktor i ardhshëm i rëndësishëm dhe vendimtar. Siç tregon Ejub: Gjersa sa nuk kuptohet korrelacioni dhe kontributi i këtyre fuqive të jashtme kritike në rritje dhe popullaritet të Islamit, ky fenomen nuk do të mundet të kuptohet në mënyrë adekuate’ (Ejub 2005: 960 -061)

Nëse e përjashtojmë variantin e tij iranian, mënyrën në të cilën është zhvilluar ‘Islami politik’ në Lindjen e afërme është i bazuar në dy drejtime me influence, në: Vehabizëm dhe Vëllazërinë muslimane. Islami që u zhvillua në Iranin bashkëkohor e karakterizojnë dy dallime të rëndësishme historike. Së pari, nacionalizmi shekullar iranian është i pamundshëm për grusht-shtet për të cilin ndihmuan SHBA-të pesëdhjetë vite të shekullit të kaluar, ndërsa pastaj, pas çerek shekulli, me represionin e regjimit monarkist diktatorial të Shahut. Kjo diktaturë e cila gëzoi përkrahjen e SHBA-s me elemente të përziera të kulturës perëndimore, është reflektim i përvojave të një gjenerate në përgjithësi. Rezistenca kundër këtij regjimi kryesisht është organizuar nëpërmjet xhamive dhe (përkundër kontributit të ideve që dolën nga komunizmi). Ideja qendrore që arriti sukses të sigurojë rënien e regjimit të Shahut dhe eliminimin e ndikimit amerikan ka qenë e konceptualizuar në parime islame. Andaj, Republika islame e Iranit u zhvillua si lëvizje popullore antiimperialiste (shih Ejub 1979: 543), për dallim nga Vëllazëria islame, përpjekjet e së cilës janë në drejtim të përmbysjes së nacionalizmit sektar autokton, është bazuar në përkrahjen e fuqive të jashtme.

Edhe Egjipti edhe Siria ndërtuan dhe mbajtën deri sot e kësaj dite regjimet shekullare nacionaliste me traditën e fortë të antiimperializmit. Ky bosht u dobësua kur kah fundi i viteve të shtatëdhjeta

erdhi deri te kolaborimi i qeverisë egjiptiane me Amerikën dhe Izraelin. Megjithatë, Siria edhe pas kësaj vazhdoi me politikën e jashtme të pavarur. Aleanca e sotme ndërmjet Iranit dhe Sirisë, ka shumëçka të përbashkët me antiimperializmin. Nuk është rastësi që këto dy shtete janë të vetmit në Lindjen e afërme të cilët nuk u kanë afruar strehim bazave ushtarake amerikane, andaj që të dy shtetet janë të ekspozuara presioneve të forta për ndryshimin e regjimit. Veçoria tjetër është se në Iran dominojnë (afër 90%) muslimanë shiitë. Edhe pse në Republikën islamike të Iranit braktisja e fesë është çështje e ndjeshme, këtë republikë në shtëpi duhet vështruar në kontekst të monokulturës, bashkë me pozitën e ndjeshme të pakicave shiite në rajon; në Pakistan, Afganistan, Liban, Siri dhe Egjipt. Duke përjashtuar behaijët, që konsiderohen kolona e pestë e Izraelit, pakicat në Iran kanë pozitë të lakmueshme. Ajo që është me rëndësi të veçantë, në Iran nuk ekziston asgjë që do të mund të krahasohej me doktrinën ‘tekfir’ vëhabiste - selefiste, e cila nënkupton hedhjen dhe keqtrajtimin e njerëzve që praktikojnë drejtim tjetër fetar.

Nga arsyet e theksuara, kur është në pyetje studimi i Islamit politik në Iran, propozoj qasje dhe aplikim tjetër të vlerave, Nga ana tjetër, në Egjipt, Palestinë, Jordani, Liban, Siri dhe në vendet arabe të Gjirit, gjatë tërë shekullit ekziston një rrjet i koordinuar selefist ose organizatë klendestine e njohur si Vëllazëria muslimane (Ihvan: Vëllezër). Me që ky grup me të vërtetë ka një drejtim jo tolerant në suaza të Islamit sunit, i cili është i lidhur me drejtimin saudit, edhe njëri edhe tjetri gjatë ekzistimit të tyre kanë qenë të lidhur me fuqitë e mëdha perëndimore me të cilat kanë kolaboruar gjatë tërë ekzistimit të tyre.

Lidhja në mes hegjemonizmit perëndimor dhe midis sekteve muslimane më jo tolerante në pamje të parë mbase nuk është e dukshme, andaj është e patjetërsueshme që ky fenomen të shikohet nga aspekti historik.

Britanikët janë ekspertë modern të qeverive imperialiste, dhe prej romakëve kanë mësuar si ta përdorin taktikën përçaj e sundo. Këtë së pari e kanë përdorur në Indi ndërsa më vonë në Lindjen e

afërme. ‘Divide et empera (përçaj e sundo) është një shprehje e vjetër romake’ u shpreh Lord William-i më 1859 përpara komisionit hetues i cili ishte formuar kah mesi i shekullit 19 për të shqyrtuar kryengritjen e armatosur, e ‘kjo duhet të ishte edhe taktikë e jona’ (në Desai 1948, fq. 354). Pas kësaj kryengritje Sir John Lawrence realizoi riorganizimin e ushtrisë bengale duke e ndarë atë në shumë regjimente etnike (Mehta dhe Patwardhan 1942: fq. 57). Në të njëjtën mënyrë, sekretari shtetëror britanik Charles Wood përmend në letrën të cilën në vitin 1862 ia shkroi guvernatorit gjeneral të Indisë, lordit Elgin: ‘Në Indi e kemi ruajtur pushtetin falë taktikës së kthimit të njërës palë kundër tjetrës. Të njëjtën gjë patjetër ta vazhdojmë edhe në të ardhmen. Andaj, punoni me të gjitha fuqitë që keni në mënyrë që t’i pengoni ata që i udhëhiqni mos të kenë ndjenja të përbashkëta’, i mësoi Wood-i nëpunësit e vet (Wood 1862: Pande 1987). Kjo fushatë përçaj e sundo, më vonë do të bëhet edhe më e fuqishme me futjen e ndasive etnike në programet shkollore. Sekretari shtetëror Viscount Cross i shkroi komandantit kolonial Viceroy Dufferin-it 1887: ‘Kjo ndasi e ndjenjave fetare me të madhe shkon në dobinë tonë dhe gëzohem që komisioni, i cili është i obliguar për vlerësimin e edukimit dhe të mjeteve edukative në Indi, do të jap rezultate të mira’ *në Pande 1987). Pas themelimit të frontit të bashkuar antikolonial në Indi, kongresit nacional të Indisë, administratori britanik iu përvesh punës për ta përçarë. Kështu sekretari shtetëror George Francis Hamilton i shkroi guvernatorit gjeneral lordit Curzon si vijon: Në qoftë se mundemi të shkatërrojmë partinë e arsimuar hinduse në dy blloqe të ndryshëm udhëheqësit e të cilëve do të kenë qëndrime diametralisht të kundërta, në atë mënyrë do të mundemi ta forcojmë pozitën tonë në krahasim me sulmet subtile dhe të pandërprera që janë të drejtuara kundër sistemit tonë arsimor i cili paraqitet si rezultat i përhapjes së arsimimit’ (Hamilton në Curzon 1899: shtator 20). Hamiltoni ishte i vetëdijshëm se perandoria britanike nuk mund të ekzistojë nëse asaj nuk i kundërvihet një popull i bashkuar.

Deri në fund të shekullit 20, K.B. Krishna (1939) vëren se politika ‘përçaj e sundo’ ka qenë shumë e përdorur në mbarë perandorinë britanike, përfshirë Cejlonin, Irlandën, Palestinën dhe Keninë. Ai përhapjen e ‘komunalizmit’ e përshkruan si një faktor kyç i politikës administrative britanike ndaj Indisë; prandaj konsideron se lufta për pavarësi nacionale kërkon kundërvënien e plotë ‘komunalizmit’ (Desai 1984).

Pas luftës së parë botërore dhe kolapsit të perandorisë osmane, administratorët kolonialë britanikë u dhanë pas kërimit të kolaboratorëve të mundshëm në botën arabe me të cilët do të mund të zbatonin taktikën ‘përçaj e sundo’. Të parët që u ranë ndër mend si të përshtatshëm ishin anëtarët e familjes Saud, që ishin të njohur me doktrinën e tyre sektare fetare, vehabizmin. Britanikët u dukeshin sauditëve të tmerrshëm në të njëjtën kohë edhe fascionues.

Winston Churchill shkruan se si vehabitët e mbretit Ibën Saud: ‘e konsiderojnë si obligim të vetin si dhe pjesë përbërëse të fesë së vet, të mbytin çdo kënd që nuk është i një mendimi me ata, ndërsa gratë dhe fëmijët t’i adoptojnë. Gratë kanë mundur të vriten nëpër lagjet e vehabitëve, thjeshtë nëse ato dilyn haptas në rrugë (Churchill 1921).

Pa marrë parasysh këtë, Churchilli më vonë do të shkruajë: ‘mahnitja ime (ndaj Ibën Saudit) ishte e madhe për shkak të lojalitetit të tij të padhunueshëm ndaj nesh’ (Churchill 1953). Një dokument i qeverisë britanike që daton prej gjysmës së 1940, thotë se: ‘ndikimi i Ibën Saudit në Lindjen e afërme është i madh dhe në shumë raste në mënyrë konzistente është shfrytëzuar me vite për mbështetje të politikës tonë’ (Wikeley 1945; shih po ashtu Sheih 2007: 47). Kur gjatë pesëdhjetë viteve të shekullit të kaluar kryetari i Egjiptit - Naseri u bë hero i nacionalizmit arab - pasi e nacionalizoi Kanalin e Suezit, dhe e mundi invazionin e përbashkët britanike-francez - Vashingtoni filloi të interesohet për familjen mbretërore saudite. Kryetari amerikan Eisenhower, thuhet se kërkoi ‘planin makiavelist të klasit të lartë me të cilin do t’i ndante arabët dhe do t’i fitonte caqet tona (Bashkimin sovjetik)...

duke përgatitur mbretin Saud si kundërpeshë ndaj Naserit. Eisenhower deklaroi: ‘Mbretit mund t’i jepet formë, sipas mundësisë si udhëheqës shpirtëror. Pasi ta bëjmë këtë, atëherë do të mund të fillojmë të insistojmë për të drejtën e tij për t’u bë lider politik’ (në Curtis 2012, 62, 68). Lidhja e afërt amerikane-saudite deri sot e kësaj dite nuk është e bazuar vetëm në marrëdhëniet e super fuqisë globale dhe të një baronit të naftës, por ka të bëjë me një fuqi botërore me kolaborat kyç politik në rajonin e Lindjes së afërme që vlen si mbjellës shumëvjeçar i përçarjes.

Kolaboratori tjetër rajonal, edhe pse më pak i besueshëm por që ka autoritet të gjerë në masë është Vëllazëria muslimane. Vëllazërinë e ka themeluar Hassan el- Benna në Egjipt gjatë viteve 1920-ta. Në fillim Vëllazëria i kundërvihet influencës britanike. Ka dhënë kontribut për pavarësi, por pikëpamjet e tij të ngushta selefiste e bënë konkurrent në lidhje me protagonistin e nacionalizmit arab, i cili ishte shumë më gjithëpërfshirës dhe mbi të gjitha shumë i popullarizuar në mesin e masave popullore. Nga perspektivat e kësaj marrëdhënie konkurruese mund të shihet se dy lëvizjet janë pasuse të Hassan el Benna-së. Këta insistonin t’u kundërvihen fuqive koloniale perëndimore joislame dhe duke lënë anësh udhëheqësit muslimanë (Butterwoth 1992: 15). Britanikët në fillim, gjatë luftës së dytë botërore, u munduan t’i frenojnë (zbutin) Vëllezërit muslimanë, por monarku probritanik, mbreti Faruk filloi t’u afrojë ndihmë financiare gjatë viteve 1940 -ta. Mendohet se Faruku ka qenë i bindur se Vëllazëria mund të paraqes ‘kundërpeshë të dobishme të forcës së partisë Wefed shekulare nacionaliste (Curtis 2012: 24). Shërbimi i inteligjencës britanik në vitin 1941 Vëllazërinë muslimane e konsideronte ‘kanosja më serioze ndaj sigurimit publik’ në Egjipt (Lia 1998: fq. 181). Por, gjatë vitit 1942 ‘vetë Britania filloi ta financojë Vëllazërinë’ (Curtis 2012: fq. 24). Britanikët e bënë këtë me qëllim që ta përçajnë këtë organizatë. Britanikët u pajtuan se duhet angazhuar për të krijuar përçarje në këtë lëvizje politike ndërmjet Hassan el- Benna-së dhe Ahmed es-Sukkari-ut (British Embassy, Cairo 1942).

Besohet se CIA deri në fund të viteve të pesëdhjeta filloi t'i japë përkrahje Vëllezërisë muslimane, ndërsa roli i saudianëve ishte të sigurojnë mjete financiare. Saudianëve u pëlqente 'politika ultra konservatore e Vëllezërve muslimanë dhe urrejtja e tyre helmuese të cilën e shfaqën ndaj komunistëve arabë' (Draitse 2012). Këto dy drejtime dallonin prej njëri tjetrit, por edhe pajtoheshin ndërmjet në shumë çështje. Për dallim nga vehabizmi i cili lindi mbi bazat e theksuara sektare, Vëllazëria muslimane lindi si reaksion ndaj dominimit evropian dhe invazionit kulturor (Commings 2009; 140-141). Megjithatë, të dyja lëvizjet kishin për qëllim krijimin e bashkësisë fetare. Lidhjet e fshehta midis fuqive të huaja, vehabitëve dhe Vëllazërisë muslimane, vunë rregulla loje për sa u përket lidhjeve kolaboracioniste në mbarë Lindjen e afërme.

Vëllazërinë muslimane në Egjipt, prej krijimit të saj e karakterizojnë qasje të ndryshme të veprimit politik, prej bisedimeve politike e gjer te asainacioni dhe sulmet e armatosura sektare. Ky grup ka qenë i ndaluar ndërsa shumë anëtarë të tij janë burgosur gjatë kohës së qeverisjes së regjimeve të proviniençave të ndryshme politike. Kah fundi i viteve të shtatëdhjeta të shekullit të kaluar, kur militantët u lidhën me Vëllazërinë muslimane, i bënë atentat kryetarit të Egjipti Enver es-Sadat-it, erdhi deri te rritja e represionit mbi këtë organizatë, ndërsa në opinion ishte e aktualizuar biseda mbi atë se a lejohet vrasja e njerëzve të akuzuar për mosbesim. Adus-Selam Ferexh mbronte mendimin se muslimanët 'në dëm të vetin' i shpërfillin imperativet e luftës së shenjtë (xhihadi) si dhe luftën kundër atyre që bëjnë mëkat apostaze. Ai, sipas traditës selefiste tekfiriste, mbrojti përmbysjen e dhunshme të regjimeve 'të mos besimtarëve duke konsideruar atë 'si metodën e vetme të drejtë e cila garanton vendosjen e shtetit të vërtetë islam' (Ehavi 1992 fq. 95). Duke gjykuar aktin e dhunës, në këtë fetva me të cilën i zhvlerësoi deklaratat e Ferexhit e të cilën e solli pas kësaj ngjarje, autoriteti kryesor i Egjiptit muftiu Ali Xhed el Hakk, pranoi se ajo në të cilën thirret Ferexhi përmendet në Kur'an, por pastaj tërhoqi vërejtjen se duhet kushtuar kujdes 124 ajeteve të tjera të cilat 'kërkojnë që të

veprohet me durim duke iu shmangur dhe duke e gjykuar konfliktin e armatosur me jo muslimanët në frymën e një bashkëjetese të qetë dhe sigurie’ (Ehavi 1992: fa. 95 - 97). Asgjë nga kjo, si duket nuk ka ndikuar në taktikën e Vëllazërisë muslimane e të mos flasim për fuqitë e huaja.

Deri në gjysmën e viteve të tetëdhjeta Vashingtoni dhe Londra, në përpjekje për t’i mundur dhe për t’i detyruar trupat ruse të tërhiqen, filluan t’i financojnë disa formacione islamike më ekstreme, duke përfshirë edhe ato për të cilat besohet se kanë kryer disa prej krimeve më të tmerrshme kundër popullatës civile. Sektarët e Afganistanit dhe Pakistanit rrjedhin prej sektes Deoband, në kuptimin doktrinar janë të ngjashëm me selefistët e vendeve të Gjirit.

Haxhi Abdul-Hak, i cili e pranoi se në vitin 1984 vuri bombë në aeroplanin e udhëtarëve është pranuar si ‘luftëtar për liri - freedom fighter’ nga ana e Margeret Thatcher dhe Ronald Reganit më 1986 (Curtis 2012ë fq. 145). Ndihma amerikane në vlerë prej miliona dollarësh i janë ndarë Gulbuddin Hekmatjarit, i cili njihet me atë se grave u ka futur thartirë në sy, heqjen e lëkurës për së gjalli të kundërshtarëve të vet dhe me masakrën e grupeve rivale. Hekmatjari ka qenë bashkëpunëtor i ngushtë me Osama bin Ladenin, por i ka vizituar edhe zyrtarët britanik në Londër gjatë viteve 1986 dhe 1988 (kaddie 2006: fq. 118; Curtis2012: fq. 146). Ai deri më sot e kësaj dite mbetet në lidhje me regjimin e Afganistanit i cili mbështet SHBA. Saudiani Osami bin Ladeni ka gëzuar përkrahjen amerikane gjatë viteve të tetëdhjeta por e humbi mëshirën e Vashingtonit për shkak të kundërshtimit të vënies së bazave amerikane në Arabinë saudite. Bin Laden organizoi disa sulme në caqet amerikane në rajon, ndërsa është i dyshuar (por kurrë zyrtarisht i dënuar) për organizimin e, sulmit terrorist më 11 shtator të vitit 2001 në Nju Jork, ku humbën jetën 3000 njerëz. New York Times-i e shpalli bin Ladeni, me rastin e vrasjes së tij si ‘luftëtari i lirisw’. Osama bin Ladeni më 1989... ndërtoi rrjetin e tij terrorist me ndihmën e Amerikës (Zernike dhe Kufman 2011).

Vëllazëria islame gjithnjë ka gëzuar përkrahje të fortë në masat e popullit, por, në aspektin praktik, programi i tij politik dhe ekonomik ngeci pas përzierjes së ideve demokratike dhe socialiste që i pranuan shumica e arabëve nacionalistë. Me Vëllazërinë gjithnjë ka dominuar klasa e mesme tregtare dhe e pronarëve të tokave dhe kombinimi i lidhjeve humanitare të cilët kalonin prej njëres në tjetrën klasë. Funksiononte si ‘shoqëri paralele në atë mënyrë që: anëtarët më të pasur i furnizonin më të varfrit me ushqim, me barëra dhe veshmbathje, përmes donacione monetare’ (Hansen 2012). Në Egjipt si dhe në Siri, Vëllazëria i ka dhënë rëndësi pronës private dhe lidhjes në mes sipërmarrësve private, që ishte krejtësisht konzistente me agjendën ekonomike të sponsorëve të tyre të kohëpaskohshëm perëndimorë. Magda Kandil nga qendra egjiptiane për studime ekonomike, për Vëllazërinë egjiptiane thotë këtë: ‘Platforma e tyre ekonomike lehtë mund të identifikohet gabimisht me ekonominë politike të ish regjimit (ushtarak) i cili nënkupton: zhvillim në bazë të pronës private, ekonomisë së lirë të tregut, rolit të reduktuar të qeverisë në ekonomi dhe forcimit të sektorit privat’. ‘Dallimi i madh është në atë se për cilin sektor privat, në të vërtetë, këtu mendohet (Hansen 2012). Vëllazëria pohon se mbron interesat e të gjithë muslimanëve sunitë, por kjo nuk është e vërtetë. Viteve të tetëdhjeta, për shembull në Palestinë, popullatën e së cilës e përbëjnë sunitët, strategjia primare politike e Vëllazërve muslimanë ka qenë (si në Egjipt) e orientuar kah ajo që t’i transformojë palestinezët në shoqëri islame, gjersa faza e dytë e kësaj strategjie nënkupton luftën e shenjt kundër Izraelit. Kjo donte të thotë se Vëllazëria e kishte patjetër të qërojë hesapet, në rend të parë, me nacionalistët palestinezë, para të bërit rezistencë forcës okupatore. Megjithatë, edhe pse shoqëria palestineze është shumë religjioze, anketat kanë treguar se 99 për qind e qytetarëve palestinezë preferon programin e përbashkët nacional PLO (Shadid 1988: fq. 677 - 680). Madje edhe grupet tjera islamike sunitë, siç është xhihadi islamik, qëndruan me PLO dhe i mbajtën lidhjet e mira dhe të forta si me popullatën sunitë ashtu edhe me atë shiite, duke u kyçur edhe me Hizbull-llahun dhe Iranin (Shadid 1988: f. 677). Sa i përket Izraelit

dhe rolit të tij, ai ka qenë shumë i vetëdijshëm për strategjinë e Vëllezërve muslimanë dha të ndarjes në mes palestinezëve e konsideronte si përparësi të veten të rëndësishme. Nga pikëpamja e Izraelit ‘çfarë do sukcesi i Vëllezërve muslimanë shkonte në dëm të nacionalistëve (PLO) të cilët, me këtë, në konsekuencën e fundit do të dobësohen’. Rezultati i kësaj ka qenë trajtimi ‘i butë’ ndaj pjesëtarëve të Vëllazërisë (nga ana e Izraelit) në krahasim me trajtimin e nacionalistëve’ (Shadid 1988 : fq. 674 -675).

Islamistët tregojnë për marrjen e mendimit publik i cili jep përkrahje të fortë vënies së drejtës islame (shariatit sh.p.) në mbarë rajonin. Shumica dërmuese në shumë vende (p.sh. 74 % në Egjipt, 89 % në territoret palestineze) përkrahjen e vënies së shariatit si ‘ligj zyrtar të vendit’. Megjithatë, i njëjti testim në të njëjtën kohë tregon përkrahje të fortë kur është në pyetje liria e fesë për pjesëtarët e religjioneve tjera. Situata e tillë është në kundërshtim me idetë e këqija sektare ‘tekfire’ të selefistëve. Ky qëndrim i shprehur antiselefist vjen pjesërisht si rezultat i të kuptuarit që shariatit të aplikohet vetëm te muslimanët, ndërsa pjesërisht për shkak se dominon mendim i ndryshëm pa marrë parasysh domethëniet e shariatit, ndërkaq pjesërisht për shkak të dallimeve në pikëpamje të rolit të liderëve fetarë në politikë (Pew Research Centre 2013: 9). Shumica dërmuese e muslimanëve në shumë vende (p.sh. 67% në Egjipt, 67 % në Tunizi, 68 % në Irak janë të brengosur për shkak të grupeve ekstremiste, ndërsa veçanërisht për shkak të ekstremistëve muslimanë (Pew Research Centre 2013: 11). Një anketë nga viti 2015 vërtetoi se një përqindje e vogël e palestinezëve shpreh simpati ndaj lëvizjeve selefiste (përfshirë edhe ISIL-in) e cila gjithashtu u përhap edhe në Gazë. Anketat (JMCC 2015) tregojnë se 3,8 % e palestinezëve ‘ndjejnë shumë simpati pozitive’, 17.8% të matur, ndërsa 64.9% nuk kanë ndonjë simpati ndaj tyre, kurse (71.1% në Gazë) nuk ndjen simpati ndaj grupeve ekstreme sektare (J;CC 2015). E gjithë kjo tregon faktin se sulmi ndaj jo muslimanëve në stilin selefist gëzon përkrahje të dobët në mes muslimanëve.

Përkundër kësaj, sektarizmi i Vëllazërisë muslimane e brengos pakicën e popullatës - të gjithë muslimanët që nuk janë selefistë (shumica e sunitëve, si dhe shiitët dhe alevitë), krishterët, druzët dhe të tjerë - që nga vet fillimi pakicat ndjehen në pozitë ‘brengosëse’ ndaj marrëdhënieve diskriminuese dhe kërcënuese të Vëllezërve muslimanë (Hourani 1947: fq. 21-15).

Ndikimi vetëdijshëm i sektarizmit, fuqitë imperiale kohë pas kohe janë në aleancë me Vëllazërinë me që kishte të bëjë me ‘organizatën islame më të vjetër, më të madhe dhe më me influencë’. Ata e kanë krejtësisht të qartë se Vëllazëria kanë karakter shumë sektar, por ajo që është më me prioritet kur është në pyetje SHBA është fakti se në radhët e Vëllazërisë, që për amerikanët është shumë me rëndësi, ‘ekziston një rrymë e fortë që ka dëshirë të bashkëpunojë me Shtetet e bashkuara’. Si ta bëjnë këtë lidhje të pranueshme, pohohet ose parashihet, që ‘kjo rrymë mundohet që krejt organizimin e Vëllezërve muslimanë ta orientojë kah pozitën e përmbajtura...’ (Leiken dhe Brooke 2007: fq. 107). ‘Bartësit r pushtetit politik duhet ta dinë se Vëllazëria paraqet një shans të dukshme’. Ky afrim na tregon mbi strategjinë ‘përçaj e bashkëpuno’ dhe për përvetësimin e afimit në bazën e ‘prej rastit në rast’ për sa i përket bashkëpunimit me islamikët e Vëllazërisë muslimane (Leiken dhe Brooke 2007: fq. 121). Kjo gjithashtu tregon se strategjisë hegjemoniste përherë i përgjigjet kjo lidhje ndaj Vëllazërisë.

6.2 Xhihadistët e perandorisë në Siri

Kur erdhi deri te shpërthimi i ‘pranverës arabe’ në Tunizi pastaj në Egjipt dhe Libi, grupet selefiste dhe Vëllezërit muslimanë u bënë shfrytëzuesit kryesorë të këtyre ndryshimeve. Në Siri ndodhi edhe një kryengritje e armatosur islame, nën maskën e protestës me të cilën kërkoheshin reforma politike.

Bindja mbi ‘maturinë’ e Vëllezërve muslimanë, të cilët qëndronin përballë xhihadistëve të dhunshëm, has në një lloj simpatije në shkrimet dhe gazetarinë perëndimor (p.sh. Leiken dhe Brooke 2007fq. 107), por kjo ka mbështetje të dobët në përvojën siriane.

Pa dyshim se idetë ‘tekfiriste’ ekstreme, me të cilat arsyetohet vrasja e pjesëtarëve të feve tjera jashta Islamit (el- Amin 2012), ishin pjesë përbërëse e doktrinës së Vëllezërve muslimanë në Siri, të paktën prej shtatëdhjetë viteve të fundit. Në këtë i kanë nxitur sponsorët saudite-vehabitë të kryengritjes së armatosur siriane, e cila plasi në vitin 2011 dhe ky orientim u bë karakteristike përbërëse e pjesës më të madhe të grupeve të armatosura. Përkundër disa rokadave të vogla, për një kohë të shkurtër, udhëheqja e opozitës politike në egzil si dhe prijësit e revolucionit dhe Këshilli i lartë ushtarak i ‘Ushtrisë së lirë siriane’ ranë nën dominimin total të grupeve selefiste mbi të cilën dominojnë Vëllezërit muslimanë (Barkan 2013: 5).

Ç’është ajo që i dallon Vëllezërit muslimanë të Sirirsë? Ata kanë e kanë historinë e vet specifike dhe karakteristika specifike, edhe pse të gjitha qëndrimet e tyre zyrtare kryesisht ishin në përputhshmëri me organizatën egjiptiane, edhe me qeverinë e Vëllezërve muslimanë në Kajro e cila veproi një kohë të shkurtër (Draister 2012). Vëllazëria u përhap prej Egjipti në Siri, ndërsa kah fundi i viteve të dyzeta të shekullit të kaluar u zhvillua në një lëvizje të fortë parlamentare, por që nga vitet e gjashtëdhjeta filloi t’i sulmojë udhëheqësit alevitë në ba’th partinë duke i konsideruar heretikë të cilët, sipas Vëllazërisë, nuk janë të denjë të përfaqësojnë bashkësinë muslimane. Prej atëherë e më tej Vëllazëria ka qenë e kyqur në luftë me qeverinë shekullare në Siri (Teitelbaum 2004: fq. 135 -154). Vëllazëria përfaqësuesit e vet i konsideronte ‘zëdhënës natyrorë të bashkësisë sunitë’, ndërsa konfliktin me qeverinë ba’thiste u mundua ta paraqes si ‘konflikt midis sunitëve dhe alevitëve’ (Batatu 1982Ë 13). Megjithatë Batatu konsideron se pushteti ba’thist kurrë nuk i ka sjell në pyetje besimin religjioz sunit, por realisht u ka paraqitur kërcënim elementeve të interesave shoqërore të klasës së lartë e të mesme tregtare dhe të pronarëve të tokave, e cila në përkrahjen që ia jepte Vëllazërisë shihte përparësi në mbrojtje të interesave të veta (Batatu 1982: 13). Programi i Vëllazërisë muslimane, sipas modelit të degës së saj egjiptiane, ka vënë në dukje lirinë liberale dhe shndërrimin e kapitalit shtetëror në atë privat, që ishte

plotësisht në përputhje me ‘pikëpamjet dhe interesat e klasave urbane muslimane-sunite tregtare dhe sipërmarrëse’ (Batatu 1982: 13 - 14). Shekullarët arabë dhe sirianë, megjithatë, preferuan një sektor të fortë shtetëror. Kah fillimi i viteve të gjashtëdhjeta, Vëllazëria krejtësisht u marginalizua, kur erdhi deri te një bashkim afatshkurtër i Egjiptit dhe Libisë (Republika arabe e bashkuar), bashkim ky, dokumenti i të cilit përmbante: ‘kombinim konfuz... (ideja) e sentimentit nacionalist dhe fetar - socializmit marksist, paralel me revolucionalizmin egjiptian, nacionalizmin arab, internacionalizmin madje politikën shekulare me përzierje islame (Naxh-xhar 1968: 184).

Megjithatë Islami nuk është shpallur fe shtetërore në dokumentin e RAB (Parker1962: 19), po as si i tillë nuk është i futur në kushtetutën e Sirisë. RAB u shkatërrua pas një kohe të shkurtër. Hafez el Asadi që erdhi kryetar më 1971, Islamit e mbante jashtë kushtetutës të Sirisë, por pranoi kompromis me udhëheqjen e Vëllazërisë muslimane duke u pajtuar se shefi i shtetit patjetër duhet të jetë musliman. Asadi më 1972 kërkoi nga imami i lartë shiit t’i pranojë alevitet si njërin prej degëve shiite. Përkundër këtij fakti, Vëllazëria edhe më tej mbante qëndrimin se Asadi dhe alevitet nuk janë muslimanë (Talhamy2009Ë 566-7). Qeveria ba’thiste e Sirisë futi në kushtetutë principin e pluralizmit ekumen sipas të cilit të gjitha religjionet janë të pranuar në mënyrë të barabartë, kjo do të thotë të gjithë drejtimit fetare të muslimanëve, krishterëve, Druzëve dhe të tjera (janë të pranuar sh.p.).

Opozita e Vëllazërisë muslimane ndaj qeverisë ba’thiste dhe pluralizmit fetar që e vendoi, mori formën e dhunës kah fundi i viteve të shtatëdhjeta (Batatu 1982: 19 -20). Përkundër doktrinës së tyre reduksioniste, konsiderohet se Vëllazërit muslimanë kanë qenë të frymëzuar nga Revolucioni islamik i Iranit që ndodhi më 1979. Edhe pse këtë revolucion e bënë muslimanët shiitë, Vëllazëria kërkoi ndihmë prej Iranit për pastrimin e hesapeve me qeverinë shekullariste të Sirisë. Por lideri iranian Ajetull-llah Ruhull-llah el - Humeini, nuk iu përgjigj asnjë kërkesë të tyre (Batatu1982: 13). Jo shumë kohë pas kësaj, ideologu kryesor i Vëllazërve muslimanë të Sirisë, Seid Hawwa, theksoi se ‘bashkësinë

islame të vërtetë e përbëjnë pjesëtarët sunitë, kështu hendeku ekzistues edhe më tepër u zgjerua në mes Vëllazërisë muslimane dhe Iranit’ *Talhamy 2009: 570; Batatu 1982: 13). Ky qëndrim anti shiit i përforcuar me teorinë vehabite, e cila aleancën e Iranit, Sirisë dhe Hizbull-llahut i mban nën kërcënim i cili është drejtuar kah ‘mbjellja e frikës prej rënies së mundshme të Sirisë dhe i vendeve tjera sunite nën pushtetin shiit’ (Talhamy 2009: 579).

Me që sistemi ba’thist i pushtetit që kishte lëshuar rrënjë të thella, ndaloi aktivitetet e Vëllazërisë për shkak të metodave të tyre të dhunshme dhe duke marrë parasysh se kryetari Hafez el Asad nuk ishte i gatshëm të lëshojë pe në kërkesat e Vëllazërisë, rrjeti i përhapur i kësaj organizate filloi të përdor metoda të armatosura në konflikt me pushtetin. Mënyra e të menduarit tekfivist e këtij grupi është demonstruar në vitin 1979 kur Vëllazëria realizoi një sërë sulmesh ndaj pjesëtarëve të bashkësisë alevite, ndaj zyrtarëve të qeverisë siriane, përfshirë këtu edhe masakrën ndaj një grupi të vogël të pjesëtarëve të studentëve të rri alevitë të akademisë ushtarake në Halep (Seale 1988:325).

Pushteti sirian burgosi shumë anëtarë të Vëllazërisë muslimane, duke e akuzuar këtë grup se kolaboron me Izraelin dhe SHBA -të. Në prill të vitit 1980 në Halep erdhi deri te konflikti ndërmjet pjesëtarëve të Vëllazërisë dhe forcave siriane të sigurimit që shkaktoi 1000 viktima (Seale 1988: 328; Talhamy 2009: 567). Shtypjen e kësaj kryengritje të armatosur të Vëllazërisë në qytetin Hama e kam sqaruar në kapitullin e katërt.

Paraqitja e ‘Ushtrisë së lirë Siriane’ (FSA) në vitin 2011 - formacionit të armatosur i cili në asnjë moment nuk ka patur strukturë të centralizuar të komandës, por në realitet bëhet fjalë për një numër të madh grupesh të cilët janë koordinuar lehtë përmes financierëve dhe furnizuesve me armë të tyre. Ky formacion është prezantuar gabimisht në shumë raporte mediatike të Perëndimit si një element organik që është zhvillua nga protestat qytetare në kombinim me këshillat vendore të vetëmbrojtjes në suaza të bashkësisë. Për shumëçka, ishte ky një kthim në jetë të humbjes së madhe të Vëllazërisë muslimane që ndodhi në Hama para 29 viteve. Megjithatë në vitin 2011 roli i forcave selefisto-xhidaiste

me qëllim është vënë në heshtje në botë, dhe atëherë kur u pranua se bëhet fjalë për atë, u mundua me çdo kusht që për konfliktin ta akuzojë qeverinë e Sirisë.

Një analist amerikan pohoi se: ‘konflikti sirian filloi si revolt shekullar qytetar kundër autokracisë. Por konflikti zgjati shumë kohë... (ekziston) një lëvizje e vogël xhihadiste në Siri e cila prej dite në ditë sa vjen e rritet... (kryetari) Asad shfrytëzoi praninë e atyre kërcënimeve xhihadiste në radhët e opozitës për ta konsoliduar përkrahjen e regjimit të vet’ (O’ Bagy 2012). Në mënyrë të ngjashme, një raport tjetër amerikan nga viti 2012 pohon: ‘Pjesa më e madhe e luftëtarëve të opozitës janë nacionalistë legjitim që luftojnë për lirinë e vendit të vet dhe për vendosjen e shtetit demokratik... shumica e pjesëtarëve të FSA-së janë muslimanë të devotshëm dhe jo islamikë dhe ata nuk janë të motivuar me sektarizëm’ (Benotman dhe Naseruddin 2012: 1). Por ky raporti i dytë më tej i karakterizon grupacionet të tubuara në suaza të FSA-së si ‘xhihadistë’, në bazë të qëllimeve të tyre kuptohet se në truallin e Sirisë dëshirojnë të vendosin shtetin islam. Në mesin e tyre bëjnë pjesë Xhebbhetun-Nusra (Fronti en-Nusra), Liwaul-Umme (Brigada nazionale, Sukurush-Sham (Shqiponjat e Shamit), Ed-dawletul-Islamijje (Shteti islam dhe Ahrarush-Sham *Benotman dhe Naserud-din 2012:2).

Kush janë ata për të cilët thuhet se e përbëjnë ‘shumicën më të madhe’ të nacionalistëve shekullar? Grupi ndërkombëtar i krizës (ICG 2012) që është e afër me politikën e Vashingtonit thekson se ‘prezenca e trendit të fortë selefist në mes kryengritësve sirianë më nuk mund të injorohet’, përmend ‘traditën e matur islame duke pohuar se ‘dy grupet që më vonë do të zhvillojnë ideologjinë e tyre të qartë’ mund të jetë e karakterit shekullar. Bëhet fjalë për brigadat Faruk dhe Halid bin Velid, që janë të stacionuara në Hums (ICG 2012: 1,6: po ashu Ebu Zejd 2012). Këto dy formacione në të vërtetë janë dy forca kryesore që kanë marrë kontrollin mbi bërthamën e vjetër të Humsit në periudhën ndërmjet 2011 -2012). Brigada Faruk u bë formacioni më i madh kryengritës ushtarak deri në atë moment sa vazhdoi konflikti sirian (Hollyday 2012: 21 -22). Gazeta The Wall Street Journal

pjesëtarë e brigadës Faruk i quajti ‘sunitë e jo islamikë të devotshëm’ (Malas 2013). Në deklaratat e tyre për shtyp në gjuhën angleze këto formacione haptas janë distancuar nga grupet e lidhura me Al-Kaidën, për të mos humbur përkrahjen e Perëndimit, por ato në Siri edhe më tej mbajnë mbi kokë të shkruara fjalët e shehadeit dhe njihen me atë se mbajnë mjekra identike me ato të selefistëve (Channel 14 News 2012). BBS - ja brigadën e Farukut e quan ‘Islamikë të përmbajtur, duke pohuar se pjesëtarët e tij e ekzagjerojnë prirjen e tyre islamike ‘për të tërhequr ndihma materiale nga vendet e Gjirit arabik’ Marcus 2013).

Ky imazh i matur me siguri se është një lloj dëshirë e kotë (Wishful thinking). Murteda-i vëren se ‘shumica e pjesëtarëve të batalionit të brigadës Faruk janë selefistë që i ka armatosur Arabia saudite, ndërsa pjesëtarët e batalionit Halid bin Velit janë lojalë të Vëllezërve muslimanë të cilët edhe e financojnë këtë lëvizje (Murteda 2012). Kah fillimi i prillit, batalionet e brigadës Faruk janë akuzuar për vënien e xhizjes ose të tatimit që u imponohet jo muslimanëve që jetojnë nën pushtetin musliman dhe atë në pjesët e provincës Hums që është e banuar me krishterë (Al-Hakika 2012; Holyday 2012 : 27). Banorët e Humsit dëgjuan se pjesëtarët e brigadave të sipërpërmendura bërtasin me parulla të gjenocidit si: ‘të krishterët në Bejrut, alevitë në varr’ (blanford 2012). Burimet e kishës ortodokse krishtere i akuzuan pjesëtarët e brigadës për raste serioze të pastrimit etnik të dhjetëra mijë krishterëve në Hums që nga fillimi i vitit 2012 (Agenzia Fides 2012). Simpatizuesit perëndimorë gjithnjë e mbrojnë brigadën Faruk, duke pohuar se të krishterët që e braktisën Humsin këtë e kanë bërë me vetë-dëshirë nga frika prej konflikteve të armatosura (Al Tamimi 2012). Këto pohime do të tingëllonin më të besueshme po të kishte ndodhur që popullata muslimane të ishte larguar nga Humsi në një numër afërsisht sa ata, por kjo nuk do të ndodhte kur janë në pyetje muslimanët. Burimet kredibile akuzojnë brigadën Faruk për minimin e spitalit në vendin e quajtur Kajsar, i cili është realizuar me thirrjen e tekbiereve ‘All-llahu Ekber’ (oxnevg3n22 2012), simpatizuesit e të cilit, këtë

incizim, e publikuan në internet, me çrast për këtë sulm me bombë e akuzuan ‘regjimin (Syrian Days of Rage 2012). Ushtria siriane pastaj nuk praktikon thirrjen e tekbirove që është një praktik e islamistëve. Komandanti i njohur i brigadës Faruk, Halid el Hamad, i cili në një incizim të videos është paraqitur në një mënyrë mizore si han zemrën e një ushtari sirian të vdekur (Greenfield 2013b). Brigada Halid bin Velid, gjithashtu, besohet se është përgjegjëse për shfrytëzimin e fëmijëve adoleshent të cilët mbajnë përgjegjësi për prerjen e kokave të të burgosurve në Hums (HRI 2012). Vështirë se mund të thuhet këtu se bëhet fjalë për ‘kryengritës të përmbajtur’.

Ekzistojnë edhe grupeve tjera selefisto-xihadiste që kanë vepruar që nga fillimi i konfliktit - si brigada që kanë mbajtur këto emra: Umer el Hattab, Ali Ibën ebi Talib, Ebu Bekër es-Siddik, Reef Dimeshk Martyrs, Ar-Radeef eth-Theuri (Murteda 2012), si dhe grupe të huaja selefiste, përfshirë këtu edhe grupin luftarak islamik të Libisë si dhe Talibanët e Pakistanit. Duket fakti se asnjëri prej ithtarëve të teorisë mbi ekzistimin e ‘Ushtrisë së lirë shekulare të Sirisë’ nuk është i aftë të emërtojë cilin do grup veç e veç. New York Times në vitin 2013 pranoi se ‘askund në territorin e Sirisë që gjendet nën kontrollin e kryengritësve nuk është e mundur të identifikohet formacioni luftarak i cili mund të karakterizohet si...’ (Hubbard 2013).

Karakteristikë e veçantë e konfliktit sirian është prania e një numri të madh të xihadistëve selefistë, veçanërisht prej vitit 2012 deri më sot, dhe atë prej vendeve të ndryshme si: Arabia saudite, Libia, Tunizia, Jemeni, Iraku, Çeçenia, Pakistani dhe prej vendeve të ndryshme të Evropës (Komireddi 2012, Gertz 2013, Kern 2013). Ky fenomen vërteton faktin se aspak nuk ka të bëjë me konfliktin nacional pastaj as që është në pyetje ‘lufta qytetare’. Forcat selefiste dhe të Vëllazërisë muslimane arrijnë t’i prolongojnë sulmet e tyre falë vërshimit të mijëra luftëtarëve të huaj, të cilët kryesisht ishin të paguar të luftojnë nga ana e Katarit dhe Arabisë saudite, ndërsa stërvitjet i kishin bërë në Jordani dhe Turqi (Draister 2013). Natyrisht, islamistët sirian humbën që nga viti 2012 por u arriti përforcimi me mijëra luftëtarë nga

xhihadistët e jashtëm, shumica e të cilëve hyrën në Siri përmes Turqisë.

Në këtë luftë të ndytë dhe të pandershme fuqitë e jashtme nuk u paraqitën si pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në konflikt, ata kryesisht paraqiten në rol të financierëve që në mënyrë të jo drejtpërdrejtë marrin pjesë në konflikt, të cilët i stërvitin dhe i furnizojnë me armë kryengritësit islamikë.

SHBA, Britania e Madhe dhe Franca në fillim ishin të angazhuara në përpjekjet diplomatike, me të cilat mundoheshin të izolojnë qeverinë e Sirisë dhe në shumë raste t'i imponojnë grupet siriane egzile jo legjitime si 'përfaqësues legjitim' të popullit sirian (Barkan 2013). Pa marrë parasysh këtë, së bashku me kolaboratoristët rajonalë, veçanërisht Turqinë, Katarin dhe Arabinë saudite, ata më vonë formuan dhe armatosën grupe të ndryshme të kryengritësve të armatosur. Turqia ofroi poligon për stërvitje në teritorin e vet dhe platformë për sulme në anën veriore të Sirisë (Edmonds 2013). Katari i ka financuar Vëllezërit muslimanë dhe siguroi armatim prej Turqisë dhe rekrutoi luftëtarë të huaj, p.sh. ata nga Jemeni, të cilët u stërvitën në Katar nga forcat speciale amerikane, para se të dërgohen ata në Siri (El Alem 2013a). Arabia saudite e cila që nga fillimi i armatosi pjesëtarët e kryengritjes së armatos në Siri, që në mars të vitit 2011, i përkrahte grupet e ndryshme të huaja të kryengritësve, përfshirë edhe Talibanët e Pakistanit (Press TV 2013).

Roli i Izraelit në këtë konflikt është i fshehtë, më së paku deri në vitin 2013 kur shteti cionist realizoi disa sulme raketash ndaj Sirisë (Gordon 2013) pas të cilëve sulme filloi t'u ofrojë ndihmë mjekësore dhe pajisje luftëtarëve islamikë në kufi me teritorin e Rrafshnaltës së Golanit (Israel Today 2013), Nuk ka dyshim se Izraeli përkrah rrëzimin e kryetarit Bashar el Asad. Gjatë vitit 2012 shefi i komandës veriore të Izraelit, gjeneralmajori Yair Golan u përqendrua drejt aleatit të fortë të Sirisë në jug të Libanit, Hizbullahut, duke deklaruar 'Unë do të isha shumë i lumtur kur Asadi do të largohej nga pushteti (Hayoum 2012). Shteti sionist lëshoi një komunikatë për shtyp e cila mund të komentohet si deklarata 'të kamufluara' duke deklaruar kohë pas kohe se Izraeli

më shumë e preferon pushtetin shekullar të Bashar el Asadit se sa kryengritësit islamikë (Times of Israel 2013); por kjo aspak nuk korrespondon me një pozitë të gjerë të shprehjes së frikës prej diçkaje që Izraeli e quan ‘boshti i të keqes’ me çka nënkupton aleancën e Iranit, Sirisë dhe Hizbull-llahut (Hazom 2013). Zyrtarë të lartë izraelitë të ministrisë së mbrojtjes e sqaruan çështjen deri në fund, kur deklaruan se për ata ‘kontrolli i Sirisë nga ana e grupeve të lidhura me El-Kaidën është opsioni më i pranueshëm se sa fitorja e forcave të Asadit’ (Pontz 2013: BICOM 2013). Ekzistojnë disa informacione ku përmendet se Izraeli i shet armë Arabisë saudite, të cilat ky vend më pastaj ua dërgon klientëve të vet në Siri (El Alem 2013b). Kjo do të thotë që, edhe pse Izraeli për armiq të vet njëjtë i konsideron si grupacionet e lidhura me Al- Kaidën ashtu edhe Sirinë shekullare, grupet sektare ekstremiste të përleshur ndërmjet paraqesin më pak rrezik për Izraelin se sa prej bllokut të organizuar e të disiplinuar që vepron si aleancë nga Libani, Siria dhe Irani. Prandaj Izraeli është këmbëngulës që me çdo kusht ta thyej atë bosht.

Në nëntor të vitit 2012, pak më shumë se gjashtë muaj prej kur grupi i vendeve ‘Miqtë e Sirisë’ dhe pas të cilit qëndronin SHBA-të, Këshilli nacional i Sirisë (SNC) i shpalli ‘përfaqësues legjitim’ të popullit sirian, i njëjti grup më pastaj u bë i varur i ‘Koalicionit nacional të revolucionit sirian dhe i forcave revolucionare opozitare’ (Barkan 2013: 1,4). Njëri nga qëllimet e kësaj manovre të organizuar të forcave perëndimore ka qenë përpjekja për t’u zvogëluar ndikimi i Vëllazërisë muslimane që dominon me këtë trup. Përkundër kësaj, Vëllazëria, shumë shpejt pas kësaj, përsëri mori rolin dominues si mbi këtë koalicion të ri ashtu edhe mbi ‘Komandën e lartë ushtarake të FSA-së’ (SMC) (Draitser 2012). SNC-ja ndikimin e vet e ngriti mbi një fakt të thjeshtë që u bë kanali kryesor për hyrjen e armëve. Megjithatë dy të tretat e komandës ushtarake që e përbëjnë 30 anëtarë konsiderohet se u takon Vëllazërisë muslimanë përkrah një grupi të vogël të islamistëve të pavarur me orientim selefistë (Barkan 2013 : 5). Për më tepër, në këtë grupacion FSA - SMC nuk bën pjesë Xhebbhetun-Nusra, grup selefist për të cilin mendohet se është

degë 'oficiale' e Al-Kaidës në Siri. Nuk ka dyshim se në mes pjesëtarëve të grupeve të bashkuar nën ombrellën e FSA-së ekzistojnë një simpati e përcaktuar ndaj En-Nusrasë. Kur SHBA-të në vitin 2012 e shpalli Nusranë 'organizatë terroriste', pjesëtarët e FSA-së menjëherë shpejtuan ta mbrojnë, me çrast 29 njësi organizative të FSA-së shpallën 'të gjithë ne jem En-Nusra' (Cockburn 2012). Nga kjo mund të biem përfundim se ndërmjet luftëtarëve selefistë dhe fraksioneve të tyre në Siri ekziston një lidhje e dobët, ndërsa herë - herë edhe luftë fraksionesh. Për dallim nga ata, Partia shiite e Libanit Hizbull-llah, pas kyqjes në luftë në Kusajr, të gjitha grupet islamike i shpalli tekfirxhinj ose vrasës sektarë (Daily Star 2013).

Në vitin 2013 gjenerali Salim Idris u emërua shef i SMC-së. Bëhet fjalë për njeriun udhëheqës të FSA-së dhe të besueshëm të Vashingtonit (Greenfiel 2013a). Idrisi bëri disa veprime duke u munduar të distancohet nga En-Nusra, por pranoi se së paku 50 përqind të kryengritësve u takojnë islamistëve pastaj se ai është i gatshëm të bashkëpunojë me Nusrën (Greenfield 2013a). Përkundër akuzave mbi konfliktet në mes FSA-së 'të përmbajtur' dhe ekstremistëve në disa raporte theksohet, e para, se luftëtarët islamikë janë faktor dominues, dhe e dyta, se Vëllazëria muslimane në rajon është rritur në forcë udhëheqëse që gëzon përkrahjen më të madhe të vendeve perëndimore, madje ata që luajnë rolin udhëheqës si në radhët e SNC-së ashtu edhe në radhët e SMC-së (Draitser 2012; Barkan 2013).

Përçarja midis Xhebbhetun-Nusra-së dhe shtetit islam në Irak dhe Levant, krahut të tij i cili prej Iraku u përhap në Siri, (ISIL, ISIS ose Daesh) duket se sinjalizoi krijim të një hendeku midis FSA-së dhe ISIL-it. Megjithatë një zhvillim i këtillë i situatës më së miri mund të kuptohet si mossa e suksesit për t'u bashkuar, me siguri për shkak të rivalitetit lokal por edhe strategjisë së Arabisë saudite me të cilën ky shtet dëshiron të pengojë të vijë deri te pavarësia e cilit do grup kryengritës. Marrja e pjesëve të Irakut verior nga ana e ISIL -it dhe ndryshimi i politikës së Vashingtonit e cila përkufizohet në strategjinë 'intervenim për qëllim mbrojtjeje', i tërhoqi vëmendjen këtij 'grupi' të ri si një lloj 'super xhihadistë'.

Në realitet ISIL-i këtë punë të fëlliqtë në Irak e bënë që nga viti 2006. Ky grup ekstrem en-Nusra-në dhe pjesën e mbetur të FSA-së në disa territore të Sirisë, por për shkak të luftës për pushtet, këto dy grupe vazhduan të bashkëpunojnë ndërmjet në luftë kundër armatës siriane. Për shembull, nga mesi e deri kah fundi i vitit 2013, grupet e mbledhura në FSA me të cilat komandonte koloneli Abdul-Xhebbar el Ukaidi dhe trupat të ISIL-it që u priu egjiptiani Ebu Xhendal dhe Ebu Omer esh-Shishani të cilën e stërvitën amerikanët, luftuan krah për krah kundër ushtrisë arabe të Sirisë disa muaj, para se ta marrin bazën ajrore Menah në Halep (Eretz Yen; Hoff 2015). Rivaliteti midis të këtyre grupeve më shumë i përngjante luftës për pushtet lokal se sa një përçarje ideologjike e vërtetë.

Kur Vashingtoni kah mesi i vitit 2014 formoi koalicionin e vet kundër ISIL-it (Drennan 2014), në pajtim me qeverinë irakiane, në këtë mënyrë siguroi praninë e trupave amerikane në territorin e Sirisë veriore, pa lejen e qeverisë siriane në Damask. Mirëpo, jo shumë kohë pas kësaj u bë e qartë se nuk ekziston vullnet për sulme ndaj ISIL-it, si ai në Siri ashtu edhe ai në Irak. Forca ajrore të SHBA-së dhe i partnerëve të saj u shfrytëzua kundër ISIL-it vetëm në viset e banuara me kurdë në të dy vendet, por jo edhe në rastin kur ISIL -i veproi në viset që ishin nën kontrollin të forcave të qeverisë siriane.

Deir eZorra dhe Palmir. Në këto raste kishte të bëjë me operacionet që u përngjanin ‘grahjes së kafshëve’ me përzënien e fanatikëve nga vendi i padëshirueshëm, herë- herë ata ku SHBA-të kishin marrëveshje për bashkëpunim (veçanërisht në rast bashkëpunimi me disa elemente të caktuar të udhëheqjes kurde) në këtë mënyrë duke u lejuar të marrin vende shtesë në Veri të Sirisë. Një analist siriane-amerikan vërejti se, edhe pse ISIL-i nuk është i aftë të sulmojë asnjë pikëmbështetje të kryengritësve ose të forcave kurde, përderisa varganët e tij nuk sulmohen nga ana e aviacionit në marrëveshje të koalicionit që lufton kundër ISIL-it, megjithatë i kishte duart e lira dhe pati mundësi krejtësisht shlireshëm të veprojë kundër forcave të qeverisë siriane, duke mos i lajmëruar aspak forcat ajrore siriane për rrezikun (Fadel 2015b).

Krahas kësaj sikur ekzistonte një koordinim i sigurt midis ofensivave simultane të ISIL-it në lindje (në Palmir, Humsin verior dhe Deir eZorr) dhe të Xhebehetun-Nusr ‘Armatës pushtuese’ në perëndim (Fadel 2015b).

Formacioni i fundit, luftëtarët e të cilit prej Turqie u hodhën në Siri e mori pjesën më të madhe të Idlib gjatë vitit 2012. Ky front i dyfishtë, i përforcuar me armatim amerikan, gjithashtu arriti t’ia tërheq vëmendjen armatës siriane e cila kishte patjetër të fokusohet në të dyja anët. Siç tregova në kapitullin dymbëdhjetë, shumica e formacioneve të armatosura që vepronin nën kujdesin e FSA-së ikën te en-Nusra ose te ISIL-i, dhe atë haptas për një ofertë më të mirë parash. Kah fundi i vitit 2013, një gazetar britanik i cili nuk e fshehu ndjenjën e vet të përbuzjes ndaj qeverisë në Damask, vëren se ‘ushtria e lirë e Sirisë - FSA’ kryesisht është bërë ‘organizatë kriminele’. Disa prej komandantëve të tyre aq mirë janë të paguar sa që nuk dëshirojnë të ndalet lufta (Sherlock 2013). Ky rast të çon të mendosh rreth asaj se në çfarë mase këta ‘xhihadistë’ mund të konsiderohen mercenarë, para se të konsiderohen fanatikë fetarë. Ia parashtrova këtë pyetje kah fundi i vitit 2013 një zyrtarit të lartë në Ministrinë për pajtim që vepron në suaza të qeverisë së Sirisë. (Musalaha) mu përgjigj se disa liderë xhihadistë janë religjiozë ndërsa të tjerët jo.

Megjithatë, edhe pse interesi material mund të merret si faktor motivues për sa i përket angazhimit të ekstremistëve, ai citon: ‘Nuk mund nënçmojmë ndikimin e qindra rrjeteve dhe programe të ndryshme të kanaleve televizive dhe radio kanaleve nga vendet e Gjirit, të cilët në mënyrë konstante transmetojnë ide me përmbajtje xhihadiste-ekstremiste. Duket se ideologjia fetare, sado që të duket ajo e vrazhdë, paraqet një faktor të rëndësishëm motivues dhe burim i cili shumë xhihadistë të perandorisë i nxit për të marrë pjesë në këtë konflikt.

Shënime:

Abouzeid, Rania (2012) ‘Syria’s Up-and-Coming Rebels: Who Are the Rarouq Brigades?’ Time, 5 October, online:

<http://world.time.com/2012/10/05/syrias-up-and-coming-rebels-who-are-the-farouq-brigades-2/>

AFP (2014) 'ISIS, Syria rebel group sign pact of 'non-aggression', Al Arabiya, 13 September, online:

<http://english.alaraboya.net/en/News/middle-east/2014/09/13/ISIS-signs-non-aggression-pact-with-Syrian-group.html>

Agenzia Fides (2012) 'Abuse of the opposition forces, "ethnic cleansing" of Christians in Homs, where Jesuits remains' 21 March, online: <http://www.fides.org/en/news/31228?idnews=31228&lan=eng#.Ufjy7qz4164>

Akhavi, Shahrough (1992) 'The Clergy's Concept of Rule in Egypt and Iran', Annals of the American Academy of Political and Social Science, Vol. 524, Political Islam, November, 92-102

Al Alam (2013a) 'Qatar intelligence chief dies of wounds in Somalia', 7 May: <http://en.alalam.ir/news/1472130>

Al Alam (2013b) 'Israel, Saudi Arabia ink deal to arm Syria militants', 25 July, online: <http://en.alalam.ir/news/1498344>

Al-Amin, Ibrahim (2012) 'The Age of the New Takfiris', Al Akhbar, 21 August, online:

<http://www.mcclatchydc.com/news/nation-world/middleeast/article2470164.html>

Al Hamadee, Mousab and Roz Gutman (2014) '1,000 Syrian rebels defect to Islamic State in sign it's still strengthening', McClatchy DC, 8 July, online:

<http://www.mcclatchydc.com/news/nation-world/world/middle-east/article24770164.html>

Al-Haqiqah (2012) 'Farouq Battalion imposes Islamic Tax on villages in "Nasserite Valley"; Muslims in Baba Amr take refuge with Christians', Al Haqiqa Website in Arabic, April 9, 2012.

<http://www.syriatruth.info>

Al-Shafqa, Muhammad Riyad (2012) 'Muslim Brotherhood Statement about the so-called 'Syrian Revolution'', General supervisor for the Syrian Muslim Brotherhood, statement of 28 March, online at:

<http://truthsyria.wordpress.com/2012/02/12/muslim-brotherhood-statement-about-the-so-called-syrian-revolution/>

Al Tamini, Aymenn (2012) 'Christians in Syria: Separating Fact from Fiction', The Henry Jackson Society, Middle East Forum, November, online: <http://www.meforum.org/3377/christians-in-syria>

Ayoob, Mohammed (1979) 'Two faces of Political Islam: Iran and Pakistan Compared', *Asian Survey*, Vol. 19, No. 6, June, 535-546

Ayoob, Mohammed (2005) 'The future of political Islam: the importance of external variables', *International Affairs* (Royal Institute of International Affairs 1944-), Vol 81, No 5, October, 951-961

Baktiari, Bahman and Augustus Richard Norton (2005) 'Voices within Islam: four perspectives on tolerance and diversity', *Current History*, January, 37-45

arkan, L. (2013) 'Syrian Opposition Forms Political Coalition, Joint Military Council Following Foreign Pressure', *Middle East Media Research Institute (MEMRI)*, Inquiry & Analysis Series Report No. 919, January 14, online:

<http://www.memri.org/report/en/print6931.htm>

Batatu, Hanna (1982) 'Syria's Muslim Brethren' *Merip Reports*, Middle East Research and Information project (MERIP), No 110, Syria's troubles, Nov-Dec, 12-20, 34, 36

Benotman, Noman and Emad Naseraldin (2012) 'The Jihadist Network in the Syrian Revolution, A Strategic Briefing', *Quilliam Institute*, 20 September, online:

<http://www.quilliamfoundation.org/press-releases/quilliam-releases-concept-paper-the-jihadist-network-in-the-syrian-revolution/>

BICOM (2013) 'Amos Gilad: Al-Qaeda threat not as serious as Syria-Iran-Hezbollah axis', 2 April, online:

<http://www.bicom.org.uk/news-article/13169/>

Blanford, Nicholas (2011) 'Assad regime may be gaining upper hand in Syria', *Christian Science Monitor*, 13 may, online:

<http://www.csmonitor.com/World/Middle-East/2011/0513/Assad-regime-may-be-gaining-upper-hand-in-Syria>

British Embassy Cairo (1942) 'First Fortnightly Meeting with Amin Osman Pacha', 18 May, FO 141/838 (in Curtis 2012: 24)

Bulos, Nabih (2015) 'US-trained Division 30 rebels 'betray US and hand weapons over to al-Qaeda's affiliate in Syria', *Telegraph*, 22 September, online:

<http://www.telegraph.co.uk/news/worldnews/middleeast/syria/11882195/US-trained-Division-30-rebels-betrayed-US-and-hand-weapons-over-to-al-Qaedas-affiliate-in-Syria.html>

Butterworth, Charles (1992) 'Political Islam: the origins', *Annals of the American Academy of Political and Social Science*, Vol 524, November, 26-37

- Carroll, Terrance G. (1986) 'Islam and Political Community in the Arab World', *International Journal of Middle East Studies*, Vol. 18, No. 2 (May), pp. 185-204
- Channel14News (2012) 'Inside Syria's Farouk Brigade', YouTube, 11 September, online:
<http://www.youtube.com/watch?v=2krSHc02MIY>
- Churchill, W.S. (1921) *Speeches: House of Commons: Speech notes, source material and Hansard*, Reference code: CHAR 9/63, speech to the House of Commons, June 14, 1921
- Churchill, W.S. (1953) *Triumph and Tragedy*, Houghton Mifflin Harcourt, Boston
- Cockburn, Patrick (2012) 'Syria: The descent into Holy War', *The Independent*, 16 December, online:
<http://www.independent.co.uk/voices/comment/syria-the-descent-into-holy-war-8420309.html>
- Commins, David (2006) *The Wahhabi Mission and Saudi Arabia*, I.B. Tauris, London
- Curtis, Mark (2012) *Secret Affairs: Britain's collusion with radical Islam, Serpent's Tail*, London
- Curzon, George Nathaniel (1899) *Curzon, India and Empire: the Papers of Lord Curzon (1859-1925) from the Oriental and India Office Collections at the British Library*, London
- Daily Star (2013) 'Takfiri groups predominate ranks of Syrian rebels: Hezbollah', May 25, online:
<http://www.dailystar.com.lb/News/Politics/2013/May-25/218353-takfiri-groups-predominate-ranks-of-syrian-rebels-hezbollah.ashx#axzz2aa6nupor>
- Debka (2014) 'Syrian rebel Yarmouk Brigades ditch US and Israel allies, defect to ISIS', 17 December, online:
<http://www.debka.com/article/24301/Syrian-rebel-Yarmouk-Brigades-ditch-US-and-Israel-allies-defect-to-ISIS>
- Desai, Akshayakumar Ramanlal (1948) *Social Background of Indian Nationalism*, Popular Book Depot, Bombay
- DIA (1982) 'Syria: Muslim Brotherhood Pressure Intensifies', *Defence Intelligence Agency (USA)*, May, online:
http://www.foreignpolicy.com/files/fp_uploaded_documents/DIA-Syria-MuslimBrotherhoodPressureIntensifies.pdf
- Draitser, Eric (2013) *Saudi Arabia, Qatar and the Struggle for the Influence in Syria*, *Global research*, 9 July, online:

<http://www.globalresearch.ca/saudi-arabia-qatar-and-the-struggle-for-influence-in-syria/5342223>

Drennan, Justine (2014) 'Who Has Contributed What in the Coalition Against the Islamic State?' Foreign Policy, 12 November, online:

<http://foreignpolicy.com/2014/12/12/who-has-contributed-what-in-the-coalition-against-the-islamic-state/>

Edmonds, Sibel (2013) 'Uber-Neocons: The Main Architects of Post-Assad Syria at Work', Boiling Frogs, 5 May,

<http://www.boilingfrogspot.com/2013/05/05/uber-neocons-the-main-architects-of-post-assad-syria-at-work/>

Eretz Zen (2014) 'US Key Man in Syria Worked Closely with ISIL and Jabhat al-Nusra', YouTube, 17 August, online:

http://www.youtube.com/watch?v=piN_MNSis1E

Fadel, Leith (2015a) '3,000 FSA Fighters Defect to ISIS in the Qalamoun Mountains', Al Masdar, 9 January, online:

<http://www.almasdarnews.com/article/300-fsa-fighters-defect-isis-qalamoun-mountains/>

Fadel, Leith (2015b) 'Anti-ISIS coalition uses ISIS to Fight Assad in Favor of Rebels', Al Masdar, 2 October, online:

<http://www.almasdarnews.com/article/anti-isis-coalition-uses-isis-to-fight-assad-in-favor-of-the-rebels/>

Gertz, Bill (2013) 'Syria is jihad central: 6,000 terrorists flood new al Qaeda training ground', The Washington Times, 2 July, online:

<http://www.washingtontimes.com/news/2013/jul/2/syria-jihad-central-6000-terrorists-flood-new-al-q/?page=all>

Gordon, Michael (2013) 'Israel Airstrike Targeted Advanced Missiles That Russia Sold to Syria, U.S. Says', New York Times, 13 July, online:

<http://www.nytimes.com/2013/07/14/world/middleeast/israel-airstrike-targeted-advanced-missile-that-russia-sold-to-syria-us-says.html>

Greenfield, Daniel (2013a) 'Obama to Rely on Syrian Leader Who Claims Al Qaeda Aren't Terrorists to Keep Weapons Out of Al Qaeda's Hands', Frontpage Mag, April 30, online:

<http://frontpagemag.com/2013/dgreenfield/obama-to-rely-on-syrian-leader-who-claims-al-qaeda-arent-terrorists-to-keep-our-weapons-out-of-al-qaedas-hands/>

Greenfield, Daniel (2013b) 'Moderate Islamists Free Syrian Army Commander Who Ate Heart, Vows Genocide', Front Page Mag, 14

may, online: <http://frontpagemag.com/2013/dgreenfield/moderate-islamist-free-syrian-army-commander-who-ate-heart-vows-mass-genocide/>

Hansen, Suzy (2012) 'The Economic Vision of Egypt's Muslim Brotherhood Millionaires', Bloomberg Businessweek, 19 April, online: <http://www.businessweek.com/article/2012-04-19/the-economic-vision-of-egypts-muslim-brotherhood-millionaires>

Hayom, Israel (2012) Iran, Hezbollah are 'up to their necks' in Syria, says Israeli general', Israel Hayom Blog, April 6, online: http://www.israelhayom.com/site/newsletter_article.php?id=3857

Hoff, Brad (2015) 'ISIS Leader Omar al-Shishani Fought Under U.S. Umbrella as Late as 2013', Levant report, 18 September, online: <http://levantreport.com/tag/menagh-airbase/>

Holliday, Joseph (2012) 'Syria's Maturing Insurgency', Middle East Security Report 5, Institute for the Study of War, June, Washington

Hourani, A.H. (1947) Minorities in the Arab World, Oxford University Press, London

HRI (2012) 'Syrian rebels use a child to behead a prisoner', Human Rights Investigations, 10 December, online: <http://humanrightsinvestigations.org/2012/12/10/syrian-rebels-use-a-child-to-behead-a-prisoner/>

Hubbard, Ben (2013) 'Islamist Rebels Create Dilemma on Syria Policy', New York Times, April 27, online: <http://www.nytimes.com/2013/04/28/world/middleeast/islamist-rebels-gains-in-syria-create-dilemma-for-us.html?pagewanted=all&r=0>

ICG (2012) 'Tentative Jihad: Syria's Fundamentalist Opposition', International Crisis Group, 12 October, online: <http://www.crisisgroup.org/~media/Files/Middle%20East%20North%20Africa/Iraq%20Syria%20Lebanon/Syria/131-tentative-jihad-syrias-fundamentalist-opposition>

Israel Today (2013) 'Israeli hospital treats Syrian rebel fighters', 17 February, online: <http://www.israeltoday.co.il/NewsItem/tabid/178/nid/23683/Default.aspx>

JMCC (2015) 'Poll No. 84 – August 2015 – No Presidential Successor, PNA Priorities', 1 September, online: <http://www.jmcc.org/documentsandmaps.aspx?id=868>

Keddie, Nikki R. (2006) Women in the Middle East : Past and Present, Princeton University Press

Kern, Soeren (2013) 'European Jihadists: The Latest Export', Gatestone Institute, 21 march, online:

<http://www.gatestoneinstitute.org/3634/european-jihadists>

Komireddi, Kapil (2012) 'Takfiri militants from Pakistan are fighting in Syria with an anti-Stransmetic cause', 21 September, online:

<http://lubpak.com/archives/228501>

Krishna, Katragadda Bala (1939) *The Problem of Minorities or Communal Representation in India*, George Allen And Unwin, London

Leiken, Robert S. and Steven Brooke (2007) 'The Moderate Muslim Brotherhood', *Foreign Affairs*, Vol. 86, No. 2 (Mar. – Apr.), 107-121

Lia, Brynjar (1998) *The Society of Muslim Brothers in Egypt: the rise of an Islamic mass movement 1928-1942*, Uthaca, p.181

Malas, Nour (2013) 'As Syrian Islamists Gain, It's Rebel Against Rebel', *Wall Street Journal*, 29 May, online:

<http://online.wsj.com/article/SB10001424127887323975004578499100684326558.HTML>

Marcus, Jonathan (2013) *Gruesome Syria video pinpoints West's dilemma*, BBC, 14 May, online:

<http://www.bbc.co.uk/news/world-middle-east-22521161>

MEC (2015) 'These are the Syrian rebels the West is crying for', *Middle East Channel*, YouTube, 10 October, online:

<https://www.youtube.com/watch?v=873cZakapxM>

Mehta, Ashok and A. Patwardhan (1942) *The Communal Triangle*, Kitabistan, Allahabad

Mezzofiore, Gianluca (2015) 'Syria: Saudi-Turkish alliance backs 'Conquest Army' rebels to defeat Bashar al-Assad', 7 May, online:

<http://www.ibtimes.co.uk/syria-saudi-turkish-alliance-backs-conquest-army-rebels-defeat-bashar-al-assad--1500212>

Mortada, Radwan (2012) *Syria Alternatives (II): no homegrown solutions*, *Al Akhbar*, 13 June, online:

<http://english.al-akhbar.com/content/syria-alternatives-ii-no-homegrown-solutions->

Najjar, Fauzi M. (1968) 'Islam and Socialism in the United Arab Republik', *Journal of Contemporary History*, Vol. 3 No. 3, The Middle East, July, 183-199

O'Bagy, Elizabeth (2012) 'Jihad in Syria', *Middle East Security Report* 6, Institute for the Study of War, Washington, online:

<http://www.understandingwar.org/report/jihad-syria>

0xnevg3n22 (2012) 'Free Syrian Army Terrorist Savages Blow Up a Hospital filled with people in Homs/Syria', YouTube, 5 September, online: <http://www.youtube.com/watch?v=yycouE-17V4>

Pande, B.N. (1987) 'History in the Service of Imperialism', (speech in the Indian Upper House of Parliament, the Rajya Sabha, made on 29 July 1977) online;

<http://www.cyberistan.org/islamic/pande.htm>

Pandey, Avaneesh (2014) 'Qatar Buckles Under Pressure From Saudi Arabia, UAE; Expels Muslim Brotherhood Leaders', IBTimes, 13 September, online:

<http://www.ibtimes.com/qatar-buckles-under-pressure-saudi-arabia-uae-expels-muslim-brotherhood-leader-1687906>

Parker, J.S.F. (1962) 'The United Arab Republik', International Affairs (Royal Institute of International Affairs 1944-), Vol. 38 No. 1, January, 15-28

Pew Research Centre (2013) 'The World's Muslims: religion, politics and society', Pew Forum on Religion and Public Life, April 30, online: <http://www.pewforum.org/Muslim/the-worlds-muslims-religion-politics-society.aspx>

Pontz, Zach (2013) 'Israeli Officials: We'd Prefer Al-Qaeda-Run Syrian to an Assad Victory', The Algemeiner, June 4, online:

<http://www.algemeiner.com/2013/06/04/israeli-officials-wed-prefer-al-qaeda-run-syria-to-an-assad-victory/>

Press TV (2013) 'Pakistani Taliban set up base in Syria: Report, 31 July, online:

<http://www.presstv.com/detail/2013/07/12/313534/taliban-set-up-base-in-syria-report/>

Roggio, Bill (2013) 'Free Syrian Army Arming Al Qaeda, ISIL Commander Claims', Transcend Media, 22 July, online:

<http://www.transcend.org/tms/2013/07/free-syrian-army-arming-al-qaeda-isil-commander-claims/>

Seale, Patrick (1988) *Asad: the struggle for the Middle East*, University of California Press, Berkeley CA

Shadid, Mohammad K. (1988) 'The Muslim Brotherhood movement in the West Bank and Gaza', *Third World Quarterly*, Vol 10, No 2, April, 658-682

Sheikh, Nveed Shahzad (2007) *The New Politics of Islam: Pan-Islamic Foreign Policy in a World of States*, Routledge, Oxford

Sheikho, Youseef (2013) 'The Syrian Oppsosition's Muslim Brotherhood Problem', Al Akhbar English, April 10, online:

<http://english.al-akhbar.com/node/15492>

Sherlock, Ruth (2013) 'How the Free Syrian Army became a largely criminal enterprise', Business Insider, 30 November, online:

<http://www.businessinsider.com.au/how-the-free-syrian-army-became-a-largely-criminal-enterprise-2013-11>

SyrianDaysOfRage (2012) (9-3-12) Qaseer | Homs | Regime Force Bomb The Hospital', YouTube, 3 September, online:

<http://www.youtube.com/watch?v=fUisEPJaq9k>

Talhamy, Yvette (2009) 'The Syrian Muslim Brothers and the Syrian – Iranian Relationship, Middle East Journal, Vol. 63 No. 4, Autumn, 561-580

Teitelbaum, Joshua (2004) 'The Muslim Brotherhood and the 'Struggle for Syria, 1947-1958. Between Accommodation and Ideology ', Middle Eastern Studies, Vol 40, No 3, May, 134-158

Times of Israel (2013) 'Israel prefers Bashar Assad to Islamist rebels', May 18, online:

<http://www.timesofisrael.com/israel-prefers-assad-to-islamist-rebels/>

Wikeley (1945) 'Memorandum: Anglo American Relations in Saudi Arabia', Publik record office, 28 Dec 1945, FO 371/ 45543/ E10148

Wood, Charles (1862) Wood Papers, India Office Library, MSS, Eur, F78, Charles Wood to Viceroy Lord Elgin (Governor General of India), March 3, 1862

Yigit, Dilek (2014) 'The Rivalry Between Saudi Arabia and Qatar And Its Reflections On the Middle East', Institute of Strategic Thinking, Ankara, 23 May, online:

<http://sde.org.tr/en/news/detail/the-rivalry-between-saudi-arabia-and-qatar-and-its-reflections-on-the-middle-east/3739>

Zambelis, Chris (2013) 'Royal Rivalry in the Levant: Saudi Arabia and Qatar Duel over Ssyria', The Jamestown Foundation, Washington, Terrorism Monitor Volume, 11 Issue: 16, online:

[http://www.jamestown.org/single/?tx_ttnewa\[tt_news\]=41249&no_cache=1#.VhjFzyv9iF8](http://www.jamestown.org/single/?tx_ttnewa[tt_news]=41249&no_cache=1#.VhjFzyv9iF8)

Zernike, Kate and Michael T. Kaufman (2011) 'Obituary: The Most Wanted Face of Terrorism', New York Times, May 2, online:

<http://www.nytimes.com/2011/05/02/world/02osama-bin-laden-obituary.html?pagewanted=all&r=0>

7. Mediat e kooptuara dhe ‘ROJTARËT’ e të drejtave njerëzore



Mediat masive të kooptuara dhe vëzhguesit e obliguar për regjistrimin e rasteve të cenimit e të drejtave njerëzore janë elemente të pashmangshme të makinerisë propaganduese të luftës kundër Sirisë. Gjithsesi se në shekullin 21 nuk mund të zhvillosh luftë afatgjate të jo drejtpërdrejta duke u bazuar vetëm në përkrahjen e masës, pa përkrahjen e armatës të besueshme të kolaboracionistëve mediatik. Për këtë arsye doktrina e Pentagonit viteve të fundit përbëhet prej objektivave të larta ambicioze, si doktrina e dominimit të plotë të quajtur ‘Full Spektrum Dominance’, që nënkupton epërsinë informative, ekonomike dhe kulturore si dhe epërsinë ushtarake (JCS 2000; Engdahl 2011. Kjo doktrinë nënkupton se rrjetet konkurrense dhe kanalet e informacionit janë objektivat ushtarake legjitime (Norton - Tazlor 1999), ku makineria komunikative-mediatike, e cila vepron si një pjesë e strukturave ushtarake të luftës, është bërë aleati kryesor luftënxitës.

Koncepti i njohur si gazetarë të integruar - ‘embedded journalists’ doli në sipërfaqe gjatë kohës së invazioanit në Irak në vitin 2003, mrrë parasysh se atëherë gazetarët perëndimorë për herë të parë ishin integruar në sistemin e trupave zaptuese amerikane. Gazetarët nuk ishin të kooptuar vetëm fizikisht në radhët e ushtrisë, por rregullisht i merrnin në kohë informatat e detajuara, u është dhënë mbrojtje fizike dhe kontroll, por e kishin patjetër të silleshin sipas parimeve të parapara me që ishin në kontakt të përditshëm me forcat imperiale, Kjo përvojë u ndihmoi ta humanizojnë problemin dhe vuajtjen e pushtuesit (Wells 2003). Ajo tjera anë në atë situatë vështrohej vetëm si numër viktimash ose si karikaturë, si armik që është larg syve. Për krimet e trupave pushtuese (masakrave, dhunimeve, torturave) është marrë vesh shumë vonë pasi kishin ngjarë ato. Rrjetet televizive private filluan ta aktualizojnë madje edhe ta humanizojnë luftën si kurrë më parë, por krejtësisht në një mënyrë të thjeshtë: Në studimet e më vonshme, edhe pse gazetarët ishin të kyçur në të vullnetarisht, ata, në realitet, informonin vetëm ‘për një pjesë të vogël të konfliktit’, ndërkaq pohonin se puna e tyre është ‘pozitive’ (Fehmy dhe Jahnston 2005). Por, një studim që trajton çështjen e dallimit në mes raporteve të të kooptuarve dhe gazetarëve të lirë amerikanë tregon, natyrisht nuk është aspak për t’u habitur, ‘dallimet të rëndësishme në tonin e përgjithshëm ndaj ushtrisë, besimin në pjesëtarët e forcave të armatosura, mënyra e formësimit të lajmeve dhe autoriteti midis raportit të të kooptuarve dhe gazetarëve të lirë’ (Haigh 2006). Ky lloj kooptimi i gazetarëve raportues të luftës u bë një farë lloj institucioni për shekullin 21.

A çka u bë me pluralizmin dhe lirinë e informimit? Koha e internetit mundësoi krijimin e kanaleve të reja të pavarura të informimit; por fuqitë e mëdha edhe kësaj u munduan t’ia gjejnë ilačin. Monopoli mediatik mori një forcë të re përmes ‘ndërvarrësisë dinamike’ me grupet tjera investuese dhe në këtë mënyrë u bë ‘partneri i tyre i koalicionit në forcë në nivel global’ (Bagdikian 2004: 136). Ajo forcë është kopjuar edhe në epokën digjitale përmes ‘marketingut digjital agresiv, reklamimit interaktiv dhe mbledhjes personale të të dhënave’ (Chester 2007), duke krijuar

me këtë ‘monopol supermediatik’ përmes dominimit të hapsirës, mekanizmave kërkuese (Chester 2007:145, 167-170, 182-183). Në të njëjtën kohë, erdhi te shtimi i madh i organizatave joqeveritare - OJ, të cilat veprojnë në hapësirën kibernetike, veçanërisht në sferën humanitarizmit, të të drejtave njerëzore, me interes të veçantë për misionet të cilat mbështeten në arësytet e bazuara në nevojën e mbrojtjes të të drejtave njerëzore. Disa prej këtyre organizatave joqeveritare - OJ vërtetë janë të pavarura por shumë prej tyre janë në listën e të vuajturve, janë të lidhur, të kooptuar ose formojnë pjesën përbërëse të interesave të fuqive të mëdha. Krijimi i votave të ‘shoqërisë qytetare’ tejet të politizuar prej kohësh është në fokus të interesave të themelatës bamirëse nacionale për demokraci (THBND) të cilën e financon qeveria amerikane. Kjo organizatë është themeluar gjatë kohës së luftës së ftohtë viteve të tetëdhjeta ashtu që përmes saj të financohen gjoja grupet jopolitike në vendet e interesuara në të cilat, në realitet, janë identifikuar ‘Kujt e Trojës’ për veprim shkatërrues të SHBA (Blum 2000). Kryetari parë i THBND-së Allen Weinstein në vitin 1991 tha se ‘shumica e asaj që ne sot e bëjmë haptas, CIA para 25 viteve e ka bërë fshehtë’ (lefebvre 2013). Gjithsesi THBND-ja ka qenë e përzier në disa grushtshtete në Amerikën Jugore dhe Karbim dhe sot puna e tij është e ndaluar në disa prej vendeve për të cilat SHBA është e interesuar siç është Irani, Kuba dhe Venezuela. Mediat e kooptuara në veçanti janë forca të rëndësishme në zhvillimin e luftërave të fshehta. Kryengritja më e re ushtarake në Siri nuk do të mund të fitonte ndihmën e rëndësishme të jashtme nëse në ndonjë mënyrë karakteri i saj i vërtetë do ishte i njohur për masën e njerëzve, prandaj fshehja e karakterit të saj të vërtetë krahas demonizimit të zakonshëm dhe panikut moral lidhur me të, detyrë qendrore është e armiqve të sirisë. Megjithatë, për shkak të pohimeve misionare në lidhje me këtë projekt - e gjoja se për qëllim të forcimit të demokracisë dhe revolucionit, mbrojtjes së fëmijëve e të ngjashme me to - dhe të shumë rasteve, bëhet fjalë për anën liberale të spektrit politik perëndimor i cili ‘e mori flamurin’ me të cilin e nisi luftën me përmasa të gjera. Kjo po ashtu përfshinë edhe mediat liberale si dhe një numër të madh të

grupeve ‘vëzhguese’ joqeveritare, midis të cilave ka shumë që plotësisht janë inkuadruar në misionin e fuqive të mëdha që ka për qëllim ‘ndërrimin e regjimit.

Mediat gjoja ‘liberale’ siç janë rrjeti Al- Xhezira dhe gazeta britanike Guardian të cilat e kritikuan Vashingtonin për invazionin në Irak në vitin 2003, u bënë mbrojtësit më të fortë të agresionit në Siri. Burimet anonime të lidhur me rrjetin kryesisht të trupave amerikane për të drejtat njerëzore siç janë Human rights Watch, ‘Avaz’ dhe ‘Purpose’ dhe krijimet e tyre kibernetike në formë të ‘Helmetave të bardha’ dhe ‘Fushatës siriane’, u bashkuan me qëllim të lobimit për krijimin e zonës për ndalimin e fluturimeve ‘no fly zone’ në Siri (Sterling 2015a). Krejtësisht ishte e qartë, pas bombardimit të NATO -s Libinë në vitin 2011, se kjo do të thotë sulm i drejtpërdrejt në Siri dhe krim masiv me qëllim të përmbysjes së qeverisë. Korruptimi moral i mbrojtësve perëndimorë ‘të të drejtave njerëzor’ e arriti në këtë mënyrë kulmin e vet.

7.1. Luftënxitësit liberalë

Disa nga ‘liberalët’ më të konsoliduar të NVO-së kanë luajtur një rol të rëndësishëm në fushatën e përhapjes së informatave të rrejshme kundër Sirisë. Yalla la Barra (2015) tregon se Kenneth Roth, drejtori Human i Rights Watch, selia e së cilës është në Amerikë, u tërbua me kryetarin e Sirisë, Basha el Asadin. Duke përcjellë praktikën propaganduese konvencionale vazhdimisht të përsëritur, Rothi dërgoi qindra kritika mbi Asadin, duke u munduar në mënyrë konstante ta lidh me krimet mbi civilët, duke shfrytëzuar në mënyrë perfide fotografitë e bëra në Gazë dhe Kobani (pas bombardimeve izraelite dhe amerikane ndaj pozicione të ISIL-it) për të vërtetuar pohimet e veta. (Syrian Free Press 2015). Rothi kryetarin e Sirisë e krahason me sulmin nuklear të Amerikës në Japoni më 1945. ‘Për planifikuesit e bombardimit të Hiroshimës (siç vepron Asadi sot) ideja ishte të vriten sa më shumë civilë’ (Roth 2015b). Natyrisht se kjo është krejtësisht e pasaktë. Për dallim nga krimi i Vashingtonit në Hiroshimë, ku nuk ka pasur instalime ushtarake, kurrë nuk janë dhënë dëshmi kredibile se Asadi ka pasur ndërmend të gjuajë.

Edhe më indikativë është ajo që Rothi askund nuk parashtron pyetje se pse ‘Shtetet e bashkuara dhe aleatët e tyre në Siri i financojnë dhe i stërvitin fraksionet ekstremiste xhihadiste me qëllim të përmbysjes së qeverisë, anëtare sovrane e Kombeve të bashkuara (La Barra 2015). Këtu bëhet fjalë për thyerjen e qartë të dokumentit të Kombeve të bashkuara si dhe nenit 1 të dy dokumenteve të ligjit ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut. Gjoja se për Human Rights Watch kjo nuk paraqet kurrfarë problemi. Roth u bë njëri prej avokatëve më agresiv midis elitës amerikane të politikës së jashtme për bombardimin amerikan në Siri. Kah fundi i vitit 2013 parashtrroi një pyetje nëse do të ishte mjaft ideja e bombardimit ‘simbolik’ amerikan nda Sirisë. Drejtori i Qendrës MIT për studime ndërkombëtare këtë e quajti ‘deklarata më injoruese dhe më jo përgjegjëse që e ka dhënë ndonjëherë ndonjë mbrojtës për të drejtat njerëzore’ (Bhatt 2014).

Edhe Amnesty International iu bashkëngjiti misionit për ndryshim të regjimit në marrëveshjen e Vashingtonit. Kjo organizatë joqeveritare që është themeluar në Londër në vitin 1961, Amnesty u bë e njohur me letrat që ua shkroi në shenjë përkrahjeje të burgosurve të ndërgjegjes. Kohëve të fundit Amnesty bëhet e kooptuar nga ana e politikës së fuqive të mëdha, Duke u bazuar në burime të anësishme që janë të lidhura me grupet islamike të armatosura, Amnesty në të gjitha mënyrat shtie versionin e anësishëm të ngjarjeve për sa i përket luftës në Siri, Për shembull, vazhdimisht përsërit pohimet e grupeve të armatosura se bombardimet e territorit të Sirisë që e kontrollojnë terroristët sollën deri te dëmet katastrofale dhe për çdo kryengritës të vrarë kanë vrarë afër 100 civilë (AI 2015). Po të ishin këto deklarata të vërteta, këto do të thoshin akuza të rënda në llogari të ushtrisë së Sirisë. Natyrisht se kjo nuk është e vërtetë. ‘Dëshmitë’ që ofrohen me qëllim të argumentimit të atyre akuzave janë të pabesueshëm sepse vijnë nga burimet e anësishme dhe janë në kontradiktë me informacionet tjera që ekzistojnë. Amnesty ‘dëshmitarët’ e vet kryesisht i gjen përmes grupeve që janë të lidhur ngushtë me islamistët e armatosur (përfshirë Qendrën për thyerjen e të drejtave njerëzore dhe dokumentacionin (VDC), rrjetin sirian për të drejta

njerëzore) që i financon Turqia, SHBA, Arabia saudite dhe Katari, kurse të gjitha këto vende përpiqen ta përmbysin qeverinë e Sirisë (Sterlin 2015b). Prej fillimit të konfliktit grupet islamiste fabrikuan rrëfime mbi masakrat që i kanë bërë, ndërsa qeveria humbjet e veta i ka paraqitur si ‘viktima civile’ (Rosen 2012). Amnesty po ashtu mbështetet në ‘Mbrotjen civile’ ose në ‘Helmetat e bardha’ të cilat janë themeluar në Amerikë dhe të cilat u japin përkrahje grupeve terroriste si Xhebbhetun-Nusra e cila është shpallur organizatë terroriste në planin ndërkombëtar (Beeley 2015b). Nuk janë vetëm dëshmitë të bazuara në burime të një anëshme, në të cilët thirret Amnesty, ata gjithashtu as burimet e veta nuk ua nënshtrojnë kritikës së fortë. VDC publikoi të dhënat mbi viktimat në Idlib nën titullin ‘Viktimat e regjimit në Idlib’ të muajit mars-prill të vitit 2015, nën numrin 12 dhe ‘Shehidët e Idlibit (luftëtarët e opozitës dhe popullata civile që u ndihmon) nën numrin 662. Grupi i fundit përmban pjesëtarë të ISIL-it dhe luftëtarë tjerë islamik (Sterlin 2015b). Në këtë listë të të dhënave për Idlib, VDC i barazon kryengritësit e armatosur me civilët, që është një praktikë e zakonshme e islamistëve që nga fillimi i konfliktit. Këto dy NVO-të nuk u bënë të kooptuar gjatë krizës siriane. Edhe pse asnjërin prej tyre nuk e financon qeveria e SHBA, ata me atë kanë vënë shumë lidhje të ngushta. Human Rights Watch (HRW) financohet prej fondacioneve të ndryshme, kryesisht prej atyre amerikane. Raportet mbi Lindjen e afërme që i publikon HRW shpesh mbështeten, që po shtu pranon haptas, garancitë që i merr fondacioneve pro-izraelite, e formuar si organizatë ‘private’ amerikane më 1978. Me fokus për luftë të ftohtë dhe të drejta njerëzore në ish Bashkimin sovjetik, këshilli drejtues HRW -së vë lidhje të ngushta me Këshillin për marrëdhënie ndërkombëtare - Council on Foreign Relations (CFR) ku janë emrat më të njohur të politikës së jashtme amerikane. HRW po shtu i ka ‘shputat’ e veta thellë në ministrinë e punëve të jashtme amerikane dhe u bë protagonist udhëheqës dhe mbrojtës i idesë për intervenim ushtarak të Amerikës në parim të mbrojtjes së të drejtave njerëzore. CFR në vitin 2000 paraqiti raportin për ‘tre opsione’ i cili i referohej ‘intervenimit humanitar’ i përgatitur për kryetarin Bill Clinton.

Kërkesa më e fortë për intervenim me qëllim të pengimit të krimeve të rënda erdhi nga ministria e punëve të jashtme (State Departament), por atë dokument e kishte shkruar Holly Burkhalter, ish drejtoresha e Human rights Watch, Burkhalter ofroi argumente me të cilat u përpoq ta bind administratën amerikane se duhet ta marr përsipër ‘udhëheqjen morale’ dhe të intervenojë ushtarakisht kudo qoftë në botë në mënyrë që të pengojë në botë kryerjen e ‘gjenocidit dhe krimit kundër njerëzimit’. Kjo ide i pëlqeu vetë-perceptimit amerikan mbi veçantinë e vet, që nënkupton se SHBA në një farë mënyre janë lideri moral i botës. Propozimet dhe këshillat që vijnë nga ministria e mbrojtjes, Pentagonit dhe Komandat e përbashkëta të ushtrisë amerikane janë shumë të përmbajtur, të cilët konsiderojnë se çdo intervenim amerikan patjetër duhet të jetë e lidhur ngushtë me mbrojtjen e interesave nacionale amerikane (CFR 2000). Pozita e fundit është konzistente me doktrinën tradicionale ushtarake që nënkupton shmangien e luftërave të pafundme që s’mund t’u parashihet rezultati. Në Amerikën Latine, pastaj, HRW ka qenë ‘shumë i pandjeshëm’ kur është në pyetje çështja e cenimit të të drejtave njerëzore nga ana e regjimeve lojale ndaj SHBA-ve, sikur ai në Kolumbi, që është më i njohur për cenimin më flagrant të të drejtave njerëzore të qytetarëve të vet në mbarë kontinentin. Derisa HRW hesht për cenimin e të drejtave njerëzore në Kolumbi, është shumë zëfortë dhe nuk nguron të sulmoj qeverinë e të ndjeri Hugoa Chavezit në Venezuelë. HRW gjithnjë ka patur agjendën e vet politike. Sipas Jose Miguel Vivanco, drejtorit të degës të HRW-së për Amerikën veriore dhe jugore, nga kjo organizatë në Venezuelë që është publikuar në dhjetorë të viti 2008 dhe i që mban emrin (Dekada nën pushtetin e Chavezit), është nxjerrë: ‘për t’i treguar botës se Venezuela nuk është model për askënd në botë’. Ky raport kritikoi më se njëqind akademikë sipas manisë së tij sepse nuk i mori parasysh bile ‘as standardet më të ulëta që përdorten në hulumtimet shkencore, pastaj për shkak të mos objektivitetit, moskujdesit e moskredibilitetit të tij’ (Acuna et al 2008). Ajo që më së shumti e ka komprometuar këtë organizatë është donacioni prej 100 mijë dollarësh amerikan të cilët HRW më 2010 i pranoi nga miliarder i Xhorxh Sorosh, që

njihet si përkrahësi i madh i Izraelit (HRW 2010). Ky lloj sponsorimi gjithnjë nënkupton obligimin e kundër shërbimit (quid pro quo). Pasi që u konstatua se disa drejtorë dhe këshilltarë të HRW-së morën punë në ministrinë e punëve të jashtme të Amerikës ose e kundërta, një grup lauratësh të shpërblimit Nobel e akuzoi Human Rights Watch se aq shumë është shkrire në administratën amerikane sa që është e pamundur t'i dallosh (Alternet 2014). Megjithatë, HRW këto kritika aspak nuk i merr parasysh. Sikur Human rights Watch as Amnesty s'u kundërvihet intervenimeve ushtarake perëndimore nëse ato janë të themeluara në principet e mbrojtjes së të drejtave njerëzore dhe të drejtës ndërkombëtare. Në vend të kundërshtimit, kjo organizatë u ofron shërbime këshillimore fuqive të mëdha si realizojnë intervenimet e sipërpërmendura. Nëse fuqitë e mëdha 'analizojnë dërgimin e armëve elementeve joqeveritare dhe grupeve të armatosura në Siri, në atë rast së pari duhet zbatuar vlerën rigoroze të rrezikut sa u përket cenimit të të drejtave njerëzore dhe duhet venduar një mekanizëm serioz që do të udhëheq me procesin e monitoringut', pohojnë nga Amnesty -a. Kjo në të vërtetë është një muzikë që dëshirojnë ta dëgjojnë fuqitë imperiale. Megjithatë, sipas të drejtës ndërkombëtare dhënia e armëve në dorë grupeve joqeveritare nuk është e lejuar, emos të flasim për sulm ndaj shtetit të pranuar (Sterling 2015b). Amnesty, në realitet, u shndërrua në konsulent e politikanëve në Vashington e cila jep instruksione se si me lustrën mbi mbrojtjen e të drejtave njerëzore lyejnë intervenimet e veta ilegale ushtarake.

Për turp, Amnesty gjatë këtyre pak viteve të kaluara, i krijoi vetes një pasqyrë si një organizatë që është e gatshme t'i përmbajë okupimet ushtarake që janë kryer në bazë të justifikimeve të rrejshme. Para vet luftës së parë të Gjirit (1990-1991) Amnesty e zgjati rrëfimin për një vajzë të re e cila pohoi se ushtria irakiane i vjedh inkubatorët prej spitaleve duke i lënë fëmijët e sapolindur të vdesin nëpër dyshemetë e një spitali të Kuvajtit. Më vonë u vërtetua se bëhej fjalë për një rrëfim të trilluar dhe se autore e rrenave ishte vajza e ambasadorit të Kuvajtit (Stauber dhe Rampton 2002; Regan 2002. Para vet bombardimeve të NATO-s

në Libi më 2011, Amnesty mori pjesë në përhapjen re rrenave se si lideri i Libisë, Gaddafi ka shfrytëzuar ‘mercenarët zezakë’ të cilët kanë bërë masakra në civilët libian. Pasi Libia u shndërrua në gërmadha, ndërsa Gaddafi u vra, kryetarja e degës së Amnesty-s (për Francën), Genevieve Garrigos, pranoi se nuk kishte dëshmi me të cilat do të mund të mbulohej ky pohim (Truth Syria 2012). Amnesty-a në Vitin 2012, mori shumë kritika të ashpra prej fushatës përmes pllakateve gjigante ku shkruante : ‘NATO ndihmon përparimin’ në Afganistan. Referimi për ‘progres’ gjoja se i referohej përparimit të të drejtave të gruas në okupimin e forcave të NATO-s. Është fakt i pamohueshëm se një dekadë pas invazionit amerikan në Afganistan gjendja e arsimimit dhe shëndetësisë të popullatës femërore ende vazhdon të jetë në një nivel trishtues. Nuk ka prej okupatorëve të huaj ushtarakë që zhvillojnë shëndetësinë dhe arsimimin, dhe veçanërisht në demokraci.

Autorja e fushatës të sipërpërmendur lidhur me Afganistanin ‘NATO: zhvillon progres’ ishte Suzanne Nossel, drejtoreshë ekzekutuese e degës amerikane të Amnesty-se cila në këtë pozitë erdhi shumë lehtë ministria e punëve të jashtme të Amerikës. Nossel në State Departament ishte e angazhuar për formulimin e politikës të SHBA-ve ngdaj Rusisë, Iranit, Libisë dhe Sirisë (Teil 2012:146). Wright dhe Rowley (2012) erdhën deri në përfundim se Amnesty, në realitet, lobon për luftat amerikane nën maskën e gjoja objektivitetit dhe brengës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Kjo organizatë ka rrënuar autoritetin e vet duke u shërbyer me një strategji të ngjashme me atë të Human Rights Watch duke mikluar dhe shërbyer State Departament-in. Të ashtuquajturat mediat ‘liberale’ në mënyrën e vet janë bërë komponentë përbërëse e planeve të luftës. Edhe pse raportet e shtëpive mediatike siç janë BBS, Guardian dhe New York Times meritojnë një rishikim kritik të kujdesshëm për shkak të marrëdhënieve konzistente antagoniste ndaj Sirisë, nuk është vështirë të kuptosh se për ç’arsye Al-Xhezira aq është komprometua. Pronari i kryesor i këtyre kanaleve është monarkia e Katarit, e cila i ka financuar dhe armatosur grupet e lidhura me Al-Kaidën në Libi dhe Siri, ndërsa

veçanërisht ato fraksione të afërta me Vëllazërinë muslimane (Kirkpatrick 2014). Një analist britanike-irakian vëren se ‘sundimtarët e Katarit në Al-Xhezirën kanë hasur një instrument për përhapjen e influencës së tyre politike... (si) u bë Katari seli e operacioneve ushtarake amerikane në mbarë Lindjen e afërme. Al-Xhezira vlen si një prej burimeve themelore të përhapjes së frikës për gjoja kërcënimet sektare që përgjojnë prej ndikimit iranian dhe shiit në rajon (Ramadani 2012). Ajo pak pavarësi që e tregon ky rrjet televiziv gjatë kohës së invazionit amerikan në Irak në vitin 2003, është çështje e së kaluarës.

Kur erdhi deri te konflikti në Siri dhe Egjipt erdhi deri te një eksodi i madh i gazetarëve të Al-Xhezirës që një numër i madh prej tyre dhanë dorëheqje duke cekur si arsye përzierjen e stafit udhëheqës në politikën redaktuese të kësaj organizate mediatike. Shefi i byrosë së Al-Xhezirës në Bejrut, Gassan bin Xhedd e lëshoi këtë shtëpi mediatike pas shpërthimit të luftës në Siri, duke treguar se si Al-Xhezira u lejoi qasje ‘atyre musafirëve nga SHBA-ja që janë të gatshëm të kritikojnë regjimin në Siri dhe të cilët, në të njëjtën kohë, janë të gatshëm ta përkrahin regjimin në Bahrejn madje ata analistë që përkrahin NATO-n. Kjo është e papranueshme. ‘Më vonë menaxheri kryesor i kësaj byroje; Hassan Sha’ban gjithashtu dha dorëheqje duke thënë se Al-Xhezira nuk proanoi të transmetojë fotografitë që i pranoi e që përmbanin imazhe të ‘luftëtarëve të armatosur të cilët u ndeshën me ushtrinë e Sirirsë në vendin e quajtur Vadi Halid’, Rrjeti e akuzoi se është pjesëtar i grupit ‘sabiha’, formacion paraushtarak i regjimit sirian. Gazetari Afshin Rattansi gjithashtu u shpreh se kjo shtëpi mediatike është bërë e anësishtme në informim, ndërkaq Ted Rall tregon se si kolumnet e tij refuzoheshin në mënyrë sistematike sa herë që i dërgonte për publikim (RT 2012). Korrespondenti nga Bejruti, Ali Hashim, po ashtu dha dorëheqje. Al-Xhezira në Egjipt i humbi 22 gazetarë të vet për shkak të kërkesave të një anëshme të stafit udhëheqës që më nuk mund të duroheshin. Gazetarëve të Al-Xhezirës u është dhënë urdhër të informojnë në dobi të regjimit të rrëzuar të Vëllazërisë muslimane. Në shenjë hakmarrje, regjimi i ri ushtarak i Egjiptit e shpalli Al -Xheziren ‘armik të Egjiptit’.

Gjatë viti 2015, kur forcat perëndimore dhe aleatët e tyre, monarkitë nga Gjiri Arabik u përpoqën që përçarjen imagjinare midis grupeve terroriste dhe ‘kryengritësve të matur’ tua paraqesin gazetarëve të vërtetë të Al-Xhezirës, kur ishte fjala për organizatën terroriste Xhebbetu-Nusra (dega zyrtare e Al-Kaidës në Sir, e cila në shumë vende të botës është e nadaluar si organizatë terroriste e Al-Kaidës, një dokument intern që ua dërgoi producenti ekzekutiv, Kelly Jarrett, gazetarëve të Al-Xhezires ku urdhëronte me sa vijon:

‘Ju lutem mos ta përshkruani fronti En-Nusra si një organizatë që ka lidhje me Al-Kaidën’. Lufta e Sirisë është e komplikuar... Realiteti është se Al-Kaida nuk është më e njëjta organizatë që ka qenë më parë dhe prandaj kjo në këtë kontekst është irelevante. Fronti An-Nusra është një pjesë e koalicionit të kryengritësve sirianë që e përbëjnë grupe të ndryshme të armatosura... është e nevojshme që shikuesit tonë ta kuptojnë se këto grupe të armatosura formojnë opozitën kryesore të qeverisë që e drejton kryetari Asad’ (MEE: 2015a). Në lidhje me këtë deklaratë nuk ka pasur asnjë kundërshtim sepse të gjithë ata që ishin të mendimit për një objektivitet redaktues të këtij TV kanalit, që me kohë e kishin lëshuar këtë redaksi’ (5 Pillars 2015). Charlie Winter, analist i fondacionit Quilliam, tha se ky ndryshim ‘është pjesë e krejt procesit normalizues të cilin Al-Kaida në Siri e kishte planifikuar të zbatojë që kohë më parë... Kjo organizatë përpiket ta ndryshojë imazhin e vet në mënyrë që të jetë e pranuar për Perëndimin’ (MEE:2015a).

7.2 Teknikat e bindjes

Edhe pjesa më e madhe e mediave perëndimore si ato qeveritare-publike ashtu edhe ato të korporatave, mbështetin çdo luftë të re. ndërsa mediat liberale veçanërisht janë zjarretë kur është fjala për rolin ‘shpëtimtar’ të luftës misionare ose ‘humanitare’. Shumë teknika të tyre propaganduese përafërsisht janë konvencionale. Para së gjithash ata bëhen të një anshëm në mënyrë të tmerrshme, ata i paraqesin humanë ‘luftëtarët e lirisë’ në anën tonë, demonizojnë palën tjetër, mbajë shumë llogari të mos lejojnë të

dëgjohej versioni tjetër i ngjarjes, ose të forcohet versioni zyrtar i luftës. Kah fundi i vitit 2015 BBS, plotë katër vite pas fillimit të luftës në Siri, vazhdimisht përsëriste disa konstatime të rrejshme për shkakun historik të konfliktit në Siri. Së pari pohoi se konflikti shpërtheu sepse ushtria siriane hapi zjarr ndaj protestuesve të paarmatosur, ndërsa pastaj ‘simpatizuesit e opozitës filluan t’i marrin armët në duart e veta, së pari për t’u mbrojtur, pastaj për t’i larguar forcat e sigurimit nga bashkësitë e tyre lokale’ (BBS 2015b). Megjithatë e vërteta është ndryshe. Sauditët pranuan një vit para se të shpërthente konflikti se i kanë armatosur pjesëtarët e kryengritje së armatosur në vendin e quajtur Daraa që nga fillimi i krizës, në mars të viti 2011. Kanali i BBS-së ‘histori’ gjithashtu pohon se Turqia, Arabia saudite dhe Katari e përkrahin atë pjesë të opozitës ku dominojnë grupet kryengritëse sunitë të matura’ (BBS 2015b). Ndërsa vetëm një vit para kësaj nënkryetari amerikan Joe Biden dhe komandanti i forcave të armatosura amerikane Martin Dempsey pranuan publikisht se aleatët rajonal amerikanë, Turqia, Arabia saudite dhe Katari i financojnë të gjitha grupet ekstreme, përfshirë edhe ISIL-in... T’i barazosh grupet e Al-Kaidës me ‘sunitët e matur (përmbajtur)’ jo që është një qasje e anësishme e informimit të BBS-së, por është edhe përhapje me qëllim e dezinformimit. Të shohim disa prej shembujve më të dalluar të asaj strategjie. Në disa muajt e parë të krizës, më 2012, kur ushtria siriane luftonte kundër brigadave islame Faruk (FSA) në qytetin Hums, u paraqitën disa reportazhe, për një djalosh me nënshtetësi të dyfishtë britanike-siriane i quajtur Danny Abdul-Daim, të cilat u popullarizuan në kanalet e CCN, Sky News dhe El-Arabijje. Danny pohon se si në bombardimin e Humsit në mënyrë masive humbin jetë civilët. Ai tregon se ka qenë në Hums dhe me sytë e vetë e ka parë se si me qindra civilë vriten rrugëve të atij qyteti. Video materialet vërtetojnë se në realitet bëhet fjalë për një sharlatan të thjeshtë që vet trilloi këtë ngjarje, duke përfshirë këtu edhe të gjitha efektet e zërit që janë prodhuar në Studio në bashkëpunim me grupet e armatosura (SzrianWorldvide 2012; Emassia, Kelence. Kardous dhe el-Kadri 2012).

Një numër i konsiderueshëm i gazetarëve perëndimorë, pasi që u tha atyre se grupet islamike me disponim miqësor ‘luftëtarë për liri’, kanë hyrë në mënyrë ilegale në Siri për ta incizuar tregimin e vet, që më pastaj të kidnapohen nga ana e islamikëve e të gjenden përpara goditjes së zjarrit të ushtrisë siriane. Një grupit si ky, të përbërë nga psë veta i priu gazetari i NBC- së, Richard Engeli, i cili u kidnapua në dhjetor të vitit 2012. Informacionet e NBC-së që pasuan më vonë vërtetojnë se Engelin dhe shokët e tij i kanë zënë peng pjesëtarët e milicisë shiite të afërta me Asadin dhe Hizbull-llahu. Engeli ofroi një përshkrim të detajizuar mbi atë se si kindapusi ‘pro Asad’ i kanë ‘keqtrajtuar gazetarët ndërsa shoferin e Ushtrisë së lirë siriane e vranë, para se ta shpëtonin atë kryengritësit e armatosur sirianë. Disa vite më vonë, New York Times bisedoi me disa njerëz, pas së cilës bisedo solli përfundim se ‘Grupin e Engelit, sipas të gjitha gjasave i zunë rob kriminelët sunit, të afërt me Ushtrinë e lirë siriane (somaiya, Chiver dhe Shoumali 2015). Më vonë u konstatua se udhëheqësit e NBC-së e morën vesht të vërtetën menjëherë pas aktit të kidnapimit të Engelit dhe grupit të tij (Gharib 2015). Raporti i New York Times -it për këtë rast e detyruan Engelin të riraportoje ku solli përfundim se ai besoi se kindapuesit e tij kanë qenë ‘kryengritësit sunitë’ të cilët u fshehën në ‘pjesëtarët milicisë shiite Shabiha’ (Somaiya, Chivers dhe Shoumali 2015). NBC-ja këtë kthesë thjeshtë e karakterizoi si ‘një detal i ri’ dhe ‘shtojcë e tregimit origjinal’ (Engel 2015). Megjithatë, nga pikëpamja e propagandës ky tregim më vonë përjetoi ndryshim total, por kjo ndodhi vetëm atëherë kur trillimi u zbulua dhe u publikua.

BBS shkoi një hap më parë nga përsëritja e thjeshtë të prapavijës të rejsme të konfliktit. Britaniku Robert Stuart u përplas me BBS për shkak të dokumentareve që i transmetoi më 30 shtator të vitit 2013 me titull ‘Shpëtimi i fëmijëve sirianë’, i cili pohoi se qeveria siriane me mjete të zjarra bombardoi një shkollë duke përdorur ‘napalm’ ose armë kimike. Kjo ngjarje ndodhi në kontekst të presionit intensiv ndërkombëtar, ku administrata amerikane u përpoq ta akuzoj rrejtshëm qeverinë siriane për përdorim të armëve kimike (shih Chapter Nine). Thuhet se ky ‘sulm ndaj

shkollës' është kryer më 26 gusht të vitit 2013 në para lagjen Umml-Kubra, në qytetin Halep. BBS me këtë rast e keqpërdori doktoreshën e spikatur antisirian, Rolau Hallam, identiteti i së cilës nuk është zbulua në raportin e BBS-së. Por këtu nuk ka të bëjë vetëm me raportin i cili është sajuar në bazë të burimeve komprometuese të një anshme. Video-incizimi kishte'incizuar stafin e BBS-së dhe të tjerë në një spital të afërt'. Stuarti prezantoi material të dokumentuar me të cilin vërtetoi se video-incizimi 'në pjesëm më të madhe ose tërësisht është i fabrikuar- trilluar'. Kjo do të thotë se me këtë BBS-ja ka luajtur një rol aktiv në fabrikimin e dëshmive. Ekspertët që e kanë kontaktuar Stuartin bënë një pasqyrë arbitrare të incizimit dhe erdhën deri te përfundimi se, në të vërtetë, aspak nuk ka të bëjë me djegien e viktimave. Audio-incizimi i doktoreshës Hallam (që mbante maskë kirurgjike) është redaktuar dhe ndryshuar në disa versione të ndryshme. Stuarti (2013,2015) publikoi një katalog të tërë të dëshmive në internet në lidhje me këtë fabrikim. Arriti të sigurojë disa mirënjohje të pakënaqshme prej disa strukturave brenda sektorëve për akuza të BBS-së, por BBS-ja nuk ngurroi të pranojë zyrtarisht dhe të publikojë demante të raporteve të tij (Stuart 2015).

Natyrisht, në shumë raste, BBS dhe mediat tjera, thjeshtë përsëritin dhe në atë mënyrë fshihen pas gënjeshtrave që i sajojnë burimet e tyre të anësishme. Duke shfrytëzuar të njëjtat burime islame, veçanërisht observatoriumin sirian për të drejta njerëzore (SOHR) me seli në Londër, BBS-ja rregullisht përsërit pohimet për atë se sulmet ndaj islamistve janë të njëjta si ato ndaj civilëve. 'Dhjetra' civilë janë vrarë në Ghoutën veriore, 'theksojnë aktivistët' (BBS 2015a). Me ç'rast, BBS aspak nuk flet për evakuimin e madh të disa mijëra civilëve prej atij vendi, por që disa muaj më parë shihej në video-incizimet (SANA 2015). Eric Zuesse (2015) thekson se krejt këto gënjeshtra që i përhap BBS-ja janë të orientuar drejt asaj se si për luftën e Al-Kaidës dhe ISIL të akuzohet kryetari Asad, si dhe për të gjitha viktimat që ranë në luftën e ndytë kundër Sirisë. Mediat australiane ndoqën aty-këtu të njëjtin shabllon të BBS-së, krahas tregimeve të shtuara mbi sulmet me fuçi-bomba 'barrel bomba' në Ghoutën Veriore, territor të cilin e kontrollon Xhebhethun-

Nusra dhe Fronti islamik më se dy vjet dhe që shfrytëzohet si bazë granatimi me minahedhëse ndaj Damaskut. Sulmet e armatës siriane në këtë territor është prezantuar si indiskriminuese dhe si masakër e qëllimshme ndaj banorëve civilë, me ç'rast shfrytëzohen video-materialet e mbledhura që kanë prodhuar grupet kryengritëse të armatosura. Për shembull, korporata mediatike australiane (ABC) në gusht të viti 2015 transmetoi një raport ku pohohet se në sulmet ajrore në Doum janë vrarë midis 80 e 100 civilë. Autore e këtij raporti të ABC-së, thuhet se ka qenë 'Korrespondentja e Lindjes së afërme dhe e agjencisë, Sophie McNeil, por burimet në bazë të cilëve është formuar ky raport, kryesisht janë simpatizuesit islamikë, sidomos SOHR-i i Londrës. Qëllimi i këtyre dezinformacioneve është shumë i qartë, ashtu si McNeil strukton në hyrjen e vet raportet e veta, duke bërë apel për intervenim më serioz të perëndimit në Siri: 'sa më shumë perëndimi të ngurrojë të ndërmarrë aksion kundër qeverisë së Asadit, Shteti islam gjithnjë e më tepër do të forcohet (McNeil 2015).

Si në rastin e televizionit shtetëror, kanalit të BBS-së, i njëjti rast është edhe me korporatat mediatike australiane, ata thjesht përsëritin pohimet e Shtëpisë së bardhë lidhur me atë se si 'Asadi i ka mbytur fëmijët me armë kimike' duke mos marrë parasysh mungesën e dëshmimeve, ndërsa ndonjë herë edhe vet i fabrikonin 'dëshmitë' e veta. Për shembull, Rick Morton i cili punon për gazetën Australian, pronar i së cilës është Rupert Murdoch, në janar të vitit 2014 pohoi se 'një raport i KB-së përmban dëshmi të besueshme se regjimi sirian është në gjendje të kryej sulm me armë kimike dhe që kjo mund të dokumentohet (Morton 2014). Megjithatë e vërteta është se shumica e raporteve të KB-së në atë kohë këtë aspak nuk e përmendnin. Mortoni a e bëri këtë nga përtacia ose me qëllim, i ka ngatërruar raportet e Shtëpisë së bardhë me raportet e KB-së. Raporti i KB-së që daton prej dhjetorit 2013 aspak nuk ia hedh fajin regjimit të Asadit për pesë sulmet kimike në Siri, por theksoi se dy sulme të këtilla janë kryer 'kundër ushtarëve' ndërsa tjetri 'kundër ushtarëve dhe civilëve'. Kjo shumë qartë tregon se sulmet e sipërpërmendura janë kryer nga ana e armikut të ushtrisë siriane (KB 2013: 18-21).

Disa raporte të më hershme mediatike tregojnë se Xhebbhetun-Nusra e kishte në pronësi gazin sarin (shih kapitullin 9). Shumë gazetarë vazhdonin me përsëritjen e versionit për këto sulme që i përhapin Shtëpia e bardhë në Vashington, madje edhe pasi që ekspertët amerikan deklaruan se raketat që kanë rënë në Gautën lindore, dhe të cilave u është bërë një analizë, nuk kanë mundur të lëshohen prej pozitive që i kontrollojnë forcat e qeverisë siriane, ashtu siç e përmendi këtë edhe Shtëpia e bardhë (Lloyd dhe Postol 2014). Dy vjet më vonë, dy deputetë të opozitës parlamentare turke kërkuar hetimin e akuzës për atë se qeveria e Turqisë grupeve islamike u ka siguruar gazin sirian që është shfrytëzuar në atë incident (Today's Zaman 2015).

Në një rrëfim krejtësisht të keq BBS-ja ka marrë pjesë përpjekjen për të fshehur vrasjen e shejh Ramadan Butit, dijetarit më të njohur e më të madh islam të Sirisë, që ndodhi në mars të vitit 2013. Ky teolog i njohur islam që ka qenë i njohur për animin e tij kah pluralizmi i përmbajtur dhe për sa u përket çështjeve fetare haptas ka folur kundër ekstremizmit islamik të dhunshëm dhe sektarizmit. Për shkak të kundërshtimit të ekstremizmit, islamistët dhe sponsorët e tyre në mediat perëndimore e quajtën 'hoxha i Asadit' (Mourteda dhe Gladstone 2013). Xhebbhetun-Nusra i kërcënua se do ta vras, gjë që edhe e bënë, pas këtij akti, si e kishte traditë kjo organizatë ekstremiste, për vrasje e tij e akuzuan qeverinë siriane. Nusra e vendoi mjetin eksplodues në xhami të Damaskut, ku shejh Buti mbanet ligjerata, ku e varën atë dhe 40 besimtarë (Mourteda dhe Gladstone). 2013). Pas kësaj, në rrjetet shoqërore u nis një fushatë e rrejshme që e përhapën islamistët, ide të cilën më vonë e mori mbi vete dhe zmadhoi gazetari i BBS-së Xhim Muir i cili pohoi se 'nuk mund të merret me mend se një eksplodim aq i vogël të bëjë aq shumë dëm dhe të mbyllet afër 50 njerëz, siç informuan mediat shtetërore', duke treguar incizimin ku shihet se el-Buti nuk vdiq përnjëherë. Me këtë dëshirë të thotë se sulmi ndaj shejh el-Butit i fabrikuar e që më pastaj këtë e shfrytëzoi qeveria siriane si mbulesë për vrasjen e shejhut-dijetarit dhe ithtarëve të tij (Muir 2013). Kjo natyrisht se ishte një gënjeshtër flagrante. Më vonë, po në të njëjtin vit, pesë terroristë

u burgosën dhe pas kësaj pranuan në televizionin sirian se kanë kryer atentat ndaj shejh el-Butit, duke sjell detaje të atij akti terrorist. Njëri prej tyre deklaroi se u është dhënë urdhër për vrasjen e tij përmes fetvasë që e dha organi ligjdhënës i en-Nusra, pasi që shejhu në një rast ‘kritikoi haptas operacionet e en-Nusra ndaj Sirirsë’ (syrian el- Ihbar 2013). Dhënia e një fetvaje të veçantë (urdhrit fetar) gjoja se ka qenë e patjetërsueshme para se të merrnin guximin t’i sulmojnë muslimanët në xhami. Pas këtij pranimi publik, as gazetari Xhim Muir as punëdhënësi i tij BBS nuk i hodhën poshtë akuzat e hershme dhe versionin e ngjarjes. Gjithashtu është me rëndësi të kihet kujdes, se Britania mu në atë moment ofroi një ndihmë të konsiderueshme materiale grupeve të armatosura në Siri, përfshirë këtu edhe të ashtuquajturve ‘kryengritësve të përmbajtur’ të cilët kanë bashkëpunuar afër njëri-tjetrit me Xhebhete-Nusrën (Hopkins 2014). Në këtë mënyrë BBS-ja praktikisht u bë pjesëmarrëse e këtij grupi kriminal. Një sërë tregimesh që janë përhapur me mjetet perëndimore të informimit, ishte përpjekje e trilluar që terroristët i përkrahte perëndimi në një farë mënyre të humanizohen, por në të njëjtën kohë, të dehumanizohen pjesëtarët e ushtrisë siriane të cilët janë të etiketuar me etiketën ‘Lojalistët e Asadit’, në vend që të quhen qytetarë që janë rreshtuar në mbrojtje të vendit të vet. Në nëntor të viti 2013 mediat australiane publikuan një titull ‘bombarduesi vetëvrasës nga Brisbani shpërtheu në Siri’ (Kryriacou dhe Mc Kenna 2013). Aspak nuk përmendej lidhur me atë se kush janë ata 35 sirianë për të cilët thuhet se janë vrarë në këtë sulm vetëvrasës. Në mars të vitit 2014 mediat britanike në të njëjtën mënyrë lajmëruan për Abdul-Vahid Maxhidin, vetëvrasësin me prejardhje prej Pakistani dhe Britanie i cili e aktivizoi një kamion të mbushur me eksploziv, i cili atë kamion të blinduar e solli deri te pozita e ushtrisë siriane në Halep e pastaj e çoi në ajër. Babai i tre fëmijë i moshës dyzetë vjeçare është paraqitur se si u ndanë fëmijëve ëmbëlsira, ndërsa raporti i BBS-së në mënyrë të veçantë e theksoi deklaratën e vëllait të tij, Hafizit në lidhje me atë, ku deklaroi ‘vëllai im s’ka qenë terrorist - ai është hero’ (Casciani 2014). BBS e heshti faktin se kush ka qenë hero i vërtetë, ky apo një ushtar

sirian, Muhamme Rexheb, i cili humbi jetën duke u munduar ta ndalojë një kamion-bombë me minahedhës dore (Syrian Lioness 2014). Po ashtu në dhjetor të vitit 2015 gazeta britanike Independent publikoi lajmin e detajuar mbi ‘vetëvrasësin e ri nga Uzbekistani i cili e incizoi si thërret parulla para se ta kryej misionin e vet të fundit në Siri’. Në incizim shihej se ishte fizikisht i shqetësuar, gjithashtu shihej se si shokët e tij militantë, deri sa ai qante para se të nisej në misionin e tij të fundit vetëvrasës’, njëri prej shokëve iu drejtua : ‘Xhefer, vëllai im, mos u frikëso. Nëse të merr frika, kujtoje All-llahun’. Në çka ky u përgjigj: “ Kam frikë vetëm mos të dështoj” dhe pas kësaj u dërgua në vdekjen e vet’ (Eleftheriou-Smith 2015). Në këtë raport nuk është përmendur asnjë fjalë e vetme për qytetarët e Sirisë se kush janë këta terroristë të huaj. Për mediat raciste perëndimore qytetarët e Sirisë u bënë ‘jo njerëz’. Hulumtuesit e kooptuar po ashtu janë angazhuar sesi t’i paraqesin këta vrasës sektar ‘të përmbajtur’ Në janar të vitit 2012, gazeta Foreign Affairs (gazetë e Këshillit amerikan për marrëdhënie të jashtme) publikoi një artikull që ishte themeluar për shqyrtim të ‘50 luftëtarëve islamikë nga grupi Ahrarush-Sham dhe frontit En-Nusra, krahas disa dijetarëve (shejhave) të fesë që ishin shkolluar në Arabinë saudite’. Ky raport insistoi të tregoi se si personat e sipërpërmendur, në realitet, angazhohen për vlera demokratike. Teksti është titulluar ‘Xhihadi demokratik sirian’, kurse mes titulli ishte ‘Pse luftëtarët e ISIL-it i përkrahin zgjedhjet. Në mënyrën klasike të të shprehurit e asaj që ata dëshirojnë të dëgjojnë, këta sektarë, famëkeq për nga prerja e kokave të jobesimtarëve krimet e të cilëve i shfaqin qartë video-shkrimet, ’u pajtuan’ se ‘demokracia është forma më dëshirueshme e regjimit. Autorët e kësaj ankete vërejnë se si deklarata e tyre është në kontradiktë me proklamimin e qëllimeve të formimit të halifatit islam’, por kjo nuk u pengoi të konkludojnë se si këto banda arritën të përfaqësojnë një lloj ardhmërie demokratike të Sirisë (mironova, Mri, Nielsen dhe Whitt 2015. Çfarë ofendimi është kz për inteligjencien njerëzore. Ky tregim dhe të ngjashëm me të janë konzistentë me një trend të përgjithshëm me të cilën u bë përpjekje për ndryshimin e imazhit dhe humanizmin e Al-Kaidës. Pasi që brigada Hazim që e

armatosën SHBA-të iku dhe armët ia dorëzoi Xhebbhetun-Nusra-së (përfshirë këtu edhe mjetet anti-tankeve (Sherlock 2014), ideja mbi forcën e vetme kryengritëse ‘të përmbajtur’, nuk ishte i qëndrueshëm në publik. Ashtu që kah fillimi i vitit 2015 u bënë përpjekje të reja që Xhebbhetun-Nusra si milicia më fortë e armatosur antiqeveritare në Siri, pas ISIL -it të rehabilitohet. Edhe pse ky grup gjatë kohë konsiderohej dega ‘zyrtare’ Al-Kaidës në Siri, të gjitha këto etiketa mund të riformulohen në aspekt mediatik. Maram Susli (2015) tregon një artikull të New York Times- it i cili pohon se Xhebbhetun-Nusra ka mundur t’i ndërpres lidhjet e veta të deriatëhershme me Al-Kaidën me shpresë të sigurojë më shumë ndihmë ushtarake’, ndërsa Rojteri publikoi që ky veprim asaj mund t’i sigurojë ‘përkrahje më të madhe nga vendet e Gjirit arabik të cilët kanë disponim armiqësor edhe ndaj Asadit por edhe ndaj Shtetit islam’. BBS-në kjo e shpiu një hap përpara, sipas mendimit të Dr. David Roberts, i cili theksoi se armatosja e En-Nusra-së nga ana e Katarit ‘mbase edhe nuk është ide e keqe’, duke mos përmendur shpëputjen e lidhjeve me Al-Kaidën. Roberts beson se marrë parasysh ‘rezistencën e ISIS-it dhe forcave të Bashar el-Asadit, Përfundimi do të duhej të përshëndet krijimin e një formacioni ushtarak të reformuar efektiv... Plani i Katarit është i realizueshëm si çdo tjetër’ (Roberts 2015). Asnjë shtet s’do të ishte në gjendje të zhvillojë një lutë të atillë të ndytë pa përkrahjen e mediave servile që i ndihmojnë asaj në këtë. Nga nna tjetër, megjithatë, disa organizata të vogla aktive përfundimore u munduan me durim t’i ndjekin dhe dokumentojnë trillimet mediatike lidhur me luftën në Siri. Organizata amerikane FAIR (Sinqeritet dhe saktësi e informimit mediatik) e cila është themeluar në vitin 1986 tregoi historikun e veprimit të CIA-s në Siri të cilën New York Times u mundua ta fsheh. Kur flet për gjoja shmangien e administratës obamiane që mos të përzihet drejtpërdrejt në konfliktin sirian- sjellja e qштуquajtur ‘hands off’ edhe pse përmend programin e pasuksesshëm të Pentagonit për stërvitje ‘të kryengritësve’, jo vetëm se me qëllim nuk e ka përmendur faktin që CIA prej vitit 2012 i ka armatosur, stërvitur dhe i ka financuar grupet kryengritës prej vitit 2012, ata pohojnë

se një gjë e tillë aspak nuk ka ngjarë’ (Johnson 2015). Shumë raporte më herët kishin vërtetuar se ka ekzistuar një program i ‘armatosjes, financimit dhe stërvitjes të forcave kundër Asadit’ në ujdishen e CIA-s e cila përgatiti afër 10.000 ‘luftëtarë kryengritës’ për të cilët u harxhuan afër një milion dollar në vit. (Johnson 2012).

Dy organizata britanike që u themeluan jo shumë herët, më sës shumti janë fokusuar në Siri: Media Lens të cilën e themeluan David Edverds dhe David Cromwell në vitin 2001 është fokusuar në analizën e luftërave që i kanë zhvilluar fuqitë e mëdha në Lindjen e afërme prej vitit të themelimit të organizatës. Ky grup ka prodhuar një sërë tekstesh serioze analitike, si artikulli i vlefshëm i David Edwards-it “dëshmi të kufizuara por të besueshme’ -Siria, Sarin, Libia, i cili i hedh një vështrim gjendjes mahnitëse të mendimit publik britanik mbi viktimat e invazionit në Irak (për të cilin me siguri ka merita mungesa e parimësisë të mediave britanike), manipulimi me informacione në lidhje me përdorimin e armëve kimike në Siri dhe rrenat që janë sajuar lidhur me Libinë dhe veçanërisht mbi domosdoshmërinë e gjoja ‘gjenocidit në Bengazi (Edward 2013).

‘Off Guardian’ është një iniciativë që merret me dezinformacione që i ka publikuar gazeta britanike Guardian, veçanërisht mbi tekstet në lidhje me Libinë dhe Sirinë, por edhe mbi krizën në Ukrainë. Rrëfimet e gazetës britanike Guardian lidhur me Sirinë të cilën e kanë analizuar në mënyrë kritike përmbajnë informata të rrejshme mbi ‘fuçi-bombat’ me të cilat fshihet natyra e vërtetë e grupeve ‘opozitare’, informime të anësishme mbi iniciativë ruse kundër terrorizmit në Siri dhe Irak, spiunimi pro-izraelit kur është fjala për informimin mbi Palestinën dhe përpjekje të pandërprera për të provokuar ‘intervenim humanitar’ në Siri (Off Guardian 2015). Kjo e fundit citon raportin Simon Jenkins ‘kërcet gishtërinjtë nga ndërgjegjja e vet’ për shkak të intervenimeve më të hershme katastrofale perëndimore (Guardian Watch 2015), e pastaj sërish preferon invazionin në lidhje me bombardimin: ‘Nëse ndonjëherë gjatë çerek shekullit të kaluar ka pasur arsye humanitare për intervenim me qëllim pacifizmi, riorganizimit dhe

vënien e një pushteti etik në një shtet të shkatërruar, definitivisht kjo është në rastin e Sirisë... nuk ekziston asnjë kurs moral, për sa i përket Sirisë, që do të mund të ishte më i qëlluar se sa dërgimi i trupave në atë vend (Jenkins 2015).

Vështrimi kritik e zhvesh tërësisht këtë iluzion të vjetër imperialist, duke konkluduar në formë të drejtë që ‘arsyet e sajura për intervenimin perëndimor janë të diskredituar dhe shpalosur deri në atë masë sa që nuk mund për to të thuhet asgjë të dobishme’ (Guardian Watch 2015). Megjithatë, këto disa organizata të thjeshta dhe disa analistë të vërtetë të pavarur, vështirë se mund t’i rrinë karshi makinerisë mediatike perëndimore, e cila në mënyrë sistematike merret me përhapjen e dezinformacioneve deri sa ta sjell punën te lufta.

7.3 ‘Lufta humanitare’ e NVO-së

Krahas organizatave të tipit Human Rights Watch dhe Amnesty International, erdhi deri te shumimi i një grumbulli të ri online të NVO-së me fokus të veçantë për luftë në Siri që financoheshin në SHBA. Helmetat e bardha, Fushata siriane, Zëri i lirë i Sirisë, Mozaiku i Sirisë, janë krijim edhe të një iniciative që e financon (Avaaz-i) i Xhorxh Soroshit dhe grupi ‘Qëllimi’ që është e lidhur me atë. Avaaz-i është themeluar në vitin 2007 si program i Res Publika-së për të cilin Xhorxh Soroshi në fillim ndau shumë prej një milion dollarë. Viteve të kaluara buxhet i tij u rrit për disa milion dollarë në vit dhe atë nga donatori identiteti i të cilit nuk është bërë publik (NGO Monitor 2013). Sekret për nga struktura e vet, karakteristika e përbashkët e Avaaz-it, me Re Publikom që e formoi grupi i Soroshit, janë lidhje të afërta me organizatat sioniste (ESB 2012). Duke u prezentuar si grup ‘aktivist’ dhe si grup për ‘të drejta njerëzore’, grupi i Avvaaz-it është i koncentruar në fushatat e interneti që merren me çështje ndërkombëtare siç është çështja e spikatur e marrëdhënieve të Palestinës dhe Izraelit. Kjo organizatë është kritike ndaj politikës së Izraelit ashtu që shumë sionistë ortodoksë Avaaz-in dhe Xhorxh Soroshin i konsiderojnë me orientim anti-izraelit (e.g, Rosenthal 2013). Por, konsideroj që Avaaz-in më mirë ta kuptojmë si ‘Sionizmi i majtë’,

gjegjesisht si një lloj drejtimi liberal proizraelit që do të paraqitet si lëvizje udhëheqëse për përkrahjen e të drejtave të palestinezëve dhe cili në të njëjtën kohë mundohet për ruajtjen e pjesës më të madhe të privilegjeve themelore rasore të cilat janë të vendosura në trungun e shtetit sionist. Avaaz-i në vitin 2011 publikoi një video-incizim ku vazhdimisht e kritikoi ashpër praktikën koloniale të vazhdimit në ndërtim ('të lagjeve të banuara'), dhe në të njëjtën kohë kritikon rezistencën palestineze ndaj okupimit izraelit me mjete të dhunshme duke promovuar një krijim të zgjidhjes paqësore në mënyrën e ekzistimit 'të dy shteteve' (Avaaz 2011). Izraelitët ndonjëherë ata qytetarë izraelit i quajnë 'vrasës që duke gjuajtur qajnë' (Landsmann 2011), por praktika e këtillë është në përputhshmëri me retorikën, edhe pse jo me praktikën, me të cilën shërbehet Vashingtoni. Duke i prezantuar hebrenjtë liberalë si avangardë që mundohen për çështjen palestineze sionistët e majtë s'janë më pak të ashpër ndaj rezistencës së armatosur palestineze dhe ndihmësve më të mëdhenj të tyre, Irani, Siria dhe Hizbull-llahu, se prej cilit do lloj tjetër të sionistëve. Marrë parasysh se sektarët islamikë nga radhët e Vëllezërve muslimaë dhe vehabistëve, të prirur nga natyra për përçarje, sionistët e ngjyrave të ndryshme gjithnjë janë të gatshëm t'i përkrahin kundër çfarë do lloji lëvizjeje ose qeverie nacionaliste arabe apo islame. Pikërisht nga kjo arsye vërejmë një simbiozë të qëndrueshme midis këtyre organizatave të reja dhe islamistëve. Avaaz-i gjatë tërë kohës e ka përmbajtur intervenimin ushtarak perëndimor (zonën e ndaluar të fluturimit) në Libi dhe Siri (Wadi 2015) që është kërkesa kryesore e grupeve të lidhura me Al-Kaidën. Disa nga përfaqësuesit e grupit Avaaz (Jeremy Hymans, David Madden dhe James Slezak) themeluan një lloj kompanie nënash, të cilën e quajtën 'Qëllimi', e cila më vonë themeloi shumë grupe më të vogla, interesi themelor i të cilëve ishte Siria (Morningstar 2015). Në realitet krejt këta janë fëmijët e Wall Street-it që kanë për qëllim të ndikojnë në opinionin publik dhe të cilët paraqiten rrejtshëm si sirianë duke arsyetuar atë lidhjeve të veta me grupet më të vogla të 'aktivistëve' islamikë, siç ishte fotografi Halid Hatib, që vpron drejtpërdrejt në radhët e grupeve të armatosura.

Pikërisht në këtë mënyrë sionistët e majtë kolaborojnë me islamistët në luftën e tyre kundër Sirisë shekullare.

Këta ‘humanitarë lufte’ të NVO-së janë të inkuadruar në disa lloje aktivitete por detyra e tyre kryesore është demonizimi i Asadit dhe i armatës siriane, dënimi i çdo veprimi i armatës siriane dhe agjitimi për krijimin e ‘non fly zone’, që është, siç dëshmon rasti i Libisë, një eufemizëm i thjeshtë për bombardim dhe përmbysje të regjimit. Fushata për Sirinë në qershor të vitit 2014 e alarmoi masën lidhur me fushatën zgjedhore të Bashar el Asadit (Sawa) e cila fitoi 200.000 ‘like’ ne Facebook. Arriti të bllokojë faqen hosting që e organizoi këtë (Rushe dhe Jalabi 2014), edhe pse në momentin e fundit (Ruble 2014).

Në fushatën e tyre për krijimin e ‘no fly zone’, Avaazi, Fushata siriane dhe Helmetat e bardha nuk i kushtuan kujdes të vërtetës as një fije më tepër se Human Rigts Watch. Avaazi pa asnjë dëshmi kredibile pohoi se gratë e Sirisë ‘ishin të detyruara të qëndrojnë para tankeve si mburojë njerëzore para se t’i zhvishnin dhe t’i dhunonin ushtarët sirianë (Avaaz 2013). Këto dezinformata janë përhapur në momentet kur opozitarët sirianë, sektarët islamikë që luftuan kundër armatës siriane, haptas e lavdëronin kidnapimin dhe dhunimin e grave të veta, vajzave dhe grave siriane, krimet që i lejuan me fetvatë e udhëhqësve të tyre pseudofetar. (Chumley 2013). Me helmetat e bardha, grupin poashtu të njohur si (mbrojtja qytetare e Sirisë) udhëheq James le Mesurier, pjesëtari i dikurshëm i ushtrisë britanike dhe mercenari Maslinaste i grupit (i cili u bashkua me Akademinë Blackwater me çka u krijua Constellis Holdings). Ky grup nuk zbulon burimet e financimit të tij por besohet se një pjesë e madhe e buxhetit të tyre vjen nga agjencia shtetërore amerikane për ndihma - USAID dhe nga qeveria britanike (Beeley 2015c). Disa bashkëpunëtorë të tij në Siri, Mus’ab Ubejde, Halid Diab dhe Faruk el Habib janë shumë të lidhur ngushtë me grupet e armatosura dhe me financierët e tyre. Ubejdi disa vjet ka qenë punonjës i Gjysmë hënës së kuqe, ndërsa kaloi në ‘degën e ministrisë së punëve të jashtme amerikane në Jordani (May Day Rescue 2015). Diabi po ashtu ka punuar Gjysmë hënën e kuqe të Katarit, është akuzuar se dy milion e dyqind mijë dollarë amerikanë i ka drejttoi

grupeve terroriste në Siri (Cartalucci 2013). Habibi ka qenë anëtar i ‘Këshillit revolucionar të Humsit’ (Beeley 2015c). Në një incident ky grup transmetoi video-incizimin e yjarrit në Daraa ku shihet një kanistër të ngjashëm me ato të cilat pjesëtarët e frontit islamik i përhapën në Damask, përsëri duke pohuar se si qeveria siriane ka kryer sulm ‘me napalm në një shkollë’. Guardiani britanik këtë dezinformatë me qejf e publikoi si të vërtetë (Shaheen 2015). Në gusht të vitit 2015 Avaazi dhe fushata siriane publikuan disa fotografi të trupave pa jetë të disa fëmijëve se si shtrirë në gërmadhat e ndërtesave të rrënuara, duke pohuar se bëhet fjalë për viktimat e sulmit që e ka kryer ushtria e qeverisë siriane gjatë sulmit në Ghoutën veriore më 2015. E njëjta fotografi është shfrytëzuar një vit më herët për të treguar si ISIL-i ka masakruar 700 persona në Deir Ezorr (Chronicle 2014). Duke gjurmuar të drejtat autoriale të këtyre fotografive zbulohet se ato i takojnë agjencisë Getty News, ndërsa e vërteta ka ndodhur në mars të vitit 2014 dhe se autori i kësaj ishte Halid Hatibi i cili pohoi se kishte të bëjë me viktimat e ‘barell bombardimeve’ të më hershme në Halep (getty Images 2014). Halidi është prezantuar si ‘aktivist’ që vepron në teritorin të cilin e kontrollojnë pjesëtarët e armatosur të Ushtrisë së lirë siriane dhe anëtarët ‘Mbrotjes civile siriane nga Halepi’, të cilët siç përmendëm më herët, janë të njohur si Helmetat e bardha (al-Hatib 2015; Laughland 2015). Në një porosi që daton prej (gushtit të vitit 2015) Helmetat e bardha (2015a) shfrytëzuan fotografinë e bombardimit të një ndërtese duke treguar me këtë se si kinse ‘kanë ardhur në vetë ngjarjen e eksplodimit’ në të cilin janë lansuar njëzetë fuçi-bomba të cilat e kanë shkatërruar copë e grim tërë ndërtesën me apartamente. Ajo fotografi është publikuar 28 muaj më herët në Christian Science Monitor -in (CSM 2013). Shihet qartë se këtu ka të bëjë me planin e riciklimit të fotografive të luftës dhe se gazetarët dhe fotografët që veprojnë në suaza të grupeve islamike nuk tremben prej asgjëje për të futur këtë lloj dezinformacioni. Gazetarët e instaluar punojnë shumë më fuqishëm kur janë bashkë në grup. Më 30 tetor të vitit 2015 Mjekët pa kufi (organizatë e cila financon klinikat në territoret që i kontrollojnë kryengritësit) dhe

observatori sirian për të drejta njerëzore bënë të ditur se ‘më së paku 70 persona janë vrarë dhe rreth 550 janë lënduar në një treg’ në anën verilindore të Damaskut. ‘Shkatërrimet që i shkaktoi sulmi i parë ajror në këtë treg u keqësuan edhe më me granatimin e ekipeve shpëtimtare’ MEE 2015b). Shqyrtimi i kujdesshëm i këtyre incizimeve të shfrytëzuara në këtë raport tregojnë me sa vijon. E para, Douma ishte nën kontrollin e grupeve kryengritëse të armatosura (të En-Nusra-s dhe Frontit islamik) më se tre vjet, ndërsa grupi më i madh i fundit i civilëve është evakuuar nga kjo para lagje në janar të vitit 2015 (Reuters 2015). Këto grupe vazhdimisht e kanë raketuar Damaskun me armë minahedhëse të njohur si ‘topat e zjarrit të xhehenntansmet’, të cilat si municion shfrytëzojnë bombolla të mëdha gazi (e.g. McDonnell dhe Bulos 2015). Analiza ed mirëfilltë e kësaj videoje tregon se të gjitha aradhet, të vrarë, të lënduar dhe shpëtimtarët e personave që ishin luftëtarë të moshës madhore, tërë kohën thërrisnin parulla ‘All-llahu ekber’, siç e kanë zakon islamistët. Shumë prej shpëtimtarëve bartnin xhaketa antiplumb ‘të helmetave të bardha’. Titulli arab i këtij video-incizimi që e transmetuan ‘helmetat e bardha’ të viktimave të sipërpërmendura ishte ‘shehidët e rënë’, titull i cili përdoret kur përmenden ‘xhihadistët’ e vdekur, të cilët e dhanë jetën për gjënë e shenjt të tyre (White Helmets 2015b). Ky tregim ilustron në mënyrë të qartë lidhjen e bashkëpunimit midis grupeve të armatosura, Helmetave të bardha, SOHR-it si dhe mediumi, në këtë rast, i Middle East Eye -së britanik.

Menjëherë pasi filloi përkrahja ajërore ruse ndaj ushtrisë siriane, më 30 shtator të vitit 2015, Helmetat e bardha në tviterin e vet publikuan fotografinë e një vajze të vogël të përgjakur e cila pohon se është plagosur në bombardimet ruse. Ky është një lajm i rrejtshëm ‘automatiksht i zbuluar... si fotografia që për herë u publikua në 25 shtator të vitit 2015, pesë ditë para fillimit të sulmeve ajrore ruse (Sputnik 2015). Tematika kryesore e Helmetave të bardha ka qenë e njëjtë sikur aja që e shfrytëzon HRW: ‘Fuçitë-bomba jo ISIL-i, janë një rrezik i vërtetë për popullin sirian’ (Roth 2015a). Pohimet e këtilla llogaritin në injorimin total sa i përket natyrës esenciale të ‘fuçi-bombave

(fjala është për bombën e cila hidhet nga helikopteri me të cilin hiqet vëmendja nga faktet dhe dëshmitë lidhur me atë se për të gjitha sulmet e grupeve ekstremiste në Siri, drejtpërdrejtë është përgjegjëse dhe qëndron SHBA-ja dhe aleatët e saj. Agjencitë perëndimore të gazetave, të cilat, kush e di për të satën herë mbështeten në këtë njeri në Britaninë e Madhe që udhëheq me 'observatorin sirian për të drejta njerëzore' (SOHR) i cili u jep numrin e saktë të civilëve të vrarë, gra e fëmijë të cilët kinse janë vrarë nga sulmet e aviacionit rus (AFP 2015), Wall Street Journal, gjithashtu duke u mbështetur në të dhënat SOHR -it dhe Shoqatës medicinale amerikane-siriane e cila pohon se 'në këtë muaj nga sulmet ajrore ruse janë goditur nëntë spitale... ku u plagosën dhjeta nga personeli civilë' (Abdurrahim 2015). Por Dominik Stillhart, drejtor i operacioneve të Kryqit të kuq ndërkombëtar, deklaroi se asnjë prej personelit të tij në teren të Sirisë nuk është i njoftuar për asnjërin prej këtyre incidenteve (RT 2015). Kur televizioni rus iu kundërvu zëdhënësve të qeverisë amerikane duke kërkuar prej tyre të japin detaje të gjoja viktimave të sulmeve ruse në spitale, ata nuk ishin në gjendje ta bëjnë një gjë të tillë. Incizimet e një spitali që ishte përmendur në raportet mbi sulmet dukej plotësisht e pa prekur. (Emma Aiden 2015). Në mes të përfaqësuesve të grupeve të armatosura, vëzhguesve të instaluar për të drejta njerëzore dhe mediave të perëndimit ekziston një simbiozë e fortë dhe ata veprojnë të sinkronizuar.

'Aktivistët' sirianë që bashkëpunojnë me Helmetat e bardha dhe me fushatën siriane, si duket operojnë në territoret që kontrollojnë grupet e afërta me Al-Kaidën, Xhebbhetun-Nusra dhe ato që i ndihmojnë atij (Sputnik 2015). Video-incizimi i sulmit të supozuar me gaz klorik është transmetuar ashtu që në fillim shfaqet 'logoja e Helmetave të bardha, ndërsa në vazhdim shihet logoja e an-Nusra-së'. Ana tjetër, qeveria e Sirisë, grupin e vogël të Helmetave të bardha e përshkruajnë si 'një ekip i vogël shpëtimtarësh që punon për frontin en-Nusra /El Kidu', ndërkaq sa i përket anës amerikane funksioni bazë i kësaj orgabizate është përhapja e propagandave online (Sterling 2015a). Video-materialet Helmetat e bardha në internet i paraqesin si vullnetarë që i tërheqin trupat e të vdekurve

dhe të lënduarve ca sekonda pas sulmeve të trilluara të Xhebbhetun-Nusra-së (Ilive Leak 2015). Ja si punon NVO-ja humanitare e cila thellë është i inkorporuar dhe i cili shërben si servis i Al-Kaidës. Mediat dhe vëzhguesit e NVO-së që shërbejnë si mbështetje logjistike të ambicieve strategjike të fuqive të mëdha perëndimore, janë një instrument shumë i rëndësishëm i makinerisë propaganduese për luftën e ndytë që zhvillohet kundër Sirisë. Ata shpesh verojnë si tandem, si burime, si komentatorë dhe si megafon për realizimin e projektit të ‘ndryshimit të regjimit’. Ata, jo vetë që mbështeten në burime patër të anësishme, siç është individuali në Britaninë e madhe që udhëheq ‘Observatorin sirian për prova të vërteta njerëzore’, por, gjithashtu, drejtpërdrejt janë të kyçur në fabrikimin mediatik të dëshmive-provave, siç ilustron shembullin BBS dhe Helmetat e bardha. Ato organizatat më tradicionale për shqyrtimin e cenimit të të drejtave njerëzore, Amnesty International dhe Human Rights Watch, po shtu kanë qëndruar pas shumë dëshmive- provave të fabrikuara që janë pranua nga burimet e afërta me Al-Kaidën. Këto organizata nuk i kanë kushtuar rëndësi kritikës që ishte drejtuar në llogari të tyre dhe që tregon konfliktin e interesave dhe kritika se si shefat e tyre kalojnë prej State departamentit amerikan ose anasjelltas.

Shënime

Pillars (2015) ‘Al Jazeera English instructs staff not to call Syria’s Jabhat al Nusra “ Al Qaeda”’, 5 Pillars UK, 22 September, online: <http://5pillarsuk.com/2015/09/22/al-jazeera-english-instructs-staff-not-to-call-syrias-jabhat-al-nusra-al-qaeda/>

Abdulahim, Raja (2015) ‘Syrian Hospitals Hit by Russian Airstrikes, Says Medical Group’. Wall Street Journal, 23 October, online: <http://www.wsj.com/articles/syrian-hospitals-hit-by-russian-airstrikes-says-medical-group-1445610055>

Acufia, Rodolfo et al (2008) ‘More Than 100 Experts Question Human Rights Whatch’s Venezuela Report’, Common Dreams, online: <http://www.commondreams.org/newswire/2008/12/17/more-100-latin-america-question-human-rights-watches-venezuela-report>

AFP (2015) ‘Nearly 450 killed in Russian air strikes on Syria’, Gulf Times, 23 October, online:

<http://www.gulf-times.com/region/216/details/460020/nearly-450-killed-in-russian-strikes-on-syria>

AI (2015) 'Death Everywhere: War Crimes and Human Rights Abuses in Aleppo, Syria', Amnesty International, 62pp, online:

<http://www.amnestyusa.org/research/reports/death-everywhere-war-crimes-and-human-rights-abuses-in-aleppo>

Alternet (2014) 'Nobel Peace Laureates to Human Rights Watch: Close Your Revolving Door to U.S. Government', 12 may, online:

<http://www.alternet.org/world/nobel-peace-laureates-human-rights-watch-close-your-revolving-door-us-governme>

Avaaz (2011) 'Recognize Palestine – New Path to Peace', 26 August, online:http://www.avaaz.org/en/middle_east_peace_now/?cl=1235614889&v=10054

Avaaz(2003) 'For the women of Syri', 20 June,online:

https://secure.avaaz.org/en/syria_the_last_straw_r/

Bagdikian,Ben H.(2004) The New Media Monopoly, Beacon Press, Massachusetts

BBS (2015a) 'Syria conflict: Air strike on Damascus suburb 'kills dozens ', 23 January,online: <http://www.BBS.com/news/world-middle-east-30957129>

BBS (2015b) 'Syria the story of the conflict', 9 October, <http://www.BBS.com/news/world-middle-east-26116868>

Beeley, Vanessa (2015a) 'White Helmets: New breed of mercenaries and propagandists, disguised as humanitarians in Syria', 1 September, 21Wire, online:

<http://21stcenturywire.com/2015/09/01white-helmets-new-breed-of-mercenaries-and-propagandists-disguised-as-humanitarians-in-syria/>

Beeley, Vanessa (2015b) 'The Propaganda war against Syria led by Avaaz and the White Helmets', Global Research, 2 October, online: <http://globalresearch.ca/the-propaganda-war-against-syria-led-by-avaaz-and-the-white-helmets/5479307>

Beeley, Vanessa (2015c) 'Syria's white helmets: war by way of deception- Part 1', 21st century Swire, 23 October, online: <http://21stcenturywire.com/2015/10/23/syrias-white-helmets-war-war-by-way-of-deception-part-1/>

Bhatt, Keane (2014) 'The Hypocrisy of Human Rights Watch', NAC LA, online:<http://nacla.org/news/2014/2/4hypocrisy-human-rights-whatch>

Blum, Wiliam (2000) 'Trojan Horse: The National Endowment for Democracy' in Rogue State, Common Courage Press, Monroe ME, online:

http://thirdworldtraveler.com/Blum/TrojanHorse_RS.html

Cartalucci, Tony (2013) 'UN's Syria "Aid" Appeal is Bid to Relieve Trapped Terrorists', Land Destroyer, 17 December, online:

<http://landdestroyer.blogspot.com.au/2013/12/syria-uns-aid-appeal-is-bid-to-relieve.html>

Casciani, Dominic (2014) 'The man from Martyr's avenue who became a suicide bomber in Syria', BBS News, 20 March, online:

<http://www.BBS.com/news/magazine-26452992>

CFR (2000) 'Humanitarian Intervention: crafting a workable doctrine', Council on Foreign Relations, Washington, online: <http://www.cfr.org/humanitarian-intervention/humanitarian-intervention-crafting-workable-doctrine/p3814>

Chester, Jeff (2007) Digital Destiny: New Media and the Future of Democracy, The New Press, New York

Chumley, Cheryl K. (2013) 'Islamic cleric decrees it OK for Syrian rebels to rape women', Washington Times, 3 April, online:

<http://www.washingtontimes.com/news/2013/apr/3/islamic-cleric-decrees-it-ok-syrian-rebels-rape-wo>

Chronicle (2014) 'Islamic State Group 'Executes 700' in Syria', 18 August, online:

<http://www.chronicle.co.zw/islamic-state-group-executes-700-in-syria/>

CSM (2013) 'Looking for Obama's Agenda in Syria', Christian Science Monitor, 14 April online: <http://www.csmonitor.com/Commentary/the-monitors-view/2013/0414/Looking-for-Obama-s-agenda-in-Syria>

Edwaeds, David (2013) 'Limited but Persuasive' Evidence- Syria, Sarin, Libya, Lies', Media Lens, 21 June, online:

<http://www.medialens.org/index.php/alert-archive/alters-2013/735-limited-but-persuasive-evidence-syria-sarin-libya-lies.html>

Eleftheriou- Smith, Loulla-Mae (2015) 'Young Uzbek suicide bomber filmed crying before carrying out final mission in Syria', Independent, 23 September, online: <http://www.independet.co.uk/news/world/middle-east/young-uzbek-suicide-bomber-filmed-crying-before-carrying-out-final-mission-in-syria-10514011.html?cmpid=facebook-post>

Emassian, Kevork, Hiba Kelanee, Feeda Kardous and Zoubaida al Kadri (2012) 'Truth about western media's favourite Syrian 'activist' Danny Dayem', 22 February, online:

<http://www.sott.net/article/242491-Truth-about-Western-medias-favorite-Syrian-activist-Danny-Dayem>

Emma Aiden (2015) 'Syria hospitals Russia accused of bombing don't exist', YouTube, 3 November, online:

<http://www.youtube.com/watch?v=MtfQoK5qYR8>

Engdahl, F. William (2011) *Full Spectrum Dominance: totalitarian democracy in the new world order*, Progressive Press, Joshua Tree, California

Engel, Richard (2015) 'New Details on 2012 Kidnapping of NBC News Team in Syria', NBC News, 15 April, online:

<http://www.nbcnews.com/news/world/new-details-2012-kidnapping-nbc-news-team-syria-n342356>

ESB (2012) 'Avaaz: Empire Propaganda Mill Masquerading as Grassroots Activism', *Empire Strikes Black*, 9 June, online:

<http://empirestrikesblack.com/2012/06/avaaz-empire-propaganda-mill-masquerading-as-grassroots-activism/>

Fahmy, Shahira and Thomas J. Johnston (2005) "How we Performed", *Embedded Journalists' Attitudes and Perception Towards Covering the Iraq War*, *Journalism & Mass Communication Quarterly*, June 2005 vol.82 no.2, pp.301-317

Getty Images (2014) Syria Conflict, Photograph 479335513, Khaled Khatib/AFP/Getty Images, 18 March, online:

<http://www.gettyimages.com.au/detail/news-photo/the-bodies-of-two-syrian-children-lie-in-the-rubble-of-a-news-photo/479335513?license>

Gharib, Ali (2015) 'How NBC Knowingly Let Syria Rebels' False War Propaganda Stand For Years', *The Nation*, 17 April, online:

<http://www.thenation.com/article/how-nbc-knowingly-let-syria-rebels-false-war-propaganda-stand-years/>

Guardian Watch (2015) 'The push of "humanitarian invasion" continues', *Off Guardian*, 19 September, online: <http://off-guardian.org/2015/09/19/the-push-for-humanitarian-invasion-continues/>

Haigh, Michael et al (2006) 'A Comparison of Embedded and Non-embedded Print Coverage of the U.S. Invasion and Occupation of Iraq', *The International Journal of Press/Politics* April 2006 vol. 11 no.2, pp.139-153

Hopkins, Nick (2014) 'Syria conflict: UK planned to train and equip 100,000 rebels'. *BBS News*, 3 July, online:

<http://www.BBS.com/news/uk-28148943>

HRW (2010) 'George Soros to Give \$100 million to Human Rights Watch', *Human Rights Watch*, 7 September, online: <https://www.hrw.org/news/2010/09/07/george-soros-give-100-million-human-rights-watch>

JCS (2000) Joint Vision 2020: America's Military- Preparing for Tomorrow, Chairman of the Joint Chiefs of Staff, USA, online: <http://mattcegelske.com/joint-vision-2020-americas-military-preparing-for-tomorrow-strategy/>

Jenkins, Simon (2015) 'Bombing is immoral, stupid and never wins wars. Syria is the latest victim', Guardian, 18 September, online: <http://www.theguardian.com/commentisfree/2015/sep/18/bombing-immoral-stupid-syria-victim-deaths-drones>

Johnson, Adam (2015) 'Down the Memory Hole: NYT Eraser CIA's Efforts to Overthrow Syria's Government', FAIR: Fairness and Accuracy in Reporting, 20 September, online: <http://fair.org/home/down-the-memory-hole-nyt-erases-cias-efforts-to-overthrow-syrias-government/>

Khatib al, Khaled (2015) 'Fleeing the frontline, Marea's poorest seek refuge in orchards', Syria Direct, 15 September, online: <http://syriadirect.org/news/fleeing-the-frontline-marea%E2%80%90poorest-seek-refuge-in-orchards/>

Kirkpatrick, David (2014) 'Qatar's Support of Islamists Alienates Allies Near and Far', New York Times, 7 September, online: <http://www.nytimes.com/2014/09/08/world/middleeast/qatars-support-of-extremists-alienates-allies-near-and-far.html>

Knightley, Phillip (2001) 'The disinformation campaign', The Guardian, 4 October, online: <http://www.theguardian.com/education/2001/oct/04/socialsciences.highereducation>

Kryriacou, Kate and Kate McKenna (2013) 'Brisbane family man's suicide blast in Syria', Courier- Mail, 13 November, online: <http://www.couriermail.com.au/news/queenslan/brisbane-family-mans-suicide-blast-in-syria/story-fnihsrf2-1226758576503>

La Barra, Yalla (2015) 'Human Rights Watch's Kenneth Roth's Obsession with Bashar al- Assad and Barrel Bombs', Yalla La Barra, 28 August, online: <http://yallalabarra.wordpress.com/2015/08/28/human-rights-watches-keeneth-roths-obsession-with-bashar-al-assad-and-barrel-bombs/>

Landsman, Carolina (2013) 'Israelis, Shooting First and Crying Later Is No Longer an Option', Haaretz, 15 March, online: <http://www.haaretz.com/opinion/.premium-1.646471>

Loughland, Oliver (2015) 'US should use radar to warn civilians of Syrian barrel bombs, group demands', Guardian, 28 February, online:

<http://www.theguardian.com/world/2015/feb/27/us-military-warn-civilians-incoming-syria-air-strikes>

Smith-Spark, Laura and Tom Cohen (2013) 'U.S., Russia agree to framework on Syria chemical weapons', CNN, 15 September, online:
<http://edition.com/2013/09/14/politics/us-syria/>

Solomon, Erica (2015) 'Iraqi Kurds claim ISIS used chemical weapons', Financial Times, 14 March, online:
<http://www.ft.com/cms/s/0/6e69cfca-ca78-11e4-8973-00144feab7de.html#axzz3WW8sO2kl>

Turbeville, Brandon (2014) 'New video evidence points to al-Nusra chemical attack against Sect Blamed in Syria Killings', New York Times, December 12 online:
http://www.nytimes.com/2012/12/13/world/middleeast/alawite-massacre-in-syria.html?_r=0

Thompson, Alex (2012) 'Was there a massacre in the Syrian town of Aqrab?' 14 December: <http://blogs.channel4.com/alex-thomsons-view/happened-syrian-town-aqrab/3426>

Today's Zaman (2013) 'Detained al-Nusra members say chemicals not for making sarin gas', 13 September, online:
http://www.todayszaman.com/national_detained-al-nusra-members-say-chemicals-not-for-making-sarin-gas_326332.html

UN (2013) United Nations Mission to Investigate Allegations of the Use of Chemical Weapons in the Syrian Arab Republik, December, online: <https://unoda-web.s3.amazonaws.com/wp-content/uploads/2013/12/report.pdf>

UNMIAUCWSAA (2013) 'Final report', United Nations Mission to Investigate Allegations of the Use of Chemical Weapons in the Syrian Arab Republik, 12 December, online:
<https://unodaweb.s3.amazonaws.com/wp-content/uploads/2013/12/report.pdf>

White Helmets (2015) 'It's time to stop the bombs', March, online:
<https://www.whitehelmets.org/>

10. Përgjegjësia për të mbrojtur dhe Loja e dyfishtë



Versioni i ri i ‘intervenimit humanitar’, i njohur si ‘Përgjegjësia për të mbrojtur’ (R2P), është zhvilluar kah fillimi i shekullit XXI. Bëhet fjalë për intervenimin e fuqive të mëdha ndërsa me këtë nënkuptohet referimi në pasojat humanitare të hezitimit për intervenim në të kaluarën, ashtu që ky u bë një argument i madh moral për intervenimin në Libi në vitin 2011. Ai intervenim u themelua mbi rrena që për popullin libian do të thoshte katastrofë e madhe. I njëjti skenar u mendua dhe provua në Siri, por ky këtu nuk pati sukses. Më së shumti e penguan Rusia dhe Kina të cilat nuk dëshironin më të luajnë lojën e Vashingtonit. Si do që të tingëllojë kjo në idenë e tij teorike, R2P në praktikë kjo është një vegël e re për zbatimin më të lehtë të intervenimit të jashtëm. Ky në vete ka një rrezik të natyrshëm sepse mundëson fshehjen në

flamurin e rrejshëm, operacionet ‘false flag’ bëjnë krim nga ana e grupeve të ndryshme të armatosura me çka tërheqin vëmendjen e opinionit botëror dhe sigurojnë anën më të fortë të përkrahjes për qëllimet e veta. Ky gjithashtu i ka shkaktuar varrimin e sistemit ndërkombëtar, i cili që nga viti 1940 është venduar parimet e sovranitetit dhe mosndërhyrjes.

Në disa aspekte është shumë e panatyrshme që aq herët, pas invazionit në Irak në bazë të arsyeve të rrejshme (shih Kramer dhe Michalowski), ka filluar të diskutohet rreth asaj se në ç’ mënyrë do të mund t’i përvetësojnë dhe t’i bëjnë të shenjta arsyet për përsëritjen e intervenim ushtarak. Vërtetë bëhet fjalë për një diskutim ekstra ordinar dhe fashionus, pikërisht për shkak të kësaj relativisht pak i kushtohet vëmendje historisë së dokumentuar të shfrytëzimit të arsyeve të ndryshme (false pretexts) për kryerjen e intervenimit. Megjithatë, në një farë mënyre, duket përsëri e logjikshme, sepse në atë formë miklon një vetëdije naive të një shoqërie ndërsa në të njëjtën kohë hapen drejtime të reja për realizimin e ambicieve të fuqive të mëdha. Kjo ‘lojë e dyfishtë’ e përzierjes së justifikimeve të rrejshme, ambicieve politike dhe racionalizimit të të mirave publike, i takojnë një traditës së vjetër prej kohërave të hershme.

Debati më ri kryesisht zhvillohet në qarqet perëndimore dhe apriori i referohet promovimit R2P -së ‘si një formë e re të të drejtës së zakonshme ndërkombëtare’, për më tepër, madje në kuptim të obligimit (Loiselle 2013: 317-341). Ky debat artikuloi përkrahjen e madhe të opinionit kur është fjala për sentimentin perëndimor në dobi të intervenimeve, po bile edhe pa marrë parasysh vetë hollësitë që e karakterizojnë atë. Kjo tregonte rikthimin e trendit të qëndrueshëm të cilin formalisht e venduan kolonitë në erë poskoloniale. Lëvizja e vendeve të painkuadruara që i përkasin 18 kombe, kryesisht të ish kolonive, nga ana tjetër, ngre lartë parimin e mosndërhyrjes mbi parimin themelor mbi të cilin bazohen shtete nacionale-nation states (Köchler 1982). Si shembull i debatit të më hershme, mund në mënyrë principiele të merret kontesti midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe shteteve të Amerikës Latine, që është objekt i debateve të ashpra në të gjitha konferencat pan-

amerikane në fillim të shekullit njëzet, ku problemi kryesor ishte refuzimi i Vashingtonit të pranojë parimin e mosndërhyrjes.

Përfundimisht, gjatë vitit 1933 SHBA-të e pranuan këtë parim (Dreier 7963: 40 - 41). Natyrisht, ShBA-të edhe më tej vazhduan të intervenojnë në vendet e Amerikës Latine, por pranimi i këtij parimi nxiti këtë fuqi të nisë të kërkojë arsye të reja të cilat do t'i mundësojnë t'i arsyetoj intervenimet e veta.

Edhe pse vet nocioni 'intervenimet humanitare' nuk është i panjohur, sepse përdoret një kohë, qasja dhe mënyra në të cilat është përpunuar teoria e doktrinës 'Përgjegjësia për të mbrojtur' padyshim se është risi. Megjithatë edhe njëra edhe tjetra ndajnë një racionalizëm me të cilin përpiqen të arsyetohen intervenimet e jashtme ushtarake në vendin tjetër dhe cila në praktikë gjithnjë nënkupton intervenimin e fuqive të mëdha në ndonjë vend tjetër, por sipas rregullit gjithnjë në emër të një grupi të gjerë vendesh. Sipas një pikëpamje na Amerika Veriore, forma bashkëkohore 'e intervenimit humanitar' është i lidhur me praktikën e më hershme të intervenimeve. Për shembull perandoria britanike kundër praktikës skllavopronare (duke harrua me këtë rast shekullin XVI, XVII dhe XVIII) si dhe pseudo idealizmit të intervencionizmit amerikan në luftën spanjolle-amerikane (Bass 209). Nga kjo pikëpamje intervenimi humanitar ka pasur dallim nga imperializmi, edhe pse atij i kundërvihen në mënyrë të njëjtë si 'realistët' ashtu edhe 'majtistët'. Bass citon John Stuarin, liberalin anglez, i njohur me kundërshtimin e tij ndaj idesë të sovranitetit absolut si dhe fenomenit të robërisë dhe i cili sërish ishte mbrojtës i madh i intervenimit humanitar. 'Barbarët nuk kanë të drejta që i kanë kombet, përpos të drejtave në një trajtim të atillë... që t'i përgatitim për t'u bërë kombe... (duhet) ndërmjetësuar në konfliktet e tyre që lindin midis shteteve të huaja, për t'i ndalur luftërrat e tyre kokëforta qytetare... dhe të bëjmë ndikim t'i ndihmojmë trajtimin më të mirë të atyre që kanë pësuar humbje... dhe në këtë mënyrë do të mund ta ndërpresim tregtinë me robër' (Mill 1867: 252 - 253).

Qëndrimi i John Stuart Mill-it mund të merret si paraardhës i 'Imperializmit liberal' - pohojnë shkencëtarët britanikë (Ferguson

2004; Cooper 2002), edhe pse diçka ndryshe nga argumentet e disave nga Amerika Veriore siç janë Ignatieff (2005) dhe Ikenberry (2012). të cilët janë shumë të dhënë pas idesë së ‘stabilitetit hegjemonist’. Sipas kësaj doktrine të Amerikës Veriore superfuqia dashamirëse nuk e shfrytëzon rolin e saj dominues, por sillet në mënyrë të vetëflijimit për t’u siguruar të gjithëve ‘mirëqenie dhe të mira’. (Keohane 1986).

Si do qoftë, ‘imperializmi leberal nuk inkadrohet në botën e dyfishtë të post-luftës së ftohtë, i cili është sistemuar me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe me kartën e dyfishtë të të drejtave njerëzore. Të dy këto dokumente themelore bazohen në të drejtën e shteteve dhe popujve për vetëvendosje. Vështirimi kritik po ashtu kërkon një interpretim serioz historik të nocionit ‘intervenimet humanitare’ dhe ‘përgjegjësisë për të mbrojtur’. Noam Chomsky pohon se ato norma duhet kuptuar si pjesë historike të doktrinë imperiale. Shumë agresione ushtarake, thekson Chomsky ‘janë të arsyeshme me një retorikë të ngritur mbi fisnikërinë e intervenimeve humanitare’ (chomsky 2008: 48).

Vetë ideja e doktrinës ‘reponsibility to protect’, pastaj, është formuar në kohën e pranimi të vetëvendosjes, sovranitetit shtetëror dhe në të njëjtën kohë, konventat mbi krimet e luftës, krimin kundër njerëzimit dhe më e reja krimin të gjenocidit. Në këtë kontekst, por pas vrasjeve masive në Kamboxhë në Ruandë, ‘Komisioni ndërkombëtar mbi intervenimet dhe sovranitetin shtetëror prej vitit 2001, promovoi idenë e ‘sovranitetit si përgjegjësi, që ishte e fokusuar në dhunë të shtetet e dobëta ose të sapoformuara. Samiti botëror i vitit 2005 konkludoi: ‘Secili shtet në vetë ka përgjegjësi të mbrojtë popullatën e vet nga gjenocidi, krimet e luftës, pastrimi etnik dhe nga krimi kundër njerëzimit... Bashkësia ndërkombëtare patjetër, ashtu si duhet pritur nga ajo, të nxit kah ajo përgjegjësi dhe t’i ndihmojë... (ndërsa) jemi të gatshëm të ndërmarrim aksion kolektiv... përmes Këshillit të sigurimit... në rast se metodat paqësore tregohen të paefektshme, dhe kur qeveritë nacionale dukshëm nuk mund ta mbrojnë popullatën e vet.’ (KB 2005: 138-139).

Esenca e këtij teksti është me rezolutën e 1967. Këshilli i sigurimit i KB-së vitin tjetër (UNCS 2006; shih po ashtu ICRTOP 2014. Edvar Luck vëren që absolutisht nuk ekziston ndonjë kontradiktë midis këtyre doktrinave dhe principit të sovranitetit shtetëror, me që termi bazohet në të drejtën konvencionale humanitare dhe ‘verifikon idenë e sovranitetit shtetëror’.

Doktrina nuk ndryshon përmbajtjen e Dokumentit të KB-së kur ka të bëjë me ligjin ndërkombëtar mbi të drejtat njerëzore. Ajo tërheq më shumë vëmendje te kapitulli i shtatë që ka të bëjë me të drejtat e Këshillit të sigurimit të KB-së për intervenim. Megjithatë, R2P nuk e ka ndryshuar ndalimin ligjor të intervenimit ushtarak, vetëm në rast vetëmbrojtjeje, ose për të penguar çfarëdo sulmi ndaj sovranitetit të cilin Këshilli i sigurimit e konsideron shkelje të ‘sigurimit kolektiv’. Të dy racionalizmat kanë për qëllim mbrojtjen e sistemit ndërkombëtar, i ndërtuar mbi parimin i integritetit të shteteve nacionale.

Në analizën kritike, e para veti karakteristike e doktrinës R2P që vërehet është ajo që R2P fuqive të mëdha u ofron racionalizëm të ri që i përket intervenimit, duke përfshirë edhe fuqitë e dikurshme koloniale duke ua mundësuar ta ‘pengojnë’ krimin të cilin në të kaluarën vet ato fuqi e kanë bërë. Rafael Lemkin - hebre polak, avokat dhe arkitekt i konceptit ‘gjenocid’ - konsideron se në kuptimin e përgjithshëm janë shumë shtete të fuqishme ato të cilat kanë qenë të prira për luftëra agresive, pastrim etnik dhe gjenocid. Gjenocidi, konsideron Lemkini nuk ka lindur si rezultat i disponimit të herëpashershëm të pushtet-mbajtësit të flaktë, pronë të vërtetë, është një model i cili vazhdimisht është përsëritur gjatë historisë... si plan i koordinuar i veprimeve të ndryshme të cilat kanë për qëllim shkatërrimin e fondamenteve mbi të cilët qëndron jeta e grupeve nacionale, me qëllim zhdukjeje të atyre grupeve’ (Frieze 2013: 138; Lemkin 1944: 79). Prandaj viktimat të gjenocidit janë banorët e territoreve rreth pronësisë së të cilave ka polemikë dhe viset e okupuara, ndërsa si kryerës të gjenocidit përshkruhen turqit osmanlinj, japonezët, mongolët dhe perandoritë spanjolle (Frieze 2013: 80, 138, 168, 184). Bloxhami i cili po ashtu ka shkruar mbi gjenocidin e Armenisë, pajtohet me

Lemkinin lidhur me atë se gjenocidet patjetër duhet kuptuar si rezultat i proceseve historike dhe i ‘marrëdhënieve të strukturuara’, e jo si ‘qëllime të këqija të njerëzve të prishur’ (bloxham 2003: 98). Ky krim i tmerrshëm u bë rezultat logjik i projekteve të dominimit që i praktikonin perandoritë. Të vetëdijshme për historinë e vet, mund të konsiderohet një akt guximtar i fuqive të mëdha të thirren në rastin ‘krime të mëdha imanente që kërcënojnë të ndodhin’, duke përfshirë edhe krimin e parashikuar të gjenocidit, si arsëyetim për intervenim. Nuk ka strukturë ose organizatë shtetërore që ka bë ndonjëherë krime masive atë masë që kanë perandoritë të cila nga vetvetiu, në vetë qenien e vet janë intervencionistë.

Shumë të vetëdijshëm për trashëgiminë koloniale, robërinë dhe gjenocidin, liderët e Lëvizjes së shteteve të painkuadruara, të cilat gati në përgjithësi janë ish kolonitë, kanë qëndruar fortë në mbrojtje të principi të mosndërhyrjes (e,g, Lage 2006). Që nga fillimi i konfliktit në Siri shumica e këtyre shteteve e hodhën poshtë idenë e intervenimit të fuqive të mëdha për shkaqe humanitare, duke konsideruar doktrinën R2P një lloj ‘Kali të Trojës’ që është krijuar që sa më lehtë mund të kryhet ‘ndryshimi i regjimit’ (Mendiluzza 2014). Veçori tjetër interesante që e vërejmë te doktrina R2P është se fuqia kryesore lëvizëse që e lëviz atë vjen nga krahu i liberalëve të spektrit politik perëndimor. Kjo është një risi sipas të cilës kjo doktrinë dallon nga përçarjet e mëparshme që mbinë brenda suazave të politikës perëndimore dhe fuqive të mëdha rreth invazionit amerikan në Irak në vitin 2003, por në pajtueshmëri me argumentin që e thekson Bass (2009) i cili lëshon një postulat qw ‘intervenimi humanitar’ rrënjët e saj të thella i ka në traditën liberale, është në kundërshtim me traditën e ‘realizmit’ e cila është në polin e kundërt të kulturës hegjemoniste. Në kapitullin e shtatë kemi shpjeguar se si Holly Burkhalter, ish drejtoresha e Human Rights Watch, ministrisë së punëve të jashtme, i ka dhënë një rol të gjerë, duke arsyetuar intervenimin ushtarak, gjoja si preventivë, për t’u ndaluar krimet e rënda. Strukturat ushtarake amerikane janë shumë më vigjilente, duke theksuar nevojën të një korelacioni të fuqishëm të

intervenimit ushtarak dhe të mbrojtjes së interesave nacionale amerikane (CFR 2000).

Intervenimi në Libi më 2011 në një masë të madhe është mbështetur në argumentet që përmbante doktrina R2P, por forcat e aleancës së NATO-s e tejkaluan lejen e mandatit të UNSC-së që kishte të bëjë me ‘zonën e ndalimit të fluturimit’ (shih RT 2010). Forcat ajrore dhe tokësore të NATO-s ishin efikase në shkatërrimin e qeverisë së Mumer Gaddafit dhe shpartallimin e shtetit libian. Ish anëtarja e Kongresit amerikan, Cynthia McKinney (2012: 12- 13) theksoi se si tre shtetet; Iraku, Libia dhe Siria janë ‘regjime të vjetra prosovjetike’, të cilët zyrtarët e Pentagonit amerikan që prej para njëzetë vitesh insistojnë t’i ‘pastrojnë’. Ky plan u bë gjithnjë më i afërt pas invazionit amerikan në Afganistan dhe Irak. Si pretekst për shkatërrimin e qeverisë libiane janë përmendur disa të ashtuquajtura krime kundër popullatës civile. Para vet kryengritjes së armatosur, në stilin e Al-Kaidës në pjesën lindore të Libisë, Graham Cronogue (2012), duke u thirrur në gazetën britanike Guardian, agjituesin kryesor të ‘intervenimit humanitar’, pohon se si ‘me qindra civilë’ janë vrarë gjatë kohës së ‘protestave’. Amnesty International (2011: 8) po ashtu e mbështeti pohimin mbi ‘vrasjet, grabitjet dhe torturat’. Megjithatë, shumica e raporteve të sipërpërmendura ka qenë e karakterizuar me konfliktin e interesave. Burimi kryesor në cilin mbështeteshin organizata e përmendura kur është fjala për të ashtuquajturin keqtrajtim që e ka kryer qeveria e Libisë. Sliman Bochuiguir, akuzat e veta i bazoi drejtpërdrejt në deklaratat që i mori nga forcat politike opozitare (Nazemroaya 2012: 132 - 134). Ai më vonë edhe vet e pranoi se në atë kohë ishte e pamundur t’i verifikojë informata që ai vet i prezantoi e që kishin të bëjnë me vrasjen e civilëve (tejl 2011), Pasi që u vra Gaddafi dhe u përmbys qeveria e tij, përgjegjësja e degës franceze të Amnesty International, Genevieve Garrigo pranoi se pohimet e më hershme lidhur me atë se Gaddafi ka shfrytëzuar ‘mercenarët afrikanë’ për masakrimin e libianëve kanë qenë disa ‘thashetheme të thjeshta që i përhapnin mediat’ (in Truth Syria). Përmes Atlantikut, drejtori i Amnesty International amerikan, Suzanne Nossel drejtpërdrejtë u rekrutua

në atë pozitë nga vendi i punës në State Departmentin amerikan, ku punoi planifikimin e politikës amerikane ndaj Rusisë, Iranit, Libisë dhe Sirisë (Teil 2012: 146; Wriht dhe Rowley 2012; Cartalucci 2012). Shteti i Katarit u ndihmoi në furnizimin me armë islamistëve libianë si dhe në përhapjen e propagandës përmes rrjetit të tij mediatik - Al-Xhezirës (Fittrakis in McKinney 2012: 22). Qeveria SHBA-së përmes dhuratave të saj nacionale për demokraci -NED, financoi disa NVO në Libi të cilët po ashtu i kantribuan agjitimit dhe apelimit të intervenimit ‘humanitar’ (nayemroaya 2012: 147). Ndeshja e interesave me rastin e debatit libian mbi rolin e R2P-së është e tmerrshme. Vlerësimet mbi humbjet njerëzore që janë bazuar në burimet të Amerikës Veriore flasin për atë se dhjetë herë më shumë janë vrarë njerëz pas intervenimit të forcave të NATO-s se sa para saj. Katër vite më vonë pas atij intervenimi, Libia edhe më tej gjendet në një situatë katasrofike (Kuperman 2015).

Pakënaqësia e madhe shpërtheu në suaza të bashkësisë akademike, pasi që Libia u prezantua si model në të cilin është testuar me sukses doktrina R2P. Dunne dhe Gelber cekin se argumentet që janë shfrytëzuar për arsyetimin e intervenimit në Libi, në realitet prishin idenë e ‘normave’ të R2P-së, kur NATO hoqi dorë nga kufizimi i ‘no fly zone’ deri te ndërrimi i regjimit ‘duke tradhtuar’ besën e KB-së dhe duke demonstruar lojalitet kur është fjala për besimin në të cilin është mundësuar intervenimi (Dunne dhe Gelber 2014: 327 - 328). Brown u pajtua, duke deklaruar se intervenimi në Libi demonstroi ‘natyrën apolitike’ të sugjeruar më herët të doktrinës mbi përgjegjësinë se patjetër të mbrohet popullata civile, ‘paraqet dobësi e jo forcë... po e zëmë se politikën mund ta zmbarsim nga rezoni i përgjithshëm, kjo në realitet është përhapje e iluzioneve dhe në këtë mënyrë shpie kah dëshpërimi dhe demoralizimi (Brown 2013: 424 - 425). Madje edhe në qarqet perëndimore, pas Libisë, kjo doktrinë e humbi shkëlqimin e saj intelektual. Trashëgimia historike mund të na ndihmojë që këtë kritikë ta një hap më parë. në mirëkuptim të doktrinës R2P si një ‘normë e lejuar’ (Steele dhe Heinze 2014: 88, 109). Të dy argumentet, ai i intervenimit humanitar dhe i

doktrinës R2P, patjetër, në frymën e hetimeve, t’u nënshtrohen parimeve të përcaktuara të shmangies së patjetërsueshme të ndeshjes së interesave dhe t’u jepet prioritet provave detale dhe përafërsisht të pavarura marrë parasysh arsyen e përdorimit. Më tej, këto argumente kanë mundur në formën më të mirë të bazohen në historinë e gjatë të intervenimeve imperiale. Kjo u referohet të gjitha konflikteve të tilla., duke përfshirë edhe pohimet e anësishme mbi masakrat e civilëve në Siri. Fabrikimi i dëshmime - provave që do të mund t’i mbulonin provat e anësishme mbi krimet, janë të dokumentuara në këtë libër, në kapitullin e tetë dhe të nëntë. Pa këtë lloj parimor të hulumtimit i tërë debati mund të shkojë viktimë e motiveve të rrejshëm ‘të lojës së dyfishtë’, që përfaqësojnë taktikën historike të cilën fuqitë e mëdha, gjatë historisë, e kanë sjell deri te perfeksionimi.

Gjatë vitit 2014 erdhi te ndryshimi i racionalizmit kryesor që i kërkonte nevoja e intervenimit perëndimor në Siri. Ky racionalizëm i ndryshimeve është prej arsyeve që bazohen në parimet e doktrinës R2P ‘responsibility to protect’ kah doktrina e re ‘mbrojtëse ose patronizuese’ e intervenimit - ‘protektive intervention’ në emër të shuarjes së terrorizmit në nivel global, Ky argument totalisht i shkel parimet të të drejtës ndërkombëtare, duke demonstruar mospërfillje ndaj të drejtave të vendeve tjera dhe popujve të tyre. Në Siri, ky argument i ri përmban edhe disa pohime të çuditshme lidhur me atë se si Vashingtoni e armatos një grup islamistësh për të luftuar kundër disa grupeve të tjerave edhe më ekstreme islamiste: Edhe intervenimi humanitar edhe ai tjetri, më saktë thënë doktrina R2P, njësoj mbajnë rrezik të madh të keqësimit të situatës dhe mund të nxisin kryerje të krimit në përmasa më të mëdha, siç është dëshmuar në shembullin e masakrës ‘fals flag’ në Siri. Kur fuqitë e jashtme i përmbajnë formacionet e veta të favorizuara në teren kundër shtetit nacional, në atë rast ekziston një mundësi e madhe e inkurajimit të atyre milicëve që pa kurrfarë frike të përgjegjësisë të kryejnë krime të rënda, ose me manipulimin e krimeve të veta në kontekstin e dhënë, akuzojnë palën tjetër, në këtë rast ‘regjimin’ duke shpresuar se provokojë një ndihmë të madhe ushtarake prej sponsorëve të vet të huaj. Ky

kontribut për keqësimin e dhunës krejtësisht arsyeton insistimin e gjerë për respekt ndaj parimit të jointervencionizmit.

Shënime :

Bass, Gary J. (2008) *Freedom's Battle: the origins of humanitarian intervention*, Vintage Books, New York

Bloxham, Donald (2003) 'The Armenian Genocide of 1915-1916: cumulative radicalization and the development of a destruction policy', *Past and Present*, No 181, November, 189

Brown, Chris (2013) 'The Anti-Political theory of Responsibility to Protect', *Global Responsibility to Protect*, Vol 5, Issue 4, 423-442

Cartalucci, Tony (2012) 'Amnesty International is US State Department propaganda', *Global research*, 22 August, online:

<http://www.globalresearch.ca/amnesty-international-is-us-state-department-propaganda/32444>

CFR (2000) *Humanitarian Intervention: crafting a workable doctrine*, A Council Policy Initiative, Council on Foreign Relations, Washington

Chomsky, Noam (2008) 'Humanitarian Imperialism: The New Doctrine of Imperialism Right', *Monthly Review*, Vol 60, No 4, September, online: <http://monthlyreview.org/2008/09/01/humanitarian-imperialism-the-new-doctrine-of-imperialism-right/>

Cooper, Robert (2002) 'The new liberal imperialism', *The Guardian*, 7 April, online: <http://www.theguardian.com/world/2002/apr/07/1>

Cronogue, Graham (2012) 'Responsibility to Protect: Syria, the Law, Politics and Future of Humanitarian Intervention Post-Libya', *Journal of International Humanitarian Legal Studies*, Volume 3 issue 1, 124-159

Dreier, John (1963) 'The Organization of American States and United States Policy', *International Organization* 17, no. 1, 40-41

Dunne, Tim and Katherine Gelber (2014) 'Arguing Matters: The responsibility to protect and the Case of Libya', *Global Responsibility to Protect*, 6, 326-349

Ferguson, (2004) *Colossus: The Rise and Fall of the American Empire*, Penguin, London

Frieze, Donna-Lee (Ed) (2013) *Totally Unofficial: the autobiography of Raphael Llemkin*, Yale University Press, New Haven

ICRtoP (2014) *International Coalition for the Responsibility to Protect*, World Federalist Movement, New York, online:

<http://www.responsibilitytoprotect.org/>

- Ignatieff, Michael (2005) *American Exceptionalism and Human Rights*, Princeton University Press, New Jersey
- Ikenberry, G. John (2012) *Liberal Leviathan: The Origins, Crisis, and Transformation of the American World Order*, Princeton University Press, New Jersey
- Keohane, Robert O. (Ed) (1986) *Neorealism and Its Critics*, Colombia University, New York
- Köchler, Hans (Ed) (1982) *Principles of Non-alignment: The Non-aligned Countries in the Eighties – Results and Perspectives*, Third World Centre, London
- Kramer, Ronald C. and Raymond J. Michalowski (2005) 'War, Agression and State Crime: A Criminological Analysis of the Invasion and Occupation of Iraq', *British Journal of Criminology*, July, 45:4, 446-469
- Kuperman, Alan J. (2015) 'Obama's Libya Debacle', *Foreign Affairs*, March-April, online:
<https://www.foreignaffairs.com/articles/libya/2015-02-16/obamas-libya-debacle>
- Lage, Carlos (2006) 'Discurso del Vicepresidente del Consejo de Estado de la República de Cuba Carlos Lage Dávila, en la Inauguración de la Reunión de Cancilleres del Movimiento de Países No Alineados, Granma, 18 September, online:
<http://www.granma.cu/granmad/secciones/noal-14/noti-noal/n060.html>
- Lemkin, Raphael (1944) *Axis Rule in Occupied Europe*, Carnegie Endowment for International Peace, Division of International law, Washington
- Loiselle, Marie-Eve (2013) 'The Normative Status of the Responsibility to Protect After Libya', *Global Responsibility to Protect*, Vol 5, Issue 3, 317-341
- Luck, Edward C. (2009) 'Sovereignty, Choice, and the Responsibility to Protect', *Global Responsibility to Protect* 1, pp. 10-21
- McKinney, Cynthia (2012) *The Illegal war on Libya*, Clarity Press, Atlanta GA
- Mendiluz, Waldo (2014) 'Debate sobre Siria en ONU, el tema humanitario como Caballo de Troya', *Avanzada*, 16 February, online:
<http://avanzada.reduc.edu.cu/index.php/especial-siria/7088-debate-sobre-siria-en-onu-el-tema-humanitario-como-como-caballo-de-troya>

Mill, John Stuart (1874) 'On the Treatment of Barbarous Nations', in *Dissertations and Discussions: Political, Philosophical, and Historical*, Vol 3, Longmans, Green, Reader and Dyer, London

Nazemroaya, Mahdi Daerius (2012) 'The Big Lie and Libya', in Cynthia McKinney (2012) *The Illegal war on Libya*, Clarity Press, Atlanta GA, 127-139

RT (2011) 'Russia accuses NATO of going beyond UN resolution on Llibya', April 17, online: <http://rt.com/news/russia-nato-un-resolution-libya/>

Steele, Brent J, and Eric A. Heinze (2014) 'Norms of Intervention, R2P and Libya', *Global Responsibility to Protect*, Vol 6, 88-112

Teil, Julian (2011) 'Lies behind the "Humanitarian War" in Libya: There is no evidence! (Part 1), NATO Crimes In Libya', YouTube, Interview with Soliman Bouchuiguir, October 15, online: <https://www.youtube.com/watch?v=j4evwAMlh4Y>

Truth Syria (2012) 'The Gaddafi Mercenaries and the Division of Africa', Youtube, Interview with Genevieve Garrigos (Amnesty International France), 4 February, online: <https://www.youtube.com/watch?v=1WFknaEKdOM>

UN (2005) 2005 World Summit Outcome, 60/1, 24 October, online: <http://www.un.org/womenwatch/ods/A-RES-60-1-E.pdf>

UNSC (2006) Resolution 1674, online: <http://www.securitycouncilreport.org/atf/cf%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/Civilians%20sres1674.pdf>

Wright, Ann and Coleen Rowley (2012) 'Amnesty's Shilling for US Wars', Consortium News, June 18, online: <https://consortiumnews.com/2012/06/18/amnestys-shilling-for-us-wars/>

11. Shëndetësia dhe sanksionet



Sistemi shëndetësor i Sirisë është shkatërruar nga lufta dhe është dobësuar nga sanksionet ekonomike perëndimore, ndërsa kriza për këtë është polemizuar si edhe te të gjitha aspektet tjera të konfliktit. Në dhjetor të vitit 2013, ministri sirian i shëndetësisë në atë kohë, Dr. Sead Najif, në bisedë me delegacioni austrian të solidaritetit që qëndroi për vizitë në Siri, anëtarë i të cilit isha edhe unë, deklaroi se terroristët që i përkrahin fuqitë e jashtme, kohë më parë shpërthyen dy kamionë-bombë në oborrin e spitalit El-Kindi në Halep, duke shkatërruar totalisht spitalin në të cilin gjendeshin komplet personeli i cili në ato momente e gjendëm në spital.

Na e tregoi video-incizimin e FSA-së (Brigadës Faruk) e cila kreu sulmin ndaj spitalit nacional në Hums në 6 prill të vitit 2012 dhe tjetri i cili e dëmtoi spitalin nacional El-Selamijje në qytetin Hams, pas sulmit i cili u krye në 21 janar të vitit 2013 dhe videoja

e tretë ku shihet spitali i dëmtuar -Ez-Zahrawi në Damask, pas një sulmi tjetër terrorist që u krye në 5 maj të vitit 2013. Delegacioni afroi edhe detaje të sulmit prej 26 nëntor të vitit 2013 në spitalin Deir Ateya në pjesët rurale të rrethinës së Damaskut, ku humbën jetën 11 anëtarë të personelit të spitalit(dy anesteziologë, tre mjekë të përhershëm, katër infermiere dhe dy vozitës).

Dr. en-Najif na tha se prej fillimit të krizës, në mars të vitit 2011, prej gjithsej 94 spitale shtetërore 67 prej tyre janë sulmuar dhe kanë pësuar dëme. Prej tyre 41 spitale janë jashtë përdorimit, 174 punëtorë janë vrarë, 127 janë të lënduar, dhe 33 janë të kidnapuar. Krahës kësaj, në vitin 1921 po ashtu janë dëmtuar shtëpitë kryesore të shëndetit, ndërsa 678 qendra të ngjashme janë jashtë përdorimit. Janë humbur ose janë jofunksionale 421 makina të spitalit, 197 makina ndihmëse janë dëmtuar, ndërsa 169 janë krejtësisht jashtë përdorimit (en-Najif 2013). Ky nivel i destruksionit tregon atë se grupet e armatosura që i financon perëndim, kanë vendosur ta shkatërrojnë komplet një shtet funksional, pa bërë llogari të marrjes përkrahje nga populli i atij shteti.

Megjithatë, po t'i lexojmë raportet të gazetave që i lansojnë ata që i përkrahin grupet e armatosura në Siri, do të mendonim se si qeveria siriane gjatë krejt kohës në mënyrë sistematike e shkatërroi sistemin e vet shëndetësor. Më pak se dy javë pas takimit tonë me ministrin e shëndetësisë, gazeta Times publikoi një tregim mbi krizën e shëndetësisë në Siri, duke u munduar të tërheq vëmendjen mbi të ashtuquajturin sulm të aviacionit sirian në spitali Darush-shifa në Halep (Aleppo). Ko misioni i KB për Sirinë e publikoi këtë raport në tetor të vitit 2013, duke i fajësuar të dyja palët në konflikt për sulmin ndaj spitaleve, dhe veçanërisht duke akuzuar qeverinë për 'injoinimin diskriminues të të drejtave ' për shërbime mjekësore si mjete të komandantëve të luftës' (OHCHR 2013). Komisioni me këtë nënkupton sulmet ndaj klinikave paraushtarake dhe qendrave shëndetësore të cilat janë nën kontrollin e grupeve të armatosura. Forcat e armatosura të Sirisë, natyrisht se i kanë sulmuar disa spitale, siç është spitali SKT në el-Huda në Halepin Lindor OHCHR 2013), pas të cilit

sulm ky institucion ra në duart dhe nën okupimin e grupeve të armatosura. Nuk ka dyshim se qeveria siriane nuk pranon t'u lejojë grupeve terroriste të menaxhojnë me spitalet në Siri, por ekziston një dyshim serioz në pohimin se kjo paraqet shkelje të të drejtave humanitare. Qeveria e Sirisë këtyre akuzave u përgjigjet se pjesëtarët e plagosur të grupeve të armatosura mund të marrin trajtim mjekësor nëpër spitalet që i menaxhon qeveria. Kjo nuk paraqet injorim të dhënies së ndihmave mjekësore. Megjithatë, Komisioni i KB-së flet për grupet 'opozitare' e jo për grupet jo legjitime të armatosura ashtu që krijojnë një konfuzion. E drejta humanitare ndërkombëtare ka disa 'zbrazëtira' në këtë fushë, por vlen të përmendet se ligji amerikan vepron në mënyrë më rigorozë se ajo që praktikon qeveria siriane, sepse pengon dhënien e ndihmës mjekësore organizatave terroriste (Lewis, Modirzadeh dhe Blum 2015). Vështirë është ta paramendosh cilin do shtet i cili do t'u lejonte grupeve të armatosura antiqeveritare të marrin kontrollin dhe të menaxhojnë me spitalet publike.

Ndonjëherë duke se spitalet bëhen qendra të vetë luftës. KB lajmëroi se pjesëtarët e brigadës Faruk 'kanë sulmuar një spital nacional Xhuratush-shshejjah (Home)... (dhe) pas disa ditëve të bërit rezistencë nga forcat qeveritare, Brigada al-Faruk e mori kontrollin mbi këtë spital. Në këtë hap të ndërmarrë kjo brigadë aspak nuk mbajti llogari për t'u shmangur viktimave civile ose, bile, ti mbrojë të sëmurët dhe të plagosurit gjatë kohës të atij sulmi. Kësaj iu kundërvunë forcat qeveritare duke u përgjigjur me sulme ajrore, që gati e shkatërruan atë spital në 17 prill' (OHCHR 2013: 4). Për më tepër, shumë më e shpeshtë është praktika nga ajo që nuk është rasti, agjencitë e KB-së raportojnë për disa raste në bazë të burimeve që ua ofrojnë qendrat e afërta me politikën përëndimore kështu që fjala është për burimet antisiriane.

Ka raste kur grupet e armatosura incizojnë shkatërrimet e spitaleve që i kanë bërë vetë, pastaj ankohen se nëpër spitale u ofrohet trajtim shëndetësor luftëtarëve të ushtrisë siriane ose nën pretekstin se ato kanë rënë në duart e ushtrisë siriane. Patëm rastin të dëgjojmë se si pjesëtarët e Brigadës el-Faruk (FSA) këndonin

tekbire 'All-llahu është më i Madh' (All-llahu ekber - sh. p.) në momentin kur e hodhën në ajër një spital publik në Kajsar, gjatë vitit 2012 (OxTRX007 2012). Thanë se si : 'el-Faruk ka demoluar spitalin publik, i cila më parë i shërbente popullit ndërsa tani shfrytëzohet vetëm për shërimin e forcave të Asadit' (Telegraph 2012). Kah mesi i vitit 2013, edhe një grup tjetër në përbërje të FSA-së, pa paralajmëruar, sulmoi spitalin nacional në Daraa. Një islamist deklaroi se grupi i tij besonte se në spital gjenden afër 50 pacientë, por se ata të gjithë ishin lojalë të qeverisë siriane' (OHCHR 2013 :4).

Mbi sulmin në spitalin el Kindi (Halep) është raportuar në mënyra të ndryshme. BBC e publikoi si titull 'Kryengritësit sirianë e kanë kthyer në mënyrë strategjike spitalin e rëndësishëm në Halep'. Në pjesën hyrëse të lajmeve u tha 'operacioni masiv vetëvrasës i kamion-bombave' arriti 'të marrë në mënyrë strategjike spitalin e rëndësishëm edhe pse të rrënuar që e okupuan lojalët e Asadit' (BBC 2013). Hedhja në ajër e komplet një ndërtese është një formë e çuditshme që mund të karakterizohet si rimarrje e një spitali. Spitali el-Kindi konsiderohet si 'ndërtesë e papërdorshme' dhe ' sipas një raporti të pa verifikuar, në atë sulm kanë humbur jetën 35 kryengritës' (BBC 2013). Këtë storie duhet interpretuar. Ata 'kryengritës' shumica e tyre ishin terroristë dhe shtetas të huaj që i takonin Xhebbhetun-Nusra-së, degës së Al-Kaidës në Siri dhe aleatëve të tyre në FSA. ' Personeli i një spitali të madh që e ruante ushtria siriane kanë qenë lojalët e Asadit. Dr. Malik Ali, ministri siriani i arsimit të lartë tregoi se spitali el-Kindi ka qenë spital i universitetit' (Anderson 2013).

Grupi i mjekëve për të drejta njerëzore i akuzoi forcat qeveritare për '90 % prej gjithsej 150 sulmeve ndaj spitaleve' (PHR 2014), por meqë ndërmjet atyre 90 % ishte edhe spitali el-Kindi, komplet kredibiliteti i kësaj organizate është shumë i keq. Ekziston një numër i madh i video-materialeve në internet që mund të shërbejnë si dëshmi se islamistë shkatërrojnë spitalin el-Kindi. Konsiderohet se afër 400 luftëtarëve antiqeveritarë u vranë në luftë për kontrollin e këtij spitali, por islamistët në fund përsëri e minuan që më pastaj

të akuzojnë rrejtshëm Qeverinë, duke deklaruar: ‘Regjimi është përgjegjës për shkatërrimin e spitalit sepse e ka shndërruar në bazë ushtarake’ (Dayoub 2013).

Konflikti po ashtu ka pasur ndikim të madh në prodhimin lokal të barnave dhe pajisjeve mjekësore, Para fillimit të krizës Siria ka qenë 90% e pavarur në aspekt të pajisjeve farmaceutike, dhe atë kryesisht në sektorin privat ku punonin 30.000 punëtorë. Siria gjithashtu ka qenë një ndër importuesit e rëndësishëm të barërave. Megjithatë kapaciteti i saj prodhues në vitin 2013 u zvogëlua në mënyrë drastike. Tre të katërtat u mbyllën, vetëm në Halep u mbyllën 20 prej tyre, për shkak të dëmtimit ose frikës nga bombardimet, për shkak të sulmeve artilerike, ‘vjedhjes dhe plaçkitjes’... nga ana e bandave të armatosura’ (Hamada 2013).

Mbi të gjitha, sanksionet ekonomike dhe tregtare të cilat i venduan SHBA dhe BE e shkatërruan, në përgjithësi, sistemin shëndetësor të Sirisë, veçanërisht shëndetësinë publike. SHBA-të imponuan sanksione më të ashpra kundër Sirisë (OFAC 2013). Sanksionet më të reja hyrën në fuqi në vitin 2004, kur administrata e kryetarit Xhorxh W. Bush-it vendosi Sirinë ta akuzojë se ‘dëmton përpjekjet amerikane dhe ndërkombëtare për stabilizimin e Irakut’. Pas saj, në vitin 2011 administrata e Obamës solli rregullin administrativ ‘si përgjigje e dhunës së vazhdueshme dhe shkeljes së të drejtave njerëzore në Siri’. Dekreti i sjellë në gusht të vitit 2011 ua ndalon shtetasve të SHBA-së (kjo përfshinë edhe kompanitë me dhjetë përqindje ose më shumë të aksioneve amerikane) të bëjnë ‘investime të reja’, të bëjnë ‘çfarëdo shërbimi Sirisë’, importimin e prodhimeve petrokimike dhe çfarëdo lloji të ‘transaksionit’ ose çfarëdo lidhje financiare me Sirinë. Pas këtij ndalimi të gjerë, Vashingtoni lejoi duke bërë disa përjashtime dhe ‘licenca gjenerike’ (OFAC 2013). Ky provizion si duket është dizajnuar si bazë juridike për futjen e ndihmave grupeve të armatosura në Siri, ‘kryengritësve sektarë.

Shprehja e sanksioneve amerikane ka pasoja më të rënda pas sanksioneve të cilat BE-ja i ka venduar Sirisë, të cilat në mënyrë të detajuar janë ruajtur në një dokument të gjerë (BE 2015) i cili

dokument po ashtu vë masa të BE-së ndaj më se 20 shteteve tjera. Sanksionet e BE-së në qasjen e vet përgjithësisht janë më selektive, sepse ato përmbajnë listën e prodhimeve dhe shërbimeve që janë të ndaluara. BE-ja imponon ndalimin e tregtisë me armë, pajisjet telekomunikative, naftës dhe gazit, valutën siriane, arin, diamantin dhe metaleve tjera të çmuara, gjithashtu ndalon transaksionet financiare, kreditë, shërbimet e sigurimeve, hyrjes nëpër aeroporte për ‘disa fluturime’ dhe ngrirjen e pasurisë për ‘disa persona, kompani dhe organe (BE 2015). Sanksionet BE-së të kushtëzuara me vet faktin që shumë shtete të saj anëtare kanë masat e veta të cilat dallojnë nga ato të BE-së. Megjithatë duket sikur ekzistojnë disa ‘zbrazëtira’ që mundësojnë dërgimin e ndonjë lloji ‘ndihme’. Sanksionet e Australisë janë të përafërta me ato të BE-së, sepse në mënyrë të kujdesshme përmendin mallin e sanksionuar e cila është e ndaluar.

Ndikimi i sanksioneve në sistemin shëndetësor të Sirisë është shpjeguar në hollësi në një punim akademik që është publikuar në vitin 2012, i cili këtë çështje e shpjegon në kontekst të disa arriturave të rëndësishme, të cilat janë realizuar para krizës. Siria arritur një sukses impresionues në shëndetësinë publike prej vitit 1970 deri te fillimi i krizës, që është shumë interesante marrë parasysh shkallën shumë të ulët të të ardhurave personale. Në periudhën midis 1970 dhe 2010 mortaliteti i foshnjave u zvogëlua prej 132 në 14, numri i nënave prej 482 në 45 (Sen, el-Fejsal dhe es-Salih) 2012: 2). Megjithatë, sanksionet ekonomike e kanë ulur në mënyrë drastike vlerën e funtës siriane që shkaktoi rritje të madhe të çmimeve të artikujve kryesor ushqimorë dhe lëndës djegëse. Sundimi i sipërpërmendur tregon tri forma në të cilat sanksionet kanë pasur ndikim katastrofal në sistemin shëndetësor sirian. E para, çmimet e shumë prodhimeve bazike ushqimore dhe konsumuese (si qumështi, gazi, orizi dhe domatet) u trefishuan gjatë vitit të parë të sanksioneve, me që të ardhurat u pakësuan, shumë qytetarë s’mund të arrinin deri te këto prodhime ushqimore. Deficiti ushqimor keq u reflektua, veçanërisht, të nënat dhe të fëmijët sapolindur. E dyta. çmimet e barërave për sëmundjet jo

ngjitëse shumë u shtrenjtuan. Sanksionet bllokuan ‘importimin e prodhimeve esenciale mjekësore, duke përfshirë edhe barërat për trajtimin e sëmundjeve kancerogjene, të diabetit dhe të sëmundjes së zemrës’. Shumë refugjatë u detyruan ta braktisin vendin për të siguruar trajtim mjekësor. E treta, ndërprerjet e furnizimit me energji elektrike gati në të gjitha pjesët e Sirisë (që shpesh i shkaktoi sulmet e grupeve të armatosura në trafostacionet dhe linjat përçuese) aq më tepër i shkaktojnë rrezik popullatës së pambrojtur’ veçanërisht gjatë periudhës së ftohtë të dimrit ose gjatë kohës së nxehtë të verës, kur nxehja dhe flladitja janë më se të nevojshme (Sen, el Fejsaldhe es-Salih 2012: 3-4).

Pavarësisht nga këto provokime të mëdha, shërbimet shëndetësore në Siri edhe më tej kryesisht janë falas, çka mundëson dhjetëra miliona konsultime vjetore falas. Organizata shëndetësore ndërkombëtare - WHO bashkëpunon me qeverinë e Sirisë, me Gjysmëhënën e Kuqe arabe të Sirisë me të cilën menaxhon shteti dhe guvernatorët e provincave, për t’i ndihmuar sado kudo ta mbajë aktiv shërbimin shëndetësor. Për shembull kah fundi i tetorit të vitit 2015, guvernatori i krahinës Daraa, Muhammed Halid el- Hannus, u takua me përfaqësuesen e WHO-së, Elizabet Hof, me qëllim të planifikimit për mbështetjen e programeve shëndetësore në këtë provincë të shkatërruar nga lufta (SANA 2015a). Kuba, partneri ndërkombëtar që disponon me kapacitete të forta në rrafshin e shëndetësisë dhe shkencës së medicinës, i ndihmon Sirisë ta rregulloj sistemin e saj shëndetësor, pastaj sektorin farmaceutik dhe biologjik. Ministri sirian i shëndetësisë më 2014 ia dorëzoi Kubës listën e prodhimeve të patjetërsueshme pas së cilës ky shtet i karai-beve dërgoi pajisje si aparate për dializë dhe një numër të madhe të barërave (Ismail 2014). Disa shtet që Sirisë i venduan sanksione lejojnë me hipokrizi t’i ofrojnë Sirisë njëfarë ndihme, që kryesisht përfundon në viset e Sirisë të cilat i kontrollojnë kryengritësit islamikë. Duhet përkujtuar që dëmi më i madh i cili iu shkaktua popullit të Irakut gjatë viteve të nëntëdhjeta, kur mortaliteti i fëmijëve u dyfishua përmes presionit

të sanksioneve që iu imponuan këtij shteti (Elwan 2014: 22). Këto masa të ashpra patjetër të hiqen sa më shpejtë që është e mundur.

Shënime:

Alwan, Ala'din (2004) 'Health in Iraq: the current situation, our vision for the future and areas of work', Ministry of Health, Baghdad, December, online: http://www.who.int/hac/crises/irq/background/Iraq_Health_in_Iraq_second_edition.pdf.

Anderson, Tim (2013) 'Syria's hospitals targeted by NATO-backed armed groups', Oriental Review, 26 December, online: <http://orientalreview.org/2013/12/26/syrias-hospitals-targeted-by-nato-backed-armed-groups/>

Baker, Aryn (2014) 'Syria's Health Crisis Spirals As Doctors Flee', Time, 4 February, online: <http://time.com/3968/syrias-health-crisis-spirals-as-doctors-flee/>

BBC (2013) 'Syria rebels take back strategic hospital in Aleppo', 21 December, online: <http://www.bbc.com/news/world-middle-east-25479725>

Dayoub, Bassel (2013) 'Suicide Bombing Leaves Historic Aleppo Hospital in Ruins', Al Akhbar, 24 December, online: <http://english.al-akhbar.com/node/18016>

DFAT (2015) 'Sanctions Regimes: Syria', Department of Foreign Affairs and Trade, online: <http://dfat.gov.au/international-relations/security/sanctions/sanctions-regimes/pages/syria.aspx>

EU (2015) 'Restrictive measures (sanctions) in force', European Union, updated to 30.09.2015, online: http://eeas.europa.eu/cfsp/sanctions/docs/measures_en.pdf

Hamada, Abdullah (2013) 'The Syrian Crisis: repercussions of the pharmaceutical industry', Syrian Economic Forum, online: <http://www.syrianef.org/En/the-syrian-crisis-repercussions-for-the-pharmaceutical-industry/>

Ismael, M. (2014) 'Syria, Cuba discuss health cooperation, Health Ministry receives 100 dialysis devices', SANA, 2 July, online: <http://sana.sy/en?p=5215>

Lewis, Dustin; Naz Modirzadeh, Gabriella Blum (2015) 'Medical Care in Armed Conflict: IHL and State Responses to Terrorism', Lawfare, 8 September, online: <http://www.lawfareblog.com/medical-care-armed-conflict-ihl-and-state-responses-terrorism>

Nayef al, Sa'ad (2013) Presentation to Australian Delegation in Solidarity with Syria, Damascus, 22 December (Dr al Nayef was, at that time, Syria's Minister for health)

OFAC (2015) 'Syria Sanctions Program', Office of Financial Assets Control, 2 August, online: <http://www.treasury.gov/resource-centre/sanctions/Programs/Documents/syria.txt>

OHCHR (2013) 'Assault on medical care in Syria', Office of the High Commissioner for Human Rights, 13 September, A/HRC/24/CRP.2, online: <http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/HRC/RegularSessions/Session24/Documents/A-HRC-24-CRP-2.doc>.

OxTRX007 (2012) 'NATO FSA Mercenaries Bomb the Al Watani Hospital in Qusayr, Homs/Syria', YouTube, 5 September, online: <http://www.youtube.com/watch?v=bL1xHEhzPKE>

PHR (2014) 'Anatomy of a Crisis: A Map of the Attacks on Health Care in Syria', Physicians for Human Rights, online map: http://s3.amazonaws.com/PHR_syria_map/web/index.html

SANA (2015a) 'Daraa Governor and WHO discuss means of enhancing cooperation to support health programs and services', Syrian Arab News Agency, 25 October, online: <http://sana.sy/en?p=59058>

SANA (2015b) 'China and Syria discuss means to enhance health cooperation', Syrian Arab News Agency, 30 November, online: <http://sana.sy/en?p=63051>

Sen, Kasturi, Waleed al Faisal and Yaser Al Saleh (2012) 'Syria: effects of conflict and sanctions on public health', Journal of Public Health, Jun; 35(2):195-9, online: <http://www.ncbi.nlm.nih.gov/pubmed/23179240>

Telegraph (2012) 'Syrian rebels claim to have blown up hospital in Homs', 4 September, online:

<http://www.telegraph.co.uk/news/worldnews/middleeast/syria/9521312/Syrian-rebels-claim-to-have-blown-up-hospital-in-Homs.html>

12. Vashingtoni, Terrorizmi dhe ISIL: Provat-dëshmitë



‘Përherë është vështirë të luhet loja e dyfishtë: në njërën anë t’u shpallësh luftë terroristëve dhe pastaj, në të njëjtën kohë, ndonjërin prej këtyre terroristëve ta shfrytëzosh si figurë në pllakën e shahut të Lindjes së afërme për të arritur interesat individuale... a janë ata të ashtuquajtur banditë të përmbajtur që ua presin njerëzve kokat ‘në mënyrë të përmbajtur?’

- Vladimir Putin (2015)

.....

Raporti mbi atë se si aeroplanët transportues amerikanë dhe britanikë i mbajnë armë ISIL-it, prej të cilëve disa i shkatërruan forcat irakiane (Iraqi News 2015) e kanë tronditur publikun perëndimor dhe në ato vende janë pritur me mosbesim të cilin e përcillte një injorim i vazhdueshëm. Në Linden e afërme vetëm një numër i vogël i qytetarëve nuk beson se Vashingtoni luan ‘lojën e dyfishtë’ me armatat e veta të afërta në Siri. Lideri jemenas, Ensarull-llah, deklaroi se ‘Aty ku ka ndërhyrje amerikane, patjetër aty janë Al-Kaida dhe ISIL-i. Ata veprojnë në interes të Amerikës’ (el- Bukaiti 2015). Krahës kësaj, disa mite kryesore edhe më tej mbeten të rëndësishme, kur është fjala për publikun perëndimor. Të zënë në kurth me ato mite kërkon shfrytëzim të mendjes dhe ofrim të dëshmimeve të mira, vetëm të përsëriturit e pohimeve nuk është e mjaftueshme.

Elitat e forta janë shumë të vetëdijshme për këtë proces dhe me tërë fuqinë që kanë bëjnë t'i kooptojnë fuqitë kritike në suaza të shoqërive të veta, duke kolonizuar vlerat dhe gjuhën progresive, duke trivializuar rolin e popullit. Për shembull, invazionet në Afganistan në vitin 2001 të kuptuarit e idesë me atë se forcat e NATO-s i ruajnë gratë musliman është promovuar në mënyrë aktive, madje edhe u bë e pranueshme. Përkundër kundërvënies së fortë ndaj invazionit në fjalë dhe okupacionit të Afganistanit, ky invazion 'humanitar' iu duk jashtëzakonisht atraktiv vetëdijes misionare të kulturës perëndimore, të cilën do të mund ta quanim si 'kompleks i shpëtimtarit'. Gjatë vitit 2012 Amnesty International promovoi një poster në të cilin shkruante: 'NATO mundëson përparimin', duke patur për qëllim me këtë të drejtat e gruas në Afganistan (Wright dhe Rowley 2012) ndërsa Instituti i Xhorxh W. Bushit mbledhi para për qëllim të promovimit të të drejtave të gruas në Afganistan (Bush Center 2013). Bilansi zhgënjyes i okupimit shumëvjeçar të NATO-s Afganistanin aspak nuk inkurajon. Raporti i UNDP -së për vitin 2013 tregoi se vetëm 5.8 % e grave të Afganistanit kanë arsimim të mesëm, në vendin e shtatë nga fundi i ranglistës në botë; ndërsa gruaja mesatare në Afganistan ka lindur gjashtë fëmijë, që është e barabartë me vendin e tretë më të lartë në botë, e që kjo ka të bëjë me shkallën e ulët të arsimimit (UNDP 2013). Ushtritë pushtuese nuk i çojnë fëmijët në shkollë. 'Lufta feministe' në Afganistan fitoi inspirimin e vet në mënyra të ndryshme nga trashëgimia koloniale britanike nga India. Si pjesë përbërëse e misionit të tij të madh civilizues ashtu si konfirmoi perandoria se dëshiron t'i mbrojë gratë e Indisë nga fenomeni {sati}, për shkak të të cilit gratë e veja indiane hidheshin në greminë nga maja e shkëmbit (ose ishin hedhur) si

pjesë banketit i varrimit të burrave të tyre. Në realitet, pushteti kolonial gati aspak nuk e ka ndryshuar këtë praktikë të izoluar (Banerjee 2014c). Përkundrazi, forcimi i vajzës dhe gruas nën pushtetin kolonial britanik mund të vlerësohet si një tallje tragjike. Në kohën e pavarësisë popullata e rritur që ka ditur shkrim lexim ka qenë vetëm 12 përqindje, ndërsa te femrat niveli ka qenë më i ulët. Edhe pse India në shumë sfera ecën trokthi, progresi në sferën e arsimimit është realizuar shumë më shpejt pas arritjes së pavarësisë në vitin 1947.

Këto fakte nuk i kanë penguar historianët siç është Niall Ferguson dhe Lawrence James t'i ikin sanitizimit historisë koloniale britanike e mos të flasim për përpjekjet e arsytimit të intervenimeve më të reja. Sot është vështirë ta arsyetosh kolonializmin, por përsëri është shumë më lehtë kur është fjala për popujt që kanë të kaluar koloniale që dëshirojnë të çlirohen nga përgjegjësia brenda historisë dhe kulturës së vet.

Gjuha verioamerikane është pak ndryshe nga ajo britanike, sepse Shtetet e Bashkuara të Amerikës pohojnë se kurrë nuk kanë qenë fuqi koloniale. Ai mit i tyre në mbi fanarin e lirisë, 'kandilit në kodër' është i rëndësishëm për krijimin e imazhit të tyre (Gamble 2012). Mirëpo fakti që Deklaratën e lirisë dhe barazisë e kanë shkruar njerëzit që kanë qenë skllavopronar dhe ata që kanë kryer pastrim etnik (Deklarata amerikane mbi pavarësinë kritikon zëshëm britanikët për vënien e kufizimit kur është në pyetje uzurpimi i vendeve autoktone me popullatë amerikane) nuk e ka mjegulluar entuziazmin për arritje e idealeve të lirisë. Ajo shkathtësi trashëgimie sot ka ndikim të madh në formulimin verbal të intervencionizmit të sotëm amerikan.

Pas invazionit në Afganistan dhe Irak vërejmë një dallim në qasje, në kuptim që sot fuqitë e mëdha i angazhojnë sektarët fanatikë që janë lojalë të tyre kundër shteteve sovraane dhe të pavarura në Rajonin e Lindjes së afërme. Madje edhe shteti i ri irakian, që doli nga gërmadhat e invazionit të vitit 2003 u bë shënjestër e sulmeve e sektarëve fanatikë të Vashingtonit. Ajo 'pranverë arabe' solli deri te zhdukja e Libisë nga ana e pseudo revolucionit islamik, mbi krahët e bombave të Vashingtonit, që më pastaj u la në duart

e grupeve të armiqësuar të Al-Kaidës dhe të kolaboracionistëve tjerë perëndimorë. Ky vend me një numër të vogël banorësh e cila dikur mund të lavdëroheshe për standardin e saj të lartë afrikan, u kthye në të kaluarën për disa dekada.

Pastaj i erdhi radha Sirisë guximtare, e cila i është kundërvënë agresionit, dhe kështu që për këtë paguan çmim të lartë; lufta propaganduese kundër saj është më e ndyta deri më sot. Një numër shumë i vogël i perëndimorëve janë të aftë ta kuptojnë këtë propagandë. Madje edhe një pjesë e madhe e majtistëve në Perëndim u bë peng i atyre iluzioneve në të njëjtën mënyrë siç është rasti me politikën e të djathtës. Fenomeni i cili në fillim u mundua të prezantohet si ‘revolucion’ nacionalist dhe shekullar - si revoltë dhe kryengritje kundër diktatorit i cili vret popullin e vet, më vonë, siç u munduan të paraqiten, udhëhoqën ‘kryengritësit e përmbajtur’ ose ‘islamistët e përmbajtur’, ndërkaq islamistët ekstremistë, të cilët vazhdimit mburren me krimet e veta duke i publikuar në rrjete sociale, portretohen si një lloj i veçantë, kundër të cilëve kanë vendosur të luftojnë Vashingtoni dhe aleatët e tij. Natyrisht, shumica e atyre konfirmimeve për një arab gjysmë të arsimuar ose për një latinoamerikan, duken krejtësisht qesharake por kur është në pyetje opinioni perëndimor, atij ende i duken të pranueshme.

Njëra prej arsyeve se pse është ashtu është fakti se nocioni komb dhe shtet në Perëndim është ndryshe. E majta perëndimore gjithnjë shtetin e ka kuptuar si monolit ndërsa nacionalizmin si një lloj fashizmi; ndërsa në kolonitë e më hershme perëndimore të gjitha shpresat i kishin në krijimin e shtetit nacional. Popujt perëndimorë kurrë nuk kanë patur Ho Chi Minh, Xhemal Abdun-naser, Nelson Mandel, Salvador Alende, Hugo Çavez apo Fidel Kastro. Njëra nga pasojat e këtij realiteti, pa marrë parasysh atë se mendimtarë perëndimor janë të gatshëm ta kritikojnë vendin e vet, ata nuk kanë treguar gatishmëri të merren me popujt tjerë. Edhe pse dikush e kritikon politikën e Vashingtonit ose të Izraelit, ata kurrë nuk do ta mbronin Kubën ose Sirinë.

Një situatë e tillë i kontribon marketingut më të lehtë të luftërave të jo drejtpërdrejta të motivuara me zell misionarësh dhe me

qëllime, të cilët si të atillë bëhen perceptues për opinionin perëndimor. Madje mund të themi se luftërat ashtu të prezantuara gjithnjë e më tepër bëhen taktikë e suksesshme e intervenimeve të reja imperiale, prej armatës së kundërt në Nigargua deri te ajo e afërta në Siri. Për derisa nuk del krejt në shesh se fuqitë e mëdha drejtpërdrejt marrin pjesë në ato luftëra, për opinionin perëndimor ideja për dhënien e ndihmës popujve tjerë për vënien në lëvizje të revolucionit dhe arritjes së ‘lirisë’ edhe më tej do të jetë atraktive. Noam Chomsky, autor i shumë librave mbi imperializmin amerikan dhe propagandën perëndimore, edhe vet i ka akceptuar pjesën më të madhe të apologjetikës perëndimore që i referohet intervencionizmit. Në rastin e Libisë ai deklaroi që intervenimi, bile edhe pa lejen KB-së, mund të arsyetohet, sepse ‘aksioni i pengimit për një masakër të mundshme në Bengazi, megjithatë, nuk është çështje që duhet lënë pas dore, pa marrë parasysh se çka mendon dikush për motivet e saj (Chomsky 2011). Pas katastrofës së Libisë, në intervistën që ia dha një gazetës opozitare siriane në vitin 2013. Chomsky tha se kryengritja islamike në Siri, pas së cilës qëndron faktori i jashtëm, paraqet një lloj ‘lëvizje protestante’ ngulfatur e cila ka qenë e detyruar të militarizohet. Ai erdhi deri te përfundimi se Amerikës dhe Izraelit nuk i shkon në interes ta përmbysin qeverinë e Sirisë. Duke pranuar se edhe vet ka qenë i ‘tronditur’ me kryengritjen e Sirisë, ai e hodhi poshtë doktrinën mbi ‘përgjegjësinë e mbrojtjes - responsibility protect’, duke thënë se është kundër intervenimit të drejtpërdrejt pa mandatin e Kombeve të bashkuara. Megjithatë, ai iu bashkëngjiti forcave të cilat duan ta ‘detyrojnë’ qeverinë siriane të largohet nga pushteti, duke se me asgjë nuk mund të arsyetohet roli i Hizbullahut në Siri (Chomsky 2013). Kjo deklaratë e tij doli pasi qw lëvizja libaneze në fjalë u kyç në luftën e Sirisë për të penguar hovin e ‘xhihadistëve’ të cilat i mbështet NATO. Si ka mundësi që edhe që edhe antiimperialistët perëndimorë të mendojnë si Shtëpia e Bardhë? Arsyet janë këto. E para, bëhet fjalë për idenë ultra majtiste ose anarkiste të cilës i takon Chomsky, e që natyrisht nënkupton kundërvënien të çdo forme të fuqisë shtetërore. Kjo, natyrisht, sipas radhitjes logjike, çon deri te kritika ndaj fuqisë

imperiale, por kjo, njëherit mbrojtësit e vet i bën indiferent ose i radhit në opozitën automatike edhe ndaj atyre shteteve që dëshirojnë ta ruajnë pavarësinë e vet. Shumë majtist perëndimor bile shprehin entuziazëm të madh kur bëhet fjalë mbi idenë për rrëzimin e një shteti të pavarur, edhe pse e dinë se alternativa e atij shteti, si në rastin e Libisë, është masakra masive, përçarja e hidhur dhe destruktiviteti i institucioneve të rëndësishme nacionale.

E dyta, mbështetja në burimet mediatike perëndimore ka bërë që shumë veta të besojnë se masakrën mbi popullatën civile në Siri e ka kryer qeveria siriane. Natyrisht se kjo aspak s'është e vërtetë. Leximi me kujdes i dëshmimeve- provave që janë në dispozicion do të vërtetojnë se shumicën e krimeve të publikuara mbi civilët në Siri (Houl, Daray, Akrah, East Ghout) i kanë kryer grupet sektare islamiste, të cilat shpeshherë i vishni qeverisë siriane.. Madje edhe atëherë kur dëshmitë objektive ishin krejtësisht të padyshimtë, siç ishte sulmi kimik në rastin e Gautës Lindore, (p.sh. ISTEAMS 2013; Lloyd dhe Postol 2014; Hersh 2013) versioni perëndimor i ngjarjeve aspak nuk ndryshoi. Pas pohimeve që i referoheshin sulmit me armë kimike pasuan akuzat lidhur me atë se si mund të jetë bombardimi i grupeve terroriste që i përmban perëndimi, në të vërtetë shfrytëzimi i 'fuçi-bombave- barel bombave, kundër popullatës civile. Bëhet fjalë për një praktikë shumë vjeçare të grupeve sektare kur shtiren se gjoja humbjet e tyre janë viktimat civile. Këto tregime nuk kanë fund. Kryetari sirian Bashar el - Asad solli një përfundim të arsyeshëm se: 'të gjitha luftërat janë të këqija... (por) por ne nuk mund të ndalemi e mos të luftojmë kundër terroristëve që i vrasin civilët nga frika që mos të na akuzojë Perëndimi se si përdorim forcën' (Asad 2015). Elementi i tretë i cili i shtrembëron perceptcionet perëndimore antiimperiale, duket se është kufizimi dhe referenca e natyrës së diskutimit. Prametrat e këtij diskutimi janë nën mbikëqyrjen e rojtarëve të korporatave (gatekeepers), por ai gjithashtu është nën ndikimin e iluzioneve perëndimore mbi influencën e tyre civilizuese. Një numër i konsiderueshëm i gazetarëve perëndimorë i kanë publikuar dhe përafërsisht i kanë detajuar gjërat, për të sqaruar disa aspekt

të konfliktit sirian, por perspektiva e tyre gati gjithnjë ka qenë e kushtëzuar me narrativet ‘liberale’ dhe ‘humanitare’ perëndimore. Gjithsesi, mbrojtja më agresive e ‘intervenimit humanitar’ gjatë këtyre viteve të kaluara vijnë nga radhët e mediave liberale si; Gardiani britanik, BBC dhe NVO si Avaazi, Amnesty International dhe Human Rights Watch. Një numër i vogël gazetarësh që u përpoqën ta ruajnë perspektivën e pavarur, siç ishte Sharmine Narwani që është arabe-amerikane, tekstet e veta i publikon jashtë shtëpive mediatike perëndimore më të njohura.

Kultura imperiale po ashtu kushtëzon industrinë e humanitarizmit. Presioni ideologjik nuk vjen vetëm prej bankave të zhvilluara por edhe prej sektorit joqeveritar i cili karakterizon ndjenjën e fortë të misionit, ai ‘kompleks shpëtimtarësh’ në lidhje me marrëdhëniet me pjesën tjetër të botës. Edhe pse fenomeni i ‘bashkëpunimit zhvillimor’ më herët ndoshta ka mbajtur idenë mbi një lloj kompensimi për durimin e pushtetit kolonial, ose asistencën në periudhën e tranzicionit kah pavarësia, sot ajo është bërë edhe një industri e re e cila llogaritet të ketë 100 mijë dollarë në vjet, për të cilën sillen vendimet kryesisht në suaza të instituteve financiare dhe agjencive të perëndimit. Pavarësisht nga mosfunksionimi i praktik i shumë programeve të ndihmave humanitare, kjo industri në esencën e vet është shumë jo demokrate dhe e ngjyrosur me përzjerje koloniale. Programet e ndihmave asnjëherë nuk janë formuar me qëllim të jenë përgjegjës para bashkësive lokale dhe popujve. Përkundër kësaj, shumë humanitarë perëndimorë besojnë se me të vërtetë mund ‘t’ shpëtojnë’ popujt e varfër të botës. Ai vetëbesim kulturor është shumë i thellë. Agjencitë humanitare jo vetëm që dëshirojnë ta përcaktojnë ekonominë politike, ato madje përpiqen të intervenojnë në proceset politike dhe kushtetuese të shteteve të cilave duan t’u ndihmojnë. Këtë e bëjnë në emër të parimeve të proklamuar të ‘menaxhimit të mirë’, masave anti-korrupsionit ose të ‘forcimit të demokracisë’. Pa marrë parasysh problemin e bashkësive lokale, rrallë herë mund të pranohet se humanitarët e jashtëm në realitet janë shumë më pak demokratë se të gjithë të tjerët.

Për shembull, në fund të shekullit të kalua, kur Timor Lreste e fituan pavarësinë e vet, agjencitë të cilat administrojnë implementimin e ndihmave të jashtme përdorën forcën e tyre financiare për të penguar zhvillimin e institucioneve në lëmin e bujqësisë të sigurimit ushqimor, duke shtyrë këtë shtet të vogël e të shkriftë kah krijimi i partive konkurruese politike në drejtim të kundërt nga krijimi i qeverisë së bashkimit nacional. Duke u përpjekur të paraqitet si lider në suaza të ‘bashkësisë të vendeve donatore’, Australi ka dhënë një kontribut të ashpër për përçarje dhe shkaktoi krizë në vitin 2006 (Anderson 2006). Gjatë mospajtimve kontinuitive rreth kufijve detare dhe resurseve të naftës dhe gazit, shkencëtarët dhe këshilltarët australian në mënyrë të shpejt u munduan ta shfrytëzojnë rastin e dobësisë për të bërë presion forcën udhëheqëse të atij vendi duke kërkuar prej saj të ‘reformohet’, që ushtrinë e vetë ta marginalizojë ose ta heq, pastaj shteti ta miratojë anglishten si gjuhë nacionale. Edhe pse krahas të gjitha këtyre presioneve, rezistenca e qytetarëve të Timorit Lindor nuk u ndal, në atë moment situata u duk sikur shumë ‘miq’ të Australisë Timorin Lindor e imagjinuan se e kanë ‘trashëguar’ nga sundimtarët e tij të më hershëm kolonialë. Në realitet shpeshherë kështu duket ajo ndjenjë e çuditshme perëndimore.

Kulturat imperiale kanë krijuar shumë pretekste mashtruese potenciale, të cilat shpeshherë tingëllojnë mirë, si të ëmbla për intervenim në kolonitë e tyre të hershme dhe shteteve të posashpallura të pavarura. Në mes atyre preteksteve për mbrojtjen e të drejtave të gruas, kujdesit për menaxhim etik, ndihmë për promovim të ‘revolucioneve’. Niveli i të folurit të dyfishtë poshtu është i mrekullueshëm. Përkundër kësaj, Intervencionizmi u krijon shumë probleme të gjithëve. Popujt e pavarur patjetër t’i mësojnë format e reja të rezistencë. Ata që kanë vullnet dhe qëllim të mirë në suaza të kulturës imperiale mbase do të ishte mirë të mendojnë për mënyrën se si ta dekolonizojmë defekt mental perëndimor. Një proces si ky goxha është i lehtë në nivelin e etikës, dhe këtë e inspirojnë parimet themelore të barazisë midis njerëzve, respekt të ndërsjellë dhe miqësi. Në rrafshin politik dhe intelektual, sugjeroj se këtë proces duhet përfshirë refleksionin (a)

mbi kuptimin e ndryshëm historik, (b) rëndësinë, funksionet
partikulare të shteteve poskoloniale, (c) kontinuitetin e relevancës
dhe kuptimin e parimit për vetëvendosje, (d) domosdoshmërinë e
shmangies së nevojës për mediat mashtruese dhe të kooptuara dhe
(e) kapje në kurth me sfidat dhe kundërvënien e iluzioneve
mashtruese mbi rolin e ashtuquajtur civilizues të ndikimit
perëndimor. Të gjitha aspektet e përmendura, duket se janë pjesë
përbërëse e defektit mental neokolonial. Ato në rrënjë janë verbim
i pazakonshëm perëndimor që prodhon dëm të gjeneruar me
intervencionizmin perëndimor.

Shënime:

Anderson, Tim (2006) 'Timor Leste: the Second Australian Intervention', Journal of Australian Political Economy, No 58, December, pp.62-93

Assad, Bashar al (2015) "Britain and France were the Spearheads in Supporting the Terrorists in Syria" President al- Assad', Internation Clearing House, 6 December, online:

<http://www.informationclearinghouse.info/article43628.htm>

Banerjee, Jacqueline (c2014) 'Cultural Imperialism or Rescue? The British and Sutte', The Victorian Weh, online:

<http://www.victorianweb.org/history/empire/india/suttee.html>

Bush Center (2015) 'Afghan Women's Project', George W, Bush Center, online: <http://www.bushcenter.org/womens-initiative/afghan-womens-project>

Chomsky, Noam (2011) 'On Libya and the Unfolding Crises', ZNet, 30 March, online: Chomsky.info/20110330

Chomsky, Noam (2013) 'Noam Chomsky: The Arab World And The Supernatural Power of the United States', Information Clearing House, 16 June, online:

<http://www.informationclearinghouse.info/article35527.htm>

Gamble, Richard M. (2012) In Search of the City on a Hill: The Making and Unmaking of an American Myth, Bloomsbury Academic, London

ISTEAMS (2013) 'Independet Investigation of Syria Chemical Attack Videos and Child Abductions', 15 September,

http://www.globalresearch.ca/STUDY_THE_VIDEOS_THAT_SPEAKES_ABOUT_CHEMICALS_BETA_VERSION.pdf

Hersh, Seymour (2013) 'Whose Sarin?' LRB, 19 December, online:
<http://www.lrb.co.uk/v35/n24/seymour-m-hersh/whose-sarin>
 Lloyd, Richard and Theodore A. Postol (2014) 'Possible Implications of Faulty US Technical Intelligence in the Danasuc Nerve Agent Attack of August 21, 2013', Mit, January 14, Washington DC, online:
<https://www.documentcloud.org/documents/1006045-possible-implications-of-bad-intelligence.html#storylink=relat>
 UNDP (2013) Human Development Report 2013, United Nations Development Programme, New York, online:
<http://hdr.undp.org/en/2013-report>
 Wright, Ann and Coleen Rowley (2012) 'Am Wright and Coleen Rowley', Consortium News, June 18,
 online:<https://consortiumnews.com/2012/06/18/amnestys-shilling-for-us-wars/>

14. Kah Lindje e afërme e pavarur



‘S’ka zyrtar të huaj që do të mund të përcaktojë ardhmërinë e Sirisë, sistemin e saj politik ose individët që do të menaxhon atë. Për këtë do të vendosë vetë populli i Sirisë.

.....

Planit të Vashingtonit për Lindje e afërme të re në Siri i ka hasur sharra në gozhdë. Përkund gjakderdhjes shumëvjeçare dhe presioneve të rrepta ekonomike Siria gjithnjë e më tepër përparon drejt fitores ushtarake dhe strategjike që do ta transformojë Lindjen e afërme. Ekzistojnë prova të qarta që tregojnë se planet e

Vashingtonit dështuan, qoftë ato lidhur me ‘ndërrimin e regjimit’, ose shkatërrimin total të Sirisë që ky shtet të bëhet jofunksional, ndërsa pastaj të copëtohet mbi parimet sektare. Në vend të kësaj vërejmë edhe më shumë boshte të forcës së rezistencës që këndellen, në mesin e të cilave është Irani, Siria, Palestina dhe Hizbull-llahu në përkrahje të Rusisë dhe Irakut.

Fitorja e Sirisë do të bazohet në përkrahjen e fortë dhe koherente popullore armatës e cila me ndihmën e aleatëve të saj të besueshëm, me tërë forcën u është kundërvënë sulmeve famëkeqe të sektarëve dhe forcave internacionale të fragmentuara të cilat e sulmojnë. Rreshtimi rajonal po ashtu ka efekt të rëndësishëm. Në fazën e hershme të konfliktit, Egjipti, i cili atëherë ishte nën pushtetin e Qeverisë së Vëllezërve muslimanë, që nuk zgjati shumë në pushtet, u hoq një armik. Edhe më e rëndësishme se kjo ishte nënshkrimi i marrëveshjes nukleare në mes SHBA-së dhe Iranit, të cilën e kundërshtoi shumë Arabia saudite dhe Izraeli, duke e ditur mirë se kjo do t’ia forcojë pozitën aleatit të rëndësishëm rajonal të Sirisë, Iranin. Nisma ruse të e cila kah fund ii shtatorit të vitit 2015, e cila dha një mbështetje ajrore në koordinim me ushtrinë arabe të Sirisë, jo që vetëm në aspekt ushtarak ishte e suksesshme, ajo gjithashtu ia hapi derën Irakut që edhe ky vend t’i bashkëngjitet si anëtarë i barabartë i Boshtit të vendeve të rezistencës. Vendimi i Rusisë, Iranit, Irakut dhe Sirisë për të instaluar qendër të përbashkët të inteligjencës për luftën kundër terrorizmit me seli në Bagdad, po ashtu nuk është aspak i rastësishëm. Kali i ngadalshëm por sigurtë i Irakut prej pozitës shtetërore të klientit amerikan, nën ombrellën e aleancës së forcave rezistuese ndaj hegjemonisë amerikane, është një tregues se kanë ndodhur shumë ndryshime.

Para fillimit të iniciativës ruse në Siri, dhe pas më se katër vite nga fillimi i luftës, gjendja ekonomike në Siri dukshëm u keqësua; por erdhi deri te konsolidimi i rrethanave të sigurisë. Natyrisht se ekzistojnë disa vise dhe enklava të okupuara, si pjesa verilindore e Halept, Rakka në lindje Xhobar dhe Douma në pjesë juglindore të Damaskut. Të gjitha këto vise me vite të tëra janë nën okupimin e

disa mijërave grupe të armatosura sektare. Megjithatë, në viset tjera grupet e armatosura nuk kanë realizuar ndonjë rezultat afatgjatë, meqë ofensivat e tyre pësuan humbje. Miliona njerëz janë arratisur nëpër viset ku gjenden qytet e mëdha perëndimore. Guvernatori i Latakije-s në korrik të vitit 2015 më tha se popullata e provincës së tij u rrit prej një milion e gjysmë në tre milionë banorë. Qyteti Swida pranoi 130.000 familje nga qyteti Daraa kështu që numri popullatës së tij arriti dyfishin. Situata e njëjtë është edhe në Tartus. Numri i banorëve të Damaskut është rritur bile deri në 8.5 milionë. Dislokimi i banorëve brenda Damaskut poashtu është i madh. Për shembull, pas sulmeve të pandërprera të An-Nusra-së dhe ISIL-it, shumica e banorëve të vendbanimit Palestinës të dërmuar në Jermuk e kishte patjetër të largohet në pjesët tjera të Damaskut siç ishte Jaramanae. Një numër shumë i vogël i banorëve të dislokuar jeton nëpër tenda, një pjesë e madhe e tyre janë të vendosur nëpër shkolla dhe nëpër institucione tjera, nëpër shtëpi familjare, nëpër apartamente me qira ose të ndonjë lloji tjetër të vendosjes.

‘Harta e luftës’ që mbahet në hapësirën kibernetike, këtë natyrisht se nuk e tregon. Kur palët kundërshtarë kur flasin për madhësi ‘territoresh’ të cilat i kontrollojnë ky apo ai grup, ata natyrisht se nuk tregojnë për atë se qeveria siriane mban kontroll mbi një numër të madh terrioresh ku jeton numri më i madh i popullatës, dhe për atë se shumica e banorëve dislokuar kërkon siguri pikërisht në ato vise të Sirisë të cilat i kontrollojnë qeveria e Sirisë. Gjatë vitit 2015 u keqësua situata sa i përket ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike, po pa marrë parasysh këtë, shkollat, qendrat medinale, sallat sportive edhe më tej janë funksionale. Edhe pse vështirë është të thuhet se jeta këtu zhvillohet normalisht me plotë kuptim të fjalës, jeta e përditshme vazhdon, Njerëzit disi mbijetojnë dhe rezistenca e tyre kundër agresorit vazhdon. Kjo rrallë here mund të shihet në raportet që dominojnë në mediat perëndimore, të cilët vazhdimisht përhapin të pavërteta në lidhje me karakterin e konfliktit sirian. Mediat perëndimore në veçanti janë të shkathët për shtrembërimin e të

vërtetës mbi atë se grupet ekstremiste në Siri i përmbajnë forcat e aleancës së NATO-s, njëherit festojnë me tollombaz përparimin e grupeve të tilla, me ç'rast duke injoruar plotësisht veprimin kundër ofensivë të armatës siriane.

Verifikimi i faktit të parë: Aspak nuk ekzistojnë 'kryengritës të përmbajtur'. Ashtu siç është përpjekur ky studim të dëshmojë lëvizjen reformiste të vërtetë politike e ka shuar kryengritja e armatosur me përkrahjen e Arabisë suadite, gjatë marsit dhe prillit. Kryengritja e armatosur që nga vetë fillimi ka qenë islamike dhe sektare. Disa vite më vonë, qytetarët e rëndomë të Sirisë të gjitha këto grupe sektare i quajnë 'Daesh' (ISIL), 'terroristë' ose 'mercenarë', duke mos u bazuar në emrat e tyre të ndryshëm. Përveç agjencive që e kishin patjetër të komunikojnë me këto grupe, për shembull, për lirim të personave të kidnapuar, u venin veshin emrave të tyre të ndryshëm për arsye praktike. Deklaratat me përmbajte të gjenocidit të cilat i publikojnë komandantët e 'kryengritësve të përmbajtur' më së miri i ilustron dallimet minore në mes të 'të përmbajturve' të gjenocidit dhe ekstremistëve të gjenocidit. Komandanti i ushtrisë së lirë siriane -FSA Lamia Nahas deklaroi: 'Pakicat siriane sado që bëhen më shumë arrogante aq më tepër bëhem i sigurt se do të duhej një holokaust për t'i hequr totalisht nga fytyra. Andaj lutem që të lëshojë (Zoti) mëshirën e vet mbi Hitlerin që i dogji hebrenjtë të kohës së vet dhe Sulltan Abdulhamitin që i ka zhdukur ermenët' (The angryArab 2015). Në të njëjtën mënyrë Abdull-llah el Aliu miqve të vet përmes rrjeteve sociale u tha se 'zhdukja e fshatrave Nusajrije (Alevite) është më me rëndësi prej lirit të kryeqendrës Damask' (Fadel 2015). Instinkti i gjenocidit të këtyre të 'përmbajturve' aspak nuk dallon nga ai të cilin e shfaqin pjesëtarët e an-Nusra-së ose të ISIL -it. Karakteri i vërtetë i konfliktit të armatosur gjithnjë ka qenë dallimi në mes të atij autoritar ose pluralist dhe në kuptimin social inkluziv i shtetit, dhe sektarizmit islamik sikur ai të cilin e praktikon Arabia saudite të cilët bëjnë kërdi nëpër Siri duke vepruar si proxy armatë në shërbim të fuqive perëndimore.

Verifikimi i faktit të dytë: Gati çdo krim për të cilin akuzohet armata siriane e kanë bërë islamistët që i përmban Perëndimi, si pjesë e strategjisë marrë sa më shumë ndihmë ushtarake nga jashtë. Konfirmimet e islamistëve vazhdimisht i përsëritin mediat perëndimore. Nuk ka dyshim se ushtria siriane ka kryer ekzekutimin e terroristëve të zënë rob dhe se policia e fshehtë edhe më tej i burgosën dhe me siguri i mundon personat që dyshon për kolabacion me terroristët, Përkundër kësaj, armata gëzon përkrahjen e madhe të popullit. Populli sirian e njëj armikun e vet andaj i ofron ndihmë armatës së vet. Nga ana tjetër, bandat e armatosura haptas mburren për krimet e veta.

Për çdo vështirues inteligjent, servimi i të pavërtetave për Sirinë, diskrediton një fakt i thjeshtë, që gjithë këto vite sa zgjatë lufta në Siri, armata siriane asnjëherë nuk ka hedhur bomba kuturu, as ka rrafshuar me tokën ndonjë vend ose vendbanim siç janë Xhobar, Douma, Rakka dhe Halepi veri-lindor. Andaj lirisht mund të themi se ku herën tjetër agjencitë perëndimore të gazetës, bazuar në burime islamiste, raportojnë për atë se si prej sulmeve ajrore siriane dhe ruse humbin jetë ‘civilë’ do të bëhet fjalë mbi sulmin pikërisht mbi ato burime islamiste që u gjetën nën goditjen e tyre. Ekzistojnë dy skenarë ‘end game’ të ndryshme për rezultatin e konfliktit në Siri që qarkullojnë në opinion. Vashingtoni dhe shërbëtorët e tij servile janë të ngujuar dhe pa kompromis për t’i realizuar qëllimet e tyre planifikuara që nënkuptojnë izolimin e kryetarit Asad nga cilido pushtet sirian të ardhshëm. Nëse kurrëgjë tjetër, ky qëndrim i tyre të paktën dëshmon për pavarësinë e vërtetë të atij njeriu. Megjithatë, arroganca perëndimore vepron nën supozimin se Sirinë ia ka nënshtuar dëshirës së vet. Kjo kërkesë e tyre e kot, bukur mirë ilustron se Vashingtoni tregon pak respekt ndaj parimeve të të drejtës ndërkombëtare. Zëdhënseja e Ministrisë së punëve të jashtme të Federatës ruse, Maria Zakharova deklaroi se SHBA-të mbase do të duhej tërhequr nga marrëveshja e Gjenevës që është arritur në vitin 2012, pasi ajo marrëveshje nuk kërkon largimin e Asadit nga vendi i kryetarit të Sirisë. Përkundrazi, ajo marrëveshje përmban klauzolën e cila në

mënyrë të qartë thotë se ‘Populli i Sirisë do të vendos për të ardhmen e vendit të vet’ (TASS 2015; KB 2012). Ky është një qëndrim i thjeshtë por fundamental të cilin aspak nuk do ta pranojë Vashingtoni. Kryetari rus, Putini, përndryshe në komunikim e sipër me ‘partnerët’ e tij perëndimorë është diplomat në mënyrë të veçantë, por megjithatë në një rast u shprehë ‘Hiqni dorë më dëshira të pangopura për të dominuar. Mjaftë u sollët në atë mënyrë vetëm se si t’i plotësoni ambiciet tuaja imperialiste. Mjaft helmuat ndërgjegjen e miliona njerëzve - sikur nuk ekziston mënyrë tjetër përpos politikës imperialiste’ (Putin 2015). Gjer sa jeni duke folur me gjuhën e demokracisë dhe të drejtave njerëzore, SHBA edhe më tej shtiret të përcaktoj ardhmërinë e vendeve tjera.

Plani ‘B’ amerikan për Sirinë gjatë kohë është dobësimi i saj e më në fund ndarja e saj. Ai plan në një mënyrë të veçantë precizon një dokument të cilin e publikoi Brookings Institute në qershor të vitit 2015 (O’Hanlon 2015). Ai dokument në mënyrë arrogante dhe pa fije turpi sugjeron se si Vashingtoni është dashur, më mirë ta copëtojë ‘problemin e Sirisë’ në ‘disa komponentë më të vogla lokale.. me të duke dhënë vizion për një lloj Sirie të konfederalizuar e cila do të ndahej në disa njësi të ndryshme autonome territoriale se sa ta mbash atë nën sundimin e një qeverie të forte të centralizuar’ (O’Hanlon 2015: 3). Preteksti i rrejshëm për këtë plan është gjoja se është kërcënimi ndaj Amerikës nga ISIL-i. Megjithatë, ky institucion, siç ka demonstruar gjer më tani kz studim, në realitet është krijim amerikan dhe i aleatëve të tij të afërt. Dokumenti i Institutit Brookings apelon se si në fillim duhet ndarë Sirinë në dy zona autonome ose ‘zona sigurie’ nu kufij me Jordaninë dhe Turqinë, në mënyrë që të vihen ‘lidhje të siguruara transporti për dorëzimin e ndihmave humanitare por edhe ushtarake’. Kolaboratorët potencialë në këtë komplot joligjor, siç ishte propozuar, mund ta kyçin: Xhejshul-islam-in (ushtrinë islame) në afërsi të Damaskut, ‘forcat e ndryshme kurde’, ‘koalicionin e kryengritësve lufta e të cilit është e fokusuar në Halep’, ‘Xhejshul-fet’h -in (ushtrinë çlirimtare e

udhëhequr nga Xhebbhetun-Nusra) e vendosur rreth qytetit Edlib, edhe disa fraksione tjera. (O'Hanlon 2015: 9,15). Praktikisht të gjithë partneret e numëruar amerikanë, përveç kurdëve, në të vërtetë janë disa lloje Al-Kaide me emra të tjerë ose janë në lidhje me këtë organizatë. Propozimi Broking-ut merr në konsideratë forcën e Damaskut, duke u shtirë se do të veprojë për ta anashkaluar. Megjithatë shkatërrimi i një shteti Sovran do të mundeshe vetëm në rast të humbjes ushtarake totale të qeverisë siriane dhe në atë rast kur më ajo nuk do të kishte aleatë të fortë.

Megjithatë, Siria ende nuk është e gjunjëzuar dhe ka aleatë të forte. Përveç kësaj rigrupimi regional shkon në favor të Sirisë. Edhe pse ende ka shumë 'mburravecë pretendues', shumica e observatorëve pajtohet që Vashingtoni e ka humbur vullnetin për eskalim të më tejme të luftës, e të mos flasim për konfrontim me Rusinë.. Disa vende rajonale këtë gjë më e kanë vërejtur dhe gradualisht kanë filluar të vënë raporte me Damaskun. Egjipti dhe Emiratet e Bashkuara Arabe (EBA), të dy shtetet në lidhjen antagoniste ndaj Sirisë, vetëm pak më herët, filluan t'i normalizojnë marrëdhëniet diplomatike me Sirinë. EBA- e, me siguri njëra prej monarkitë 'më fleksibile' arabe të Gjirit, por gjithashtu, sipas civateve të nënkryetarit amerikan, Biden, e lidhura me ISIL-in, është e preokupuar me gajlet e veta. Kohëve të fundit pushtetet e këtyre vendeve burgosën disa dhjetëra islamistë në lidhje me, gjoja, komplotin i cili u dasht që monarki absolute ta shndërrojë halifat absolut (Bloomberg 2015). Për sa i përket Egjiptit, ky vend që përsëri është në duart e ushtrisë, pas një pushteti afat shkurtë të Vëllezërve muslimanë, u ballafaqua me terroristët e vet sektarë, nga radhët e vetë Vëllazërisë. Shumica e vendeve arabe sot mbrojnë integritetin territorial të Sirisë qoftë ajo edhe në mënyrë verbale, mbështetin përpjekjet siriane në luftë kundër terrorizmit. Analiste egjiptian, Hasan Ebu Talib 'gjykon dhe hedh poshtë aksionin unilateral ushtarak të Turqisë kundër Sirisë (Reuters 2015).

Qeveria e Erdoganit, e cila u përpoq të imponohet si kreu i Vëllezërve muslimanë në rajon, gjithnjë e më tepër ndahet nga

partnered antisirianë dhe ballafaqohet me problem e brendshme, të cilët më shumë i përkasin pakicës së saj kurde. Vashingtoni u përpoq t'i përdor kurdët separatist në mënyrë të barabartë kundër Bagdadit dhe Damaskut, kurse Turqia kurdët i konsideron armiq të vet kryesor, ndërsa grupet ekstremiste kryejnë mbi ata masakër nën parullën e braktisjes (së fesë - sh.p.) duke shpallur 'renegatë'. Për sa i përket pozitës kurde gjatë historisë, bashkësitë e tyre kanë gëzuar autonomi shumë më të gjerë në Iran dhe Siri. Marrëveshja e fundit e Vashingtonit me Iranin mund të vlerësohet si një zhvillim i rëndësishëm i ngjarjeve, pas tensioneve që vazhdojnë që 14 vjet, meqë Irani vlen si aleati më i rëndësishëm rajonal i Sirisë shekullare dhe si oponent i rreptë i sektarizmit të llojit saudian. Konfirmimi i rolit serioz të Iranit në rajon e lënduar forte Arabinë saudite dhe Izraelin, por kjo është shumë mirë për Sirinë. Pas nënshkrimit të marrëveshjes historike me Iranin erdhi deri te garat serioze diplomatike në rajon për forcimin e pozitave, dhe me të drejtë mund të thuhet se s'ka dyshim se me këtë marrëveshje Irani është forcuar mirë për sa u përket çështjeve rajonale. Një dekadë pas planeve të Vashingtoni 'destruksioneve kreative që janë dizajnuar me qëllim dobësimi të influencës së Iranit, dhe vetëm disa muaj para fillimit të iniciativës ushtarake ruse në Siri, të brendshmit në Vashington shprehën pakënaqësinë dhe dëshpërimin e vet, duke vlerësuar se sot influence e Iranit ka arritur pikën kulmore gjatë katër dekadave të kaluara.

Vendimi i Rusisë që u soll kah fundi i shtatorit të vitit 2015 për të përdorur fuqinë serioze ajrore që t'i ndihmojë ushtrisë siriane u tregua si hap vendimtar. Rusia, e ftuar në mënyrë legale të marrë pjesë në Siri, vazhdimisht i apelonte Amerikës për bashkëpunim në Siri, zbuloi se vërtet amerikanët bëjnë dredhi. Vashingtoni është kapur në vepër, i zënë në kurth të fjalëve të tij plotë hipokrizi. SHBA-ja shtiret se nuk është pronari i ISIL-it duke iu shmangur sulmeve ndaj këtij grupi terrorist kur qytetet e Sirisë që ishin nën kontrollin e ISIL-it ranë njëri pas tjetrit, duke u shtirë se ekziston një dallim fundamental ndërmjet ISIL-it dhe 'kryengritësve të përmbajtur'. Për dallim nga amerikanët, Rusia u

pajtua me Sirinë se të gjitha grupet e armatosura antiqeveritare, në realitet janë të njëjtët terroristë sektarë. Amerikanët gjatë tërë kohës nuk pranojnë t'i vënë emër ndonjërit prej grupeve të 'kryengritësve të përmbajtur' të vet, pas së cilës filloi Rusia, duke u bazuar në këshillën e qeverisë siriane, t'i sulmojë të gjitha. SHBA-ja e ballafaquar me këtë situatë filloi të protestojë kundër këtij qëndrimi të Rusisë duke thënë se Rusia i sulmon edhe 'të përmbajturit', ose bile, se rusët me qëllim 'i vrasin civilët', por këtë amerikanët ishin të paaftë ta ndalin. As Vashingtoni madje asnjëri prej aleatëve të tij s'kanë guxim për konfrontim të drejtpërdrejt me fronti që e përbëjnë Siria. Irani, Rusia, Iraku dhe Hizbull-llahu. Forcat tokësore ruse ose ato zyrtare iraniane nuk kanë marrë pjesë në konflikt. Megjithatë, komandantët ushtarakë iranianë e kishin mobilizuar milicinë nga rajoni në mënyrë që ta forcojnë ushtrinë siriane, duke insistuar t'i kthejnë viset të cilat më herët ranë nën kontrollin e bandave të armatosura të cilave u ndihmon Perëndimi.

Disa besojnë se iniciative ruse në Siri do të përfundojë me pa sukses si Intervnimi i Bashkimit Sovjetik në Afganistan në periudhën 1979 - 1989. Megjithatë ka dallime të mëdha në këto dy raste. I pari, ushtria arabe e Sirisë dhe populli sirian që më se katër vite me sukses i bëjnë rezistencë luftës të jo të drejtpërdrejt më të ashpër në historinë e re njerëzore. Qeveria e Afganistani kah fundi i vitit 1970, me njëherë në fillim të luftës i thirri në ndihmë tanket dhe trupat sovjetike. I dyti, Siria ka shumë aleatë të fortë rajonal, Iranin dhe Hizbull-llahun, pak kohë më parë edhe Irakun. Qeveria e Afganistanit në vitin 1979 ishte e rrethuar me armiq. I treti, përkrahja ruse me sulme ajrore. Edhe pse shumë e rëndësishme, luftën tokësore ia lë armatës siriane, të cilës i ofrojnë ndihmë milicia siriane e vendit dhe ajo nga rajoni. Larg asaj që Vlladimir Putini nuk ka menduar për atë se iniciative ruse në aspekt historik do të krahasohet me rolin e Bashkimit Sovjetik në Afganistan. Megjithatë rezistenca e guximshme që e bënte populli sirian ka luajtur një rol vendimtar. Po të mos kishte qëndruar kaq gjatë populli sirian duke bërë rezistencë, ose sikur

kryetari Asad të kishte ikur nga vendi, ashtu siç veproi kryetari i Ukrainës, Janakoviç, Siria nuk do të merrte ndihmë të drejtpërdrejt nga Federata ruse. Ajo fiton sepse populli sirian i ka qëndruar pas armatës së vet në luftën kundër provokimeve sektare, kryesisht duke zhvilluar betejat e veta kundër JNATO-s dhe terrorizmit multinacional të cilin e mbështetin monarkitë arabe të Gjirit. Populli sirian, përfshirë edhe shumicën e muslimanëve të devotshëm sunit, u kundërvunë njerëzve të këqij e brutal që ua presin kokat njerëzve e që i promovojnë monarkitë e Gjirit. Këtu nuk bëhet fjalë për konflikt sektar as që është në pyetje lufta shiite dhe sunite. Lufta kundër Sirisë është një luftë klasike imperiale ku shfrytëzohen armata mercenare. Kur të përfundojë lufta në Siri nuk do të ketë vend për rolin e Vashingtonit prej arsyeve të njëjta që përdhunuesit dhe vrasësit kurrë nuk thirren në familjet që kanë vuajtur prej krimeve të tyre se si ata të mund të mblidhen përsëri.

Implikimet regjionale, vërtetë, mund të jenë të thella. Fitorja e Sirisë do të shënonte fundin e politikës gjakpirëse dhe makute të Vashingtonit për 'ndërrimin e regjimit' në mbarë rajonin, prej Afganistanit gjer në Irak, Libie Siri. Nga vdekja dhe mundimet e kësaj lufte të pandershme dhe të ndytë, lindet një bosht edhe më i fortë i rezistencë së hegjemonizmit 'Axis of Resistance'. Siria mbijetoi, Irani u bë më i fortë e më i fuqishëm, Iraku i bashkëngjitet boshtit të rezistencë, ndërsa Rusia vendosmërisht, në mënyrë të kundër-tezës, i ka mbështetur. Ky kombinim do ta mbyll fatin dhe në margjinat e historisë do t'i çojë planet që janë bërë për 'Lindje e afërme të re' ku do të dominonte aleanca amerikano-izraelite-turko-saudiane. Uniteti rajonal dhe pavarësia lindin duke paguar tatim të madh gjaku, Por, këto realizohen.

Shënime:

Angry Arab, The (2015) 'This is what the candidate for Syria's provisional (opposition) government wrote on Facebook: a holocaust', 4 Agust, online: <http://angryarab.blogspot.fr/2015/08/this-is-what-candidate-for-syrias.html>

Assad al, Bashar (2015) 'President al-Assad: New anti-terrorism coalition must succeed, otherwise the whole region will be destroyed', Interview with Iranian Khabar TV, Transcript at SANA, 4 October, online: <http://sana.sy/en/?p=56697>

Bloomberg (2015) 'U.A.E. to Prosecute 41 Accused of Trying of Establish Caliphate', 2 August, online: <http://www.bloomberg.com/news/articles/2015-08-02/u-a-e-to-prosecute-41-accused-of-trying-to-establish-caliphate>

Fadel, Leith (2015) 'U.S. Backed Syrian Opposition Official Calls for the Extermination of Alawites', Al Masdar, 7 December, online: <http://www.almasdarnews.com/article/u-s-backed-syrian-opposition-official-calls-for-the-extirmination-of-alawites/>

Karam, Zeina and Adaam Schreck (2015) 'Iran nuclear deal opens diplomatic channels for Syria', AP, 6 August, online: <http://news.yahoo.com/iran-nuclear-deal-opens-diplomatic-channels-syria-161740195.html>

Kenner, David (2015) 'For God and Country, and Iran, Foreign Policy, 5 March, online: <http://foreignpolicy.com/2015/03/05/for-god-and-iran/>

O'Hanlon, Michael (2015) 'Deconstructing Syria: towards a regionalized strategy for a confederal country', Center for 21st century Security and Intelligence, Brookings, 23 June, online: <http://www.brookings.edu/research/papers/2015/06/23-syria-strategy-ohanlon>

Putin, Vladimir (2015) 'Banned In USA Putin Explains Who Supports ISIS', Lybio, 2 October, online: <http://lybio.net/banned-in-usa-putin-explains-who-supports-isis/people/>

Reuters (2015) Egypt defends Syria's territorial unity after Turkey moves against IS', 2 July, online: <http://uk.reuters.com/article/2015/07/29/uk-mideeast-crisis-syria-egypt-idUKKCN0Q31AY20150729>

TASS (2015) 'Moscow: US should retract signature to Geneva communiqué if it wants Syria regime change', 23 September, online: <http://tass.ru/en/politics/823017>

UN (2012) 'Action Group for Syria, Final Communiqué, 30.06.2012', United Nations, 30 June, online:

<http://www.un.org/News/dh/infocus/Syria/FinalCommuniqueActionGroupforSyria.pdf>

15. Të mbetemi të informuar

Shumica e mediave perëndimore, përfshirë edhe mediat e monarkive të Gjirit (Al-Xhezire, Al Arabijje) janë shumë të njëanshëm dhe në shumë raste bile edhe, në mënyrë të barabartë, kanë marrë pjesë në fabrikimin e dëshmive-provave për ta penguar propagandën siriane të luftës. Kjo nxitë pyetjen: ko do të mund të gjenim informata kredibile dhe të besueshme? Kjo pyetje nuk ka përgjigje të thjeshtë, ndërsa lexuesi do të sjell përfundim se kam shfrytëzuar një numër të madhe të burimeve të informacioneve. Megjithatë, këtu do të sjell një list të shkurtër të burimeve on line relevante, të cilat relativisht janë të pavarura nga agjenda e fuqive të mëdha, e që janë të arritshme në gjuhën angleze dhe në gjuhët tjera. Këto vëzhguesin objektiv duhet ta bëjnë të jetë më mirë i informuar.

A. National Media, anti-imperial

SANA –Syrian Arab News Agency (<http://sana.sy/en/>)

Syrian TV (<http://www.syrianonline.sy>)

Press TV- Iranian network (<http://www.presstv.com>)

FNA (Fars News Agency) –Iran (<http://en.farsnews/>)

RT- Russian Television (<https://www.rt.com/news/>)

Telesur Latin America

(<http://www.telesurtv.net/english/section/news/index.html>)

B.Non- Government, independent

Middle East Channel- Syria (<http://www.me-channel.com>)

Al Akhbar- Lebanon (Englishservice closed in April 2015, but still a good archive) (<http://english.al-akhbar.com>)

Al Mayadeen- Lebanon (only in Arabic)

(<http://www.almayadeen.net/>)

As Safir- Lebanon (<http://assafir.com/Channel/50/English>)

Al Manar –Lebanon, Hezbollah

(<http://www.almanar.com.lb/english/main.php>)

Mint Press-USA (<http://www.mintpressnews.com/>)

Uprooted Palestinians- blog

(<https://uprootedpalestinians.wordpress.com/>)

Electronic Intifada-USA

(<https://uprootedpalestinians.wordpress.com/>)

Syrian Free Press-USA (<https://syrianfreepress.wordpress.com/>)

Vineyard of the Saker- USA (<http://thesaker.is/>)

South Front- Canada, UK, USA (<http://www.globalresearch.ca/>)

Al Masdar –USA (<http://www.almasdarnews.com/>)

New Eastern Outlook-Russia (<http://journal-neo.org/>)

Counter Punch –USA (<http://www.counterpunch.org/>)

The Greanville Post- USA (<http://www.greanvillepost.com/>)

SOTT-USA and France (<http://www.sott.net/>)

Hands off Syria- Australia

(<http://www.handsoffsyriasydney.com/>)

C. Critical media analysis

Media lens- UK- (<http://www.medialens.org/>)

Off Guardian- UK- (<http://pff-guardian.org/>)

FAIR-USA (<http://fair.org/>)

